FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 174

Tiranë – E enjte, 6 gusht 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 617, datë 30.7.2026	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2026–2030 dhe të planit të veprimit 2026-2030	17621

VENDIM
Nr. 617, datë 30.7.2026

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR KULTURËN 2026–2030 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2026-2030

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2026–2030 dhe të planit të veprimit 2026-2030, sipas teksteve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe të gjitha institucionet e përmendura në strategjinë dhe në planin e veprimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PËRMBAJTJA

Parathënie
Hyrje
Lista e shkurtimeve
1. Analiza e gjendjes historike dhe sfondit aktual
1.1 Trashëgimia Kulturore Materiale (TKM)
1.2 Vizitueshmëria dhe turizmi i trashëgimisë
1.3 Trashëgimia Kulturore Jomateriale (TKJ)
1.4 Institucionet e Artit dhe Kulturës
1.5 Skena e pavarur dhe projektet artistike
1.6 Edukimi përmes kulturës
1.7 Dukshmëria ndërkombëtare dhe diplomacia kulturore
1.8 Infrastruktura kulturore
2. Sfidat kryesore të sektorit kulturor
2.1 Prioritetet strategjike
3. Lidhja me kornizën ndërkombëtare dhe harmonizimi strategjik
4. Vizioni: Kultura si infrastruktura e së ardhmes
4.1 Aksesueshmëria dhe pjesëmarrja: kultura si një mjet për mirëqenie dhe kohezion social
4.2 Për një ekosistem krijues të hapur, inovativ dhe të ndërlidhur
4.3 Drejt një ekosistemi kulturor digjital kombëtar
4.4 Roli i sektorit të pavarur
4.5 Forcimi i kuadrit rregullator dhe reforma ligjore
4.6 Si të lexohet dokumenti
5. Politikat
5.1 Politikat për trashëgiminë
5.2 Korniza e politikave për rritjen e industrive krijuese
5.3 Politikat për infrastrukturën kulturore
5.4 Politikat për përfshirjen dhe aksesueshmërinë
5.5 Politikat ndërsektoriale
6. Objektivat e Strategjisë
6.1 Shtylla 1 - Kultura si nxitëse për cilësinë e jetës
6.2 Shtylla 2 - Kultura si mjet dialogu në nivel ndërkombëtar
6.3 Shtylla 3 - Mundësimi i ekosistemit kulturor
6.4 Përputhja e tre shtyllave strategjike me prioritetet kulturore kombëtare për vitet 2026–2030
6.5 Analiza e riskut: risqet institucionale, financiare, të kapaciteteve, politike dhe masat konkrete parandaluese
7. Strategjia në veprim
7.1 Treguesit e performancës për prioritetin "Ruajtja dhe mbrojtja e siteve të trashëgimisë kulturore"
7.2 Treguesit e performancës për prioritetin "Nxitja e rritjes së industrive krijuese"
7.3 Treguesit e performancës për prioritetin "Zhvillimi i infrastrukturës kulturore"
7.4 Treguesit e performancës për prioritetin "Promovimi i përfshirjes dhe aksesueshmërisë"
8. Financimi dhe operacionalizimi i strategjisë
8.1 Buxheti dhe arsyetimi financiar
8.2 Mekanizmat për qeverisje financiare dhe qëndrueshmëri
8.3 Buxheti i aktiviteteve
8.4 Dispozita buxhetore

8.5 Masat prioritare dhe mbrojtja e strategjisë nga krizat
Shtojcat
Shtojcë I – Terma dhe Përkufizime
Bibliografia

This publication has been realized with the financial contribution of the Italian Agency for Development Cooperation. The contents do not necessarily reflect AICS official opinion. Responsibility for information and views expressed therein lies entirely with Fondazione Santagata ETS.

Parathënie

Ky botim u realizua falë kontributit financiar të *Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS)* dhe me mbështetjen shkencore të *Fondazione Santagata per l'Economia della Cultura* ETS.

Hartimi i *Strategjisë Kombëtare për Kulturën në Shqipëri 2026–2030* u mbështet mbi një qasje të strukturuar, të bazuar në fakte dhe pjesëmarrje, me qëllim kalimin gjithëpërfshirës dhe të matshëm nga faza e analizës në atë të formulimit strategjik. Metodologjia ndërthuri një analizë të gjerë dokumentare, angazhimin e palëve të interesit, konsultimet me ekspertë mbështetës si dhe proceset e njëpasnjëshme të validimit. Faza analitike përfshiu rishikimin e dokumentacionit ekzistues, politikave, legjislacionit, të dhënave dhe studimeve, si dhe hartëzimin e aktorëve, analizën krahasuese, vlerësimin e nevojave, analizën e infrastrukturës dhe identifikimin e mangësive në katër aspekte prioritare: trashëgimia kulturore, industritë krijuese, infrastruktura kulturore, si dhe gjithëpërfshirja dhe aksesueshmëria.

Kjo fazë u pasurua nga një proces i gjerë pjesëmarrjeje, ku u përfshinë operatorë kulturorë nga sektori institucional dhe ai pavarur, autoritetet lokale dhe aktorë nga ekosistemet e kulturës dhe turizmit, duke përfshirë edhe përfaqësues nga diaspora aty ku ishte e përshtatshme. Aktivitetet e angazhimit përfshinë takime individuale, anketa, intervista dhe punëtori tematike, siç ishte organizimi i Forumit të hapur mbi "*Gjendjen e Përgjithshme të Kulturës në Shqipëri*" më 10 tetor 2025, me qëllim identifikimin e sfidave, mundësive dhe rrugëtimeve të zhvillimit në të ardhmen. Diskutimet tematike u projektuan për të evidentuar mundësitë, nevojat për resurse dhe modelet e referencës për sektorin, duke përdorur metoda të studimeve të së ardhmes si ndërtimi i skenarëve, punëtoritë pjesëmarrëse, skanimi i trendeve dhe hartëzimi i burimeve. Për të forcuar më tej kornizën strategjike, u zhvillua një konsultim i stilit *Delphi* me ekspertë ndërkombëtarë, çka mundësoi validimin e vazhdueshëm dhe përmirësimin e drejtimeve strategjike, duke siguruar njëkohësisht përputhshmërinë me praktikat më të mira botërore.

Puna e kryer u bë e mundur dhe falë mendimeve dhe angazhimit të një numri të gjerë profesionistësh të kulturës dhe përfaqësuesish institucionalë, të cilët ofruan ekspertizën e tyre përgjatë gjithë procesit. Përvoja e tyre kolektive në kontekste institucionale, të pavarura dhe ndërkombëtare i dha thellësi dhe pluralitet reflektimit strategjik që qëndron në themel të këtij dokumenti, duke mbështetur në mënyrë të çmuar grupin bërthamë të punës nga *Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit*, AICS dhe Fondazione Santagata, i cili udhëhoqi me përkushtim të plotë procesin e hartimit të kësaj strategjie.

AICS mbështeti të gjithë procesin, në kuadër të angazhimit të saj më të gjerë për forcimin e politikave kulturore, nxitjen e zhvillimit gjithëpërfshirës dhe promovimin e ngritjes së kapaciteteve institucionale në Shqipëri. AICS gjithashtu kontribuoi aktivisht në dialogun strategjik dhe siguroi përputhshmërinë me prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe kornizat e zhvillimit.

Hyrje

Në përputhje me kuadrin e politikave kulturore evropiane, **Strategjia Kombëtare e Kulturës 2026–2030** e pozicionon kulturën si një komponent thelbësor të zhvillimit të qëndrueshëm të Shqipërisë, duke e vendosur atë në qendër të proceseve të modernizimit shoqëror, ekonomik dhe institucional. Kultura trajtohet jo vetëm si një shprehje e identitetit dhe trashëgimisë historike të vendit, por edhe si një nxitëse e inovacionit, e kohezionit social dhe e zhvillimit ekonomik të bazuar në dije dhe krijimtari.

Përmes një qasjeje të integruar të politikave publike, strategjia synon të forcojë rolin e sektorit kulturor si një faktor ndërsektorial që kontribuon në mirëqenien e qytetarëve, në zhvillimin e ekuilibruar territorial dhe në konsolidimin e qeverisjes demokratike. Deri në vitin 2030, Shqipëria synon të konsolidojë pozicionin e saj si një qendër kulturore me rëndësi në Ballkanin Perëndimor dhe si një aktore aktive në hapësirën kulturore evropiane. Ky objektiv do të mbështetet në valorizimin e trashëgimisë së pasur kulturore dhe në zhvillimin e një ekosistemi të qëndrueshëm dhe dinamik krijues, i cili promovon pjesëmarrjen kulturore, nxit dialogun ndërkulturor dhe kontribuon në rritjen ekonomike të udhëhequr nga inovacioni dhe industritë kulturore dhe krijuese.

Lista e shkurtimeve

AICS	Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim *(Agenzia Italiana per la Cooperazione allo Sviluppo)*
AKSHI	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit
API	Ndërfaqe e Programimit të Aplikacioneve *(Application Programming Interface)*
BE	Bashkimi Evropian
CERV	Programi i BE-së për Qytetarët, Barazinë, të Drejtat dhe Vlerat *(Citizens, Equality, Rights and Values)*
CRPD	Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara *(Convention on the Rights of Persons with Disabilities)*
DIGIT.AL.HERITAGE	Platforma Kombëtare Digjitale e Trashëgimisë Kulturore
DRTK	Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik *(Geographic Information System)*
GLAM	Galeri, Biblioteka, Arkiva dhe Muze *(Galleries, Libraries, Archives and Museums)*
HIA	Vlerësimi i Ndikimit në Trashëgimi *(Heritage Impact Assessment)*
IKK	Industritë Kulturore dhe Krijuese
IKTK	Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
IKRTK	Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPMG	Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave *(Integrated Policy Management Group)*

KKM	Këshilli Kombëtar i Muzeve
KKTKM	Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPI	Treguesit Kryesorë të Performancës *(Key Performance Indicators)*
MD	Ministria e Drejtësisë
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe *Inovacionit (emërtim i mëparshëm i MTKS-së)*
MF	Ministria e Financave
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MM	Ministria e Mjedisit
MTKS	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit
NJAKPA	Njësitë e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OSHC	Organizata e Shoqërisë Civile
PI	Pronësia Intelektuale
PPP	Partneritet Publik-Privat
QKVT	Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale
QRKREJ	Qendra Rajonale për Konservim dhe Restaurim për Evropën Juglindore
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës

SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SPK	Skena e Pavarur Kulturore
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TKM	Trashëgimia Kulturore Materiale
TKJ	Trashëgimia Kulturore Jomateriale
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë *(United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization)*
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

1. Analiza e gjendjes historike dhe sfondit aktual

Ndër vite sektori kulturor dhe trashëgimia kulturore në Shqipëri kanë kaluar periudha sfidash të shumta. Pas periudhës së ndryshimeve sociale dhe ekonomike, shumë objekte të rëndësishme historike dhe kulturore janë përballur me degradim, mungesë mirëmbajtjeje dhe administrim të papërshtatshëm. Në këtë kontekst, mungesa e një vizioni strategjik dhe e një kornize ligjore të konsoliduar ka penguar zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit kulturor dhe ka kufizuar mundësitë për të shndërruar trashëgiminë në një aset të mirëfilltë zhvillimi ekonomik dhe social.

Një nga problematikat kryesore ka qenë ndikimi i zhvillimeve urbane të pakontrolluara. Ndërhyrjet e pakualifikuara në qendrat historike, ndërtimet pa kriter dhe shpërfillja e vlerave arkitekturore dhe estetike kanë cënuar integritetin e objekteve dhe hapësirave kulturore, duke kompromettuar identitetin dhe kujtesën kolektive të komuniteteve. Ky fenomen ka qenë veçanërisht i theksuar në qendrat urbane historike, ku presioni i zhvillimit ekonomik shpesh ka kaluar mbi mbrojtjen e vlerave kulturore.

Një tjetër sfidë e rëndësishme ka qenë infrastruktura e dobët dhe e pasigurt kulturore dhe artistike. Institucionet kulturore, teatrot, galeritë, muzetë, bibliotekat dhe hapësirat e tjera artistike, kanë funksionuar shpesh në kushte të vështira, pa kalendar artistik të qëndrueshëm dhe pa mbështetjen e nevojshme financiare dhe strategjike. Kjo ka kufizuar zhvillimin e veprimtarive kulturore, ka pamundësuar përfshirjen e artistëve në projekte të vazhdueshme dhe ka penguar krijimin e një ekosistemi të qëndrueshëm krijues.

Për më tepër, mungesa e investimeve dhe e menaxhimit të qëndrueshëm ka kufizuar potencialin e sektorit kulturor si motor për zhvillimin ekonomik dhe promovimin e imazhit të vendit. Në periudha të gjata, artistët dhe profesionistët e kulturës përballeshin me vështirësi për realizimin e projekteve, mungesën e hapësirave të përshtatshme dhe mbështetjen financiare të nevojshme, duke krijuar një hendek midis potencialit krijues dhe mbështetjes institucionale.

1.1 Trashëgimia Kulturore Materiale (TKM)

Shqipëria zotëron një mozaik pasurish kulturore materiale, qytete e qendra historike, zona arkeologjike, peizazhe kulturore, e elementë natyrorë me vlera të jashtëzakonshme, të shpërndara në të gjithë territorin. Inventarizimi, klasifikimi dhe publikimi i tyre po konsolidohen përmes platformës zyrtare të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), ku lista kombëtare është e aksesueshme publikisht dhe përditësohet periodikisht. Ky proces rrit transparencën, përmirëson aksesin në të dhënat, dhe mbështet vendimmarrjen për ruajtjen, menaxhimin dhe promovimin e pasurive kulturore.

Qasja institucionale është fokusuar në forcimin e inventarizimit dhe regjistrave, përfshirë botimin online të pasurive kulturore, përmirësimin e planeve të menaxhimit për sitet me vlera të jashtëzakonshme, zhvillimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkufitar, si dhe

promovimin ndërkombëtar përmes mekanizmave të UNESCO-s. Kjo siguron menaxhim të integruar, përdorim publik të qëndrueshëm dhe edukim kulturor cilësor.

Gjatë dekadës së fundit, Shqipëria ka nisur një rrugëtim të qëndrueshëm drejt forcimit të menaxhimit të trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit të sektorit kulturor. Për herë të parë, institucionet kanë filluar të trajtojnë trashëgiminë kulturore jo vetëm si një pasuri historike, por edhe si një aset strategjik për zhvillim ekonomik, turizëm dhe përfshirje sociale. Inventarizimi i pasurive kulturore dhe regjistrimi i tyre, përmirësimi i planeve të menaxhimit dhe bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkufitar kanë shërbyer si bazat e këtij transformimi, duke rritur kapacitetet për menaxhim të qëndrueshëm dhe promovim ndërkombëtar.

Presioni urbanistik dhe turistik mbi qendrat historike, ndërhyrjet infrastrukturore në zona të ndjeshme dhe nevoja për financim të vazhdueshëm për konservim kanë kërkuar vendime të kujdesshme dhe politika të vazhdueshme mbështetëse. Për pasuritë ndërkufitare dhe transnacionale, si Liqeni i Ohrit dhe Pyjet e Ahut, koordinimi institucional ka qenë i domosdoshëm për të garantuar ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të këtyre vlerave që tejkalojnë kufijtë kombëtarë.

Rezultatet e arritura flasin për vlera konkrete dhe të prekshme. Rreth **650 ndërhyrje** restauruese janë realizuar në të gjithë Shqipërinë në objekte të ndryshme, qendra historike, ansamble urbane, objekte kulti, kala, ura, vepra inxhinierike, site arkeologjikë dhe banesa. Ky proces ka shndërruar situatën e trashëgimisë kulturore, duke kthyer objekte të degraduara në pasuri të rikuperuara, të siguruara dhe të përdorshme për komunitetin dhe vizitorët.

Shpërndarja e ndërhyrjeve tregon një fokus strategjik në qytetet me vlera të njohura ndërkombëtarisht ku spikasin Gjirokastra, ndjekur nga Korça, Berati, Shkodra dhe Tirana. Investimet nuk kanë qenë thjesht restaurime fizike: ato kanë krijuar mundësi për zhvillim turistik, hapësira kulturore funksionale dhe rritje të vizibilitetit ndërkombëtar të Shqipërisë.

Një nga historitë më të spikatura është ajo e rilindjes urbane. Transformimi i Pazarit të Ri në Tiranë dhe rikthimi i identitetit të qendrave historike të Krujës, Gjirokastrës, Vlorës, Korçës, Shkodrës dhe Beratit kanë krijuar modele të reja për integrimin e kulturës me zhvillimin ekonomik dhe turizmin. Qytetet historike nuk janë parë më vetëm si vendndodhje për ruajtje të monumenteve, por si qendra dinamike që kombinon restaurimin e vlerave historike, zhvillimin e bizneseve lokale dhe krijimin e hapësirave publike për art dhe aktivitet kulturor.

Një tjetër instrument i rëndësishëm ka qenë "*Bonusi i Rijetëzimit*", që ka ofruar mbështetje financiare për pronarët dhe përdoruesit ligjorë të objekteve kulturore pjesë e ansambleve historike urbane, qendrave historike dhe zonave arkeologjike. Ky bonus ka mundësuar që restaurimi të mos mbetet një privilegj i institucioneve shtetërore, por të përfshijë edhe pronarët privatë, duke rritur përgjegjësinë dhe përfshirjen e komunitetit. Për shembull, gjatë viteve 2022–2023, nga 269 aplikime përfituan 92, kryesisht në Gjirokastër dhe Berat, qytete të njohura nga UNESCO.

Progresi është i dukshëm referuar veçanërisht viteve të fundit: ndërhyrjet dhe investimet për restaurim dhe konservim janë rritur mbi 300% në disa raste, ndërsa monitorimet dhe inspektimet në site arkeologjike janë shtuar mbi 220% (krahasim viti 2023 në raport me vitin 2024-2025). Kjo tregon një angazhim të qëndrueshëm financiar, një përforcim të kapaciteteve institucionale dhe një koordinim operativ që garanton planifikim të qëndrueshëm dhe efikas.

1.2 Vizitueshmëria dhe turizmi i trashëgimisë

Krahasimi midis periudhës para një dekade dhe vitit 2025 tregon një transformim të jashtëzakonshëm strukturor dhe funksional të sektorit të trashëgimisë kulturore në Shqipëri. Nga një numër vizitorësh prej 200,538 në vitin 2013, Shqipëria arriti të regjistrojë 1,523,587 vizitorë në vitin 2025, një rritje prej 1,323,049 vizitorësh ose +555%, duke e shumëfishuar mbi shtatë herë vizitueshmërinë brenda një periudhe 12-vjeçare.

Kjo rritje krahas trendit të përgjithshëm të turizmit, reflekton një tregues të zhvendosjes cilësore drejt turizmit kulturor, i cili ka marrë peshë të veçantë në ofertën kombëtare. Rritja e qëndrueshme e vizitorëve reflekton përmirësim të dukshëm të atraktivitetit dhe aksesueshmërisë së siteve kulturore, si dhe një interes të shtuar për përvoja që lidhen me identitetin, traditat dhe trashëgiminë e vendit.

Disa faktorë kyç kanë ndikuar drejtpërdrejt në këtë performancë të jashtëzakonshme:

- Investimet në restaurim dhe mirëmbajtje, të cilat kanë siguruar cilësi dhe integritet të siteve, duke rritur sigurinë dhe kënaqësinë e vizitorëve.
- Forcimi i kapaciteteve menaxheriale, përmes hartimit dhe zbatimit të planeve të menaxhimit, që kanë mundësuar një menaxhim më efikas, planifikim afatgjatë dhe përdorim të qëndrueshëm të resurseve kulturore.
- Zgjerimi i ofertës kulturore, nga 16 në 27 objekte të vizitueshme me biletë, duke diversifikuar përvojën për vizitorët dhe duke integruar më shumë site me vlera të jashtëzakonshme në rrjetin turistik.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe promovimit, që ka përforcuar imazhin e trashëgimisë kulturore në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar, duke e bërë atë një destinacion tërheqës dhe të njohur globalisht.

Veçanërisht domethënëse është fakti që rritja e të ardhurave (+30.63% vetëm në raport me vitin 2024) tejkalon ritmin e rritjes së vizitorëve. Kjo tregon jo vetëm fluks më të madh, por edhe një eficencë më të lartë ekonomike, duke hapur perspektiva të reja për vetëqëndrueshmëri financiare të institucioneve të trashëgimisë.

Një element kyç i këtij transformimi është digjitalizimi i shërbimeve për vizitorët. Për herë të parë, biletaria online është ofruar përmes platformës "*e-Albania*" për 7 site kryesore kulturore. Ky sistem i integruar lehtëson qasjen e publikut, rrit transparencën dhe eficencën, dhe përmirëson përvojën e vizitorit, duke i dhënë një dimension modern menaxhimit të trashëgimisë kulturore në Shqipëri.

1.3 Trashëgimia Kulturore Jomateriale (TKJ)

Trashëgimia kulturore jomateriale në Shqipëri përbën një komponent thelbësor të identitetit kombëtar dhe një burim të rëndësishëm për kohezionin social, krijimtarinë komunitare dhe zhvillimin e qëndrueshëm kulturor. Në përputhje me orientimet e Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2019–2025, politikat institucionale janë përqendruar në ruajtjen dhe dokumentimin e kësaj trashëgimie, në fuqizimin e komuniteteve bartëse përmes programeve edukative dhe të rritjes së kapaciteteve, si dhe në promovimin e saj në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Pavarësisht këtij potenciali të konsiderueshëm krijues dhe kulturor, trashëgimia jomateriale mbetet e ndjeshme ndaj një sërë zhvillimesh strukturore, përfshirë braktisjen e zonave rurale, emigracionin, transformimet socio-ekonomike dhe dobësimin e mekanizmave tradicionalë të transmetimit ndërbrezor.

Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në përforcimin e praktikave ndërkombëtare dhe në konsolidimin e marrëdhënieve me UNESCO-n, duke regjistruar disa nga elementet më përfaqësuese të trashëgimisë jomateriale.

1. Në vitin 2022, *Xhubleta*, veshja emblemë e grave të Alpeve, u përfshi në *Listën e Trashëgimisë në Nevojë për Mbrojtje Urgjente* gjatë sesionit të 17-të në Rabat, duke njohur rrezikun e humbjes së mjeshtërisë tradicionale dhe nevojën për ndërhyrje të drejtpërdrejtë për mbrojtjen e saj.
2. Në vitin 2023, tradita e Transhumancës, lëvizja sezonale e blegtorëve dhe bagëtive në zonat malore dhe fushore, u regjistrua në Listën Përfaqësuese të Trashëgimisë Jomateriale të Njerëzimit si pjesë e një nominimi shumëkombësh, duke nënvizuar vlerën e saj ekologjike, shoqërore dhe kulturore.
3. Në vitin 2024, tradita e "*K'cimit të Tropojës*" u përfshi gjithashtu në Listën Përfaqësuese të Trashëgimisë Jomateriale të Njerëzimit gjatë sesionit të 19-të të Komitetit Ndërqeveritar në Paraguai, duke vendosur këtë dukuri të veçantë në hartën ndërkombëtare të vlerave kulturore.
4. Në vitin 2025, UNESCO regjistroi "*Artin e të luajturit, këndvarit dhe bërjes së lahutës*" në Listën e Trashëgimisë në Nevojë për Mbrojtje Urgjente, duke njohur kompleksitetin e kësaj tradite epike dhe rrezikun e zhdukjes së saj për shkak të migrimit, plakjes së bartësve dhe mungesës së transmetimit të rregullt ndërbrezor.
5. Po në vitin 2025, në kuadër të programit "*Kujtesa e Botës*" të UNESCO-s, arkiva e negativëve, objekteve dhe dokumenteve të Pietro dhe Kel Marubi u përfshi në këtë regjistër prestigjioz ndërkombëtar, duke njohur vlerën e jashtëzakonshme dokumentare dhe historike të kësaj pasurie unike për Shqipërinë dhe rajonin.

Këto regjistrime shënojnë hapa të rëndësishëm për prezencën e Shqipërisë në UNESCO dhe për forcimin e mbrojtjes së trashëgimisë jomateriale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ato përfaqësojnë arritje kyçe që dëshmojnë gjithashtu se Shqipëria ka hyrë në një fazë të re të qeverisjes kulturore, ku bashkëpunimi ndërinstitucional, angazhimi komunitar dhe përqafimi i standardeve ndërkombëtare shërbejnë si mekanizma për ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë jomateriale. Ato gjithashtu krijojnë një bazë të fortë për intensifikimin e mëtejshëm të masave për dokumentim, edukim, promovim dhe mbështetje financiare, duke garantuar që këto vlera të mbeten të gjalla dhe të transmetueshme për gjeneratat e ardhshme.

Me mbështetjen e UNESCO-s, Shqipëria ka bërë një hap të rëndësishëm drejt dokumentimit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale. Në këtë kuadër, është ngritur *Regjistri i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale*, një mjet thelbësor për regjistrimin e elementëve që përfaqësojnë identitetin, traditat dhe praktikat kulturore të vendit.

Ndërkohë, vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe artizanëve dhe zanatçive tradicionalë, si një komponent i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore dhe i zhvillimit ekonomik lokal. Mbështetja për këta profesionistë ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në ruajtjen e traditave dhe nxitjen e inovacionit në artizanatin shqiptar. Vetëm në vitin 2025, përmes granteve të specializuara, janë mbështetur 47 projekte dhe artizanë, duke përfshirë punime të pastra tradicionale, prodhime artistike dhe iniciativat që synojnë promovimin e zanateve në tregun lokal dhe ndërkombëtar.

1.4 Institucionet e Artit dhe Kulturës

Para një dekade, institucionet e artit dhe kulturës në Shqipëri funksiononin në kushte të kufizuara. Aktiviteti ishte relativisht i ulët: realizoheshin rreth 201 shfaqje, me 8 premiera dhe rreth 39,000 spektatorë.

Në vitin 2025, numrat janë rritur ndjeshëm: janë realizuar 1,162 shfaqje, 120 premiera dhe janë regjistruar 479,664 spektatorë. Në terma përqindjeje, kjo përfaqëson rritje +478% të shfaqjeve, +1,400% të premierave dhe +1,122% të spektatorëve krahasuar me nivelin e mëparshëm. Kjo tregon një ndryshim të madh në volum dhe përpjekjet e institucioneve për të zgjeruar aktivitetin dhe përfshirjen e publikut.

Një ndryshim konkret në sektor ka qenë rritja e pagave për artistët e Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, me rritje page 46%-59%. Ky ndryshim ka pasur një efekt të drejtpërdrejtë: ka përmirësuar motivimin dhe stabilitetin e profesionistëve të artit, ka mundësuar që artistët t'i përkushtohen më shumë prodhit të shfaqjeve dhe ka ndihmuar në ruajtjen e kapaciteteve profesionale brenda institucioneve.

Sidoqoftë, sfidat infrastrukturore mbeten të dukshme. Shumë teatro, galeri dhe muze funksionojnë ende në ndërtesa të vjetruara, me pajisje të kufizuara dhe hapësira të pamjaftueshme për të përballuar fluksin e shtuar të publikut. Pandemia COVID-19, detyroi institucionet kulturore të reduktonin shfaqjet, e të kufizonin numrin e spektatorëve dhe, në disa raste, të ndërprisnin aktivitetet për muaj me radhë.

Në përgjithësi, periudha 2013–2025 tregon një transformim të dukshëm të aktiviteteve dhe pjesëmarrjes, me përmirësim të motivimit të artistëve dhe zgjerim të audiencës. Megjithatë, sfidat infrastrukturore, nevoja për financim të qëndrueshëm dhe përgatitja për situata emergjente mbeten pika kyçe që duhet të adresohen për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe funksionim normal të institucioneve kulturore.

1.5 Skena e pavarur dhe projektet artistike

Gjatë periudhës 2014–2025, skena e pavarur artistike në Shqipëri ka shënuar një zhvillim të dukshëm, megjithatë me sfida të vazhdueshme për qëndrueshmëri dhe akses në burime. Në

këtë dekadë, rreth 2,077 projekte kulturore janë mbështetur përmes thirrjeve publike dhe granteve, duke përfshirë fusha të ndryshme: art performativ, ngjarje kulturore, letërsi, prodhim dramaturgjik dhe muzikor, artizanat dhe mobilitet shfaqjesh.

Në terma financiarë, fondet e alokuara për projektet e skenës së pavarur janë rritur ndjeshëm:

- **Viti 2014:** 52,223,030 lekë
- **Viti 2024:** 132,223,030 lekë (+153% krahasuar me 2014)
- **Viti 2025:** 300,000,000 lekë (+127% krahasuar me 2024 dhe rreth +474% krahasuar me 2014)

Fondet e vitit 2025 përbëjnë rreth 26% të buxhetit total të periudhës 2014–2025, duke treguar një përqendrim të madh mbështetje në vitet e fundit të dekadës. Një element i rëndësishëm në këtë proces ka qenë dialogu me komunitetin artistik, i zhvilluar përmes degjesave publike dhe platformës "*Zërat e Kulturës*", që ka lehtësuar identifikimin e nevojave reale të skenës së pavarur dhe ka kontribuar në orientimin e fondeve drejt projekteve me impakt më të madh.

Një aspekt që ka marrë vëmendje të veçantë ka qenë shtrirja gjeografike e mbështetjes. Projeketet nuk janë përqendruar vetëm në kryeqytet, por janë shpërndarë edhe në qytete të tjera si Korçë, Gjirokastër, Shkodër, Vlorë, Durrës, Elbasan, Berat, Pogradec, Sarandë, duke u përpjekur të mbështesin krijimtarinë në të gjithë territorin dhe të përfshijnë komunitete lokale në aktivitetet kulturore. Kjo qasje ka synuar jo vetëm decentralizimin e mundësive për artistët, por edhe zhvillimin e kapaciteteve kulturore në rajone, duke kontribuar në një diversitet më të madh të ofertës artistike dhe në rritjen e pjesëmarrjes së publikut lokal.

Në total, rreth 1,500 projekte janë mbështetur gjatë kësaj dekade me një fond prej 1,150,320,600 lekë, duke treguar një përpjekje për të fuqizuar aktivitetin e pavarur artistik. Megjithatë, përtej numrit të projekteve dhe vlerës së fondeve, mbetet sfidë sigurimi i qëndrueshmërisë afatgjatë, zhvillimi i kapaciteteve menaxheriale të organizatave dhe krijimi i mundësive reale për punësim për artistët dhe profesionistët e rinj.

1.6 Edukimi përmes kulturës

Rëndësi të veçantë në zhvillimin e sektorit kulturor ka marrë boshti i edukimit kulturor, ku programi "*Edukimi mbi dhe përmes Kulturës*", i strukturuar sipas modelit të UNESCO-s, ka shërbyer si një urë lidhëse mes institucioneve arsimore dhe atyre kulturore. Ky program ka synuar të integronte artin dhe trashëgiminë kulturore në procesin arsimor, duke krijuar audienca të reja dhe duke rritur ndërgjegjësimin e nxënësve mbi vlerat kulturore dhe artistike të vendit.

Në vitin 2025, programi ka përfshirë mbi 500 aktivitete, duke përfshirë vizita në muze, galeri, site historike dhe hapësira të tjera kulturore. Më shumë se 18,000 nxënës janë përfshirë në këto aktivitete, duke krijuar jo vetëm eksperienca edukative të drejtpërdrejta, por edhe duke ushqyer interesin dhe respektin për trashëgiminë dhe artin që nga moshat më të reja. Kjo qasje ka kontribuar gjithashtu në zgjatjen e ndikimit të institucioneve kulturore, duke i bërë ato më të aksesueshme dhe më të lidhura me komunitetin.

1.7 Dukshmëria ndërkombëtare dhe diplomacia kulturore

Ekosistemi kulturor i Shqipërisë ka hyrë në një fazë modernizimi të thellë, ku diplomacia kulturore, pjesëmarrja qytetare, edukimi kulturor dhe trashëgimia po ndërthuren në një qasje të vetme për zhvillim të qëndrueshëm. Në fushën e diplomacisë kulturore, ndër arritjet më të mëdha ka qenë organizimi i *Javëve Kulturore Ndërkombëtare* nën sloganin "*Shqipëria mikpret Botën*", ku në edicionet e viteve 2022-2025 janë realizuar në total mbi 1,800 aktivitete, me pjesëmarrjen e rreth 1,200 artistëve të huaj me mbi 30 shtete pjesëmarrëse, duke e kthyer vendin në një hapësirë të rëndësishme të dialogut ndërkulturor dhe shkëmbimit artistik.

Po në 2025, është prezantuar për herë të parë nisma "*CulturAlb – Ditët Kulturore Shqiptare në Botë*" që e zhvendosën aksin e prezantimit drejt zhvillimit të audiencave të huaja me 142 aktivitete në 18 shtete dhe 885 artistë shqiptarë të angazhuar dhe promovuar, duke i dhënë identitetit kulturor shqiptar një ekspozim të ri ndërkombëtar dhe duke forcuar profilin e vendit si destinacion kulturor me rritje.

Gjatë ciklit strategjik 2019–2025, Shqipëria ka konsoliduar dukshëm profilin e saj ndërkombëtar në fushën e artit, arkitekturës dhe krijimtarisë bashkëkohore, duke u shndërruar në një aktor të identifikueshëm në skenën globale të *Bienales së Venecias*.

Në vitin 2021, pavijoni shqiptar "*Në shtëpinë tonë (Apart)*" adresoi transformimet sociale dhe fqinjësinë urbane në Shqipërinë post-'90, duke marrë vëmendje të gjerë në mediat ndërkombëtare dhe rajonale për qasjen e tij antropologjike dhe hapësinore. Në edicionin e vitit 2023, projekti "*Përsiatje të pakohë: Si mësojmë të jetojmë në realitete të sintetizuara*" solli një qasje novatore mbi arkitekturën virtuale, inteligjencën artificiale dhe realitetet e reja digjitale, duke e vendosur Shqipërinë në qendër të debatit global mbi rolin e teknologjisë në projektim dhe duke u pasqyruar në platforma si *ArchDaily, World Architecture Community* dhe *Artribune*.

Në vitin 2024, në kuadër të Bienales së Artit të Venecias, artistja shqiptare Iva Lulashi u prezantua me projektin "*Love as a Glass of Water*", një qasje intime dhe reflektuese mbi marrëdhëniet njerëzore, trupin dhe kujtesën emocionale, duke shtuar një dimension të ri në përfaqësimin bashkëkohor të artit shqiptar në arenën ndërkombëtare.

Ndërsa në vitin 2025, pjesëmarrja shqiptare me projektin "*Building Architecture Culture*", të kuruar nga Anneke Abhelakh, sjell në fokus një tjetër dimension bashkëkohor: marrëdhënien midis arkitektëve të huaj dhe peizazhit shqiptar në tranzicion, duke reflektuar hapjen kulturore, transformimin urban dhe ndërveprimet ndërkombëtare që kanë karakterizuar Shqipërinë në dy dekadat e fundit.

Këto pjesëmarrje dokumentojnë një evolucion të dukshëm artistik, nga identiteti social tek urbanizmi kritik dhe tek arkitektura digjitale, si edhe drejt eksplorimeve më intime të artit bashkëkohor, duke e vendosur Shqipërinë si një laborator të ideve të reja, një hapësirë eksperimentimi dhe një kontribuese aktive në diskursin global të artit dhe arkitekturës bashkëkohore.

Një dimension i veçantë i zhvillimit kulturor gjatë periudhës së fundit ka qenë konkursi "*Arti në Hapësirat Publike*", i cili ka synuar të lidhë qytetin, komunitetin dhe krijimtarinë artistike

në mënyrë direkte. Gjatë këtij konkursi u realizuan 7 instalacione artistike në hapësira publike, të cilat nuk ishin thjesht veprat e artistëve, por projekte multidisiplinare që përfshinin ekipe të mëdha artistësh, arkitektësh, inxhinierësh, dizajnerësh dhe ndërtuesish. Ky model ka ofruar jo vetëm një eksperiencë vizuale dhe estetike për qytetarët, por edhe një mundësi praktike për bashkëpunim profesional dhe zhvillim kapacitetesh në fusha të ndryshme.

Pjesëmarrja në këto projekte ka qenë shumë e lartë: 132 projekte kandidate nga 72 artistë, që përfaqëson një kombinim të talentit lokal dhe ndërkombëtar. Artistë nga Italia, Polonia, Greqia, Kina, India dhe Pakistani sollën diversitet estetik dhe konceptual, duke sjellë në hapësirat publike një dialog kulturor të gjerë dhe të pasur.

1.8 Infrastruktura kulturore

Gjatë dekadës së fundit, investimet në infrastrukturën kulturore në Shqipëri kanë shënuar një transformim të dukshëm, duke synuar jo vetëm restaurimin dhe rikonstruksionin e objekteve ekzistuese, por edhe krijimin e hapësirave të reja për veprimtari artistike, edukim dhe turizëm kulturor. Këto ndërhyrje pasqyrojnë një kombinim të projekteve madhore kombëtare dhe mbështetjes ndërkombëtare, duke u fokusuar tek restaurimi i monumenteve, ndërtimi i qendrave të reja dhe pajisja e institucioneve kulturore me kapacitete moderne.

Në vitet e fundit janë realizuar ndërhyrje madhore si rikonstruksioni i Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, duke përmirësuar infrastrukturën performative dhe kushtet e punës për artistët; ndërtimi i ARTURBINA, një hapësirë e re për artin dhe aktivitete kreative urbane, restaurimi i Sallës së Universitetit të Arteve dhe digjitalizimi i Mozaikut të Tiranës, duke ruajtur vlerat historike dhe artistike ekzistuese; ngritja e muzeve të reja dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese, si Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi në Shkodër, Muzeu Kombëtar i Arsimit në Korçë, "*Shtëpia me Gjethe*" dhe Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar në Korçë; Parku i Artit në ish-Kinostudio, përfaqëson një hapësirë kulturore të hapur dhe multidisiplinare, ku artistët, kineastët, dizajnerët dhe profesionistët e tjerë krijues mund të zhvillojnë projekte të ndryshme, nga instalacione vizuale dhe performanca, te ngjarje dhe aktivitete komunitare.

Përveç projekteve kombëtare, Bashkimi Evropian ka mbështetur programin *EU4CULTURE*, duke alokuar rreth 40 milionë euro për restaurimin e 23 objekteve të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019. Këto ndërhyrje kanë përfshirë manastire, kisha, kala, muze etnografikë dhe pajisje për galeritë kombëtare, duke krijuar një rrjet të integruar për ruajtjen e trashëgimisë materiale, ku spikat Muzeu Arkeologjik i Durrësit, Muzetë Etnografikë të Krujës dhe Kavajës, restaurimi i Teatrit të Kukullave, Kulla Veneciane në Durrës, Kalaja e Bashtovës, restaurimi i mozaikut të Muzeut Historik Kombëtar, etj.

Në të njëjtën kohë, janë nisur projekte të rëndësishme në proces, që synojnë të krijojnë hapësira të reja për art, edukim dhe qasje publike si Teatrit i ri Kombëtar dhe Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, restaurimi dhe muzealizimi i Muzeut Historik Kombëtar, si dhe i Galerisë Kombëtare të Arteve, krahas shumë investimeve të tjera paralele.

Këto investime kanë pasur ndikim të dyfishtë: nga njëra anë, kanë përmirësuar standardet infrastrukturore dhe kushtet për artistët, studiot dhe institucionet, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e aktiviteteve kulturore; nga ana tjetër, kanë rritur aksesin për publikun dhe vizitorët, duke e bërë trashëgiminë kulturore më të dukshme dhe më të përdorshme si një burim arsimor, turistik dhe social.

2. Sfidat kryesore të sektorit kulturor

Megjithatë, sektori kulturor përballet me sfidat të ndryshme përfshirë burime të kufizuara, pabarazi në aksesin e gjerë në jetën kulturore dhe paqëndrueshmëri profesionale, të cilat Strategjia Kombëtare e Kulturës 2026-2030 synon t'i adresojë përmes forcimit të institucioneve, zhvillimit të kapaciteteve krijuese dhe promovimit të pjesëmarrjes së gjerë qytetare, duke e vendosur sektorin kulturor në qendër të zhvillimit të qëndrueshëm dhe integrimit evropian.

- **Pjesëmarrja kulturore mbetet e pabarabartë,** veçanërisht jashtë qendrave urbane, dhe shumë artistë dhe krijues përballen me pasiguri në zhvillimin e karrierës së tyre. Integrimi i kulturës me zhvillimin ekonomik, përfshirë turizmin dhe industritë krijuese, nuk është shfrytëzuar ende në potencialin e plotë. Megjithë arritjet që ka shënuar, sektori përballet me sfida të rëndësishme që kërkojnë ndërhyrje strategjike.
- **Burimet financiare shpeshherë të pamjaftueshme dhe të mbështetura kryesisht në buxhetin e shtetit**, kufizojnë zhvillimin e projekteve inovative dhe të qëndrueshme, duke penguar potencialin krijues të vendit.
- **Infrastruktura kulturore, duke përfshirë bibliotekat, muze dhe qendrat kulturore, kërkon modernizim dhe digjitalizim për të qenë më të aksesueshme dhe funksionale.** Pabarazitë territoriale dhe sociale ndikojnë drejtpërdrejt në pjesëmarrjen qytetare, duke lënë jashtë nga aktivitetet kulturore një pjesë të konsiderueshme të komuniteteve, veçanërisht të rinjtë jashtë qendrave urbane.
- **Profesionalizmi në sektorin kulturor ndeshet gjithashtu me paqëndrueshmëri:** shumë artistë dhe krijues të pavarur përballen me sfida për të ndërtuar karriera të qëndrueshme dhe për të zhvilluar projektet e tyre në kushte sigurie institucionale. Ndërkohë, lidhja e kulturës me zhvillimin ekonomik dhe turizmin mbetet e paplotë, duke humbur mundësinë për të shfrytëzuar potencialin e plotë të sektorit si motor i zhvillimit kombëtar dhe promovimit ndërkombëtar.

2.1 Prioritetet strategjike

Agjenda e Re Evropiane për Kulturën dhe duka vijuar që prej 2025 , *Busulla Kulturore për Evropën*, përcaktojnë **pesë prioritete kryesore** për bashkëpunimin evropian në sferën e politikave kulturore:

1. Qëndrueshmëria në trashëgiminë kulturore
2. Kohezioni dhe mirëqenia

3. Një ekosistem që mbështet artistët, profesionistët e kulturës dhe krijuesit, si dhe përmbajtjen evropiane
4. Barazia gjinore
5. Marrëdhëniet kulturore ndërkombëtare

Strategjia Kombëtare e Shqipërisë për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 ndjek nga afër këto prioritete. Ajo thekson qëndrueshmërinë duke përforcuar institucionet dhe infrastrukturën kulturore, duke nxitur kohezionin përmes rritjes së pjesëmarrjes dhe aksesit kulturor, si dhe duke ndërtuar një ekosistem të gjallë që mbështet artistët dhe sektorët krijues. Strategjia angazhohet më tej për barazinë gjinore dhe marrëdhëniet kulturore ndërkombëtare, duke e njohur kulturën si një urë jetike midis Shqipërisë dhe partnerëve të saj evropianë. Ky harmonizim siguron që politikat kulturore të Shqipërisë jo vetëm të përparojnë zhvillimin kombëtar, por edhe të sinkronizohen me vizionin më të gjerë evropian, duke lehtësuar integrimin në kornizat kulturore dhe të politikave evropiane.

3. Lidhja me kornizën ndërkombëtare dhe harmonizimi strategjik

Përafrimi me BE

Politikat kulturore evropiane kanë përjetuar një transformim thelbësor, duke kaluar në mënyrë progresive nga një qasje e fokusuar kryesisht tek trashëgimia dhe arti drejt një koncepti gjithëpërfshirës, ku kultura shihet si nxitëse e zhvillimit ekonomik, inovacionit dhe kohezionit social. Integrimi i kësaj perspektive në Strategjinë Kombëtare të Kulturë në Shqipëri synon të zhvillojë institucione dhe ekosisteme të qëndrueshme, të mbështesë artistët dhe profesionistët e kulturës, të rrisë pjesëmarrjen qytetare dhe të integrojë kulturën në zhvillimin ekonomik dhe turizmin kulturor. Përmes këtij harmonizimi, Shqipëria synon të forcojë institucionet dhe infrastrukturën kulturore, të ndihmojë zhvillimin profesional të krijuesve, të promovojë barazinë gjinore dhe të forcojë marrëdhëniet kulturore ndërkombëtare, duke e pozicionuar sektorin kulturor si një faktor kyç të zhvillimit të vendit dhe promovimit ndërkombëtar.

Programet kryesore evropiane që mbështesin sektorin kulturor përfshijnë Creative Europe dhe CERV, të cilat aktualisht janë në proces harmonizimi drejt një instrumenti të unifikuar financimi. Një mbështetje e konsiderueshme sigurohet gjithashtu përmes Politikës Evropiane të Kohezionit dhe programeve të Bashkëpunimit Territorial Evropian, duke mundësuar zhvillimin e projekteve kulturore dhe krijuese në nivel rajonal dhe ndërkufitar, dhe duke promovuar integrimin dhe bashkëpunimin kulturor në gjithë Bashkimin Evropian.

Kontributi i Strategjisë në zhvillimin e industrive krijuese, transformimin digjital dhe rritjen e atraktivitetit kulturor mbështet drejtpërdrejt objektivat e *Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor* dhe *Agjendës së tij të Reformave,* duke përforcuar konkurrueshmërinë rajonale, transformimin digjital, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe qasjen në mundësitë e financimit përmes instrumenteve të Bashkimit Evropian.

Përafrimi me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së

Strategjia Kombëtare për Kulturën 2026–2030 kontribuon drejtpërdrejt në disa nga *Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm* të OKB-së (OZHQ), duke pasqyruar rolin ndërsektorial të kulturës në arsim, barazi, rritje ekonomike, komunitete të qëndrueshme dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Tabela e mëposhtme hartëzon tri shtyllat e strategjisë me OZHQ-të më përkatëse, duke përforcuar koherencën me kuadrin global të zhvillimit të qëndrueshëm krahas përafrimit me BE-në të theksuar më sipër.

OZHQ	Shtylla(t) e Strategjisë	Kontributi
OZHQ 4 – Arsimi Cilësor	Shtylla 1; Shtylla 3	Programimi i edukimit përmes kulturës, ngritja e kapaciteteve digjitale dhe profesionale
OZHQ 5 – Barazia Gjinore	Ndërsektori ale	Integrimi gjinor në pjesëmarrje, krijimtari dhe qeverisje
OZHQ 8 – Punë e Denjë dhe Rritje Ekonomike	Shtylla 2; Shtylla 3	Statusi i Artistit, sipërmarrja krijuese, instrumentet e financimit
OZHQ 9 – Industria, Inovacioni dhe Infrastruktura	Shtylla 3	DIGIT.AL.HERITAGE, AL CLOUD, qendrat e inovacionit, partneritetet universitet-industri
OZHQ 10 – Reduktimi i Pabarazive	Ndërsektori ale	Riekuilibrimi territorial, mbështetja për zonat rurale, minoritetet dhe skenën e pavarur
OZHQ 11 – Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme	Shtylla 1; Shtylla 3	Infrastruktura kulturore urbane, trashëgimia në planifikimin hapësinor, decentralizimi
OZHQ 13 – Veprimi për Klimën	Shtylla 1	Gatishmëria ndaj rreziqeve, qëndrueshmëria klimatike, reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë për asetet e trashëgimisë
OZHQ 16 – Paqe, Drejtësi dhe Institucione të Forta	Shtylla 3	Qeverisja transparente, meritokracia, llogaridhënia, auditimi i jashtëm

OZHQ17 – Partneritete për Objektivat	Shtylla 2	Bashkëpunimi ndërkombëtar, programet e BE-së, partneritetet ndërkufitare

4. Vizioni: Kultura si infrastruktura e së ardhmes

Në Shqipëri, kultura është një burim i gjallë, i aftë të gjenerojë inovacion, punësim dhe kohezion. Sitet e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s si Qendrat Historike të Beratit dhe Gjirokastrës, Butrinti, Rajoni i Liqenit të Ohrit, peizazhet bregdetare të Adriatikut dhe Jonit, traditat gojore, iso-polifonia, arkitektura e trashëguar nga periudha osmane dhe rrënojat klasike të Apolonisë dhe të Durrësit, etj., të gjitha dëshmojnë për një qytetërim të ndërtuar ndër shekuj. Në të njëjtën kohë, një brez i ri me artistë, me specialistë të fushave të ndryshme të dizajnit, regjisorë, muzikantë, etj. po i ripërcakton konturet e krijimtarisë shqiptare në një kontekst global.

Deri në vitin 2030, Shqipëria mund ta pozicionojë veten si një vend me kulturë bashkëkohore mesdhetare: një shtet që vlerëson diversitetin e tij historik dhe territorial si një burim inovacioni dhe dialogu. Vizioni i strategjisë duhet të mbështetet në idenë e një ekosistemi kulturor, në të cilin mbrojtja e trashëgimisë, prodhimi krijues, arsimi dhe kërkimi janë të ndërlidhura brenda një sistemi koherent të nxitur nga cilësia, bashkëpunimi dhe përfshirja.

Në kontekstin shqiptar, kultura duhet t'i përgjigjet tre sfidave kryesore:

1. Forcimit të kohezionit social dhe territorial
2. Ndërlidhjes me ekonominë dhe zhvillimin e qëndrueshëm
3. Zhvillimi i diplomacisë kulturore në nivel ndërkombëtar

Së pari, kultura mund të jetë një mjet i fuqishëm për përfshirjen sociale. Vlerësimi i trashëgimisë jomateriale, nga diversiteti gjuhësor te zanatet tradicionale, nënkupton njohjen dhe përqafimin e pluralizmit kulturor të Shqipërisë, duke e shndërruar atë në një burim force dhe kohezioni. Projektet kulturore të bazuara në komunitet, shkollat e muzikës dhe të zanateve, si dhe programet e dedikuara për të rinjtë dhe gratë, mund të nxisin fuqizimin dhe pjesëmarrjen aktive qytetare.

Së dyti, kultura përbën një sektor ekonomik në rritje. Industritë kulturore dhe krijuese, si filmi, dizajni, videolojërat, botimet, artet interpretuese, zanatet dhe turizmi kulturor, gjenerojnë vlerë ekonomike, krijojnë vende pune të kualifikuara dhe nxisin inovacionin teknologjik. Mbështetja e këtij sektori nënkupton krijimin e kushteve për një ekonomi të bazuar në dije, të diversifikuar dhe të qëndrueshme, të rrënjosur në identitetin kulturor.

Së treti, kultura shërben si një instrument i rëndësishëm i diplomacisë dhe i ndërtimit të imazhit kombëtar. Pjesëmarrja në rrjetet kulturore evropiane dhe ndërkombëtare, promovimi i trashëgimisë së njohur nga UNESCO dhe mbështetja e krijimtarisë bashkëkohore

kontribuojnë në pozicionimin e Shqipërisë si një urë lidhëse midis Evropës dhe Mesdheut, një hapësirë dialogu, bashkëpunimi dhe vitaliteti kulturor. Vizioni i Strategjisë është të nxisë një ekosistem kulturor në të cilin liria artistike, pluralizmi kulturor dhe autonomia institucionale respektohen si kushte mundësuese për krijimtarinë, pjesëmarrjen dhe angazhimin ndërkombëtar.

Në këtë kuadër, kjo strategji mëton ta pozicionojë kulturën në thelb të politikave kombëtare të zhvillimit, si shtylla e katërt e qëndrueshmërisë, krahas dimensioneve ekonomike, sociale dhe mjedisore.

DEKLARATA E VIZIONIT

Deri në vitin 2030, Shqipëria do të jetë një qendër dinamike kulturore mesdhetare, ku trashëgimia, krijimtaria dhe pjesëmarrja formojnë një ekosistem të integruar që shërben si shtylla e katërt e zhvillimit kombëtar.

4.1 Aksesueshmëria dhe pjesëmarrja: kultura si një mjet për mirëqenie dhe kohezion social

Në dy dekadat e fundit, vëmendja ndërkombëtare ndaj lidhjes mes kulturës, shëndetit dhe mirëqenies është rritur ndjeshëm, e mbështetur dhe në prova shkencore dhe praktikat në zhvillim. Ky proces është shoqëruar me një ndryshim paradigme: pjesëmarrja kulturore nuk perceptohet më thjesht si aktivitet argëtues apo shprehës, por si një faktor kyç për promovimin e shëndetit dhe mirëqenies së individëve dhe komuniteteve.

Institucionet kulturore, në këtë kontekst, nuk janë më thjesht qendra për prodhimin artistik, por aktorë të rëndësishëm që kontribuojnë në gjenerimin dhe mbështetjen e kushteve për një jetë cilësore. Kultura, e njohur si një nga përcaktuesit socialë të shëndetit, mund të nxisë mirëqenie, kohezion social dhe ndjesinë e përkatësisë, duke luajtur një rol të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Kërkimet shkencore mbi marrëdhënien midis kulturës dhe shëndetit janë intensifikuar ndjeshëm, në pesë vitet e fundit. Një pikë referimi në këtë drejtim përbën *Raporti Nr. 67 i Organizatës Botërore të Shëndetësisë* (OBSH) i vitit 2019, i cili, përmes analizës së më shumë se 3,000 studimeve shkencore, evidentoi se pjesëmarrja pjesëmarrja kulturore dhe shprehja artistike përmirësojnë shëndetin mendor, forcojnë lidhjet shoqërore, promovojnë plakjen aktive dhe rrisin rezistencën e komunitetit (Fancourt & Finn, 2019). Raporti i OBSH-së thekson gjithashtu se arti dhe kultura janë burime vendimtare për promovimin e shëndetit, të afta të kontribuojnë në parandalimin, kujdesin dhe menaxhimin e sëmundjeve në çdo fazë të jetës.

Ky vizion është përmbledhur dhe konsoliduar në *Planin Evropian të Punës për Kulturën 2023–2026* të BE-së (*EU Work Plan for Culture 2023-2026*) i cili, për herë të parë, legjitimon ndër shtyllat e tij strategjike aleancën midis kulturës dhe shëndetit (Këshilli i Bashkimit Evropian,

2022). Në botimin "*Artet në politikën e shëndetit publik: Progresi dhe mundësitë*" (Dow et al., 2023), analiza e 172 dokumenteve të hartuara nga një numër i madh vendesh pasqyron evolucionin e politikave në pikëtakimin midis kulturës dhe shëndetit, duke sjellë shembuj nga niveli lokal dhe kombëtar.

Në këtë kontekst, bashkëpunimi ndërmjet sektorëve të kulturës dhe shëndetësisë nuk përfaqëson thjesht sinergji operacionale, por një zbatim konkret të parimit se shëndeti është rezultat i ndërveprimit dinamik midis individëve, komuniteteve dhe mjediseve në të cilat ata jetojnë.

Në nivel ndërkombëtar, interesi ndaj lidhjes mes kulturës, shëndetit dhe mirëqenies është intensifikuar më tej kohët e fundit. Ndër kontributet më të rëndësishme është "*Dokumenti i pozicionimit mbi kulturën, shëndetin dhe mirëqenien*" (2022), i cili përshkruan përparësitë për integrimin e kulturës në strategjitë evropiane të shëndetit publik dhe kohezionit social. Kjo lidhje pozitive theksohet gjithashtu nga iniciativa "*Kultura për shëndetin*" (2021–2023), e promovuar nga Komisioni Evropian, e cila solli raportin e vitit 2022 "*Kontributi i kulturës në shëndet dhe mirëqenie*" një nga analizat ndërkombëtare më të përditësuara (Zbranca et al., 2022).

Brenda këtij kuadri, kontributi i kulturës në një mirëqenie të re (mirëqenie kulturore), tani i njohur edhe në kornizat kryesore evropiane dhe ndërkombëtare, propozon një vizion të integruar në të cilin kultura vepron në sinergji me sistemet sociale, arsimore dhe shëndetësore, midis aktorëve publikë dhe privatë, brenda një konteksti të fokusuar në barazi për të luftuar pabarazitë në akses.

Mësimet e nxjerra nga këto përvoja ndërkombëtare konvergojnë në një përfundim thelbësor: pjesëmarrja kulturore kërkon politika të mirëstrukturuara, të qëndrueshme dhe koherente. Në mënyrë që kultura të shpalosë plotësisht vlerën e saj shumëdimensionale për qytetarët, është e nevojshme të tejkalohet një qasje e kufizuar që e konsideron atë kryesisht në funksion të turizmit. Në këtë kuadër, trashëgimia kulturore, artet dhe krijimtaria duhet të rikthehen në rolin e tyre të plotë shoqëror, si faktorë që nxisin zhvillimin e potencialit individual, përfshirjen sociale dhe zhvillimin njerëzor. Në këtë perspektivë, kultura lidhet ngushtë edhe me konceptin e aftësive jetësore, të përcaktuara nga OBSH, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve të individëve për të përballuar sfidat e jetës dhe për të ndërtuar komunitete më të qëndrueshme.

Promovimi i pjesëmarrjes kulturore, në thelb do të thotë mbështetje e aftësisë së njerëzve për t'u shprehur, për të ndërtuar marrëdhënie dhe për të kontribuar në mënyrë aktive në jetën publike. Është një akt demokracie, si dhe një investim në kapitalin shoqëror dhe shëndetin e komunitetit. Siç theksohet në raportin e fundit "*Kultura dhe demokracia: evidenca*" (Komisioni Evropian & ECORYS, 2023), pjesëmarrja kulturore forcon angazhimin qytetar, kohezionin shoqëror dhe cilësinë e demokracisë, por pabarazitë vazhdojnë të ndikojnë në aksesin aktual në kulturë. Për rrjedhojë, hartimi i politikave për të kthyer përvojat kulturore në gjithëpërfshirëse dhe të përballueshme ekonomikisht nënkupton shndërrimin e kulturës në një të drejtë dhe në një burim të përbashkët.

Që kjo të bëhet e mundur, një **parakusht themelor është aksesueshmëria universale, fizike, shqisore, njohëse, ekonomike dhe digjitale**, e konsideruar jo si një çështje thjesht teknike, por si një parim politik që garanton mundësi të barabarta për përdorim dhe pjesëmarrje. Në shoqëritë bashkëkohore, e drejta e çdo personi për të marrë pjesë plotësisht në jetën kulturore nuk është më thjesht një zgjedhje politike diskrecionale, por një strategji e domosdoshme, si edhe një detyrim ligjor dhe një zgjedhje etike, e sanksionuar në një sërë aktesh të ndryshme ndërkombëtare.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD), e ratifikuar nga Shqipëria më 11 shkurt 2013, përcakton se shtetet duhet të sigurojnë aksesin e personave me aftësi të kufizuara në jetën kulturore në baza të barabarta me të tjerët, duke miratuar "*të gjitha masat e duhura*" për të hequr barrierat materiale, informative dhe të komunikimit që kufizojnë një pjesëmarrje të tillë (Neni 30). Ky detyrim përfshin si aksesin fizik në pasuritë kulturore ashtu edhe disponueshmërinë e përmbajtjes dhe shërbimeve kulturore të përdorshme dhe të projektuara për t'u aksesuar nga të gjithë (p.sh., informacion, udhëzues, video, etj.).

Në nivel evropian, *Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës mbi Vlerën e Trashëgimisë Kulturore* për Shoqërinë ("*Konventa e Faros*"), e nënshkruar edhe nga Shqipëria, riafirmon se trashëgimia kulturore është një element qendror për të drejtat e njeriut dhe cilësinë e jetës dhe se "*të gjithë kanë të drejtë të përfitojnë nga trashëgimia kulturore dhe të kontribuojnë në pasurimin e saj*". Konventa e zhvendos fokusin nga monumentet e veçanta te përdorimet, kuptimet dhe përfshirja sociale, duke i ftuar shtetet dhe komunitetet të hartojnë politika të trashëgimisë që garantojnë akses dhe pjesëmarrje për të gjithë.

Gjithashtu , *Karta e Solfagnano-s* (G7, Përfshirja dhe aftësia e kufizuar, 2024) përfaqëson një angazhim politik të kohëve të fundit dhe konkret nga qeveritë e ekonomive kryesore të botës për të promovuar përfshirjen dhe aksesin universal në të gjitha kontekstet, duke përfshirë vendet kulturore, përmes masave që nxisin pjesëmarrjen, projektimin e përbashkët dhe miratimin e teknologjive dhe praktikave gjithëpërfshirëse. Karta thekson rëndësinë e konsultimit aktiv me personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre në përcaktimin e politikave publike.

Së fundmi, Strategjia parashikon gjithashtu një sektor kulturor gjithëpërfshirës, të sigurt dhe jodiskriminues, ku barazia gjinore promovohet në mënyrë aktive dhe çdo dëshmi e dhunës apo diskriminimit me bazë gjinore në hapësirat kulturore trajtohet përmes parandalimit, mbrojtjes, monitorimit dhe veprimeve korrigjuese, në përputhje me Ligjit nr. 64/2025 për "*Barazinë Gjinore*".

4.2 Për një ekosistem krijues të hapur, inovativ dhe të ndërlidhur

Gjatë dekadës së fundit, industritë kulturore dhe ato krijuese (IKK) të Shqipërisë kanë filluar të marrin formë si një ekosistem dinamik, por ende i brishtë. Siç u vu re gjatë fazës së analizës së gjendjes ekzistuese, vendi pret një gamë në rritje të aktiviteteve krijuese, nga filmi dhe animacioni te muzika, botimet dhe media digjitale, që përfaqësojnë rreth 3% të PBB-së dhe punësojnë më shumë se 20,000 persona. Megjithatë, sektori mbetet shumë i fragmentuar, i

përqendruar në kryeqytet dhe i varur nga investimet publike dhe iniciativat e financuara nga jashtë.

Mes të gjitha fushave të IKK-së, industritë e përmbajtjes dhe medias paraqiten si fronti më premtues për inovacionin dhe punësimin e të rinjve. Rritja e platformave digjitale, prodhimit audiovizual, animacionit dhe rrëfimit krijues e lidh Shqipërinë me një treg më të gjerë evropian dhe global për përmbajtje kulturore. Megjithatë, barrierat strukturore, financimi i kufizuar, infrastruktura e dobët, mungesa e aftësive dhe mungesa e kapacitetit digjital, ende kufizojnë zhvillimin e tyre.

Deri në vitin 2030, industritë e përmbajtjes dhe medias në Shqipëri duhet të evoluojnë në një ekosistem krijues të hapur, inovativ dhe të ndërlidhur, ku trashëgimia, rrëfimtaria dhe krijimtaria digjitale bashkohen për të gjeneruar rritje të qëndrueshme ekonomike, përfshirje sociale dhe vizibilitet kulturor.

Ky vizion përputhet me tranzicionin e Evropës drejt një peizazhi mediatik të fuqizuar nga ana digjitale dhe të larmishëm nga ana kulturore, siç përshkruhet në *Perspektivën e Industrisë Mediatike Evropiane* (2025). Si rrjedhim, Strategjia Kombëtare e Kulturës në Shqipëri synon të pozicionojë vendin si një qendër rajonale për përmbajtje krijuese, të aftë të prodhojë dhe eksportojë vepra origjinale, duke forcuar njëkohësisht themelet e saj teknologjike dhe institucionale.

Ambicia afatgjatë është që Shqipëria të bëhet pjesë e zinxhirit evropian dhe global të vlerave të përmbajtjes kulturore, nga filmi dhe animacioni te lojërat, muzika dhe realiteti i zgjeruar (XR), duke promovuar njëkohësisht pluralizmin kulturor dhe lirinë krijuese. Kultura dhe krijimtaria duhet të bëhen komponentë integralë të zhvillimit të qëndrueshëm, duke fuqizuar krijuesit e rinj, duke nxitur pjesëmarrjen e komunitetit dhe duke përforcuar identitetin kulturor të Shqipërisë brenda peizazhit digjital të Evropës.

Sektori krijues në Shqipëri karakterizohet kryesisht nga prania e operatorëve mikro dhe strukturave informale, të cilët veprojnë shpesh në mënyrë të pavarur dhe me kapacitete të kufizuara për t'u integruar në tregje më të gjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, bashkëpunimi ndërmjet nënsektorëve të ndryshëm, si filmi, muzika, media dhe turizmi, mbetet sporadik dhe ende nuk ka çuar në krijimin e rrjeteve të qëndrueshme apo të strukturave të mirëorganizuara të prodhimit kulturor dhe krijues. Këto qendra mund të zhvillohen përmes partneriteteve midis bashkive, OJF-ve kulturore dhe investitorëve privatë, duke u frymëzuar nga modelet e suksesshme ndërkombëtare që kombinojnë infrastrukturën fizike me rrjetëzimin, mentorimin dhe mundësitë e financimit.

Arsimi dhe trajnimi në fushat kulturore dhe krijuese mbeten kryesisht teorike, jo plotësisht të përshtatur me nevojat e reja në fushat e teknologjisë dhe sipërmarrjes. Nuk ka shkollë të specializuar ose ofertë të vazhdueshme trajnimi për animacion, media digjitale ose prodhim audiovizual, duke çuar në migrim të talenteve dhe inovacion të kufizuar. Integrimi i arsimit krijues dhe teknologjik brenda kurrikulave universitare dhe profesionale është i nevojshëm. Programet për animacion, projektim lojërash, rrëfimi i të dhënave dhe sipërmarrje krijuese duhet të zhvillohen në partneritet me akademitë krijuese dhe shkollat mediatike nga vende të

tjera. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional dhe skemat e shkëmbimit do të ndihmonin në mbajtjen e profesionistëve të rinj dhe në ndërtimin e një fuqie punëtore krijuese të aftë për t'u angazhuar me standardet ndërkombëtare të prodhimit.

Trashëgimia dhe folklori i pasur i Shqipërisë përfaqësojnë një burim frymëzimi të pashfrytëzuar në kuadër të krijimtarisë bashkëkohore. Krijuesit vendas përballen me pengesa në mbrojtjen dhe monetizimin e punës së tyre për shkak të ndërgjegjësimit të dobët për të drejtën e pronësisë intelektuale dhe aksesit të kufizuar në tregjet ndërkombëtare.

Promovimi i krijimit dhe komercializimit të pronësisë intelektuale (PI) origjinale shqiptare që riinterpreton traditat, historitë dhe simbolet kombëtare në formate të shumta mediatike - film, animacion, lojëra dhe dizajn - është gjitashtu i nevojshëm. Përforcimi i mbrojtjes së PI-së, ofrimi i ndihmës ligjore dhe të marketingut për krijuesit dhe lehtësimi i pjesëmarrjes në panaire dhe festivale ndërkombëtare do të ndihmonte në shndërrimin e identitetit kulturor në një nxitës të vlerës ekonomike. Sektori varet kryesisht nga investimet publike ose programet institucionale, me qasje të kufizuar në kredi, kapital sipërmarrës ose financim të inovacionit. Në tërësi, ekzistojnë pak stimuj për investime private në ndërmarrjet krijuese. Për këtë arsye, krijimi i stimujve fiskalë, skemave të garancisë dhe fondeve për inovacion në mbështetje të bizneseve të reja krijuese dhe partneritetet ndërsektoriale, do të ishte një hap pozitiv. Për këtë mund të ndiqen modele evropiane si *MediaInvest* ose *Instrumenti i Garancisë së Sektorëve Kulturorë dhe Krijues.* Partneritetet publik-privat dhe grantet shumëvjeçare duhet të kenë përparësi për të mundësuar eksperimentimin, kërkimin dhe bashkëprodhimet ndërkombëtare.

4.3 Drejt një ekosistemi kulturor digjital kombëtar

Aktualisht, digjitalizimi brenda ekosistemit kulturor dhe mediatik është i kufizuar dhe i shpërndarë në mënyrë të pabarabartë. Ndërkohë që disa institucione kryesore në Tiranë kanë bërë hapa të rëndësishëm për digjitalizimin e arkivave dhe në adaptimin e mjeteve digjitale, pjesa më e madhe e institucioneve kulturore rajonale dhe sipërmarrjeve krijuese vazhdon të përballet me mungesë të infrastrukturës së nevojshme, kapaciteteve të specializuara profesionale dhe të burimeve financiare, të gjithë elementë thelbësore për angazhimin e tyre në prodhimin dhe shpërndarjen digjitale të përmbajtjeve kulturore.

Për të transformuar sistemin kulturor dhe krijues të Shqipërisë në një ekosistem të integruar, të bazuar në të dhëna dhe të gatshëm për inovacion, krijimi i një infrastrukturë gjithëpërfshirëse kombëtare digjitale kulturore do të jetë thelbësore. Ky mjedis funksional do të shërbejë si një platformë mundësuese që do të lidhë trashëgiminë, krijimtarinë, arsimin dhe aksesin publik brenda një vizioni të unifikuar dhe të qartë. Krijimi i *Qendrës Kombëtare Digjitale Krijuese* do të rrjetëzojë institucionet kulturore, *startup*-et krijuese dhe universitetet, duke shërbyer si një platformë për shkëmbimin e njohurive, inovacionin dhe trajnimin. E konceptuar jo vetëm si një hapësirë fizike ose virtuale, por si porta e dukshme drejt një ekosistemi digjital më të gjerë, kjo qendër mund të ndërlidhet dhe me iniciativa evropiane si *Creative Europe, MediaInvest* ose *EIT Culture & Creativity* për të përforcuar integrimin teknologjik, për të promovuar eksperimentimin me IA-në dhe XR dhe për të siguruar përfshirjen e aktorëve rajonalë në rrjetet e inovacionit digjital.

Kjo qendër vepron njëkohësisht dhe si pikë hyrëse në një *Ekosistem Digjital Kombëtar* që inkurajon bashkëpunimin, ndërveprimin dhe kapacitetin digjital në të gjithë vendin. Kjo qendër duhet të bashkojë të dhëna, rrëfim digjital, shërbime dhe mjete inovative, duke u vendosur si pika qendrore e referencës për ndarjen e informacionit, zhvillimin e kapaciteteve, krijimin e përputhjeve midis aktorëve të sektorit dhe nxitjen e angazhimit të vizitorëve në të gjithë Shqipërinë.

Qendra do të mbështetet mbi një program të mirëpërcaktuar të *Infrastrukturës Kombëtare të Hartëzimit dhe të Dhënave*. Trashëgimia materiale, duke përfshirë të gjitha muzetë, bibliotekat, monumentet, qendrat historike dhe sitet arkeologjike do të vijojnë të hartëzohen sipas standardeve ndërkombëtare të përcaktuara nga UNESCO dhe ICCROM, duke gjeneruar një burim dinamik, shumëgjuhësh të gjeoreferencuar dhe të aksesueshëm përmes një portali digjital ndërmedial. Trashëgimia jomateriale do të vijojë plotësimin e regjistrit të posaçëm kombëtar (Regjistri i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale) që dokumenton traditat, ritet, zanatet, historitë gojore, dhe që mbështetet te pjesëmarrja aktive e komunitetit dhe format e reja të dokumentimit audiovizual.

Së bashku, të gjithë elementët e mësipërm formojnë bazën për krijimin e një hapësire që mundëson unifikimin dhe ndërveprueshmërinë e të dhënave të trashëgimisë kulturore, duke u mundësuar institucioneve të bashkëndajnë njohuritë, të përmirësojnë praktikat e ruajtjes dhe të krijojnë narrativa që pasqyrojnë kontekstet lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Një hapësirë e tillë e të dhënave të trashëgimisë përbën bazën digjitale të domosdoshme për sisteme ndërvepruese, rrjedha të dhënash ndërinstitucionale dhe shërbime publike digjitale të ardhshme.

4.4 Roli i sektorit të pavarur

Strategjia Kombëtare për Kulturën 2026–2030 e konsideron sektorin e pavarur kulturor një partner kyç në zbatimin e saj, duke përfshirë qeverisjen, financimin dhe mekanizma të tjerë mundësues.

Për më tepër, Strategjia njeh se zhvillimi i shëndetshëm i sektorit kulturor dhe krijues kërkon një terren të barabartë të operimit midis institucioneve publike kulturore dhe aktorëve privatë ose të pavarur. Në këtë kontekst, roli i shtetit shqiptar është të stimulojë investimet publike dhe private, duke mbrojtur, promovuar dhe siguruar rritjen afatgjatë të sektorit të pavarur. Duke fuqizuar aktorët e pavarur dhe duke nxitur bashkëpunimin e tyre me institucionet formale, Strategjia synon të kultivojë një mjedis kulturor pluralist dhe të ripërtërishëm që mund të përshtatet me sfidat dhe mundësitë e reja. Kjo përfshin mbështetjen e autonomisë, rritjen e ndërtimit të kapaciteteve, promovimin e mekanizmave të financimit të drejtë, përmirësimin e aksesit në infrastrukturë dhe mjete digjitale, si dhe lehtësimin e angazhimit me komunitetet në nivel lokal dhe ndërkombëtar. Së fundmi, forcimi i sektorit të pavarur kontribuon në mënyrë vendimtare në pasurinë, qëndrueshmërinë dhe rëndësinë sociale të ekosistemit kulturor në Shqipëri.

4.5 Forcimi i kuadrit rregullator dhe reforma ligjore

Për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore
Themelimi i Institutit të Monumenteve të Kulturës (IMK) në vitin 1965 shënoi përpjekjen e parë sistematike për të përcaktuar tre objektiva kryesore për ruajtjen e trashëgimisë kombëtare: miratimin e instrumenteve ligjore që sigurojnë mbrojtjen efektive të pasurive me rëndësi historike dhe artistike; zhvillimin e një inventari gjithëpërfshirës të monumenteve kulturore; dhe miratimin e masave paraprake dhe emergjente për të mbrojtur trashëgiminë historike dhe arkeologjike nga përkeqësimi.

Ligji Nr. 9048/2003 "*Për trashëgiminë kulturore*" shënoi fillimin e një faze të re legjislative, duke përcaktuar kuadrin ligjor për identifikimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ligji përcaktoi parimet që rregullojnë klasifikimin dhe ruajtjen e trashëgimisë materiale dhe jomateriale dhe përcaktoi kompetencat mes institucioneve të ndryshme, duke përfshirë Institutin e Monumenteve të Kulturës, Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Institutin Arkeologjik, Institutin e Kulturës Popullore dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shtetit. Ky ligj tashmë është shfuqizuar dhe aktualisht ligji Nr. 27/2018 "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", i ndryshuar, ka kontribuuar në krijimin e një kuadri ligjor më koherent.

Megjithatë, pavarësisht konsolidimit të kuadrit rregullator , modelet bashkëkohore të qeverisjes kërkojnë një zhvendosje drejt administrimit të përbashkët ose bashkëpunues të pasurive kulturore, duke mundësuar përfshirjen aktive të aktorëve privatë të aftë për të siguruar burime financiare që shteti, duke pasur parasysh kufizimet buxhetore, nuk mund t'i ofrojë në mënyrë të qëndrueshme, duke ndjekur njëkohësisht parimin themelor se trashëgimia kulturore është një e mirë kolektive dhe jo thjesht një variabël ekonomik.

Si rrjedhim, Shqipëria angazhohet për të riprojektuar arkitekturën e saj rregullatore në përputhje me standardet evropiane, pa hequr dorë nga historia e saj institucionale, traditat administrative apo specifikat sociale dhe territoriale.

Propozimet e zhvilluara në seksionet vijuese mbështesin një kalim nga një model kryesisht i centralizuar dhe me ruajtjen si fokus të tij kryesor, drejt një ekosistem qeverisjeje më dinamik të bazuar në autonominë institucionale, administrimin e përbashkët, njohjen e zgjeruar profesionale dhe infrastrukturën digjitale. Edhe pse ky vizion buron nga përvojat e konsoliduara evropiane, veçanërisht modelet italiane dhe franceze, qëllimi nuk është riprodhimi i tyre, por zhvillimi i një kuadri që është koherent dhe i përgjigjet specifikave të kontekstit institucional dhe normativ shqiptar.

Forcimi i autonomisë së institucioneve kulturore publike.
Një fushë e rëndësishme e reformës ka të bëjë me nivelin e autonomisë së dhënë institucioneve publike të kulturës.

Në Itali, që nga viti 2014, disa muze publikë të përzgjedhur kanë përfituar një *autonomi të zgjeruar*, e cila u ofron drejtorëve të tyre lirinë menaxheriale, financiare, organizative dhe shkencore. Ky model i ka mundësuar institucioneve të ushtrojnë kontroll efektiv mbi

programimin, burimet njerëzore dhe mbledhjen e tarifave, brenda kuadrit të përgjegjësisë ligjore publike.

Një autonomi e tillë duhet, megjithatë, të kalibrohet mirë, në mënyrë që të mos ndërpresë lidhjen institucionale midis funksioneve të mbrojtjes dhe atyre të vlerësimit, të mos thellojë pabarazitë territoriale, si dhe të mos nënshtrojë ekspertizën shkencore dhe kuratoriale ndaj imperativave të menaxhimit.

Në Francë, muzetë kombëtarë kryesorë të organizuar si *Établissements publics administratifs* (EPA) gëzojnë status juridik të plotë sipas së drejtës publike dhe autonomi menaxheriale dhe shkencore, ndërkohë që mbeten subjekt i prioriteteve kulturore kombëtare përmes kontratës së objektivave dhe performancës, e cila përcakton objektiva shumëvjeçare të detyrueshme.

Në të dy këto vende, rritja e autonomisë menaxheriale, ndonëse jo pa kufizimet e veta, ka qenë një faktor vendimtar në nxitjen e inovacionit dhe diversifikimin e bruimeve të të ardhurave përtej financimit tradicional ministror.

Në kontekstin shqiptar, një kalim gradual drejt një regjimi të diferencuar autonomie mund të rezultonte i dobishëm. Krijimi i një kategorie të njësuar ligjore për institucionet kulturore publike, e cila do të përfshinte ndër të tjera, *Qendrën Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore,* do t'u mundësonte muzeve dhe parqeve arkeologjike të operonin me buxhete të pavarura, të rekrutonin personel sipas nevojave specifike të kontekstit, të zhvillonin strategji financiare dhe kulturore afatgjata dhe të lidhnin partneritete të strukturuara publik-privat. Njëkohësisht, një qasje e tillë duhet të garantojë që aksesi publik në trashëgimi të mbetet një interes i përgjithshëm i mbrojtur, i lidhur në mënyrë të pandashme me funksionin themelor të ruajtjes dhe mbrojtjes së saj.

Duke pasur parasysh ndikimin e mundshëm sistemik të këtyre reformave, zbatimi i tyre mund të nisë fillimisht në institucionet më të rëndësishme strategjike, të identifikuara në bazë të treguesve të tillë si të fluksit të vizitorëve dhe niveli i aksesueshmërisë publike. Në një fazë të mëvonshme, dhe mbi bazën e një vlerësimi të performancës administrative, si në aspektin e efikasitetit ashtu edhe të efektivitetit, ky model mund të shtrihet gradualisht në institucionet e tjera në të gjithë territorin e vendit.

Funksionimi i autonomisë institucionale varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga integriteti dhe transparenca e proceseve përmes të cilave formohen organet drejtuese si dhe i organeve këshillimore, si *Këshilli i Artit.* Përbërja dhe funksionimi *i tyre* duhet të pasqyrojnë të njëjtat parime të hapjes, kompetencës dhe pavarësisë mbi të cilat mbështetet vetë kuadri i autonomisë. Ky proces kërkon kalimin nga logjika e emërimeve administrativ drejt thirrjeve publike të hapura dhe konkurruese, me përzgjedhje të mbikqyrur nga panele teknike të pavarura. Përfaqësimi i balancuar në panele teknike, duke garantuar pjesëmarrjen e profesionistëve të pavarur nga sektori kulturor dhe krijues, krahas përfaqësuesve të institucioneve dhe të shoqërisë civile, nuk përbën vetëm një element procedural, por një kusht thelbësor për qeverisjes të mirë institucionale Një përbërje e tillë kontribuon në ruajtjen e integritetit dhe pavarësisë së vendimmarrjes, duke parandaluar ndikimin e interesave

administrative ose politike dhe duke siguruar që autonomia institucionale të përkthehet në drejtim artistik dhe intelektual të bazuar në kompetencë profesionale.

Rikonceptimi i trashëgimisë kulturore si një pasuri kolektive.
Një fushë tjetër që kërkon rishqyrtim ka të bëjë me konceptualizimin e vetë trashëgimisë kulturore. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, *Neni 59(1)(g)*, identifikon midis objektivave socialë të shtetit mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare dhe kulturore dhe ruajtjen e gjuhës shqipe. Kjo pasqyron një koncept tradicional, të përqendruar te shteti, të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

Në këtë drejtim, zgjerimi i mekanizmave të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit midis sektorit publik dhe privat mund të ndjek modelin e parashikuar në Kodin e Trashëgimisë Kulturore në Itali (d.lgs. 42/2004), i cili ofron një model të suksesshëm rregullator. Për më tepër, Kodi aktual i Prokurimit Publik i Italisë (d.lgs. 36/2023), ndryshe nga kodi francez i prokurimit publik, përcakton dispozita specifike (Nenet 132–134) për prokurimin në sektorin e trashëgimisë kulturore, duke lejuar instrumente fleksibël (duke përfshirë kontratat falas, sponsorizimet dhe PPP-të) me procedura të thjeshtuara për zgjedhjen e partnerëve privatë.

Në të gjithë Evropën, qasja e bashkëpunimit midis sektorit publik dhe privat ka një rëndësi të veçantë. Kuadri rregullator italian mbi hapësirat e përbashkëta urbane përfshijnë drejtpërdrejt qytetarët dhe shoqatat në menaxhimin e hapësirave kulturore, ndërsa kontratat kulturore territoriale të Francës promovojnë përgjegjësinë e përbashkët midis autoriteteve shtetërore dhe aktorëve lokalë për të siguruar akses të gjerë kulturor, për të forcuar bashkëpunimin ndërqeveritar, për të mbështetur programimin kulturor afatmesëm dhe për të integruar politikën kulturore me strategji më të gjera të zhvillimit territorial.

Shqipëria mund të mbështetet në këto modele duke miratuar marrëveshje partneriteti të institucionalizuara ose kontraktuale që përfshijnë administratat qendrore dhe lokale, qytetarët, universitetet dhe ndërmarrjet private ose me qëllime shoqërore për bashkëmenaxhimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale.

Krijimi gradual i një kuadri ligjor për profesionistët e kulturës.
Një ekosistem i qëndrueshëm i qeverisjes kulturore garanton ekzistencën e një komuniteti profesional të njohur dhe të mbrojtur. Shqipëria ende nuk ka një kuadër ligjor që të përcaktojë statusin juridik të profesionistëve të kulturës, duke adresuar çështje të tilla si natyra e paqëndrueshme e të ardhurave në sektorin krijues, lëvizshmëria ndërkombëtare dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional. Ky hendek rregullator tkrijon pasiguri strukturore për profesionistët e fushës, dobëson qëndrueshmërinë e ekosistemit kulturor dhe kufizon aftësinë e vendit për të mbajtur talente të kualifikuara, si dhe për të zhvilluar bashkëpunime dhe partneritete ndërkombëtare.
Përvojat krahasuese, si figura e *conservateurs du patrimoine* në Francë, përpjekjet e Italisë (ende të papërfunduara) për të rregulluar profesionet e kulturës (p.sh., arkeologët dhe restauratorët) dhe rregullimi i *conservadores-restauradores* në Portugali, tregojnë se njohja formale ligjore kontribuon në forcimin e qëndrueshmërisë sektoriale.

Një ligj i posaçëm për profesionistët e kulturës në Shqipëri mund të krijojë bazat për mbrojtje të përshtatshme të punës dhe të mbrojtjes sociale, për korniza kontraktuale të qarta dhe për vendosjen e standardeve profesionale të bazuara në specifikime teknike, siç janë standardet normative UNI të Italisë (p.sh., UNI 11588 për profesionet e muzeve). Krijimi dhe/ose përmirësimi i mëtejshëm i regjistrave profesionalë për arkeologët, restauratorët, historianët e artit dhe ekspertë të tjerë të kulturës, do të promovonte më tej profesionalizmin dhe garantonte cilësinë e shërbimeve dhe ndërhyrjeve në sektor.

Digjitalizimi në mbështetje të aksesit të përmirësuar dhe qeverisjes së trashëgimisë kulturore.
Në Shqipëri, bazat e të dhënave, inventarët, platformat *GIS* dhe katalogët e muzeve mbeten të fragmentuara dhe me ndërveprueshmëri të kufizuar. Ky fragmentim pengon planifikimin strategjik, monitorimin, kërkimin dhe aksesin e barabartë publik, duke thelluar kështu pabarazitë territoriale.

Një shembull i rëndësishëm, megjithëse kërkon shumë burime, është *Plani Kombëtar i Rimëkëmbjes dhe Rezistencës* (PKRR) i Italisë, i cili, brenda Misionit 1 ("*Digjitalizimi, Inovacioni, Konkurrueshmëria, Kultura dhe Turizmi*"), dhe konkretisht Komponentit 3 ("*Turizmi dhe Kultura 4.0*"), krijon një ekosistem shumë-teknologjik dhe ndërdisiplinor për inovacionin digjital, trajnimin dhe kërkimin në sektorin e trashëgimisë kulturore.

Integrimi më i gjerë i mjeteve digjitale në Shqipëri do të kontribuonte në kapërcimin e dobësive strukturore në qeverisjen e trashëgimisë kulturore, duke lehtësuar shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve dhe duke promovuar politika të të dhënave të hapura në përputhje me kërkesat e ndërveprueshmërisë. Një infrastrukturë e tillë do të ishte thelbësore për monitorimin e riskut, mbrojtjen në rast emergjence dhe luftimin e trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore, në përputhje me angazhimet që rrjedhin nga ratifikimi i fundit i *Konventës së Nikozisë*.

Për më tepër, mbrojtja efektive e trashëgimisë kulturore kërkon njësi të specializuara të zbatimit të ligjit. Një model shumë i suksesshëm është *Komanda Italiane e Karabinierëve për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore*, e cila vepron që nga viti 1969 dhe ka për detyrë parandalimin e eksporteve të paligjshme dhe lehtësimin e rikuperimit të pasurive kulturore të vjedhura.

4.6 Si të lexohet dokumenti

Strategjia buron nga katër prioritete kryesore të përcaktuara nga *Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit*, të identifikuara pas një vlerësimi të thelluar të sektorit. Ato janë:

1. Ruajtja dhe mbrojtjen e siteve të trashëgimisë kulturore
2. Rritja e industrive krijuese
3. Zhvillimi i infrastrukturës kulturore
4. Promovimi i përfshirjes dhe aksesueshmërisë.

Këto prioritete pasqyrojnë nevojat specifike të Shqipërisë dhe pajtueshmërinë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Pjesë e procesit analitik, ishte dhe shqyrtimi i *Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019–2025*, me komponentët e saj kryesorë dhe orientimet strategjike të përmbledhura në tabelën më poshtë. Kjo sintezë ofron një pasqyrë koncize të kornizës ekzistuese të politikave, duke shërbyer si një nga pikat e referencës për përcaktimin e drejtimeve të reja strategjike.

Orientimet kryesore të Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025		
Objektivi Strategjik	**Masat kryesore**	**Rezultatet e pritura**
1. Krijimi i një kornize të qëndrueshme legjislative dhe institucionale për zhvillimin e arteve, kulturës dhe trashëgimisë kulturore	Miratimi dhe rishikimi i legjislacionit bazë (Ligji për artin dhe kulturën, Ligji për kinematografinë, Ligji për pensionet e posaçme për profesionet artistike) Forcimi i sistemeve rregullatore dhe mekanizmave zbatues, veçanërisht në fushën e të drejtës së autorit Prezantimi i partneriteteve publike-private dhe strategjike në qeverisjen e trashëgimisë kulturore	Përputhja me standardet rregullatore të BE-së Rritja e qartësisë ligjore dhe parashikueshmërisë brenda sektorit kulturor Modele menaxhimi më të qëndrueshme dhe të diversifikuara
2. Reformimi i menaxhimit të trashëgimisë kulturore dhe institucioneve muzeale	Zbatimi i Ligjit për trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë (Nr. 27/2018) Përgatitja e planeve të menaxhimit të integruar për qendrat historike dhe siteve arkeologjike Përfshirja e instrumenteve legjislative, financiare dhe administrative në kornizat e menaxhimit	Struktura menaxhimi më të decentralizuara dhe efikase Ruajtje dhe konservim më i mirë i pasurive kulturore Potencial i forcuar për turizëm dhe arsim
3. Modernizimi dhe konsolidimi i rrjetit institucional	Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve kulturore Krijimi i institucioneve të reja dhe ristrukturimi i atyre ekzistuese Avancimi i transformimit digjital përmes platformave të tilla si Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore dhe sistemet e biletave elektronike	Aksesueshmëri dhe transparencë më e madhe Rritje në numrin e audiencës dhe të ardhura të vetë-gjeneruara Ndërlidhje e përmirësuar midis institucioneve kulturore
4. Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe avancimi i zhvillimit profesional	Zbatimi i programeve të trajnimit dhe certifikimit profesional të vazhdueshëm Promovimi i aftësive ndërsektoriale (p.sh., menaxhimi i projekteve, njohuritë ligjore, sipërmarrja) Pjesëmarrja në nisma ndërkombëtare shkëmbimi dhe rrjetëzimi	Kompetencë profesionale dhe konkurrueshmëri e përmirësuar në fuqinë punëtore kulturore. Bashkëpunim ndërkombëtar i zgjeruar. Aftësi të përforcuara drejtuese dhe menaxherial
5. Rritja e autonomisë financiare dhe diversifikimi i mekanizmave të financimit	Inkurajimi i mobilizimit të donacioneve, sponsorizimeve, financimit ndërkombëtar dhe programeve të BE-së. Futja e stimujve fiskalë për të stimuluar investimet private në kulturë dhe trashëgimi	Varësi më e ulët nga buxheti i shtetit Flukse financiare më të qëndrueshme dhe më të parashikueshme për sektorin. Angazhim më i lartë i sektorit privat në zhvillimin kulturor

Në kuadër të strategjisë kombëtare për kulturën në Shqipëri, **tre perspektivat kryesore për zhvillimin sektorial** nuk janë thjesht qasje konceptuale, por **janë identifikuar si tre shtyllat themelore strategjike të planit.** Këto perspektiva shërbejnë jo vetëm si një përgjigje efektive

ndaj nevojave të shprehura nga palët e interesit, por edhe si një katalizator për shfrytëzimin e pikave të forta unike të Shqipërisë, me synimin fundor të maksimizimit të potencialit transformues të kulturës në shoqëri.
Qasja në zhvillimin e shtyllave fillon me identifikimin e boshllëqeve dhe kërkesave urgjente në sektorin kulturor dhe krijues siç janë ***përfshirja, aksesueshmëria, zhvillimi i aftësive dhe modernizimi i infrastrukturës***. Aktivitetet janë formuluar për të trajtuar mangësitë e rëndësishme, për të krijuar një mjedis të favorshëm për profesionistët dhe audiencën kulturore dhe për të garantuar që asnjë komunitet apo grup të mos lihet pas dore. Analiza e të dhënave ekzistuese dhe angazhimi gjithëpërfshirës i palëve të interesuara theksuar këto nevoja, duke i dhënë përparësi ndërhyrjeve që ofrojnë përfitime materiale dhe nxisin qëndrueshmërinë e sektorit. Në vend që të përqendroheshin propozomet vetëm tek mangësitë, u hartëzuan dhe pikat e forta ekzistuese të Shqipërisë: një trashëgimi të pasur dhe e larmishme, një industri krijuese dinamike, një traditë e konsoliduar e përsosmërisë artistike (përfshirë praktikat e njohura nga UNESCO) dhe rrjetet e palëve të interesit. Duke shfrytëzuar këto pika të forta, strategjia mbështet iniciativa që përforcojnë identitetet kombëtare dhe lokale, promovojnë diplomacinë kulturore dhe rrisin pozicionimin në treg për kulturën dhe krijimtarinë shqiptare brenda dhe jashtë vendit. Krahasimi me praktikat më të mira dhe analiza krahasuese me homologët evropianë lejon rritjen e mëtejshme të avantazheve ekzistuese sektoriale.

Perspektiva e tretë e përdorur për të identifikuar shtyllat kryesore të strategjisë përqendrohet në aftësinë e sektorit për të nxitur ndryshime më të gjera shoqërore. Duke integruar parimet e orientuara drejt së ardhmes - inovacionin, qëndrueshmërinë dhe bashkëpunimin ndërsektorial - strategjia fuqizon kulturën si një nxitës kryesor i kohezionit social, zhvillimit të qëndrueshëm dhe sipërmarrjes krijuese. Mekanizmat e zbatimit përfshinë punëtori me pjesëmarrje me fokus vizionimin, ndërtimin e skenarëve dhe metodologjinë *Delphi* për të nxitur vizionin kolektiv për të ardhmen, si dhe koordinimin e politikave në shumë nivele dhe për shumë qëllime. Kjo perspektivë siguron që kultura të mos trajtohet si një aset statik, por si një motor transformimi me ndikim të matshëm në të gjithë shoqërinë shqiptare.

Strategjia përputhet me **kuadrin më të gjerë të politikave** të Shqipërisë mbi integrimin evropian, turizmin, zhvillimin e të rinjve dhe atë rural, angazhimin e diasporës dhe transformimin digjital. Ajo bazohet në një metodologji të qartë që përfshin praktikat më të mira, rishikimet rregullatore dhe krahasimin me standardet e Bashkimit Evropian dhe ato rajonale. Për më tepër, hartimi i politikave funksionon në tre nivele plotësuese:

- nivelin legjislativ, i cili siguron një kuadër ligjor koherent të harmonizuar me normat e BE-së;
- nivelin fiskal, i fokusuar në mekanizma të qëndrueshëm financimi, stimuj dhe partneritete publik-privat; dhe
- nivelin organizativ-menaxherial, që synon rritjen e kapaciteteve institucionale, modeleve të qeverisjes dhe mekanizmave të koordinimit ndërsektorial.

Kjo qasje me tre nivele siguron koherencë, llogaridhënie dhe efikasitet në zbatimin e strategjisë kombëtare kulturore brenda agjendës gjithëpërfshirëse të zhvillimit dhe integrimit të Shqipërisë.

Çdo shtyllë më pas vihet në funksion përmes objektivave specifike. Objektivat mbështeten në një rishikim gjithëpërfshirës të të dhënave ekzistuese, analizën e të dhënave sektoriale dhe kontributin e gjerë të palëve të interesit, duke përfshirë institucionet kryesore kulturore, operatorët e pavarur, sektorin krijues, aktorët rajonalë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile. Angazhimi i palëve të interesit u sigura përmes konsultimeve kombëtare si "*Gjendja e Përgjithshme e Kulturës në Shqipëri*" (GSCA), si dhe përmes pyetësorëve të synuar dhe raundeve të konsultimeve të organizuara nga MEKI dhe UNAA 2024.

Për çdo objektiv, specifikohen veprime të detajuara. Këto variojnë nga reformat ligjore dhe masat fiskale deri te ndërtimi i kapaciteteve, modernizimi i infrastrukturës, digjitalizimi, mbështetja e sipërmarrjes kulturore dhe partneritetet në nivel vendor dhe ndërkombëtar. Megjithatë, duke pasur parasysh kontekstin dinamik të brendshëm dhe të jashtëm në ditët e sotme, kërkohen rishikime vjetore për t'ju përshtatur kushteve në ndryshim. Përveç kësaj, duhet të hartohet një plan operativ vjetor, për të përkthyer veprimet strategjike në hapa konkretë, duke siguruar që strategjia të jetë e përditësuar, fleksibël dhe e aftë për t'u përshtatur.

Për më shumë transparencë dhe për ta lehtësuar planifikimin operacional, aktivitetet brenda strategjisë janë të strukturuara si sipas shtyllave, ashtu edhe sipas Objektivave Specifike. Kjo strukturë e dyfishtë e ndihmon Ministrinë përgjegjëse për kulturën të paraqesë dhe të diskutojë planet strategjike në dy formate plotësuese. Një qasje e tillë siguron që strategjia të jetë e kuptueshme dhe e aksesueshme, lehtëson dialogun e synuar dhe u mundëson të gjithë aktorëve të interesuar, përfshirë institucionet qeveritare, aktorët e sektorit dhe shoqërinë civile të angazhohen në zbatimin dhe monitorimin e saj sipas interesave dhe mandateve përkatëse.

Së fundmi, kjo mënyrë organizimi garanton një ndjenjë të bashkëndarë pronësie dhe mbështet natyrën pjesëmarrëse dhe bashkëpunuese të zbatimit të strategjisë, si dhe përputhjen e saj me praktikat më të mira në hartimin e politikave dhe angazhimin e palëve të interesit.

Të gjitha veprimet dhe politikat artikulohen përgjatë një **plani të qartë zbatimi**, që mbulon periudhën 2026-2030. Plani përfshin një kornizë të qëndrueshme monitorimi dhe vlerësimi, duke përcaktuar treguesit, aktorët dhe përgjegjësitë për dorëzimin në kohë dhe vlerësimin e ndikimit.

Pas përcaktimit të shtyllave dhe objektivave të qarta, strategjia ofron një kornizë të qëndrueshme, por të adaptueshme, e cila lejon integrimin dhe rishikimin e veprimeve specifike, duke mundësuar reagime të shpejta dhe efektive ndaj sfidave, mundësive dhe ndryshimeve të kontekstit.

Plani i veprimit bashkërlidhur dokumentit, ofron një kornizë të detajuar për secilën ndërhyrje të propozuar. Ato përshkruajnë objektivat specifike, përshkrimin, aktivitetet kryesore dhe afatin kohor të zbatimit, dimensionin sektorial dhe strategjik, përfituesit e synuar, treguesit e monitorimit, palët e interesuara të përfshira, burimet teknologjike të nevojshme, ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme, vlerësimin e kostove në buxhetin e MTKS dhe burimet e

mundshme të financimit. Secila fletë shërben si një referencë operacionale e përmbledhur për të mbështetur zbatimin dhe monitorimin e planit.

Aktivitetet kryesore janë propozuar bazuar në tre kritere kryesore: *vizibiliteti dhe pozicionimi ndërkombëtar*, duke siguruar që veprimi të ketë kapacitetin për të përfaqësuar dhe komunikuar strategjinë e përgjithshme në mënyrë efektive; *ndikimi te përfituesit direktë*, duke reflektuar potencialin për të gjeneruar përfitime materiale dhe të matshme; dhe *realizueshmëria financiare*, duke konfirmuar përputhshmërinë e veprimit me burimet e financimit të disponueshme dhe qëndrueshmërinë e tij të përgjithshme.

5. Politikat

Modernizimi i sektorit të kulturës në Shqipëri kërkon ndërhyrje të koordinuara ligjore, institucionale dhe menaxheriale për të mbrojtur trashëgiminë, për të zhvilluar industritë krijuese, për të përmirësuar infrastrukturën dhe për të promovuar përfshirjen dhe aksesibilitetin. Reformat legjislative sqarojnë rolet, forcojnë kornizat ligjore për trashëgiminë dhe krijimin artistik dhe vendosin bazën për pjesëmarrjen e komunitetit. Mekanizmat e financimit kanalizojnë burimet për restaurim, prodhim dhe infrastrukturë, duke kapërcyer mungesën kronike të financimit dhe duke nxitur barazinë territoriale. Përpjekjet menaxheriale përqendrohen në standardet profesionale, rrjetet kombëtare, transformimin digjital dhe partneritetet që përfshijnë sektorin publik, privat dhe atë të tretë. Duke i dhënë përparësi të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe aksesit digjital, këto reforma adresojnë boshllëqet e kapaciteteve, pabarazitë rajonale dhe pengesat në inovacion. Qasja gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunimi ndërsektorial bëhen përparësi strukturore, duke fuqizuar komunitetet në vendimmarrje dhe menaxhim. Së fundmi, ky model i integruar politikash synon të rrisë vitalitetin kulturor të Shqipërisë, të forcojë ekonominë e saj krijuese dhe të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm në përputhje me standardet evropiane dhe aspiratat lokale.

5.1 Politikat për trashëgiminë

5.1.1 Status quo

Korpusi zyrtar i trashëgimisë së Shqipërisë përfshin mbi 2,200 monumente të listuara dhe 206 zona të mbrojtura, duke pasqyruar një ndërthurje të pasur të qendrave të lashta urbane, arkitekturës fetare, fortifikimeve, ansambleve vernakulare, parqeve arkeologjike dhe veprave inxhinierike. Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë materiale funksionon përmes një sistemi kompleks që përfshin ministritë e linjës, agjencitë e specializuara, drejtoritë rajonale dhe institucionet e pushtetit vendor. Drejtoritë rajonale, thelbësore për dokumentimin dhe monitorimin, përballen me kufizime të kapaciteteve, pasi praktikat e reja, si qasjet ndaj peizazhit dhe inventarët digjitalë, janë ende duke u zhvilluar dhe integruar. Trashëgimia kulturore jomateriale (TKJ) ka një histori institucionale më të re dhe të fragmentuar. Regjistri dinamik kombëtar po zgjerohet, por shumë tradita mbeten ende të padokumentuara. Regjistri perceptohet më shumë si një mjet përputhshmërie ndaj kërkesave të UNESCO-s sesa si një mjet i fuqishëm për mbrojtjen në nivel komunitar; transmetimi është ende i bazuar në familje dhe pabarazitë rajonale vazhdojnë. Përfshirja e komunitetit, thelbësore sipas *Konventës së Faros*, është e kufizuar dhe kryesisht e bazuar në ngjarje, ndërsa praktikat e pakicave shpesh nuk njihen sa duhet.

Muzetë luajnë një rol kyç, por janë të përqendruara kryesisht në zonat urbane dhe përballen me sfida që lidhen me financimin, fragmentimin e qeverisjes, kapacitetet profesionale dhe transformimin digjital. Përpjekjet e fundit për zgjerim dhe rinovim synojnë modernizimin e menaxhimit dhe infrastrukturës; megjithatë, ndërtimi i kapaciteteve teknike dhe menaxheriale nuk ka ecur në të njëjtin ritëm me këto investime.

Analiza e gjendjes ekzistuese konfirmon sfidën e rritjes së kapaciteteve, nevojën për një planifikim më të mirë strategjik digjital, përshpejtimin e inventarizimit dhe domosdoshmërinë për koordinim më të mirë. Centralizimi, modelet e kufizuara të pjesëmarrjes dhe mangësitë në aftësitë digjitale duhet adresuar gjithashtu. Artizanët, të cilët janë elementë kyç për ruajtjen materiale dhe mbrojtjen e TKJ-së, veprojnë kryesisht si pjesë e ekonomisë informale, me mbështetje institucionale dhe vizibilitet ende të pamjaftueshëm. Ndonëse financimi i restaurimit dhe digjitalizimi janë rritur, investimet mbeten shumë të centralizuara rreth Tiranës dhe në zonat periferike nuk ofrohen shërbime të të njëjtit nivel si në infrastrukturë, ashtu edhe në programim.

Aksesueshmëria fizike dhe digjitale mbetet e kufizuar. Vetëm institucionet kryesore në Tiranë përmbushin standardet ndërkombëtare të aksesueshmërisë, ndërsa muzetë dhe sitet rajonale kanë vështirësi në modernizimin e tyre.

Digjitalizimi i TKJ-së, veçanërisht i traditave gojore dhe arkivat e komunitetit, është i paplotë, duke rrezikuar humbjen e shumë praktikave lokale për shkak të dokumentimit të pamjaftueshëm dhe strategjive të dobëta të transmetimit.

Propozimet e palëve të interesit

Gjatë procesit të konsultimit me palët e interesit në fazën e hartimit të strategjisë, u theksuan disa nevoja urgjente për sektorin e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë, duke përfshirë digjitalizimin e koleksioneve të trashëgimisë, krijimin e arkivave digjitale për trashëgiminë jomateriale, sigurimin e subvencioneve për restaurim, përcaktimin e standardeve profesionale, rritjen e promovimit të trashëgimisë jomateriale, krijimin e një muzeu të synuar për trashëgiminë jomateriale dhe dokumentimin e pasurive të trashëgimisë që nuk gëzojnë ende mbrojtje ligjore. Këto prioritete pasqyrojnë ndërgjegjësimim ekzistues mbi praktikat më të mira ndërkombëtare dhe njëkohësisht, një kërkesë për inovacione lokale përkatëse për të siguruar vazhdimësinë dhe vlerësimin e burimeve të pasura kulturore të Shqipërisë.

Lidhur me nevojat e mësipërme, pas një analize të thelluar identifikohen disa shkaqe kryesore të cilat mund të ndikojnë të tilla si: programet e restaurimit nuk janë të financuara sa duhet, sistemet digjitale mbeten të kufizuara dhe të fragmentuara, kapacitetet e stafeve në institucionet e trashëgimisë janë të pabarabarta dhe inventarizimi i pasurive të trashëgimisë është i paplotë ose jo i përditësuar. Këto dobësi strukturore thellohen më tej nga mungesa e sistemeve të centralizuara të të dhënave si dhe nga niveli i kufizuar i investimeve në inovacion dhe trajnim profesional.

Këto kufizime strukturore përkthehen në praktik në një nivel të pamjaftueshëm dokumentimi, interpretimi dhe vlerësimi të pasurive të trashëgimisë kulturore brenda politikave dhe programeve publike. Mekanzimat e ruajtjes parandaluese duhet të forcohen në kuadër të strategjive institucionale.
Si rrjedhojë, një pjesë e konsiderueshme e potencialit të trashëgimisë kulturore shqiptare mbetet e pashfrytëzuar në funksion të arsimit, angazhimit të komunitetit, dhe zhvillimit socio-ekonomik.

Pasojë e drejtëpërdrejtë e kësaj situate është rreziku i humbjes së një pjese të konsiderueshme të materialit kulturor dhe ndërprerja e vazhdimisësisë së transmetimit të njohurive. Elementët materialë dhe jo-materialë rrezikojnë të zbehen nga kujtesa koletive në mungesë të dokumentimit dhe vlerësimit të duhur. Integrimi i trashëgimisë në kurrikulat arsimore dhe itineraret turistike mbetet i kufizuar, duke reduktuar mundësitë për përdorim dhe përfshirje më të gjerë publik, si dhe duke kufizuar kontributin e saj potencial në zhvillimin e qëndrueshëm dhe rritjen ekonomike në nivel lokal.

Konsultimet me palët e interesit dhe analiza e gjendjes ekzistuese, evidentojnë nevojën për një qasje të integruar me disa nivele të politikave për menaxhimin e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë. Në këtë kuadër, identifikohen tre nivele të ndërlidhura të ndërhyrjes nëpërmjet politikave, të cilat synojnë të mbështesin modernizimin e sektorit, qëndrueshmërinë e tij dhe të rrisin vlerën e tij për komunitetin.

Së bashku, këto tre nivele politikash hedhin themelet për zhvillimin e një sektori të trashëgimisë kulturore në Shqipëri që është modern, i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Masat legjislative, intitucionale, financiare dhe menaxheriale, ndërveprojnë dhe përforcojnë njëra-tjetrën, duke krijuar përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj sfidave të identifikuara gjatë analizës së sektorit dhe procesit të konsultimit me grupet e interesit. Këto sfida lidhen me kapacitetet e kufizuara institucionale, pabarazitë territoriale në mbulim dhe akses, inventarizim ende të paplotë të pasurive, fragmentimin e mekanizmave të qeverisjes, si edhe me nivelin e kufizuar të pjesëmarrjes së komunitetit në menaxhimin dhe valorizimin e trashëgimisë kulturore.

Niveli legjislativ

Dimensioni legjislativ përqendrohet në përditësimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullator ekzistues me qëllim adresimin e boshllëqeve të evidentuara në legjislacionin aktual dhe në zbatimin e tij në praktikë.

Korniza ligjore ekzistuese parashikon kriteret për klasifikimin e trashëgimisë kulturore dhe përcakton procedura të qarta për verifikimin dhe deklarimin e tyre (Nenet 50-70 të ligjit). Megjithatë, kuadri ligjor duhet të plotësohet dhe të pasurohet më tej. Legjislacioni i përmirësuar duhet gjithashtu të nxisë qasje të reja digjitale për dokumentimin dhe të mbështesë njohjen e trashëgimisë që nuk ka pasur më parë status ligjor.

Nga perspektiva e hartimit të ligjit, në funksion të anëtarësimit në BE, ligji aktual do të ndryshohet dhe deri në vitin 2030, autoritetet duhet të miratojnë ndryshimin në legjislacionin ekzistues dhe aktet nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij, në mënyrë që ligji të jetë plotësisht funksional. Megjithatë, efektiviteti i çdo përmirësimi legjislativ do të varet edhe nga kapaciteti i institucioneve të mandatuara për ta zbatuar atë, veçanërisht Ministria përgjegjëse për kulturën, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK).

Për të siguruar funksionimin efektiv të kuadrit rregullator të përmirësuar, strategjia duhet të shoqërohet me masa që forcojnë kapacitetet institucionale, qartësojnë mandatet dhe

përforcojnë autonominë operacionale dhe autoritetin profesional të IKTK-së dhe DRTK-ve. Rritja e kapacitetit dhe qëndrueshmërisë institucionale është një parakusht për zbatimin e ligjit, zbatimin e besueshëm dhe integritetin e të gjithë sistemit të ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

Niveli fiskal

Mbështetja financiare përbën një nga instrumentet kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të trashëgimisë kulturore dhe për garantimin e ruajtjes, promovimit dhe transmetimit të saj tek brezat e ardhshëm. Politikat fiskale dhe mekanizmat e financimit duhet të adresojnë pabarazitë territoriale në shpërndarjen e burimeve, duke orientuar investimet jo vetëm drejt institucioneve kryesore kulturore në qendrat urbane, por edhe drejt institucioneve, komuniteteve dhe iniciativave lokale në zonat rajonale dhe rurale, të cilat shpesh kanë akses të kufizuar në financim dhe shërbime kulturore.

Mbështetja financiare, nëpërmjet buxhetit të shtetit, granteve, subvencioneve dhe mekanizmave të tjerë publikë e privatë të financimit, është thelbësore për restaurimin, konservimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë kulturore materiale, si dhe për dokumentimin, digjitalizimin, promovimin dhe transmetimin e trashëgimisë kulturore jomateriale. Njëkohësisht, ajo duhet të mbështesë forcimin institucional të muzeve, qendrave interpretuese dhe institucioneve të tjera të dedikuara mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore.

Kjo kornizë financimi synon të përmirësojë aksesin fizik dhe digjital në trashëgiminë kulturore, të rrisë kapacitetet për ruajtjen parandaluese dhe menaxhimin e qëndrueshëm të aseteve kulturore, si dhe të nxisë përdorimin e teknologjive inovative dhe modeleve të reja të administrimit. Gjithashtu, ajo synon të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve publike, sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë, duke diversifikuar burimet e financimit dhe duke rritur ndikimin e investimeve në sektorin e trashëgimisë kulturore.

Niveli menaxherial

Politikat menaxheriale theksojnë standardet kombëtare, regjistrat digjitalë dhe trajnimin e stafit. Analiza e situatës aktuale evidenton se institucionet e trashëgimisë kulturore nuk kanë kapacitetet teknike, menaxheriale dhe digjitale të nevojshme për dokumentimin, monitorimin, ruajtjen dhe interpretimin efektiv të pasurive kulturore. Reformat menaxheriale duhet të përqendrohen në zhvillimin e standardeve të qarta profesionale, krijimin e inventarëve digjitalë qendrorë dhe rajonalë, si dhe në zbatimin e trajnimit të vazhdueshëm të stafit dhe ndërtimin e kapaciteteve, veçanërisht në lidhje me mjetet e reja digjitale dhe modelet pjesëmarrëse. Forcimi institucional dhe miratimi i praktikave më të mira do të ndihmojnë në adresimin e mangësive të evidentuara dhe do të sigurojnë qëndrueshmërinë dhe cilësinë e menaxhimit të trashëgimisë në të gjithë vendin. Përveç kësaj, forcimi i mbështetjes për artizanët dhe mundësimi i kalimit të tyre nga ekonomia informale në atë formale do të kontribuojë në ruajtjen e trashëgimisë materiale dhe jomateriale.

5.1.2 Menaxhimi aktual i pasurive kulturore në Shqipëri

Në kontekstin shqiptar, menaxhimi i pasurive kulturore kryhet në mënyrë direkte nga institucionet dhe entitetet shtetërore, të cilat janë ministria përgjegjëse për kulturën, nëpërmjet institucioneve të saj të specializuara dhe drejtorive të saj rajonale. Edhe pse ka

kaluar kohë nga hyrja në fuqi dhe fillimi i zbatimit të Ligjit Nr. 27/2018, administrimi i drejtpërdrejtë i pasurive kulturore vazhdon të mbetet forma kryesore e menaxhimit dhe ruajtjes së tyre në Republikën e Shqipërisë, duke siguruar përputhshmëri me normat kushtetuese dhe dispozitat ligjore në fushën e trashëgimisë kulturore.

Administrimi direkt kryhet nëpërmjet DRTK-ve, zyrave për administrimin dhe koordinimin e pasurive kulturore dhe autoriteteve vendore. Zyrat për administrimin dhe koordinimin e parqeve arkeologjike janë struktura të posaçme të krijuara bazuar në Ligjin e mëpashme Nr. 9048/2003 "*Për trashëgimë kulturore*", ligjin nr.906, datë 6.6.2002 "*Për Zonat e Mbrojtura*", si dhe ligjin nr.8934, datë 5.9.2002 "*Për mbrojtjen e mjedisit*" sipas kuadrit ligjor mjedisor për pasuritë komplekse kulturore, siç janë komplekset historiko-arkeologjike, monumentale, arkitektonike-urbane dhe mjedisore. Meqenëse zona të caktuara arkeologjike mbivendosen me zona me status mbrojtjeje mjedisore, ndërhyrjet në këto zona kryhen në bashkërendim dhe në përputhje me planin e menaxhimit të zonës së mbrojtur përkatëse. Në praktikë, në disa raste vërehen mbivendosje kompetencash në menaxhimin e vendeve të trashëgimisë kulturore ndërmjet Drejtorive Rajonale dhe autoriteteve vendore. Një shembull i tillë është Kalaja e Gjirokastrës, ku vetë monumenti administrohet nga DRTK Gjirokastër, ndërsa muzetë që ndodhen brenda saj menaxhohen nga Bashkia.

Në kuadrin aktual ligjor, administrimi i pasurive kulturore dhe i zonave ku ato ndodhen rregullohet nga një tërësi dispozitash ligjore që synojnë garantimin e mbrojtjes, ruajtjes, menaxhimit të qëndrueshëm dhe përdorimit të kontrolluar të këtyre vlerave. Në fushën e trashëgimisë kulturore, kuadri kryesor rregullator përcaktohet nga Ligji Nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", i ndryshuar, i cili përcakton format e administrimit të pasurive kulturore, përgjegjësitë e institucioneve shtetërore, si dhe mundësinë e aplikimit të modeleve të administrimit të drejtpërdrejtë dhe indirekt.

Ndërkohë, për territoret ku pasuritë kulturore ndërthuren me vlera natyrore ose ndodhen brenda zonave të mbrojtura, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura dhe mbrojtjen e mjedisit. Ky kuadër synon të sigurojë një qasje të integruar të menaxhimit territorial, ku ruajtja e vlerave kulturore realizohet në harmoni me objektivat e konservimit të biodiversitetit, peizazhit dhe ekosistemeve natyrore. Në rastet kur pasuritë kulturore ndodhen brenda zonave që kanë edhe status mbrojtjeje mjedisore, administrimi dhe ndërhyrjet në këto territore realizohen në bashkërendim ndërinstitucional, duke respektuar kërkesat e legjislacionit për trashëgiminë kulturore, zonat e mbrojtura dhe planet përkatëse të menaxhimit.

Aktualisht, pasuria kulturore e cila menaxhohet në formën e administrimit indirekt sipas Ligjit Nr. 27/2018, "*Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë*", i ndryshuar janë *Nënzonat e trashëgimisë kulturore dhe peizazhit*, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, të cilat janë nën administrimin e *Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit*, në bazë të Ligjit Nr. 50/2022, "*Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit, pjesë e parkut kombëtar të Butrintit, midis Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit të Menaxhimit të Butrintit*". Megjithëse, ky rast paraqet një nga shembujt më të konsoliduar dhe të suksesshëm të zbatimit të modelit të menaxhimit indirekt të pasurive kulturore në Shqipëri, miratimi i këtij ligji u shoqërua me polemika të shumta në debatin publik dhe politik, kryesisht për shkak

të kundërshtimit nga opozita parlamentare, ai iu nënshtrua gjithashtu kontrollit të kushtetutshmërisë. Një grup përfaqësuesish të parlamentit (1/5 e anëtarëve të parlamentit) kërkuan shpalljen e antikushtetueshmërisë së ligjit 50/2022. Me Vendimin Nr. 34, datë 24.4.2024, Gjykata Kushtetuese vendosi rrëzimin e kërkesës.

5.1.3 Orientime të reja politike

Trashëgimia kulturore e Shqipërisë përbën një ekosistem unik dhe të pasur vlerash historike, kulturore dhe natyrore, por që mbetet strukturalisht i brishtë. Gjatë dekadës së fundit është shënuar progres i konsiderueshëm në forcimin e arkitekturës ligjore dhe institucionale të këtij sektori. Ky progres është materializuar veçanërisht përmes miratimit të Ligjit 27/2018 "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", i ndryshuar, krijimit dhe konsolidimit të regjistrave të trashëgimisë dhe zgjerimit gradual të zonave të mbrojtura. Këto zhvillime kanë kontribuar në konsolidimin e standardeve të ruajtjes dhe të mandateve institucionale, duke rritur kapacitetet e sistemit për të përballuar edhe sfida të jashtëzakonshme, si tërmeti i vitit 2019 dhe pandemia e COVID-19.

Megjithatë, vlerësimet në fushën e muzeve, trashëgimisë kulturore jomateriale (TKJ) dhe trashëgimisë materiale tregojnë se vazhdon të ekzistojë një hendek midis përmirësimeve në kuadrin ligjor dhe institucional dhe aftësisë reale të sistemit për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive sfidave bashkëkohore. Orientimet e reja të politikave të trashëgimisë synojnë të adresojnë këtë hendek duke artikuluar një kornizë strategjike holistike dhe të orientuar drejt së ardhmes, e cila e koncepton trashëgiminë kulturore jo si nënsektorë të fragmentuar, por si një të mirë publike të integruar, duke e pozicionuar atë si motor të zhvillimit të qëndrueshëm dhe si përgjegjësi të përbashkët institucionale, shoqërore dhe komunitare.

Një sfidë e përsëritur në të gjithë nënsektorët e trashëgimisë kulturore është fragmentimi i qeverisjes dhe kapaciteti i kufizuar i institucioneve në nivele të ndryshme. Sektori i trashëgimisë së paluajtshme përballet me zbatim jo të njëtrajtshëm të rregullave të planifikimit, integrim të kufizuar të mbrojtjes së trashëgimisë në proceset e zhvillimit dhe koordinim të pamjaftueshëm midis autoriteteve qendrore, rajonale dhe bashkiake. Muzetë, përveç kësaj, përballen me sfida strukturore ku zbatimi i ligjit të ri bashkëjeton me kapacitete profesionale të ndryshme, mungesë të standardeve të unifikuara dhe modele qeverisjeje që mund të forcohen, si dhe një hapësirë për të zhvilluar më tej rolin arsimor dhe angazhimin komunitar. Ndërkohë, fusha e TKJ-së, pavarësisht arritjeve të rëndësishme në inventarizim dhe institucionalizim, vazhdon të mbetet e ndikuar nga angazhimi vullnetar dhe pjesëmarrja e komunitetit, si dhe nga ekspozimi përmes aktiviteteve dhe festivaleve, në mungesë të mekanizmave të qëndrueshëm të mbrojtjes. Financimi i kufizuar dhe i padiversifikuar, pabarazitë rajonale, mungesa e burimeve njerëzore dhe pabarazitë rajonale dhe integrimi i moderuar në fushën e arsimit dhe zhvillimit lokal ndikojnë në qëndrueshmërinë e këtij sektori.

Ekosistemi i trashëgimisë kulturore në Shqipëri mbetet i brishtë për t'u përballur me sfidat e reja, përfshirë ndryshimet klimatike, urbanizimin e shpejtë, transformimet demografike dhe rritjen e paprecedentë të turizmit. Praktikat e konservimit janë kryesisht reaktive, ndërsa sistemet e dokumentimit, hulumtimit dhe monitorimit kërkojnë forcim dhe zhvillim të mëtejshëm për të siguruar qëndrueshmërinë dhe mbrojtjen efektive të pasurive kulturore.

Transformimi digjital është ende i pjesshëm dhe i pabarabartë, karakterizuar nga inventarizim i paplotë, metadata të paqëndrueshme dhe kapacitete digjitale të kufizuara. Burimet financiare mbeten kryesisht të varur nga buxheti i shtetit, me diversifikim të pamjaftueshëm, stimuj të kufizuar për përfshirjen e sektorit privat dhe mungesë të një qasje sistemike ndaj qëndrueshmërisë financiare të muzeve dhe institucioneve të trashëgimisë kulturore.

Mekanizmat e përfshirjes së komunitetit dhe të administrimit të përbashkët, që përfaqësojnë parime themelore të qeverisjes bashkëkohore të trashëgimisë kulturore, ende nuk janë implementuar plotësisht në praktikë.

Ndodhur në këtë kontekst, Strategjia Kombëtare për Kulturën 2026–2030 adopton një qasje të integruar dhe ekosistemike për sektorin e trashëgimisë kulturore. Muze dhe pasuritë e paluajtshme, si dhe trashëgimia jomateriale, trajtohen jo si elementë të ndarë, por si pjesë të një sistemi të vetëm, që kërkon mbrojtje, modernizim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Strategjia thekson se zhvillimi i qëndrueshëm dhe konsolidimi i trashëgimisë kulturore shqiptare mund të arrihet vetëm përmes forcimit të institucioneve, fuqizimit të komuniteteve, implementimit të praktikave të qeverisjes moderne dhe përmes adoptimit të modeleve të diversifikuara të financimit të qëndrueshëm.

Në këtë kuadër, strategjia artikulon katër qëllime strategjike, të cilat adresojnë sfidat e identifikuara dhe formulojnë një vizion të integruar dhe koherent për zhvillimin e sektorit të trashëgimisë gjatë dekadës së ardhshme.

Qëllimi Strategjik 1: Mbrojtja dhe vlerësimi i trashëgimisë kulturore të Shqipërisë
Ky qëllim adreson nevojat më urgjente të sektorit, duke përfshirë përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional të mbrojtjes, forcimin e mekanizmave të ruajtjes, si dhe sigurimin e transmetimit të trashëgimisë kulturore jomateriale. Strategjia pranon se mbrojtja dhe vlerësimi janë dy aspekte të ndërvarura: mbrojtja duhet të jetë e qëndrueshme, e ndjeshme dhe parandaluese ndaj rreziqeve, ndërsa vlerësimi duhet të jetë i përgjegjshëm dhe i orientuar drejt administrimit afatgjatë të pasurive kulturore.

Objektivi specifik 1.1 Forcimi i kornizës ligjore, institucionale dhe planifikuese për mbrojtjen e trashëgimisë.
Ky objektiv synon të konsolidojë përpjekjet për modernizimin e kuadrit ligjor, përforcimin e qeverisjes me disa nivele, integrimin e trashëgimisë në planifikimin hapësinor dhe përafrimin e praktikave e menaxhimit të saj me strategjitë mjedisore dhe klimatike. Ai prezanton vlerësimet e ndikimit në trashëgimi dhe thekson mekanizmat e koordinimit, të cilët mundësojnë funksionimin më koherent dhe efikas të të gjithë sistemit.

Objektivi specifik 1.2 Përmirësimi i ruajtjes, gatishmërisë ndaj riskut dhe qëndrueshmërisë ndaj klimës.
Ky objektiv synon të zhvendos sistemin e menaxhimit të trashëgimisë nga një qasje pasive e ruajtjes drejt një modeli parandalues dhe proaktiv. Ai mbështetet në zhvillimin e sistemeve kombëtare të vlerësimit të riskut, standardeve të kujdesit parandalues dhe

forcimit të kapaciteteve të specializuara për ruajtjen e pasurive kulturore. Në këtë mënyrë, adresohen dobësitë strukturore dhe sfidat afatgjata të sistemit. Planifikimi i bazuar në evidenca shërben si një mjet thelbësor për të përmirësuar kapacitetet ripërtëritëse ("*resilience*") dhe për të siguruar qëndrueshmëri afatgjatë të trashëgimisë.

Objektivi specifik 1.3 Mbrojtja dhe transmetimi i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (TKJ).
Ky objektiv synon të forcojë mbrojtjen e TKJ-së përmes një qasjeje të udhëhequr nga komuniteti, duke siguruar plotësimin dhe mirëmbajtjen e inventarit kombëtar dhe duke promovuar integrimin e TKJ-së në arsim, programe kulturore për të rinjtë dhe zhvillim lokal. Ky objektiv e zhvendos fokusin nga dokumentimi teknik drejt transmetimit të qëndrueshëm, duke prioritizuar bashkëpunimin e vazhdueshëm me komunitetet bartëse dhe mbrojtjen e elementëve të rrezikuar të trashëgimisë kulturore jomateriale.

Së bashku, këto objektiva krijojnë një themel të qëndrueshëm për një sistem të integruar mbrojtjeje të trashëgimisë kulturore, të aftë të adresojë sfidat strukturore afatgjata, si dhe ato që rrjedhin nga turizmi, urbanizimi dhe transformimet socio-ekonomike.

Qëllimi Strategjik 2: Modernizimi dhe forcimi i ekosistemit të trashëgimisë
Ky qëllim synon të përforcojë strukturat dhe proceset e qeverisjes së trashëgimisë kulturore, duke krijuar një sistem më efikas, të koordinuar dhe të përgjegjshëm. Ai thekson se mbrojtja efektive e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë kërkon forcimin e kapaciteteve institucionale në të gjitha nivelet - qendrore, rajonale dhe lokale - duke përmirësuar menaxhimin, koordinimin dhe transparencën; duke afruar dhe mbajtur profesionistë të trajnuar dhe të kualifikuar; dhe duke mundësuar muze të modernizuar dhe një infrastrukturë digjitale funksionale dhe të integruar.

Objektivi Specifik 2.1 Ndërtimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale në sektorin e trashëgimisë dhe muzeve
Ky objektiv synon forcimin e institucioneve kulturore të decentralizuara, përmirësimin e kushteve të punës dhe zgjerimin e mundësive të të nxënit. Ky objektiv synon ngritjen e standardeve profesionale dhe garantimin për institucionet e trashëgimisë që të përfitojnë nga zhvillimi i qëndrueshëm i kapaciteteve njerëzore dhe institucionale.

Objektivi Specifik 2.2 Modernizimi i sistemit të muzeve dhe promovimi i ekselencës
Ky objekti sjell nevojën për krijimin e një rrjeti kombëtar muzeor të integruar, zbatimin e modeleve të përditësuara të qeverisjes, ngritjen e një sistemi akreditimi dhe zhvillimin e një kuadri arsimor të harmonizuar për muzetë. Ky objektiv nxit gjithashtu avancimin e përvojave moderne të vizitorëve, promovon qasjen pjesëmarrëse dhe programimin e orientuar drejt komunitetit.

Objektivi Specifik 2.3 Ndërtimi i një ekosistemi digjital kombëtar të unifikuar për trashëgiminë kulturore
Ky objektiv synon të trajtojë fragmentimin ekzistues përmes digjitalizimit të të gjithë inventarëve kombëtarë dhe duke krijuar një platformë ndërvepruese që integron GIS-in, dokumentacionin, monitorimin dhe protokollet e të dhënave të hapura. Njohuritë

digjitale bëhen një përparësi strategjike, duke fuqizuar institucionet *GLAM* dhe duke mundësuar aksesin publik, transparencën dhe menaxhimin e bazuar në të dhëna. Qeverisja e të dhënave të platformës - përfshirë standardet e dokumentimit, kontrollin e cilësisë së metadata-s dhe integritetin e Regjistrit Kombëtar - do të ushtrohet nga IKRTK, përmes njësisë së digjitalizimit EXPA, në bashkëpunim me institucionet kontribuese.

Qëllimi Strategjik 3: Trashëgimia si nxitëse e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mirëqenies së komunitetit

Ky qëllim e pozicionon trashëgiminë kulturore si një burim strategjik për zhvillim gjithëpërfshirës dhe zhvillim të qëndrueshëm territorial. Ai synon të harmonizoje prioritetet kombëtare me agjendat dhe standardet ndërkombëtare, veçanërisht me qasjet e promovuara nga UNESCO, të cilat theksojnë rëndësinë e peizazheve kulturore, pjesëmarrjen aktive të komuniteteve dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm si instrumente për ruajtjen dhe valorizimin e trashëgimisë kulturore.

Objektivi Specifik 3.1 Integrimi i trashëgimisë në kornizat kombëtare dhe lokale të zhvillimit.

Ky objektiv synon të forcojë ndërveprimin midis trashëgimisë kulturore dhe politikave të zhvillimit duke konsoliduar lidhjet me turizmin, zhvillimin rajonal, rigjenerimit rural dhe planifikimit urban. Në këtë kuadër, peizazhet kulturore konceptohen si hapësira për zbatimin e qasjeve të integruara të menaxhimit, duke nxitur bashkëpunimin ndërinstitucional dhe sinergjitë ndërsektoriale.

Objektivi Specifik 3.2 Promovimi i turizmit të qëndrueshëm kulturor.

Ky objektiv synon të nxisë zhvillimin e turizmit kulturor në mënyrë të qëndrueshme, përmes menaxhimin e përgjegjshëm të vizitorëve, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe diversifikimin e destinacioneve kulturore. Ai përshtat në kontekstin shqiptar udhëzimet ndërkombëtare për turizmin e qëndrueshëm të promovuara nga UNESCO dhe parashikon krijimin e sistemeve afatgjata të monitorimit dhe interpretimit të trashëgimisë kulturore.

Objektivi Specifik 3.3 Mbështetja e ekonomive krijuese dhe kulturore të bazuara në trashëgimi.

Ky objektiv synon të fuqizojë artizanët, krijuesit dhe sipërmarrësit vendas përmes skemave të mbështetjes financiare, ndërtimit dhe zhvillimit të markës, programeve të inkubacionit dhe modeleve të bashkë-investimit. Përmes këtyre instrumenteve, ai nxit zhvillimin e iniciativave ekonomike që mbështeten në vlerat dhe pasuritë e trashëgimisë kulturore, duke inkurajuar inovacionin dhe krijimin e vlerës së shtuar në nivel lokal.

Objektivi specifik 3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së komunitetit, të drejtave kulturore dhe administrimit të përbashkët . Ky objektiv synon të promovojë zbatimin e parimeve të *Konventës së Faros*, duke mundësuar marrëveshje bashkë-menaxhimi, krijimin e këshillave lokale të trashëgimisë dhe nxitjen e iniciativave qytetare në fushën e kërkimit dhe dokumentimit të trashëgimisë. Ai promovon pjesëmarrjen e barabartë kulturore dhe angazhimin afatgjatë të komunitetit.

Qëllimi Strategjik 4: Inovacioni, financimi dhe qeverisja e bazuar në evidenca
Ky qëllim synon të garantojë qëndrueshmërinë afatgjatë të sektorit të trashëgimisë kulturore përmes modernizimit të mekanizmave të qeverisjes, forcimit të sistemeve të menaxhimit të pasurive të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s dhe promovimit të modeleve inovative dhe të qëndrueshme të financimit.

Objektivi Specifik 4.1 Modernizimi i sistemeve kombëtare të qeverisjes dhe menaxhimit të trashëgimisë.
Ky objektiv synon përafrimin e kornizave të menaxhimit të trashëgimisë kulturore me standardet dhe praktikat ndërkombëtare, forcimin e mekanizmave të qeverisjes dhe garantimin e pajtueshmërisë me standartet e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s dhe integrimin e trashëgimisë kulturore në sistemet kombëtare të monitorimit dhe raportimit.
Objektivi Specifik 4.2 Krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm financimi për trashëgiminë.
Ky objektiv synon zhvillimin e një kornize kombëtare financimi të diversifikuar për sektorin e trashëgimisë kulturore, duke kombinuar instrumentet financiare ekzistuese dhe të ardhshme posaçmërisht për trashëgiminë, stimujt fiskalë, partneritetet publike-private, dhe iniciativat pilot për rritjen e autonomisë institucionale. Ai parashikon gjithashtu forcimin e kapaciteteve në menaxhimin financiar, me qëllim nxitjen e një diversifikimi më të madh të burimeve financiare dhe rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit.

Objektivi Specifik 4.3 Promovimi i inovacionit dhe partneriteteve ndërsektoriale.
Ky objektiv synon të fuqizojë kërkimin, laboratorët e inovacionit, ndërmjet universiteteve dhe industrisë, si dhe angazhimin e diasporës, duke e vendosur inovacionin si një komponent thelbësor për qëndrueshmërinë afatgjatë të sektorit të trashëgimisë kulturore dhe për zhvillimin e praktikave të menaxhimit modern.

Objektivi Specifik 4.4 Zhvillimi i të dhënave, statistikave dhe treguesve të ndikimit kombëtar për trashëgiminë. Ky objektiv synon të forcojë hartimin e politikave të bazuara në evidencë duke krijuar një sistem të standardizuar përmes mbledhjes së të dhënave, zhvillimin e treguesve të lidhur me *Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm* (SDGs), si dhe integrimin e sistemeve të monitorimit dhe vlerësimeve të ndikimit.

Këto katër qëllime strategjike formojnë së bashku një vizion ambicioz të integruar për sektorin e trashëgimisë që është i mbrojtur, modern, i orientuar drejt komunitetit, inovativ dhe të mbështetur mbi modele të qëndrueshme financimi. Zbatimi nis me një fazë transversale të *Rivlerësimit Kombëtar të Trashëgimisë*, e cila mbështet disa kategori veprimesh përmes përditësimit të statusit juridik dhe pronësisë, përcaktimit të gjendjes fizike bazë, verifikimit të të dhënave për digjitalizim dhe qartësimit të profileve të vlerave kulturore. Të dhënat e përftuara orientojnë më tej planifikimin strategjik dhe vendimmarrjen mbi prioritetet e investimeve. Seksionet e mëposhtme zhvillojnë këtë perspektivë strategjike duke trajtuar çështje specifike që kërkojnë vëmendje të posacme brenda kuadrit të politikave të trashëgimisë të përcaktuar më sipër. Këto rekomandime nxjerrin në pah konsiderata shtesë,

ligjore, operative, financiare ose tematike, që dolën nga analiza dhe konsultimet me palët e interesit, të cilat kërkojnë reflektim të thelluar dhe veprime të koordinuara.

5.1.4 Aspekte thelbësore për vëmendje institucionale dhe strategjike
Pavarësisht synimeve ambicioze gjatë hartimit të Ligjit Nr. 27/2018, veçanërisht në lidhje me reformën institucionale dhe konceptuale të trashëgimisë kulturore, tetë vite pas hyrjes në fuqi, zbatimi i tij në praktikë ka hasur sfida të dukshme në praktikë.

Ligji vazhdon të paraqesë sfida interpretimi për zbatimin e tij, si rrjedhojë e volumit dhe kompleksitetit të dispozitave. Pengesat e hasura në praktikë specifikojnë përfshijnë dhe çështjet e mëposhtme:
Diskutimi mbi modelet e menaxhimit. Që nga miratimi i ligjit, janë ndërmarrë disa iniciativa të cilat kanë synuar kryesisht zhvillimin e administrimit indirekt përmes fondacioneve të posaçme, konkretisht Neni 171, pika 3, shkronjat "a" dhe "e", dhe pikat 5 dhe 6, Neni 172 dhe Neni 173, pika 1. Forma e administrimit indirekt përmes fondacioneve private, edhe pse paraqitet si një formë shumë moderne, efektive dhe e pavarur e administrimit, është përballur me shumë reagime negative. Kjo për shkak të traditës administrative në institucionet shqiptare, e cila ka favorizuar historikisht, administrimin e drejtpërdrjtë nga struktura shtetërore, duke e konsideruara këtë si formët më të sigurt për të garantuar mbrojtjen e interesit publik, në këtë rast të pasurisë kulturore. Hapësira për forcimin e kapaciteteve dhe përvetësimin e koncepteve të reja ligjore nuk ka qënë e mjaftueshme, duke ndikuar kueshtu në promovimin jo të plotë të koncepteve të reja, duke penguar përvetësimin dhe zbatimin e tij në praktikë nga aktorët përgjegjës.

Kuptueshmëria e ligjit. Kuptueshmëria ka qenë sfida kryesore gjatë zbatimit të ligjit. Ajo lidhet me tre arsye kryesore: 1) shtrirja e gjerë dhe kompleksiteti i çështjeve që rregullon, 2) përsëritja e disa dispozitave, dhe 3) mungesa e promovimit dhe/ose trajnimeve të duhura të personave përgjegjës për zbatimin e tij. Siç u analizua më sipër, ligji prezanton shumë koncepte të reja në lidhje me klasifikimin e pasurive kulturore, procedurat për verifikimin e vlerave kulturore, procedurat për ndërhyrjet në pronat private dhe publike, si dhe forma të reja të mbrojtjes dhe ruajtjes së pasurive kulturore dhe koncepte të reja në lidhje me administrimin dhe përdorimin e pasurive kulturore.

Struktura e re institucionale, edhe pse nuk e ndryshon marrëdhënien e ndërvarësisë, zgjeron kompetencat e organeve të mëparshme. Nga ky këndvështrim, zgjerimi i kompetencave nuk është reflektuar në rritjen e numrit të personelit dhe ndividëve përgjegjës për për zbatimin e tyre. Personeli ekzistues paraqet nevojën për trajnim të specializuar në lidhje me ligjin e ri dhe konceptet e reja të prezantuara prej tij, veçanërisht në lidhje me format e reja të administrimit dhe përdorimit të pasurive kulturore.

Hartimi i akteve nënligjore. Përveç debateve në lidhje me ligjin, një pengesë shtesë në zbatimin e tij lidhet me mosmiratimin e plotë të akteve nënligjore, të cilat duhej të ishin nxjerrë brenda dy viteve nga hyrja në fuqi. Mungesa e nxjerrjes së akteve nënligjore ngre dy probleme:

- Pengimin e zbatimin efektiv të ligjit, veçanërisht të dispozitave për të cilat kërkohet miratimi i akteve nënligjore për funksionim efektiv.

- Paqartësinë dispozitave përkatëse. Aktet nënligjore, duke përshkruar detajet për zbatimin e dispozitës, sqarojnë qëllimin e dispozitës në fjalë duke e bërë atë më të qartë dhe konkret.

Autonomia institucionale për organet/organizatat kulturore. Siç u shpjegua më sipër, ligji Nr. 27/2018, edhe pse ristrukturoi institucionet ekzistuese dhe krijoi institucione të reja duke zgjeruar fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, nuk sjell asnjë ndryshim në marrëdhënien e ndërvarësisë midis institucioneve shtetërore, duke lënë në fuqi kufizimet në lidhje me autonominë institucionale. Për shëmbull, *Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore* (DRTK) përfaqësojnë strukturat më të afërta me proceset konkrete të ruajtjes dhe mbrojtjes së pasurive kulturore. Nga pikëpamja institucionale, ato funksionojnë në varësi të ministrisë përgjegjëse për kulturën dhe financohen përmes buxhetit të shtetit. Kjo marrëdhënie varësie plotësohet nga roli i koordinimit dhe monitorimit të ushtruar nga *Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore* (IKTK), duke krijuar një strukturë të dyfishtë mbikëqyrjeje institucionale.

Nga ana tjetër, ligji i ri parashikonte tashmë modele alternative administrimi që synonin rritjen e shkallës së pavarësisë institucionale. Kjo qasje materializohet përmes përfshirjes së formave të reja të administrimit, në veçanti përmes krijimit të organizatave jofitimprurëse nga ministria përgjegjëse për kulturën ose nga institucione të tjera të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore. Bazuar në këto modele, administrimi i pasurive kulturore mund t' u transferohet këtyre subjekteve nëpërmjet marrëveshjevee të posaçme të lidhura me ministrinë përgjegjëse. Krijimi i subjekteve të reja dhe transferimi i administrimit përmes marrëveshjeve synonte krijimin e kushteve për një menaxhim më të pavarur dhe më fleksibël.

Nga pikëpamja e menaxhimit të trashëgimisë kulturore, ministria përgjegjëse për kulturën, si autoriteti kryesor qeverisës në këtë fushë, duhet të forcojë zbatimin efektiv të ligjit, të promovojë një shpërndarje më të balancuar të përgjegjësive në administrimin e trashëgimisë kulturore dhe të konsolidojë mekanizmat e monitorimit dhe mbikëqyrjes institucionale.

Imperativat për modernizimin e sektorit muzeor. Sektori i muzeve në Shqipëri funksionon pa një autoritet të unifikuar koordinues, çka sjell zbatim të fragmentuar të politikave, pabarazi në kapacitetet institucionale dhe mangësi të vazhdueshme në përmbushje të standardeve profesionale. Mungesa e një kuadri kombëtar akreditimi bën që muzetë të operojnë pa kritere të qarta dhe transparente cilësie, duke kufizuar mekanizmat e llogaridhënies dhe duke cenuar besimin e publikut.

Rrugët e zhvillimit profesional në sektor mbeten të fragmentuara dhe kryesisht informale: nuk ekziston një sistem kombëtar i njohur certifikimi, mungon një strukturë e qartë e zhvillimit në karrierë dhe mundësitë për trajnim dhe shkëmbim ndërkombëtar mbeten të kufizuara. Pabarazitë rajonale e thellojnë më tej këtë situatë: ndërsa muzetë në Tiranë përfitojnë nga afërsia me ekspertizën dhe burimet profesionale, institucionet muzeore në rajone përballen me nivel të kufizuar të ekspertizës profesionale dhe me infrastrukturë teknike të pamjaftueshme.

Modelet e qeverisjes mbeten relativisht të ngurta, ku administrimi direkt përbën formën dominuese, shpesh edhe të vetmen të funksionimit. Pavarësisht parashikimeve të ligjit nr. 27/2018, mekanizmat alternative të administrimit si për shëmbull fondacionet e posaçme, deri më sot janë zbatuar në mënyrë të kufizuar.

Muzetë funksionojnë kryesisht të izoluar nga njëri-tjetri, në mungesë të mekanizmave për shkëmbimin e përvojave, ndarjen e burimeve apo programimin e koordinuar. Përjashtimi digjital mbetet gjithashtu i theksuar , më pak se 10% e muzeve janë të integruar në platforma digjitale, ndërsa standardet e dokumentimit paraqesin dallime të konsiderueshme, duke ndikuar si në ruajtjen e koleksioneve, ashtu edhe aksesin publik.
Këto dobësi strukturore kufizojnë aftësinë e sektorit për të përmbushur me cilësi funksionet kulturore, arsimore dhe kërkimore, për t'iu përgjigjur standardeve të integrimit evropian, si dhe për të dhënjë një kontribut domethënës në zhvillimin e ekonomisë së turizmit. Adresimi i këtyre mangësive kërkon ridizenjim të koordinuar institucional, mekanizma transparentë të garantimit të cilësisë, si dhe investime të qëndrueshme në kapacitetet profesionale, duke hedhur kështu themelet për një ekosistem muzeor modern, llogaridhënës dhe me vlerë të lartë publike.

Qëndrueshmëria socio-ekonomike e bartësve të TKJ-së: Aktualisht, bartësit e TKJ-së funksionojnë kryesisht në mënyrë informale, pa mbështetje të strukturuar në formën e njohjes sistematike institucionale apo të mekanizmave të qëndrueshëm financiarë. Kjo situatë cenon vazhdimësinë e praktikave të transmetimit ndërbrezor, thellon mungesën e burimeve në zonat rurale ku traditat e TKJ janë më të përqendruara dhe rrezikon mbijetesën afatgjatë të shprehjeve kulturore në rrezik zhdukjeje, të cilat mbështeten në rolin aktiv të praktikuesve të gjallë. Për të kaluar nga njohja simbolike në një mbështetje të strukturuar dhe efektive, nevojitet krijimi i një kuadri formal që garanton qëndrueshmërinë socio-ekonomike të bartësve të TKJ-së. Mbi bazën e konsultimeve me *Akademinë e Shkencave të Shqipërisë* propozohet që bashkitë të akordojnë statusin "*Trashëgimi e Gjallë*" për bartësit e identifikuar të TKJ-së, i cili të jetë i lidhur me një skemë kompensimi financiar mujor, e konceptuar si një formë "*shërbim transmetimi të traditës*" në dobi të komunitetit, duke njohur rolin e tyre thelbësor në ruajtjen dhe përcjelljen e praktikave të trashëgimisë kulturore jomateriale. Ky sistem i decentralizuar njohjeje i shndërron bartësit nga subjekte pasive në profesionistë të njohur dhe të vlerësuar institucionalisht, duke adresuar mungesën e burimeve në zonat rurale dhe duke garantuar transferimin ndërbrezor të aftësive dhe praktikavetë rrezikuara. Kjo masë me kosto të ulët dhe ndikim të lartë, mbështet drejtpërdrejt komunitetet rurale strukturalisht të brishta, por që përbëjnë një nga shtyllat e identitetit kulturor të Shqipërisë.

Digjitalizimi i trashëgimisë materiale. Duke e konsideruar procesin e digjitalizimit të trashëgimisë si një sfidë të së ardhmes në sektorin kulturor, ministria përgjegjëse për kulturën ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me *Fondacionin Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit* (AADF), për krijimin e platformës digjitale për sektorin e trashëgimisë kulturore (ose qendrës së digjitalizimit). Kjo nismë parashikon gjithashtu ngritjen e një qendre të dedikuar digjitalizimi, të pajisur me infrastrukturë teknologjike sipas standardeve bashkëkohore dhe të mbështetur nga personel i kualifikuar profesionalisht. Ngritja e saj është në vazhdim të projektit "*Fuqizimi i muzeve përmes teknologjisë*" (Empowering Museums Through Technology), i cili synonte ruajtjen dhe promovimin e vlerës unike të koleksioneve

muzeale shqiptare duke kombinuar trashëgiminë kulturore me teknologjinë, nëpërmjet ekspertizës ndërkombëtare të imazherisë së trashëgimisë kulturore. Dy vjet më parë, AADF-ja mbështeti zhvillimin dhe përmirësimin nëpërmjet teknologjisë të dy muzeve kombëtare kushtuar artit dhe ikonografisë mesjetare, përkatësisht *Muzeut Kombëtar të Ikonografisë Onufri* në Berat dhe *Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar* në Korçë. Projekti është i ndarë në tre faza, 1) vlerësimi i koleksioneve muzeale, 2) digjitalizimi i tyre dhe 3) zbatimi i teknologjisë interaktive në muze. IKTK administron platformën kombëtare *webgis* të monumenteve dhe siteve kulturore, si dhe platformën kombëtare webgis të zonave arkeologjike dhe shërbimit arkeologjik në Shqipëri. Pasuritë e trashëgimisë kulturore regjistrohen në bazën e të dhënave të administruar nga *Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore* (IKRTK). Informacioni mbi vlerat, gjendjen e konservimit dhe karakteristikat kryesore të çdo monumenti apo siti të trashëgimisë kulturore dokumentohen përmes skedarëve individualë të monumenteve. Këto të dhëna mund të konsultohen dhe të vizualizohen përmes platformës webgis, duke përzgjedhur monumente specifike ose zona të caktuara në hartën digjitale.

Digjitalizimi i trashëgimisë jomateriale. Digjitalizimi i trashëgimisë kulturore jomateriale përbën një nga sfidat kryesore të së ardhmes për sektorin e trashëgimisë. Ndryshe nga trashëgimia materiale, e cila mbështetet në masa të mirëpërcaktuara konservimi dhe restaurimi, trashëgimia jomateriale kërkon qasje të ndryshme dokumentimi dhe ruajtjeje, pasi praktikat, njohuritë dhe shprehjet kulturore që e përbëjnë atë nuk mund të trajtohen me të njëjtat mekanizma që aplikohen për pasuritë fizike. Si rrjedhim, është e nevojshme të krijohen arkiva digjitale duke regjistruar këto shprehje kulturore në formate audio dhe audiovizuale, me qëllim dokumentimin sistematik të tyre për të lehtësuar ruajtjen, aksesin dhe transmetimin te brezat e ardhshëm. Për këtë arsye, UNESCO ka filluar procesin e regjistrimit dhe arkivimit të këtyre formave të shprehjeve kulturore me teknologjitë më të avancuara digjitale me qëllim dokumentimin dhe ruajtjen e imazheve dhe tingujve të këtyre kryeveprave. Për këtë qëllim, UNESCO dhe *Korporata Japoneze e Transmetimeve* (Nippon Hoso Kyokai) nisën në gusht 2004 një partneritet për arkivat e imazheve të trashëgimisë. Në këtë kuadër, IKRTK, në bazë të nenit 32 të Ligjit Nr. 27/2018, i ndryshuar, vijon të mbetet institucioni përgjegjës për standardet kombëtare të regjistrimit, identifikuesit unikë, integritetin dhe gjurmueshmërinë e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të pasurive kulturore. Institucionet e linjës dhe ato territoriale - përfshirë muzetë, parqet arkeologjike dhe DRTK-të - prodhojnë dhe përditësojnë të dhënat burimore sipas protokolleve të unifikuara të përcaktuara nga IKRTK. Kjo ndarje e qartë e roleve është parakusht për funksionimin koherent të veprimeve të propozuara (si *DIGIT.AL.HERITAGE* etj.) dhe për shmangien e fragmentimit institucional në menaxhimin e të dhënave të trashëgimisë kulturore. Aksesi publik në të dhënat e Regjistrit Kombëtar do të ushtrohet sipas një politike të klasifikimit të informacionit, duke balancuar transparencën me mbrojtjen e pasurive dhe siteve të ndjeshme. Në kuadër të përmirësimeve legjislative, rekomandohet dhe krijimi i një mekanizmi të strukturuar bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet ministrisë përgjegjëse për kulturën dhe strukturave të zbatimit të ligjit (Policisë së Shtetit, Policisë Kufitare dhe Administratës Doganore, etj.) për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë.

Çështjet e pronësisë: Pronësia mbetet një nga barrierat e vazhdueshme dhe komplekse për ruajtjen, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore të

paluajtshme të Shqipërisë. Ndonëse prej dekadash është identifikuar si një sfidë ndërsektoriale që kërkon veprim të koordinuar midis kulturës, drejtësisë, regjistrimit të pronave, qeverisjes vendore dhe zhvillimit territorial, përpjekjet e deritanishme në nivel kombëtar nuk kanë dhënë rezultatin e synuar. Por rrishtazi ka filluar një nismë tjetër qeveritare për regjistrimin me prioritet të pronave shtetërore, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt adresimit të kësaj sfide. Megjithatë mbeten ende nevojat për trajtimin tërësor të problematikave të mbivendosjeve të pasurive, apo braktisjeve të pronave. Ky hendek është veçanërisht i dukshëm në Gjirokastër, ku rastet e pronësisë së copëzuar dhe të paqartë vazhdojnë të pengojnë ruajtjen e strukturës së saj historike. Çështja mbetet e pazgjidhur, e fragmentuar nëpër institucione dhe jo plotësisht e trajtuar në kornizat e politikave të integruara, duke theksuar nevojën për një angazhim të ardhshme dhe të dedikuar për të kuptuar plotësisht dhe eksploruar rrugët e mundshme drejt tejkalimit të barrierave që lidhen me pronësinë.

Rastet e braktisjes së banesave si pasojë e emigrimit janë mjaft të zakonshme në Evropë. Shembuj të spikatur përfshijnë Italinë, ku shpopullimi rural ka çuar në një numër të madh banesash të braktisura, por edhe Bullgarinë, Rumaninë, Hungarinë dhe Poloninë, ku zonat rurale preken rëndë nga emigrimi masiv dhe plakja e popullsisë; si dhe Berlinin pas rënies së Murit, i cili përjetoi lëvizje të mëdha migrimi dhe, si pasojë, një numër të konsiderueshëm pronash nbetën vakante.

Politikat për pronat e braktisura kanë ndryshuar ndjeshëm në të gjithë Evropën, duke filluar nga legalizimi i shtëpive vakante të okupuara nga artistët pas rënies së Murit të Berlinit, te procesi i kthimit të pronës për ata që u detyruan të linin shtëpitë e tyre pas Luftës së Dytë Botërore, e deri te politikat që synojnë restaurimin e banesave tradicionale në fshatra e zona rurale për të luftuar shpopullimin.

Këto shembuj ofrojnë njohuri të vlefshme për të reflektuar mbi situatën e Shqipërisë, megjithatë ato mbeten të pamjaftueshme për të rrokur plotësisht kompleksitetin e saj. Ndryshe nga Italia, Polonia apo Berlini, Shqipëria përballet me sfidën shtesë të menaxhimit të trashëgimisë së zhvillimit informal gjatë periudhës pas tranzicionit, e cila shton një shtresë tjetër paqartësie strukturore në menaxhimin e pronës dhe planifikimin urban. Trajtimi i duhur i këtij dimensioni do të kërkonte një analizë më gjithëpërfshirëse dhe shumëplanëshe që merr në konsideratë faktorët historikë, ligjorë, socialë dhe ekonomikë, një sipërmarrje kjo që tejkalon qëllimin dhe objektivat e këtij dokumenti. Për këtë arsye, rekomandohet komisionimi i një studimi të posaçëm, të fokusuar specifikisht në pasojat dhe zgjidhjet që lidhen me zhvillimin informal, me qëllim krijimin e një baze të fortë për hartimin e politikave të mirëinformuara dhe të strategjive të ndërhyrjes të përshtatshmea për kontekstin unik të Shqipërisë.

Financimi publik për operimin bazë: DRTK-të dhe IKTK vënë në dukje se rezultatet bazë të ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore nuk mund të arrihen vetëm përmes projekteve me financim konkurrues, por kërkojnë një qasje sistematike dhe të qëndrueshme. Ato rekomandojnë një linjë buxhetore të garantuar për operimin dhe punën në terren, të përcaktuar përmes një formule shpërndarjeje të drejtë dhe transparente që reflekton numrin e monumenteve/siteve, shtrirjen e mbulimit territorial dhe shkallën e ekspozimit ndaj riskut,

si dhe nevojën për mbështetje të dedikuar për monumentet në gjendje risku. Në këtë kuadër, nevojitet financim bazë i shtuar nga shteti për veprimet mbrojtëse rutinore, inspektimet dhe stabilizimin e menjëhershëm, duke ofruar paralelisht dhe fonde me bazë konkurrimi për inovacion dhe projekte pilot. Kjo qasje nënvizon gjithashtu rëndësinë e një alokimi bazë më të lartë të buxhetit të përgjithshëm nga *Ministra e Financave*, pasi detyrimet ligjore të ruajtjes e mbrojtjes, sado minimale, janë të pandërprerera dhe nuk mund të varen nga pasiguritë e cikleve të projekteve.
Subvencione për restaurim: sipas ligjit nr. 27/2028, ndërhyrja për konservimin/restaurimin e trashëgimisë kulturore në prona private, kostot e ndërhyrjeve vullnetare të konservimit, të parashikuara në Nenin 89 të këtij ligji, mbulohen nga pronari ose poseduesi i tyre. Për të mbështetur ndërhyrjet vullnetare, është ideuar dhe zbatuar programi i "*Bonusit të Rijetëzimit*", një iniciativë vjetore e Qeverisë Shqiptare, e implementuar nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për kulturën, me qëllim restaurimin dhe rijetësimin e ndërtesave në qendrat historike. Ky mekanizëm promovon modele biznesi të qëndrueshme, të cilat gjenerojnë të ardhura dhe mundësi punësimi për komunitetin lokal. Kjo iniciativë është një ndihmë financiare për të gjithë ata individë që zotërojnë një ndërtesë në qendrat historike të qyteteve dhe marrin përsipër për ta zhvilluar më tej atë duke kontribuar në zhvillimin ekonomik lokal.

Duke marrë në konsideratë problemet e pronësisë me të cilat përballet shoqëria shqiptare, burimet e pakta financiare, si dhe mungesën e vullnetit për të kryer ndërhyrjet, ligji në fjalë e ka trajtuar gjithashtu edhe këtë çështje. Bazuar në nenet 90-94 të ligjit, në rast se pronari ose poseduesi nuk përmbush detyrimin për të kryer ndërhyrje konservuese dhe në këtë mënyrë nuk zbaton vendimin e *Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale* (KKTKM), Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore merr përsipër t'i kryejë vetë këto ndërhyrje duke zgjedhur një institucion privat ose publik për të kryer punimet.

Lidhur me financimin e ndërhyrjeve në pasuritë kulturore publike, ligji ka krijuar *Fondin e Kujdesit për Trashëgimisë Kulturore* në formën e një fondi financiar publik, i cili mbështet politikën kombëtare të mbrojtjes, ruajtjes dhe zhvillimit të trashëgimisë kulturore materiale.

Bazuar në VKM 737/2020 "*Për përcaktimin e rregullave për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale*", të ndryshuar, të ardhurat e fondit përdoren për të mbështetur politikën kombëtare për ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave të trashëgimisë kulturore materiale, në drejtimet kryesore të mëposhtme:

- kryerjen e ndërhyrjeve emergjente për konsolidimin, konservimin dhe restaurimin e pasurive kulturore;
- zbatimin e projekteve për zhvillimin, mbrojtjen, konservimin, restaurimin dhe rivitalizimin e pasurive kulturore dhe/ose nëpërmjet granteve ose instrumenteve të tjera të financimit;
- kryerjen e studimeve, dokumentimin në kuadër të mbrojtjes, ruajtjes dhe rehabilitimit të trashëgimisë kulturore materiale, siç përcaktohet në Ligjin Nr. 27/2018, si dhe hartimi i projekteve për mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e pasurive kulturore;
- zhvillimin e projekteve kulturore, me qëllim promovimin e trashëgimisë kulturore materiale;

- trajnimin e stafit dhe specialistëve, në të gjitha nivelet, në fushën e identifikimit, mbrojtjes, konservimit dhe rehabilitimit të trashëgimisë kulturore materiale;
- zhvillimin e aktiviteteve të tjera të trashëgimisë kulturore, me miratimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Standardet profesionale. Sipas pikës 6, Neni 82 të ligjit, trajnimi i vazhdueshëm i personave që janë të pajisur me licencat e përmendura në pikën 2 të këtij Neni, kryhet nga "*Qendra Rajonale për Konservimin dhe Restaurimin e Evropës Juglindore*" pranë IKTK-së, ose nga subjekte publike ose private, në bazë të një marrëveshjeje bashkëpunimi. Kriteret dhe nivelet e cilësisë që duhet të ketë programi i trajnimit të vazhdueshëm përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë. Bazuar në VKM Nr. 464, datë 26.7.2023 "*Për funksionimin, organizmin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë të Qendrës Rajonale për Restaurim dhe Konservim*", misioni i kësaj qendre është trajnimi dhe përditësimi i njohurive të restauratorëve dhe subjekteve të licencuara, sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore, hartimi dhe zbatimi i programeve të trajnimit për specialistët në fushën e trashëgimisë kulturore materiale.

5.1.5 Rekomandime mbi përmirësimet ligjore

Lidhur me disa çështje të ngritura nga palët e interesit gjatë Forumit të hapur mbi "Gjendjen e Përgjithshme të Kulturës në Shqipëri" në tetor 2025, dhe konsultimeve me institucionet e linjës, vlerësojmë se nuk ka ndonjë implikim ligjor, apo ndonjë nevojë për ndryshime ligjore më shumë sesa është analizuar më sipër. Zgjidhjet për këto çështje mund të gjenden në legjislacion, siç shpjegohet në këtë analizë.

- **Subvencionet për restaurim.** Duke gjykuar nga korniza ligjore në fuqi, është e rëndësishme të identifikohen dy çështje në lidhje me subvencionet e restaurimit. Kryerja e punimeve ka dy çështje për të zgjidhur:

  1) mënyra e ndërhyrjes së ministrisë për të kryer punimet e restaurimit. Ajo parashikon mundësinë e ndërhyrjeve me bashkëpunimin e pronarit/poseduesit duke rregulluar procedurën vullnetare të restaurimit dhe pavarësisht nga vullneti i tyre duke rregulluar ndërhyrjet e detyrueshme dhe duke dhënë mjetet për të zbatuar ligjërisht vendimmarrjen e institucioneve të trashëgimisë. Duke marrë në konsideratë problemet që rrjedhin nga çështjet e pronësisë në Shqipëri, ligji i ka trajtuar edhe këto çështje duke vendosur të njëjtin detyrim për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore për pronarin dhe poseduesin dhe duke i vendosur ata në të njëjtën pozicion ligjor procedural.

  2) mbështetja financiare e punimeve. Ligji nr. 27/2018 ka parashikuar *Fondin për Kujdesin e Trashëgimisë Kulturore*, i cili është provuar si një burim efektiv financimi për kryerjen e punimeve të restaurimit për të dyja llojet e ndërhyrjeve. Në rast të ndërhyrjeve të detyrueshme, duke marrë në konsideratë urgjencën e punimeve të tilla, ai siguron burimin e menjëhershëm financiar të investimit deri në ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit për institucionet e trashëgimisë kulturore. Në rast të kryerjes vullnetare të punimeve, ai ka shërbyer si një mjet financimi për projektin e bonusit të Rijetëzimit. Një nga burimet e financimit të këtij Fondi ka statusin e "*të ardhurave të*

paplanifikuara jashtë fondit të miratuar në ligjin vjetor të buxhetit", që do të thotë se këto të ardhura janë nën kontrollin e strukturës përgjegjëse për menaxhimin e tyre. Këto fonde nuk zhvendosen në buxhetin e shtetit në fund të vitit financiar, por mbeten nën kontrollin e Ministrisë së Kulturës për t'u përdorur sipas ligjit dhe akteve nënligjore të trashëgimisë kulturore. Që do të thotë se ato nuk janë të lidhura nga afati i buxhetit për përdorimin e këtyre fondeve, por janë një shumë e përhershme që menaxhohet nga një strukturë e veçantë dhe kryhet në buxhetin e ministrisë vitin pasardhës. Financimi që ka këtë status është "b) *të ardhura dytësore të gjeneruara nga ofrimi i shërbimeve dhe përdorimi i pasurive kulturore nën administrimin e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ose institucioneve të specializuara nën juridiksionin e saj dhe nën administrimin e institucioneve nën ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe muzetë publikë*". Ky zë mund të jetë një burim i rëndësishëm financimi nëse menaxhohet siç duhet brenda Fondit. Duke marrë në konsideratë faktin që Fondi ka shërbyer si një mjet i rëndësishëm për financimin e të dyja mënyrave të ndërhyrjeve, si dhe statusin e veçantë të njërit prej zërave të financimit, është e rëndësishme të forcohet më shumë ky burim financimi duke lobuar vazhdimisht në Ministrinë e Financave në mbështetje të pavarësisë së tij dhe një vetëmenaxhimi të plotë të këtij Fondi nga ministria kompetente për trashëgiminë kulturore. Lobimi duhet të synojë zgjerimin e statusit të "*të ardhurave të paplanifikuara jashtë buxhetit limit*" edhe tek zërat e tjerë të Fondit.

- **Konsolidimi i praktikës së Bonusit të Rijetëzimit** duke e rregulluar atë ligjërisht, nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore përkatëse. Kjo mund të zbatohet përmes një procedure të zgjedhur projekti ose një procedure konkurruese. Ajo duhet të bëhet një praktikë e përsëritur, pasi shërben gjithashtu si një mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin e pronarëve/poseduesve mbi rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore.

5.1.6 Identifikimi i institucioneve dhe aktorëve përgjegjës për zbatimin e reformave.

Përmbushja e objektivave të strategjisë kërkon bashkëveprim aktiv midis institucioneve të specializuara të trashëgimisë kulturore të organizuara nga ministria përgjegjëse për kulturën, në partneritet me agjencitë partnere dhe palët e interesuara në fushën e trashëgimisë kulturore.

Ministria përgjegjëse për kulturën do të udhëheq procesin e ndryshimeve ligjore, si dhe procesin e hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore, duke krijuar grupe pune me përfaqësues të institucioneve të specializuara. Grupet e punës do të ndahen në bazë të objektit të rekomandimit që do të zbatohet.

Grupet e punës do të jenë:

- Grupi i punës për ndryshimet në ligj
- Grupi i punës për miratimin e akteve nën-ligjore

Lidhur me trajnimin intensiv, ai duhet të organizohet nga një strukturë e përhershme brenda ministrisë, e cila do të jetë Drejtoria e Politikave për Trashëgiminë Kulturore.

Ministria përgjegjëse për kulturën do të jetë institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të rekomandimeve. Ajo do të mbikëqyrë hartimin e ndryshimeve legjislative dhe riorganizimin e institucioneve kulturore në varësi.

Institucione të specializuara që do të përfshihen:

- Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
- Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore
- Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore
- Qendra Kombëtare për Aktivitete Tradicionale
- Institucionet e Rrjetit Kombëtar Arkivor
- Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë
- Instituti i Arkeologjisë

Miratimi i ndryshimeve ligjore të sipërcituara do të kërkojë gjithashtu bashkëpunimin me ministritë kyçe si janë, siç janë Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave.

5.2 Korniza e politikave për rritjen e industrive krijuese

Kur politikat kulturore klasifikohen sipas funksionit të tyre, shfaqen të paktën dy kategori kryesore: politikat e ruajtjes dhe ato të përkushtuara ndaj prodhimit kulturor (Santagata, 2007). Sot, përtej domosdoshmërisë për të ruajtur, menaxhuar dhe mbrojtur trashëgiminë, është koha që burime t'i alokohen dhe krijimi të kulturës së re, mbrojtjes dhe mosdegradimit të peizazhit, tejkalimit të neglizhencës ndaj edukimit të të rinjve, si dhe zhvillimit të kërkimit teknologjik.

Zhvillimi ekonomik i industrive kulturore mbështetet thellësisht te krijimtaria. Krijimtaria është një aset strategjik për rritjen ekonomike për disa arsye:

- Ajo shërben si një kontribut themelor në proceset estetike, dekorative dhe të dizajnit, duke ndikuar në komponentët e pronësisë jomateriale dhe intelektuale të produkteve;
- Është thelbësore në inovacionin teknologjik, rritjen e produktivitetit dhe standardet teknike;
- Ajo i shton produkteve vlerë simbolike, duke ndikuar në formësimin e kërkesës dhe në rritjen e konkurrueshmërisë;
- Ajo riorganizon ndërmarrjet rreth praktikave epistemike dhe atyre me bazë komunitare (Creplet et al., 2003; Wenger, 1998), duke krijuar një sinergji jetike mes dimensioneve intelektuale/artistike/kognitive dhe atij ekonomik të orientuar drejt angazhimit në treg dhe rregullat organizative.

Në thelb, transformimet e mëdha të shoqërisë dhe kulturës kanë lehtësuar kalimin nga sistemet statike drejt kornizave më dinamike dhe të hapura, duke rritur nevojën për përshtatshmëri, për kapacitete në adresimin e sfidave të reja, si dhe për gjenerimin e përgjigjeve inovative në vendimmarrje.

Sfidat e vazhdueshme me të cilat përballet industria kulturore dhe krijuese e Shqipërisë kërkojnë një sërë ndërhyrjesh të synuara dhe në disa nivele. Çdo drejtim i politikave legjislativ, institucional, financiar dhe menaxherial, arsyetohet dhe adreson

drejtpërdrejt shkaqet strukturore, efektet dhe ndikimet e identifikuara si në analizën e gjendjes aktuale, ashtu edhe gjatë konsultimeve me palët e interesit.

Analiza e situatës ekzistuese të industrive kulturore dhe krijuese (IKK) të Shqipërisë nënvizon si potencialin e konsiderueshëm, ashtu edhe sfidat strukturore të vazhdueshme. Sektori përfshin një gamë të larmishme fushash, nga animacioni, filmi dhe dizajni, te moda, botimet, artizanati, muzika dhe media digjitale, të cilat së bashku kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, punësimin, kohezionin social, formimin e identitetit kulturor dhe zhvillimin e turizmit.

Konsultimet me palët e interesit evidentojnë nevoja urgjente për: krijimin e një shkolle animacioni me cikël të plotë dhe të rrënjosur në folklorin shqiptar; rritjen e financimit për kinemanë dhe përmirësimin e shpërndarjes dhe marketingut; zhvillimin e mekanizmave mbështetës për startup-et krijuese dhe tregjet e veprave të artit; njohjen e statusit ligjor të artistit të pavarur; si dhe krijimin e qendrave artistike që të funksionojnë përtej modeleve tërësisht publike ose të mbështetura vetëm nga donatorët.
Këto kërkesa pasqyrojnë si aspiratat e profesionistëve të rinj për përafrim me standardet evropiane, ashtu edhe sfidat që lidhen me fragmentimin e sektorit, investimet e kufizuara private, pabarazitë territoriale dhe mungesën e mbështetjes sistematike për sipërmarrësit krijues.

Shkaqet kryesore që pengojnë zhvillimin e IKK-së përfshijnë:

- Instrumente financimi të kufizuara dhe jokonsistente, ku mbështetja publike kanalizohet kryesisht përmes thirrjeve vjetore dhe me shumë pak grante shumëvjeçare ose mekanizma sponsorizimi;
- Edukim i pamjaftueshëm i specializuar, veçanërisht në animacion dhe media digjitale, si dhe mungesë e kurrikulave ndërdisiplinore dhe të orientuara drejt biznesit;
- Korniza ligjore dhe fiskale të paqarta dhe të fragmentuara për artistët, krijuesit e pavarur dhe bizneset e reja, çka pengon profesionalizimin e sektorit dhe dekurajon investimet private;
- Pabarazinë territoriale, pasi infrastruktura dhe programimi janë përqendruar kryesisht në Tiranë, duke i lënë krijuesit rajonalë të nënshërbyer;
- Rrjetëzimin e dobët ndërsektorial, aksesin e kufizuar në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe përvetësimi i ulët i teknologjisë.

Si rezultat i këtyre kufizimeve strukturore:

- Vëllimi i prodhimit në industritë krijuese është i ulët, ku produkti i përshtatshëm për eksport apo njohje ndërkombëtare mbetet i ulët;
- Migrimi i theksuar i talenteve, veçanërisht midis profesionistëve të rinj që kërkojnë arsimim dhe mundësi jashtë vendit;
- Sipërmarrja krijuese dhe inovacioni mbeten kryesisht të pashfrytëzuara, duke penguar kapacitetin e sektorit për rritje dhe konkurrueshmëri ndërkombëtare;
- Folklori dhe tradita, ndonëse njihen si burime strategjike, nuk integrohen sistematikisht në forma të reja krijuese ose kurrikula, duke kufizuar kontributin e tyre në kulturën bashkëkohore dhe diversifikimin ekonomik.

Pasojat e këtyre sfidave të pazgjidhura janë të rëndësishme:

- Ekonomia kulturore e Shqipërisë performon nën kapacitetin e saj, duke humbur mundësi për krijimin e vendeve të punës, zgjerimin e turizmit dhe zhvillimin e markës globale;
- Identiteti krijues kombëtar dhe përfaqësimi i trashëgimisë në tregjet ndërkombëtare mbeten të dobëta, duke zvogëluar ndikimin dhe vizibilitetin kulturor të vendit;
- Migrimi i talenteve, veçanërisht midis brezave të rinj, rrezikon si ripërtëritjen e sektorit, ashtu edhe transmetimin e trashëgimisë jomateriale;
- Pa reforma të qëndrueshme ligjore, menaxheriale dhe fiskale, sektori krijues rrezikon fragmentim dhe dobësim të mëtejshëm, ndërkohë që rritet kërkesa për industri kulturore inovative, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Sektorët kulturorë dhe krijues të Shqipërisë janë të pasur me potencial, por të kufizuar nga legjislacioni i fragmentuar, koordinimi i kufizuar dhe mekanizmat e nënzhvilluar të mbështetjes. Pavarësisht traditave të forta artistike dhe trashëgimisë institucionale, qeverisja kulturore mbetet kryesisht e centralizuar dhe procedurale, në vend që të jetë strategjike.

Kjo strategji i përgjigjet objektivit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE deri në vitin 2030 dhe ofron një udhërrëfyes për modernizimin ligjor dhe institucional, duke harmonizuar kornizat kombëtare me *acquis* të BE-së, konventat e UNESCO-s dhe kornizën e Evropës Krijuese. Ajo përkthen analizat paraprake, si hartëzimi i instrumenteve legjislative, arkitektura institucionale dhe performanca e sektorit kulturor, në një plan koherent për reformë dhe zbatim.

5.2.1 Parimet udhëzuese

- **Përafrimi me *acquis* të BE-së dhe standardet e UNESCO-s:** Ndërsa Shqipëria përparon drejt anëtarësimit në BE dero në 2030, përafrimi me *acquis communautaire* në fushën e kulturës (Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura) kthehet në një objektiv strategjik ashtu edhe një imperativ ligjor. Arritja e gatishmërisë së plotë kërkon që legjislacioni kulturor, sistemet e qeverisjes dhe praktikat institucionale të Shqipërisë të harmonizohen në mënyrë progresive me standardet evropiane të transparencës, autonomisë dhe të drejtave kulturore. Ky parim angazhon në modernizimin sistematik të kuadrit ligjor dhe institucional, duke siguruar pajtueshmëri të plotë me normat dhe praktikat më të mira të BE-së deri në momentin e anëtarësimit. Ai gjithashtu përfshin parimet e Konventës së UNESCO-s të vitit 2005 për "*mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjeve kulturore*", duke siguruar që modeli i zhvillimit kulturor të Shqipërisë të mbështesë lirinë artistike, diversitetin dhe pjesëmarrjen demokratike. Deri në vitin 2030, sistemi kulturor i Shqipërisë duhet të jetë plotësisht i përgatitur për të funksionuar brenda peizazhit kulturor dhe krijues evropian, duke kontribuar në një hapësirë kulturore evropiane të unifikuar, inovative dhe konkurruese.
- **Gjithëpërfshirja dhe diversiteti kulturor:** Politika kulturore duhet të sigurojë që të gjitha komunitetet dhe identitetet etnike, gjuhësore, rajonale dhe sociale të mund të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në jetën kulturore të Shqipërisë. Gjithëpërfshirja kërkon si mekanizma institucionalë ashtu edhe dhe iniciativa nga baza që fuqizojnë zëra të ndryshëm, promovojnë dialogun ndërkulturor dhe mbrojnë shprehjet kulturore

të pakicave. Ky parim mbështet gjithashtu rigjallërimin e trashëgimisë kulturore jomateriale, zanateve tradicionale dhe formave të reja krijuese, duke siguruar që zhvillimi kulturor të pasqyrojë pluralizmin dhe pasurinë e shoqërisë shqiptare.

- **Transparenca, meritokracia dhe llogaridhënia publike:** Besueshmëria dhe qëndrueshmëria e qeverisjes kulturore varen nga vendimmarrja transparente, konkurrenca e drejtë dhe llogaridhënia e matshme. Financimi publik, përzgjedhja e projekteve dhe emërimet e drejtuesve duhet të ndjekin kritere të qarta, të bazuara në meritë, në përputhje me modelet e qeverisjes së BE-së dhe parimin e pavarësisë ("*arm's length*"). Institucionet kulturore dhe organet e financimit duhet të miratojnë praktikat e të dhënave të hapura, të publikojnë raporte vjetore dhe duhet t'u përmbahen treguesve të standardizuar të performancës. Kjo qasje siguron besimin e publikut, lufton klientelizmin dhe forcon legjitimitetin e investimeve kulturore.
- **Decentralizimi dhe aksesi i drejtë në kulturë:** Pjesëmarrja kulturore duhet të shtrihet përtej kryeqytetit dhe qyteteve kryesore. Strategjia promovon decentralizimin territorial, duke fuqizuar bashkitë dhe institucionet rajonale për të planifikuar dhe zbatuar programe kulturore lokale. Forcimi i qeverisjes kulturore lokale, sigurimi i fondeve të dedikuara rajonale dhe mbështetja e qendrave kulturore komunitare do të sigurojnë që qytetarët në mbarë Shqipërinë - urbanë, ruralë apo të zonave më të thella - të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga investimet kulturore dhe mundësitë krijuese. Kjo përputhet me objektivat e kohezionit të BE-së dhe promovon zhvillimin e balancuar rajonal përmes kulturës.
- **Barazia gjinore dhe pjesëmarrja e të rinjve:** Kultura duhet të jetë një mjet për barazinë, fuqizimin dhe përfaqësimin. Strategjia angazhohet për integrimin e parimit të barazisë gjinore në të gjitha politikat dhe programet kulturore, duke siguruar pjesëmarrjen e grave në krijimin artistik, menaxhimin kulturor dhe organet vendimmarrëse. Njëkohësisht, ajo i jep përparësi pjesëmarrjes së rinisë, duke mbështetur artistët e rinj, startup-et krijuese dhe iniciativat arsimore që nxisin talentin dhe angazhimin qytetar. Këto qëllime janë në përputhje me Strategjinë e BE-së për Barazi Gjinore 2020–2025 dhe Strategjinë e Sektorit të Rinisë të Këshillit të Evropës.
- **Transformimi digjital dhe ndërveprimi**: Tranzicioni digjital po ripërcakton mënyrën se si krijohet, shpërndahet dhe konsumohet kultura. Strategjia promovon digjitalizimin e përmbajtjes kulturore dhe arkivave, adoptimin e sistemeve të ndërveprueshme të të dhënave në të gjitha institucionet, si dhe përdorimin e teknologjisë për të rritur aksesin dhe inovacionin në shërbimet kulturore. Transformimi digjital mbështet gjithashtu transparencën, aksesin e hapur dhe hartimin e politikave të bazuara në evidenca. Ndërveprueshmëria midis bazave kombëtare të të dhënave dhe sistemeve të BE-së do të sigurojë gatishmërinë e Shqipërisë për integrimin në hapësirën kulturore digjitale evropiane.

5.2.2 Situata aktuale legjislative dhe institucionale

Sektori kulturor dhe krijues i Shqipërisë operon nën një grup të gjerë ligjesh specifike si Ligji nr. 10352/2010 "*Për Artin dhe Kulturën*" (i ndryshuar), Ligji nr. 8096/1996 "*Për Kinematografinë*" (i ndryshuar), Ligji nr. 8576/2000 "*Për Bibliotekat*", Ligji nr .9154/2003 "*Për arkivat*" (i ndryshuar), Ligji nr. 9616/2016 "*Për librin në Republikën e Shqipërisë*", Ligji nr. 70/2016 "*Për Artizanatin*", Ligji nr. 35/2016 "*Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të*

lidhura me to" (i ndryshuar). Së bashku, këto akte ofrojnë bazën ligjore për institucionet kulturore, menaxhimin e trashëgimisë dhe sektorët krijues të Shqipërisë.
Pavarësisht kësaj baze ligjore gjithëpërfshirëse, korniza mbetet e fragmentuar, e zbatuar në mënyrë të pabarabartë dhe pjesërisht e papërditësuar. Shumë nga këto ligje janë miratuar në kohë të ndryshme, shpesh në përgjigje të nevojave sektoriale dhe jo si pjesë e një vizioni koherent politik. Kjo ka çuar në mbivendosje të kompetencave, mospërputhje midis legjislacionit dhe praktikës dhe përputhshmëri të kufizuar me standardet kulturore evropiane në zhvillim. Mangësitë në zbatim vazhdojnë për shkak të kufizimeve buxhetore, koordinimit të pamjaftueshëm ndërinstitucional dhe mekanizmave të dobët të zbatimit.

Pejsazhi institucional i kulturës është po aq kompleks. Ministria përgjegjëse për kulturën mbikëqyr një rrjet institucionesh të varësisë - duke përfshirë *Teatrin Kombëtar, Teatrin e Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Bibliotekën Kombëtare, Galerinë Kombëtare, Qendrën Kombëtare të Kinematografisë* dhe disa institucione të tjera të trashëgmisë së artit dhe kulturës.

Mungesa e një strukture të qëndrueshme organizative ka penguar zbatimin e programeve kulturore shumëvjeçare dhe ka zvogëluar aftësinë e Ministrisë përgjegjëse për të ofruar udhëheqje strategjike. Ndryshimet e shpeshta në konfigurimin e brendshëm dhe në staf kanë fragmentuar funksionet administrative dhe kanë gërryer kujtesën institucionale, duke cenuar vazhdimësinë dhe ekspertizën e nevojshme për një ekzekutim të qëndrueshëm të politikave.

Kjo paqëndrueshmëri ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në institucionet kulturore të varësisë, të cilat mbështeten nga Ministria përgjegjëse për mbikëqyrje, financim dhe orientim të politikave. Ndryshimet e përsëritura në linjat e raportimit, procedurat e financimit dhe rregullat e qeverisjes kanë krijuar pasiguri dhe mospërputhje në menaxhim. Shumë institucione kanë qenë të detyruara të veprojnë në mënyrë reaktive, duke u përqendruar te pajtueshmëria administrative në vend të planifikimit strategjik, inovacionit artistik apo zhvillimit të audiencës.

Pas riorganizimeve të njëpasnjëshme dhe shpërbërjes së organeve koordinuese ndërmjetëse, siç është *Qendra Kombëtare për Art dhe Kulturë* (QKAK) në vitin 2015, sistemi i qeverisjes kulturore është centralizuar dhe i menaxhuar vertikalisht. Ndonëse këto reforma synonin të përmirësonin kontrollin administrativ, ato në praktikë ato kanë kufizuar iniciativën, fleksibilitetin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional. Mungesa e një strukture kombëtare koordinimi ka reduktuar mundësitë për financimin e bazuar në projekte, partneritetet dhe mbështetjen për aktorët kulturorë të pavarur dhe rajonalë. Vendimmarrja tani është përqendruar në nivel ministror, duke kufizuar kështu aftësinë e reagimit ndaj dinamikave kulturore në zhvillim dhe zbehur pjesëmarrjen lokale.

Shumë organizata vazhdojnë të operojnë me statute të vjetruara, autonomi të kufizuar menaxheriale dhe mekanizma të paqartë llogaridhënieje. Iniciativat e pavarura hasin vështirësi për të pasur qasje në strukturat e mbështetjes publike, ndërsa bashkëpunimi midis sektorit publik, privat dhe atij jofitimprurës mbetet sporadik dhe i pakoordinuar.

Si rezultat, modeli aktual i qeverisjes së sektorit është i fragmentuar, i centralizuar dhe i drejtuar në mënyrë administrative. Institucionet veprojnë sipas statuteve të veçanta me mandate që mbivendosen dhe llogaridhënie jokonsistente, çka dobëson koordinimin midis nivelit kombëtar dhe atij lokal. Kjo strukturë kufizon inovacionin, transparencën dhe kapacitetin për të ndërtuar partneritete të qëndrueshme ndërmjet sektorëve.

Në përgjithësi, sistemi kulturor i Shqipërisë gëzon themele të forta ligjore por mbetet institucionalisht i nënorganizuar. Sfida nuk qëndron te mungesa e ligjeve, por te mospasja e një modeli organizativ koherent, të integruar dhe fuqizues, i cili u lejon institucioneve dhe profesionistëve të fushës të veprojnë si nxitës të vërtetë të zhvillimit kulturor, krijues dhe shoqëror. Një reformë gjithëpërfshirëse e qeverisjes, e ndërtuar mbi autonominë, meritokracinë, financimin e bazuar në performancë dhe standardet evropiane të llogaridhënies, është thelbësore për të çliruar potencialin e plotë të sektorit dhe për të siguruar gatishmërinë e tij për anëtarësim në BE deri në vitin 2030.

Nevojat e reja për reforma legjislative dhe organizative

- Legjislacioni në fuqi ruan strukturën thelbësore për mbrojtjen e trashëgimisë dhe mbikëqyrjen institucionale, por **nuk pasqyron më realitetin në zhvillim të ekonomisë krijuese**, punës artistike apo integrimit evropian. Korniza mbetet e centralizuar dhe e fragmentuar, me mbivendosje kompetencash, modele rregullatore të vjetëruara dhe mekanizma të kufizuar për koordinim ndërinstitucional.
- Institucionet kulturore publike në varësi të Ministrisë përgjegjëse për kulturën kryejnë **funksione të vlefshme ruajtjeje dhe edukimi**; megjithatë, sistemi gradualisht është bërë më shumë administrativ sesa mundësues, duke kufizuar inovacionin, bashkëpunimin dhe aktivitetin artistik të pavarur. Korniza ekzistuese e qeveris kulturën kryesisht përmes kontrollit dhe pajtueshmërisë dhe jo përmes promovimit, pjesëmarrjes dhe partneritetit. Qeverisja e sektorit dhe kuadri rregullator duhet të kalojnë nga një model i orientuar vetëm drejt ruajtjes drejt një modeli të orientuar nga promovimi dhe pjesëmarrja, ku kultura dhe krijimtaria njihen si asete strategjike kombëtare. Modernizimi legjislativ është thelbësor jo vetëm për të siguruar pajtueshmërinë me standardet e BE-së, por edhe për të arritur reformën organizative të nevojshme që institucionet e Shqipërisë të operojnë në mënyrë efikase, transparente dhe në sinergji me homologët evropianë.

Për të mundësuar një ekosistem kulturor modern, gjithëpërfshirës dhe të përafruar me standardet evropiane, Shqipëria duhet të ndërmarrë një reformë të koordinuar të kornizave ligjore, institucionale dhe mekanizmave të financimit e mbështetjes për sektorin kulturor. Fushat e mëposhtme prioritare përshkruajnë veprimet kryesore legjislative dhe të politikave të nevojshme për të arritur përafrimin me standardet e BE-së, për të forcuar qeverisjen kulturore dhe për të siguruar kushte të drejta dhe të qëndrueshme si për artistët, ashtu edhe për institucionet kulturore.

i.Rishikimi i paketës ligjore kulturore në kuadër të anëtarësimit në BE

Një rishikim gjithëpërfshirës dhe modernizim i të gjithë kuadrit rregullator në fushën e kulturës rekomandohet të kryhet për të siguruar pajtueshmërinë me *acquis-të* kulturore

të BE-së, konventat e UNESCO-s dhe standardet e Këshillit të Evropës. Është e nevojshme që legjislacioni aktual të harmonizohet për të krijuar një bazë koherente dhe të orientuar drejt së ardhmes. Ky proces do të trajtojë gjithashtu mbivendosjet dhe mospërputhjet midis ligjeve, do të qartësojë mandatet institucionale dhe do të modernizojë instrumentet rregullatore për të pasqyruar më mirë realitetet e ekonomisë krijuese.

ii.Rishikimi i kuadrit mbështetës për artistët dhe profesionistët e kulturës
Paralelisht me reformën e legjislacionit kulturor, do të shqyrtohen masa për përmirësimin e kuadrit institucional dhe administrativ që mbështet artistët dhe profesionistët e kulturës, me synim përmirësimin e kushteve të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, rritjen e aksesit në skemat ekzistuese të mbështetjes dhe forcimin e mbrojtjes sociale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në këtë drejtim, do të nxitet zhvillimi i mekanizmave të bashkëpunimit me sektorin privat, përmes promovimit të donacioneve, sponsorizimeve dhe formave të tjera të mbështetjes për aktivitetet kulturore dhe krijuese, në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues. Këto mekanizma synojnë të kontribuojnë në diversifikimin e burimeve të financimit për kulturën, forcimin e partneriteteve ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, si dhe rritjen e qëndrueshmërisë së projekteve dhe nismave kulturore.
Çdo masë që mund të kërkojë ndryshime në kuadrin ligjor ose financiar do të trajtohet përmes proceseve dhe instrumenteve përkatëse të politikëbërjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kuadrin buxhetor.

iii. Parashikimi i stimujve fiskalë për sponsorizime dhe investime private
Duke u mbështetur në modelet e suksesshme të BE-së (p.sh., "*Bonusi i Artit*" në Itali), Shqipëria mund të marrë në konsideratë, në planin afatmesëm, opsione politikash të hartuara për të nxitur investimet private në kulturë përmes sponsorizimeve, donacioneve dhe formave të tjera të kontributit. Çdo opsion i tillë duhet të vlerësohet përmes konsultimit paraprak fiskal dhe analizës së ndikimit për të përcaktuar rëndësinë, përballueshmërinë financiare dhe përputhshmërinë e tij me politikën kombëtare të të ardhurave dhe kërkesat e përafrimit me BE-në. Nëse miratohen përfundimisht, këta mekanizma mund të ndihmojnë në diversifikimin e burimeve të financimit dhe forcimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të institucioneve kulturore, por nuk duhet të paraqiten si një angazhim i menjëhershëm në sajë të kësaj Strategjie.

iv. Njohja dhe mbrojtja e Statusit të Artistit si një kornizë ndërsektoriale
Statusi i Artistit do të njihet jo domosdoshmërisht përmes një ligji të veçantë, por si një kornizë legjislative ndërsektoriale e integruar në disa akte. Kjo kornizë do të përcaktojë statusin ligjor dhe social të artistëve dhe profesionistëve të kulturës, duke garantuar shpërblim të drejtë, mbrojtje sociale dhe njohje profesionale në përputhje me standardet evropiane për punë të denjë, barazi gjinore dhe liri krijuese. Një komponent thelbësor i kësaj reforme do të jetë krijimi i një *Baze Kombëtare të të Dhënave për Artistët*, duke mundësuar identifikimin, regjistrimin dhe klasifikimin e artistëve dhe profesionistëve të kulturës në të gjitha disiplinat. Baza e të dhënave do të shërbejë si mjet zyrtar referimi për të lehtësuar aksesin në skemat e mbështetjes publike, përfitimet sociale dhe mundësitë e trajnimit, duke përmirësuar njëkohësisht transparencën dhe koordinimin e

politikave. Krijimi dhe administrimi i kësaj baze të dhënash do të realizohet në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 10325, datë 23.9.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore", duke garantuar ndërveprueshmërinë e saj teknike me platformat ekzistuese qeveritare dhe duke shmangur çdo duplikim të informacionit zyrtar. Ajo gjithashtu do të mbështesë monitorimin statistikor, duke ndihmuar në përafrimin e sistemeve kombëtare të të dhënave kulturore me standardet e BE-së për punësimin kulturor dhe krijues. Për më tepër, korniza do të përcaktojë kriteret profesionale për praktikën artistike dhe do të ofrojë akses të strukturuar në trajnime, lëvizshmëri dhe programe të mësimit gjatë gjithë jetës, duke siguruar zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe njohje si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë evropian.

v. Reforma e qeverisjes institucionale për entitetet kulturore kombëtare
Një model modern qeverisjeje do të vendoset për institucionet kombëtare, teatrot, operën dhe baletin, bibliotekat, muzetë dhe galeritë, duke vënë theksin te transparenca, meritokracia dhe llogaridhënia. Reformat kryesore do të përfshijnë procedura të qarta emërimi për bordet dhe drejtorët, mekanizma financimi të bazuar në performancë, autonomi menaxheriale dhe standarde më të forta auditimi dhe vlerësimi. Këto ndryshime synojnë të profesionalizojnë menaxhimin kulturor dhe të përafrojnë qeverisjen institucionale me praktikat më të mira të sektorit publik evropian.

vi. Njohja ligjore e industrive krijuese si një sektor strategjik ekonomik
Industritë krijuese, të cilat përfshijnë artin, dizajnin, median dhe zanatet, etj. do të njihen ligjërisht si një komponent kyç i strategjive të inovacionit, turizmit dhe digjitalizimit të Shqipërisë. Kjo reformë do të promovojë sipërmarrjen, eksportet dhe investimet, duke i pozicionuar industritë krijuese si motorë të rritjes së qëndrueshme, punësimit dhe konkurrueshmërisë ndërkombëtare. Integrimi me programet e BE-së "*Creative Europe*" dhe "*Horizon Europe*" do të jetë një mekanizëm qendror për të lidhur ndërmarrjet krijuese shqiptare me strukturat dhe tregjet evropiane të vlerës. Së bashku, këto reforma do ta transformojnë sistemin kulturor të Shqipërisë nga një kornizë rregullatore e fragmentuar, në një arkitekturë moderne qeverisjeje të harmonizuar me BE-në, e cila promovon krijimtarinë, mbron artistët, fuqizon institucionet dhe nxit pjesëmarrjen aktive në hapësirën kulturore evropiane deri në vitin 2030. Rrjedhimisht, modernizimi legjislativ nuk është vetëm një domosdoshmëri ligjore, por edhe themeli strukturor për rinovimin institucional dhe dinamizmin kulturor.

Modernizimi i legjislacionit kulturor të Shqipërisë duhet të shkojë paralelisht me një transformim të thellë të strukturave të saj të qeverisjes institucionale. Vetëm ligjet nuk mund të sigurojnë progres nëse institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre nuk janë të fuqizuara, llogaridhënëse dhe të orientuara në mënyrë strategjike. Ministria përgjegjëse për kulturën dhe rrjeti i saj i institucioneve të varësisë - teatrot, bibliotekat, muzetë, galeritë dhe qendrat kombëtare - kërkojnë një model qeverisjeje që i jep përparësi autonomisë, transparencës dhe performancës së matshme mbi kontrollin administrativ.

Rrjedhimisht, reforma institucionale është dimensioni operacional i procesit të modernizimit legjislativ. Përmes qartësimit të mandateve, forcimit të llogaridhënies menaxhuese dhe vendosjes së mekanizmave të financimit të bazuar në performancë, Shqipëria mund të

sigurojë që institucionet e saj kulturore të funksionojnë si agjentë proaktivë dhe krijues dhe jo si ekzekutues pasivë të politikave shtetërore. Përafrimi i qeverisjes institucionale me standardet evropiane jo vetëm që do të rrisë efikasitetin dhe profesionalizmin, por gjithashtu do të rikthejë besimin publik në administratën kulturore dhe do të përforcojë gatishmërinë e Shqipërisë për anëtarësim në BE deri në vitin 2030.

5.2.3 Vlerësimi i mangësive ligjore dhe institucionale

Vlerësimi i mangësive ligjore dhe institucionale (VMLI) do të shërbejë si mjeti qendror analitik për të drejtuar Shqipërinë drejt një kornize koherente dhe të harmonizuar me BE-në për qeverisjen kulturore. Qëllimi i tij kryesor është të identifikojë mospërputhjet midis strukturave aktuale ligjore, rregullatore dhe institucionale të Shqipërisë dhe kërkesave të *acquis* të BE-së, konventave të UNESCO-s dhe rekomandimeve të Këshillit të Evropës.

Duke identifikuar mbivendosjet, shtesat dhe dobësitë e kapaciteteve, VMLI-ja do të ofrojë një plan të qartë për renditjen e reformave, duke siguruar që modernizimi legjislativ, ristrukturimi institucional dhe përmirësimet e qeverisjes të bëhen në një mënyrë të koordinuar dhe të qëndrueshme. Ky proces do të ndihmojë gjithashtu në përcaktimin e niveleve bazë të performancës dhe në përcaktimin e përgjegjësive institucionale të nevojshme për monitorimin e progresit të Shqipërisë drejt pajtueshmërisë deri në vitin 2030.

VMLI-ja duhet të kombinojë analizën ligjore, hartëzimin institucional dhe dialogun me palët e interesit në një proces vlerësimi të integruar, duke siguruar si saktësi teknike ashtu edhe gjithëpërfshirje të politikave.

Komponentët kryesorë metodologjikë përfshijnë:

- **Analiza e mangësive ligjore.** Një krahasim i detajuar nen për nen i legjislacionit në fushën e kulturës në Shqipëri me direktivat e BE-së, konventat e UNESCO-s dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, duke identifikuar dispozitat që kërkojnë ndryshim, konsolidim ose zëvendësim.
- **Hartëzimi institucional.** Shqyrtimi i mandateve, strukturave qeverisëse, ndarjes së burimeve dhe mekanizmave të koordinimit midis institucioneve në varësi të ministrisë përgjegjëse për kulturën dhe organeve përkatëse, për të nxjerrë në pah mbivendosjet strukturore dhe fushat me performancë të ulët.
- **Konsultimet me palët e interesit.** Një qasje pjesëmarrëse që përfshin artistë, profesionistë të kulturës, organizata të shoqërisë civile, bashki dhe akademinë për të siguruar që prioritetet e reformës pasqyrojnë nevojat reale sektoriale dhe gjithëpërfshirjen sociale.
- **Krahasimi referues.** Krahasimi referues ("*benchmarking*") do të shërbejë si një komponent qendror i procesit të reformës, duke siguruar që legjislacioni dhe modelet e qeverisjes kulturore të Shqipërisë të evoluojnë paralelisht me kërkesat e integrimit evropian sipas Kapitullit 26 të Anëtarësimit në BE "*Arsimi dhe Kultura*". Ky proces shkon përtej një krahasimi të thjeshtë dhe do të përqendrohet në përafrimin funksional me arkitekturat institucionale, ligjore dhe financiare të shteteve anëtare të BE-së. Procesi i krahasimit duhet të përfshijë një analizë të detajuar krahasuese me vende të përzgjedhura të BE-së, sistemet kulturore të të cilave kanë kaluar me sukses nga modele të centralizuara drejt qeverisjes autonome dhe të bazuara në performancë. Ai

do të identifikojë instrumentet e politikave, mekanizmat e financimit dhe strukturat institucionale të përshtatshme për kontekstin administrativ dhe fiskal të Shqipërisë. Po kështu, krahasimi rajonal me vende të ngjashme do të ofrojë një pasqyrë të reformave të ndërmarra nga vendet fqinje në faza të ngjashme të përafrimit me BE-në, duke theksuar mësimet e nxjerra dhe qasjet praktike për zbatimin e qeverisjes kulturore dhe kornizave të "*Statusit të Artistit*".

Kjo qasje shumëdimensionale do të sigurojë që VMLI-ja të funksionojë jo vetëm si një rishikim teknik, por edhe si një proces ndërtimi kapacitetesh dhe formimi konsensusi për pronësinë e reformës në të gjithë ekosistemin kulturor.

Rezultatet

VMLI-ja do të prodhojë një bllok të strukturuar dokumentesh politike dhe ligjore, që do të përbëjnë shtyllën kryesore të rrugëtimit të zbatimit të reformës:

1. **Raporti i VMLI-së (2026):** Raporti i VMLI-së do të shërbejë si dokumenti kryesor diagnostikues dhe referues i politikave për agjendën e reformës kulturore të Shqipërisë. Ai do të konsolidojë të gjitha gjetjet analitike nga vlerësimet ligjore, institucionale dhe të qeverisjes në një raport të vetëm të strukturuar. Raporti do të përfshijë një Matricë të Pajtueshmërisë dhe Reformës, duke hartëzuar çdo ligj sektorial dhe strukturë institucionale përkundrejt direktivave të BE-së, konventave të UNESCO-s dhe standardeve të Këshillit të Evropës. Kjo matricë do të identifikojë fushat specifike që kërkojnë ndryshime legjislative, konsolidim ose shfuqizim; rregullime institucionale për të përmirësuar efikasitetin dhe koordinimin; si dhe prioritetet rregullatore për përafrimin me *acquis* të BE-së sipas Kapitullit 26 "*Arsimi dhe Kultura*". Përtej diagnozës, raporti do të ofrojë gjithashtu mundësi reformash të bazuara në skenarë, duke ofruar rrugëtime alternative në varësi të kapaciteteve administrative dhe burimeve të disponueshme. Rrjedhimisht, ai do të shërbejë si bazë për sekuencimin e reformave dhe si referencë monitorimi për vlerësimin e progresit gjatë gjithë periudhës 2026-2030.

2. **Plani i Veprimit (2026–2030):** Plani i Veprimit i VMLI-së do t'i përkthejë gjetjet diagnostikuese në një plan operacional për zbatimin e reformës. I strukturuar si një plan i ndarë në faza dhe afate, raporti do të lidhë çdo rekomandim për reformën legjislative dhe institucionale me autoritetet specifike përgjegjëse, duke përfshirë Ministritë përgjegjëse për kulturën dhe financat dhe agjencitë përkatëse, me etapat kryesore, afatet kohore dhe tregues performance të përcaktuar qartë. Plani do të sigurojë koherencë midis dimensioneve të ndryshme të reformës: përditësimet legjislative, modernizimi i qeverisjes institucionale, mekanizmat e financimit dhe zhvillimi i burimeve njerëzore. Ai gjithashtu do të krijojë një kornizë të integruar monitorimi dhe vlerësimi, duke i mundësuar Ministrisë përgjegjëse për kulturën të ndjekë progresin e reformës çdo vit përmes treguesve të matshëm, siç janë numri i ligjeve të rishikuara, institucionet që adoptojnë qeverisjen e bazuar në performancë dhe nivelet e pajtueshmërisë me standardet kulturore të BE-së. Plani i Veprimit do të rishikohet dhe përditësohet çdo dy vjet për të reflektuar progresin, për të siguruar

përshtatshmërinë ndaj kërkesave në zhvillim të BE-së dhe për të ruajtur pronësinë politike dhe administrative të procesit të reformës.

3. **Paketa e instrumenteve për reformën institucionale:** VMLI-ja duhet të prodhojë një *Paketë Instrumentesh për Reformën Institucionale* të hartuar për të vënë në funksion parimet moderne të qeverisjes korporative në të gjitha institucionet kulturore të Shqipërisë. Kjo paketë do të përfshijë udhëzime të standardizuara për ristrukturimin institucional, duke vendosur theksin te transparenca, llogaridhënia dhe efikasiteti në menaxhim dhe vendimmarrje. Ajo do të përcaktojë role dhe përgjegjësi të qarta për bordet drejtuese, drejtuesit ekzekutiv dhe organet mbikëqyrëse në përputhje me modelet e qeverisjes së BE-së. Paketa e instrumenteve do të prezantojë gjithashtu mekanizma të kontraktimit të bazuar në performancë, duke lidhur financimin menaxherial dhe institucional me rezultate të matshme, të tilla si shtrirja e audiencës, pjesëmarrja kulturore, inovacioni dhe qëndrueshmëria financiare. Ajo do të ofrojë modele për raportet vjetore të performancës dhe standardet e bërjes publike të të dhënave, duke siguruar që institucionet të raportojnë mbi treguesit kryesorë (produktin artistik, përfshirjen, integritetin financiar dhe ndikimin në komunitet) në mënyrë transparente dhe të krahasueshme. Në të njëjtën kohë, paketa e instrumenteve do të saktësojë procedurat e brendshme të auditimit dhe pajtueshmërisë, duke u mundësuar institucioneve të vlerësojnë praktikat e tyre të qeverisjes, të identifikojnë rreziqet dhe të forcojnë mekanizmat e mbikëqyrjes. Duke i përafruar këto standarde me reformat më të gjera të qeverisjes së sektorit publik, paketa e instrumenteve do të sigurojë që institucionet kulturore të operojnë sipas një kornize llogaridhënieje të stilit korporativ, duke balancuar pavarësinë artistike me administrimin e përgjegjshëm financiar dhe menaxherial.

Përmes këtyre rezultateve, VMLI-ja do të ofrojë si një kornizë strategjike ashtu edhe një mjet operacional, duke lidhur analizën me veprimin dhe duke siguruar që modernizimi i qeverisjes kulturore të Shqipërisë të jetë i bazuar në evidenca, gjithëpërfshirës dhe plotësisht në përputhje me angazhimet e saj për anëtarësim në BE.

Gjetjet e VMLI-së do të shërbejnë si bazë operacionale për zbatimin e Strategjisë për Artin, Kulturën dhe Industritë Krijuese 2026 –2030. Përmes përkthimit të të dhënave nga diagnostifikimi në hapa reformues të zbatueshëm, VMLI-ja do të udhëzojë Ministrinë përgjegjëse për kulturën dhe institucionet e saj partnere në përcaktimin e përparësive të ndryshimeve legjislative, ristrukturimin e kornizave të qeverisjes dhe optimizimin e mekanizmave financiarë. Rekomandimet e saj do të ofrojnë drejtpërdrejt informacione për Planin e Zbatimit dhe Monitorimit, duke siguruar që progresi drejt përafrimit me BE-në, autonomisë institucionale dhe njohjes profesionale të artistëve të ndiqet në mënyrë sistematike dhe transparente gjatë gjithë periudhës 2026–2030.

5.2.4 Zbatimi

Zbatimi i Strategjisë për Artin, Kulturën dhe Industritë Krijuese (2026–2030) do të kërkojë një qasje të koordinuar, të të gjithë qeverisë, të udhëhequr nga ministria përgjegjëse për kulturën në partneritet me ministri dhe agjenci të tjera kyçe. Procesi duhet të drejtohet nga një

arkitekturë e qartë qeverisjeje që siguron llogaridhënie, bashkëpunim ndërministror dhe përputhshmëri me angazhimet e Shqipërisë për anëtarësim në BE.

Institucioni Kryesor: Ministria përgjegjëse për kulturën do të shërbejë si institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të strategjisë. Ajo do të mbikëqyrë hartimin e ndryshimeve legjislative, riorganizimin e institucioneve kulturore në varësi dhe funksionalizimin e mekanizmave të rinj të financimit kulturor.

Ministritë dhe Agjencitë koordinuese:

- **Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit:** Përgjegjëse për integrimin e industrive krijuese brenda kornizës kombëtare të inovacionit dhe sipërmarrjes, për lehtësimin e pjesëmarrjes së sektorit privat dhe promovimin e prodhimit kulturor të orientuar drejt eksportit.
- **Ministria e Financave**: Siguron harmonizimin fiskal dhe qëndrueshmërinë buxhetore për zbatimin e mekanizmave financiarë të strategjisë, duke përfshirë krijimin e Fondit të Kulturës dhe Industrive Krijuese.
- **Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI):** Mbështet transformimin digjital të institucioneve kulturore, sistemet e të dhënave të hapura dhe krijimin e bazave të të dhënave për regjistrimin, raportimin dhe monitorimin.
- **Institucionet e pushtetit vendor:** Luajnë një rol qendror në promovimin e decentralizimit, duke siguruar që aksesi dhe pjesëmarrja kulturore të shtrihen përtej Tiranës dhe duke forcuar dimensionin kulturor të qeverisjes vendore.
- **Njësia e Koordinimit të Politikave Kulturore (NJKPK):** Një njësi e re brenda Ministrisë aktualisht përgjegjëse për kulturën duhet të veprojë si organ qendror i monitorimit dhe raportimit për zbatimin e kësaj strategjie. NJKPK-ja do të mbledhë dhe analizojë të dhëna nga të gjitha institucionet kulturore, do të ndjekë progresin përkundrejt treguesve të matshëm, si dhe do të përgatisë raporte vjetore të performancës që do t'i paraqiten Këshillit të Ministrave dhe Parlamentit. Ajo gjithashtu do të shërbejë si pikë ndërlidhëse midis institucioneve publike, aktorëve të pavarur kulturorë dhe partnerëve të BE-së, duke siguruar që reformat të mbeten pjesëmarrëse, transparente dhe në përputhje me prioritetet e pranimit në BE sipas Kapitullit 26 "*Arsimi dhe Kultura*".

5.2.5 Hapat thelbësorë

Periudha 2026–2030 përfaqëson një moment përcaktues për transformimin kulturor të Shqipërisë. Reformat e parashikuara sipas kësaj strategjie synojnë të krijojnë një sistem modern, transparent dhe gjithëpërfshirës të qeverisjes kulturore, të aftë për të përmbushur si objektivat kombëtare të zhvillimit, ashtu edhe kërkesat e anëtarësimit në BE.

Përmes një legjislacioni koherent, ristrukturimit institucional dhe njohjes profesionale të punës krijuese, Shqipëria do të kalojë nga një sistem kulturor i fragmentuar dhe i drejtuar në mënyrë administrative, në një ekosistem dinamik që e vlerëson krijimtarinë si një shtyllë të jetesës demokratike dhe të rritjes ekonomike.

Dy hapa qendrorë janë thelbësorë në formësimin e këtij transformimi:

- **së pari, riorganizimi i institucioneve kulturore kombëtare sipas parimeve të qeverisjes korporative,** duke siguruar autonomi, llogaridhënie dhe menaxhim të bazuar në performancë;
- dhe **së dyti, njohja ligjore e Statusit të Artistit**, duke garantuar kushte të drejta pune, mbrojtje sociale dhe të drejta profesionale për praktikuesit e kulturës.

Të dyja këto reforma mund të realizohen në mënyrë efektive përmes ndryshimeve të Ligjit Nr. 10 352/2010 "*Për Artin dhe Kulturën*" (i ndryshuar), i cili duhet të shërbejë si një akt legjislativ ombrellë që harmonizon të gjitha ligjet sektoriale mbi kinematografinë, bibliotekat, trashëgiminë, zanatet dhe të drejtën e autorit.

Ky kuadër i unifikuar do të sigurojë bazën ligjore që sistemi kulturor i Shqipërisë të funksionojë në mënyrë koherente, efikase dhe në përputhje të plotë me *acquis-të* kulturore evropiane. Deri në vitin 2030, arti, kultura dhe industritë krijuese të Shqipërisë do të qëndrojnë si nxitës të zhvillimit të qëndrueshëm, inovacionit dhe integrimit evropian. Institucionet kulturore do të veprojnë në mënyrë autonome, por llogaridhënëse; artistët do të njihen dhe mbrohen si profesionistë; ndërsa ekonomia krijuese do të shfaqet si një shtyllë strategjike e progresit kombëtar.

Së fundmi, kjo strategji e sheh kulturën jo vetëm si rojtaren e identitetit kombëtar, por edhe si një forcë për prosperitetin e saj të ardhshëm, duke i lidhur qytetarët përmes krijimtarisë, duke e forcuar pjesëmarrjen demokratike dhe duke e pozicionuar Shqipërinë plotësisht brenda hapësirës kulturore evropiane.

Një plan veprimi i përcaktuar me faza për modernizimin legjislativ, reformën institucionale dhe zbatimin e politikave

Viti	Pikat kryesore strategjike	Produktet dhe rezultatet kryesore
2026	Nisja dhe vlerësimi bazë	• Themelimi i Njësisë së Koordinimit të Politikave Kulturore (NJKPK) brenda Ministrisë aktualisht përgjegjëse për kulturën • Fillimi i Vlerësimit të Mangësive e Ligjore dhe Institucionale (VMLI), duke përfshirë hartëzimin e të gjitha ligjeve sektoriale dhe mandateve institucionale • Formimi i grupeve tematike të punës mbi reformën legjislative, qeverisjen, industritë krijuese dhe politikën fiskale. • Konsultime me palët e interesit me artistë, institucione, bashki dhe shoqëri civile. • Integrimi i Fondit në propozimin e buxhetit të shtetit të vitit 2026.
2026	Hartimi i kuadrit ligjor dhe diversifikimi i mekanizmave të financimit për kulturën	• Përfundimi i Raportit të VMLI-së dhe miratimi i Planit të Veprimit për Reformën Kulturore 2026–2030. • Hartimi i ndryshimeve të ligjit "*Për Artin dhe Kulturën*", i ndryshuar (ligji ombrellë) që konsolidon kornizat sektoriale dhe prezanton "*Statusin e Artistit*" • Vlerësimi i kuadrit ekzistues ligjor dhe institucional për mbështetjen e artistëve dhe profesionistëve të kulturës, me hartimin e rekomandimeve për përmirësimin e mekanizmave të mbështetjes sociale dhe zhvillimin e formave të bashkëpunimit me sektorin privat përmes sponsorizimeve, donacioneve dhe investimeve kulturore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. • Projektimi i "*Bazës Kombëtare të të Dhënave Kombëtare për Artistët*" dhe puna përgatitore për infrastrukturën digjitale dhe protokollet e regjistrimit. • Miratimi i mekanizmave të rinj të financimit të sektorit të artit dhe kulturës.
2027	Miratimi dhe zbatimi pilot	• Miratimi nga Parlamenti i ndryshimeve të ligjit "*Për Artin dhe Kulturën*", i ndryshuar, dhe legjislacionit dytësor përkatës. • Zbatimi pilot i modelit të ri të qeverisjes në institucione të përzgjedhura (p.sh., Teatri Kombëtar, TKOBAP , Biblioteka Kombëtare). Nisja e Bazës Kombëtare së të Dhënave për Artistët dhe faza e parë e regjistrimit. • Funksionalizimi i stimujve fiskalë për sponsorizime dhe partneritete private. • Vlerësim afatmesëm për të vlerësuar efektivitetin legjislativ, reformat qeverisëse dhe performancën institucionale.

2028	Zbatimi i plotë i reformave të qeverisjes dhe institucioneve	• Zgjerimi i kornizës së re qeverisëse në të gjitha institucionet kulturore kombëtare. • Zbatimi i kontratave të financimit të bazuara në performancë dhe standardeve të menaxhimit korporativ. • Nisja e programeve të zhvillimit profesional për menaxherët dhe artistët kulturorë. • Ngritja e programeve të financimit të decentralizuar të kulturës përmes partneriteteve rajonale dhe komunale. • Integrimi i sistemeve të të dhënave kulturore të Shqipërisë me kornizat statistikore të BE-së;
2029	Konsolidimi dhe integrimi në BE	• Zbatim i plotë i kornizës së "*Statusit të Artistit*", duke përfshirë mekanizmat e mbrojtjes sociale dhe rregullimet fiskale. • Vlerësimi dhe përmirësimi i Fondit bazuar në rezultatet e performancës. • Zgjerimi i pjesëmarrjes në programet e BE-së (Creative Europe, Horizon Europe, etj.). • Forcimi i bashkëpunimit kulturor ndërkombëtar përmes platformave rajonale dhe iniciativave të diplomacisë kulturore të BE-së. • Raport vjetor për Parlamentin që përmbledh progresin institucional dhe përafrimin me acquis të BE-së.
2030	Vlerësimi përfundimtar dhe plani i ardhshëm	• Vlerësim gjithëpërfshirës i reformave legjislative, institucionale dhe financiare, duke vlerësuar gatishmërinë për integrimin e plotë kulturor të BE-së sipas Kapitullit 26. • Publikimi i Raportit të Transformimit Kulturor 2026–2030 që dokumenton arritjet, mësimet e nxjerra dhe sfidat e mbetura. • Përgatitja e Strategjisë Kulturore pas vitit 2030 (2031–2035) me fokus në inovacionin digjital, qëndrueshmërinë dhe partneritetet globale • Institucionalizimi i mekanizmave të përhershëm të monitorimit dhe vlerësimit brenda Ministrisë përgjegjëse për kulturën për të siguruar vazhdimësinë e politikave përtej vitit 2030.

Kronologjia e mësipërme 2026–2030 ofron një plan të strukturuar që kalon nga diagnoza te konsolidimi. Ajo fillon me koordinimin institucional dhe rishikimin ligjor (2026), vijon me miratimin dhe zbatimin pilot (2027–2028) dhe përfundon me zbatimin e plotë, vlerësimin dhe harmonizimin me BE-në (2029–2030). Përmes kësaj qasje të fazuar, Shqipëria do të sigurojë koherencë legjislative, llogaridhënie institucionale dhe njohje profesionale për artistët, që të gjitha këto parakushte thelbësore për gatishmërinë kundrejt anëtarësimit në BE.

5.3 Politikat për infrastrukturën kulturore

Infrastruktura kulturore e Shqipërisë, e cila përfshin muzetë, bibliotekat, teatrot, galeritë dhe qendrat shumëfunksionale, përbën shtyllën kryesore për prodhimin, shpërndarjen dhe pjesëmarrjen kulturore në të gjithë vendin. Palët e interesit mbështesin zgjerimin e tipologjive të muzeve, përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese të muzeve, përfshirjen e teknologjisë për të pasuaruar përvojën e vizitorëve, transformimin e muzeve dhe hapësirave kulturore në qendra dinamike për turizëm dhe angazhim të komunitetit, si dhe punësimin e stafit të dedikuar për edukimin, TI-në, komunikimin dhe mbledhjen e fondeve. Ekziston gjithashtu një kërkesë e fortë për qendra kulturore shumëfunksionale, duke përfshirë salla dhe amfiteatro, të cilat përmbushin funksione të shumta në shërbim të komunitetit, rinisë dhe krijimtarisë. Pavarësisht një portofoli të pasur me pasuri kulturore dhe numrit në rritje të aktiviteteve kulturore publike, rrjeti i infrastrukturës mbetet i përqendruar në Tiranë dhe në disa qytete të mëdha, duke lënë zonat periferike dhe rurale kryesisht të nënshërbyera. Analiza e situatës aktuale konfirmon rolin qendror të infrastrukturës kulturore për rigjenerimin territorial, inovacionin, shtrirjen edukative dhe kohezionin social, si dhe thekson nevojën për përfshirje dhe aksesueshmëri më të gjerë në dimensionet fizike, digjitale dhe programative.

Infrastruktura kulturore e Shqipërisë duhet të kuptohet brenda një konteksti më të gjerë të "*ekologjisë së kulturës*", një sistem i integruar që lidh krijimin, prodhimin, ekspozimin, shpërndarjen, pjesëmarrjen dhe mirëqenien sociale. Hapësirat kulturore nuk janë asete të izoluara, por nyje mundësuese në këtë vazhdimësi. Qëndrueshmëria e tyre varet nga shëndeti i të gjithë zinxhirit të vlerës, që nga mjediset e prodhimit artistik deri te angazhimi i audiencës dhe hapësirat e të nxënit. Njohja e kësaj ndërvarësie sistemike garanton që investimet në infrastrukturë të përforcojnë të gjithë ekosistemin e shprehjes dhe pjesëmarrjes kulturore.

Disa faktorë kufizojnë ofrimin efektiv dhe përjetimin e infrastrukturës kulturore të Shqipërisë. Shumë muze dhe objekte kulturore janë të vjetruara, vuajnë nga menaxhimi i fragmentuar, nënfinancimi kronik dhe specializimi i pamjaftueshëm i stafit (veçanërisht në TI dhe komunikim). Përpjekjet për decentralizim janë të kufizuara, ku shumica e burimeve dhe projekteve kryesore - të gjitha të financuara nga BE-ja ose

përmes fondeve të bashkëpunimit - mbeten ende të centralizuara në Tiranë, duke theksuar në këtë mënyrë pabarazitë territoriale në infrastrukturë dhe shërbime kulturore. Megjithatë, iniciativa pozitive si investimet e *Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit* në rindërtimin e kinemave lokale tregojnë për përpjekje të fokusuara me qëllim rigjallërimin e infrastrukturës audiovizive jashtë kryeqytetit dhe për të përmirësuar aksesin rajonal në përvojat kulturore. Institucionet rajonale dhe bashkiake shpesh nuk kanë kapacitetet e nevojshme teknike, menaxheriale dhe financiare për të zhvilluar, menaxhuar apo sjellur risi në lidhje me hapësirat kulturore, përfshirë këtu transformimin e tyre digjital dhe integrimin me modelet bashkëkohore të pjesëmarrjes. Gjithashtu ekziston një deficit në planifikimin e koordinuar midis kulturës, turizmit dhe zhvillimit urban, çka pengon sinergjitë dhe zbeh kapacitetin e hapësirave kulturore për të shërbyer si motorë për rritje gjithëpërfshirëse dhe ndërlidhje sociale.

Duke u mbështetur në konceptin e ekologjisë kulturore, kjo politikë thekson një qasje të bazuar në rrjet, e cila lidh institucionet, vendet dhe aktorët krijues përmes qarkullimit të përmbajtjes, turneve, rezidencave dhe programimit të përbashkët. Infrastruktura digjitale mund dhe duhet të shfrytëzohet për të rritur aksesin dhe pjesëmarrjen, duke mundësuar që përmbajtja kulturore të lëvizë pa pengesa midis territoreve dhe audiencave. Kjo "*logjikë rrjeti*" garanton që investimi në një hapësirë të vetme të kontribuojë në sistemin më të gjerë të vitalitetit, përfshirjes dhe lëvizshmërisë kulturore.

Efektet e menjëhershme të këtyre kufizimeve janë të dukshme në përvojën e përgjithshme kulturore: vendet kulturore shpesh ofrojnë ndërveprim të kufizuar, kushte të dobëta për vizitorët dhe angazhim të ulët digjital, gjë që kufizon aftësinë për të tërhequr dhe mbajtur audiencën. Cilësia, diversiteti dhe aksesueshmëria e hapësirave kulturore - veçanërisht jashtë qendrave urbane - mbeten nën potencialin e tyre, dhe përmirësimet teknologjike janë sporadike dhe të shpërndara në mënyrë të pabarabartë. Hapësirat shumëfunksionale për art, programe rinore, zanate tradicionale dhe performanca të drejtpërdrejta janë të pakta, duke cenuar mundësitë për bashkëpunim ndërsektorial, të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe ndërtimin e komunitetit. Kjo infrastrukturë e fragmentuar kufizon pjesëmarrjen kulturore dhe pengon krijimin dhe konsumin e përmbajtjes së re kulturore, duke përforcuar përjashtimin dhe pabarazinë rajonale.

Këto barriera sistemike kanë implikime afatgjata për shoqërinë dhe ekonominë shqiptare. Potenciali i kulturës për të nxitur zhvillimin lokal, kohezionin territorial, inovacionin dhe konkurrueshmërinë ndërkombëtare mbetet i nënshfrytëzuar. Infrastruktura dhe programimi i pamjaftueshëm kontribuojnë në nivele të ulëta të konsumit dhe angazhimit kulturor, veçanërisht jashtë Tiranës dhe zonave të tjera urbane. Investimet e pamjaftueshme në objekte moderne dhe kapacitete digjitale pengojnë përfshirjen sociale, kufizojnë transmetimin e njohurive ndërgjeneracionale

dhe ulin atraktivitetin e Shqipërisë si një destinacion i turizmit kulturor. Në fund, këto sfida cenojnë angazhimin qytetar dhe aftësitë për ripërtëritje , ngadalësojnë ndërtimin e kapaciteteve në sektorin kulturor dhe dobësojnë '*fuqinë e butë*" të vendit dhe diplomacinë kulturore në skenën ndërkombëtare.

Qëndrueshmëria e infrastrukturës kulturore varet nga financimi publik i parashikueshëm dhe stabiliteti i qeverisjes. Përtej investimeve sporadike, Shqipëria ka nevojë për një kornizë koherente që siguron vazhdimësinë e operacioneve, mirëmbajtjen dhe përdorimin e hapësirave kulturore nga komuniteti. Infrastruktura kulturore duhet të funksionojë si një hapësirë qytetare gjithëpërfshirëse - që është e hapur, mundëson pjesëmarrjen dhe garanton siguri - ku qytetarët e përjetojnë kulturën si një e mirë publike. Garantimi i një mbështetjeje operacionale të qëndrueshme dhe i një qasjeje të drejtë është jetik për ruajtjen e vlerës demokratike të institucioneve kulturore.

Drejtimet e rekomanduara të politikave për infrastrukturën kulturore në Shqipëri, kuadri legjislativ, instrumentet e synuara fiskale dhe reformat menaxheriale, u përgjigjen drejtpërdrejt shkaqeve strukturore, pasojave dhe ndikimeve të identifikuara gjatë analizës së situatës aktuale dhe falë konsultimeve me palët e interesit. Së bashku, këto orientime politike ofrojnë një kornizë koherente për të çliruar potencialin e infrastrukturës kulturore të Shqipërisë, duke garantuar që ajo të shndërrohet në një motor dinamik për kohezionin social, zhvillimin ekonomik, barazinë territoriale dhe inovacionin konkurrues ndërkombëtar. Mbështetja fiskale garanton burime të qëndrueshme për përmirësimin e infrastrukturës së vjetëruar, investimet teknologjike dhe specializimin funksional të objekteve në të gjithë vendin.

Çdo masë politike do të zbatohet përmes një lenteje ekologjike dhe relacionale, duke pranuar që çdo hapësirë kulturore kontribuon njëkohësisht në një ekosistem krijues lokal dhe në një rrjet kombëtar prodhimi, edukumi dhe pjesëmarrjeje qytetare. Investimet do të udhëhiqen nga të dhëna konkrete se si çdo ndërhyrje forcon zinxhirin e vlerave kulturore, promovon përfshirjen dhe përmirëson ekuilibrin rajonal. Kjo qasje e përafron politikën e infrastrukturës kulturore me objektivat më të gjera të mirëqenies sociale, kohezionit territorial dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Niveli Legjislativ

Sqarimi i përgjegjësive institucionale për mirëmbajtjen dhe investimet në infrastrukturën kulturore është thelbësor, pasi menaxhimi i fragmentuar dhe rolet e papërcaktuara pengojnë zbatimin efektiv, modernizimin dhe zgjidhjen e problemeve. Veprimi legjislativ garanton që të gjitha ministritë, agjencitë dhe autoritetet lokale përkatëse ti kuptojnë mandatet e tyre, gjë që mundëson planifikimin e koordinuar, ndarjen e burimeve dhe monitorimin. Kjo, aga ana tjetër, mundëson përmirësimin sistemik dhe zgjerimin e muzeve dhe qendrave shumëfunksionale jashtë Tiranës, duke

adresuar pabarazitë territoriale dhe duke përmirësuar qeverisjen e hapësirave kulturore për një qëndrueshmëri afatgjatë.
Për të garantuar zbatimin e qëndrueshëm të kësaj Strategjie në të gjithë territorin, do të rekomandohen masa specifike koordinimi vertikal. Do të parashikohet detyrimi ligjor për *Plane Kulturore Vjetore* në nivel vendor, të zhvilluara në bashkërendim me Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor. Njëkohësisht, përafrimi progresiv me Strategjinë do të shërbejë si kusht për akses në instrumentet kombëtare të bashkëfinancimit.

Ky qasje është konceptuar për të garantuar jo vetëm që zbatimi i Strategjisë të ketë bazë ligjore, por dhe që ajo të përvetësohet efektivisht dhe nga vetë bashkitë: sistemi shpërblen angazhimin aktiv dhe pjesëmarrjen, në vend që të kufizohet thjesht me ndëshkimin e mospërmbushjes. Në këtë mënyrë, përafrimi me Strategjinë shndërrohet në një mundësi konkrete për bashkësitë lokale, dhe nuk mbetet thjesht një detyrim burokratik.

Paralelisht, do të miratohet një *Standard Kombëtar i Aksesueshmërisë në Kulturë*, i cili do të përcaktojë kërkesat minimale për aksesin fizik, sinjalistikëm orientuese, interpretimin gjithëpërfshirës dhe aksesin digjital. Ky standard do të bëhet i detyrueshëm për të gjitha projektet e infrastrukturës të financuara me fonde publike dhe do të zbatohet në mënyrë progresive në hapësirat ekzistuese.

Niveli Fiskal
Financimi i dedikuar për infrastrukturën dhe përfshirja e partneriteteve publik-privat (PPP) janë të nevojshme për të tejkaluar nënfinancimin kronik, si dhe për krijimin e hapësirave aktive të turizmit dhe komunitetit. PPP-të, aty ku zbatohen me përpikmëri, mund të mobilizojnë ekspertizë dhe kapital shtesë, duke lehtësuar modernizimin e objekteve dhe duke mbështetur transformimin e hapësirave kulturore në mjedise ndërvepruese, dinamike dhe të qëndrueshme. Këto masa fiskale trajtojnë jo vetëm deficitet infrastrukturore, por gjithashtu mundësojnë që infrastruktura kulturore të shërbejë si motor për zhvillimin lokal, krijimtarinë dhe turizmin, duke sjellë efekte zinxhir pozitive për rritjen ekonomike dhe gjithëpërfshirjen.

Në këtë kuadër, do të krijohet një *Fond i dedikuar për Mirëmbajtjen dhe Rikonstruksionin e Infrastrukturës Kulturore* për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të investimeve. Fondi do të ofrojë grante shumëvjeçare, të bazuara në performancë, për të mbështetur mirëmbajtjen e rregullt, përmirësimet e efiçiencës energjitike, rritjen e aksesueshmërisë dhe forcimin e pëkujdesjes ndaj koleksioneve. Kualifikimi për përfitimin e ndihmës që ky instrument mundëson, do të lidhet me gjendjen e aseteve të institucionit, planin operacional të miratuar dhe kapacitetin e bashkëfinancimit.

Niveli Menaxherial

Riorganizimi strukturor i muzeve dhe parqeve, i kombinuar me krijimin e roleve të dedikuara për edukimin dhe TI-në, trajton kufizimet e kapaciteteve dhe mbështet inovacionin. Reformat menaxheriale promovojnë profesionalizimin dhe specializimin, duke siguruar që muzetë, bibliotekat dhe qendrat kulturore të jenë të pajisura për të ofruar programe ndërvepruese dhe edukative, për të adoptuar teknologji të reja dhe për të angazhuar audienca të ndryshme. Duke u dhënë përparësi pozicioneve të stafit për edukimin, komunikimin dhe TI-në, institucionet mund të përmirësojnë përvojën e vizitorëve, aksesueshmërinë dhe transformimin digjital, duke rritur aftësinë e sektorit për të nxitur angazhimin qytetar, të nxënit gjatë gjithë jetës dhe konsumin kulturor. Ndryshime të tilla janë të domosdoshme për ta bërë infrastrukturën kulturore plotësisht reaktive ndaj nevojave bashkëkohore dhe standardeve ndërkombëtare.

Për të përforcuar koherencën dhe efikasitetin, do të ngrihet një *Rrjet Kombëtar i Hapësirave Kulturore*, i strukturuar në nivele funksionale - qendra kryesore kombëtare, qendra rajonale dhe pika lokale aksesi - secila me përgjegjësi të përcaktuara për ruajtjen, kërkimin, edukimin, prodhimin, ekspozimin dhe shtrirjen në komunitet. Rrjeti do të lehtësojë ekspozitat shëtitëse, rezidencat e përbashkëta dhe programimin e përbashkët, të mbështetura nga shërbime të përbashkëta si prokurimi, shpërndarja digjitale dhe sistemet e menaxhimit të audiencës.

Gjithashtu, do të krijohet një *Regjistër Kombëtar i Infrastrukturës Kulturore,* i konceptuar si një inventar dinamik, i gjeoreferencuar, i të gjitha hapësirave kulturore publike. Regjistri do të përfshijë të dhëna mbi pronësinë, gjendjen, aksesueshmërinë, pajisjet teknike dhe profilin energjitik, si dhe statistika mbi vizitorët dhe të programet. Ai do të shërbejë si një instrument mbështetës për një vendimmarrje që synon shpërndarjen e drejtë të investimeve dhe financimin e bazuar në performancë.

Në mbështetje të këtyre reformave, do të zbatohet dhe *Programi për Zhvillimin e Lidershipit dhe Aftësive* për drejtorët, kuratorët, stafin edukativ, teknikët dhe personelin e mirëmbajtjes së institucioneve kulturore. Programi do të forcojë kompetencat në menaxhimin e aseteve kulturore, programimin gjithëpërfshirës, funksionimin digjital dhe menaxhimin e partneriteteve, duke siguruar që infrastruktura kulturore të menaxhohet sipas standardeve bashkëkohore profesionale.

Zbatimi i këtyre masave do të kërkojë koordinim të ngushtë midis Ministrisë përgjegjëse për kulturën, bashkive dhe institucioneve të tjera përkatëse. Për të mbështetur bashkitë në këtë proces, do të ngrihet një program gjithëpërfshirës për ndërtimin e kapaciteteve, duke ofruar të gjitha mjetet dhe udhëzimet e nevojshme për t'u mundësuar autoriteteve lokale të zhvillojnë në mënyrë efektive *Planet Kulturore Vjetore.* Kjo do të përfshijë mbështetje praktike si shembuj planesh nga kontekste të krahasueshme, modele dokumentesh dhe korniza të standardizuara, sesione trajnimi dhe asistencë teknike të dedikuar. Qëllimi është të garantohet që asnjë bashki të mos

mbetet pa njohuritë dhe burimet e nevojshme për t'u angazhuar në mënyrë kuptimplote me Strategjinë.

Progresi do të monitorohet përmes raportimit periodik duke përdorur të dhëna nga Regjistri i Infrastrukturës Kulturore dhe treguesit e performancës institucionale. Ministria përgjegjëse për kulturën do të publikojë një raport dyvjeçar mbi *Gjendjen e Infrastrukturës Kulturore*, duke paraqitur arritjet kryesore, treguesit mbi shpërnarjen rajonale të investimeve dhe pajtueshmërinë me standardet e aksesueshmërisë dhe qëndrueshmërisë.

Bashkëpunimi ndërsektorial, me politikat e arsimit, turizmit, mjedisit dhe zhvillimit lokal, do të garantojnë që infrastruktura kulturore të kontribuojë në përfshirjen sociale, kohezionin rajonal dhe rritjen e qëndrueshme, në përputhje me vizionin parësor të kulturës si një motor i vlerës publike dhe pjesëmarrjes qytetare.

5.4 Politikat për përfshirjen dhe aksesueshmërinë

Konsultimet me palët e interesit dhe analiza e situatës aktuale nxjerrin në pah kërkesat urgjente për përmirësimin e aksesueshmërisë në mbarë sektorin kulturor të Shqipërisë: infrastrukturë dhe informacione të përshtatshme dhe për personat me aftësi ndryshe, mundësi kulturore përtej kryeqytetit, mbështetje për fëmijët me të ardhura të ulëta dhe akses universal në sitet kulturore. Këto prioritete pasqyrojnë qartë konsideratën gjerësisht të përhapur që kultura duhet t'u shërbejë audiencave të ndryshme dhe të jetë e integruar në të gjitha shtyllat e politikave - përfshirë trashëgiminë, prodhimin krijues, edukimin dhe infrastrukturën - jo të mbetet e kufizuara në programe të veçuara. Kuadri ligjor i Shqipërisë (përfshirë ligjet për pakicat dhe antidiskriminimin) dhe angazhimet ndërkombëtare (UNESCO, Këshilli i Evropës, standardet e BE-së) hedhin hapat e parë për përfshirje, por mbeten ende për tu adresuar disa mangësi serioze për sa i përket zbatimit, hartimit dhe monitorimit të ndikimit në nivelet lokale dhe kombëtare.

Aksesi në kulturë është zgjeruar përmes platformave digjitale, tarifave të reduktuara të hyrjes dhe iniciativave lokale, për shembul përmes tureve virtuale në muze dhe arkivave digjitale, por pabarazitë rajonale mbeten të konsiderueshme. Institucionet kryesore në Tiranë ofrojnë përvoja të rinovuara dhe të aksesueshme si dhe mjete digjitale, ndërsa sitet rajonale shpesh vuajnë nga mospërputhja me standardet ndërkombëtare të aksesueshmërisë, mungesa e auditimeve gjithëpërfshirëse dhe e përfshirjes sistematike të grupeve të margjinalizuara, çka sjell një pjesëmarrje të pabarabartë kulturore.

Vështirësitue kryesore për një akses të drejtë dhe të barabartë përfshijnë:

- Mungesën e zbatimit të standardeve të aksesueshmërisë si në kontekstet fizike dhe digjitale; nuk ka një auditim të unifikuar kombëtar apo një manual teknik që udhëzon eliminim apo zbehjen e barrierave kulturore;
- Financimin dhe investimet e kufizuara për përshtatje gjithëpërfshirëse, veçanërisht në zonat rajonale dhe rurale; shumica e burimeve dhe programeve janë përqendruar në Tiranë;
- Mbështetjen e pamjaftueshme për pjesëmarrjen e pakicave, personave me aftësi të kufizuara dhe komuniteteve të margjinalizuara si në prodhimin kulturor ashtu edhe në qeverisje; angazhimi i palëve të interesit shpesh kufizohet në përfshirjen e bazuar në aktivitete të veçanta, dhe jo në mekanizmat e vendimmarrjes;
- Ndërgjegjësimin e ulët të institucioneve dhe komuniteteve në lidhje me kornizat e përfshirjes, duke sjellur zbatim të fragmentuar të praktikave të mira dhe nënshfrytëzim e mbrojtjes ligjore ekzistuese.

Pasoja e këtyre shkaqeve është një sistem kulturor ende i karakterizuar nga barriera për personat me aftësi të kufizuara, grupet me të ardhura të ulëta dhe pakicat. Pjesa më e madhe e infrastrukturës së aksesueshme, e programimit gjithëpërfshirës dhe e shërbimeve digjitale janë të përqendruara në qendrat kryesore urbane, veçanërisht në Tiranë. Muzetë, qendrat kulturore dhe sitet rajonale mbeten pas, duke gjeneruar pabarazi të theksuara territoriale dhe duke kufizuar pjesëmarrjen e plotë të komuniteteve jashtë kryeqytetit apo atyre me nevoja të veçanta. Konsumi dhe prodhimi kulturor janë të shpërndarë në mënyrë të pabarabartë, ku pakicat kombëtare, të rinjtë, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara janë shpesh të nën-përfaqësuar në institucione, role profesionale dhe organe vendimmarrëse. Përjetimi i përfshirjes mbetet i fragmentuar dhe episodik, në vend që të jetë i rrënjosur në të gjitha aspektet e jetës kulturore.

Nëse nuk u jepen zgjidhje barrierave ekonomike, fizike dhe simbolike, Shqipëria rrezikon të vazhdojë një cikël që kufizon pjesëmarrjen e komuniteteve, frenon shprehjen krijuese dhe dobëson qëndrueshmërinë dhe vitalitetin e sektorit të saj kulturor. Përfshirja e vërtetë duhet të kuptohet si një parim që duhet të jetë i integruar në të gjitha politikat, praktikat dhe investimet kulturore - duke i mundësuar çdo komuniteti në Shqipëri të ketë akses, të formësojë dhe të përfitojë nga jeta kulturore e vendit. Drejtimet e politikave legjislative dhe menaxheriale në fushën e aksesit në kulturë në Shqipëri trajtojnë drejtpërdrejt shkaqet, pasoja dhe ndikimet sistemike të evidentuara nga palët e interesit ashtu edhe nga analiza e situatës aktuale. Këto drejtime politike operacionalizojnë parimin e përfshirjes, institucionalizojnë llogaridhënien dhe shfrytëzojnë rrjetet për ndryshime sistemike - duke e orientuar Shqipërinë drejt një modeli ku çdo komunitet ka akses kuptimplotë dhe të qëndrueshëm në jetën kulturore, pavarësisht nga pozicioni gjeografik, aftësitë apo të ardhurat.

Niveli Legjislativ

Aktualisht, mandatet institucionale të paqarta si dhe fragmentimi e mbivendosja e përgjegjësive përbëjnë pengesën kryesore për mirëmbajtjen dhe përshtatjen e qëndrueshme e të drejtë të infrastrukturës kulturore në të gjithë vendin. Përmes sqarimit në nivel legjislativ se cilat organe janë përgjegjëse për investimet e vazhdueshme dhe mirëmbajtjen, - përfshirë përcaktimin e standardeve minimale të aksesueshmërisë - garantohet që llogaridhënia mbi aksesueshmërinë dhe përfshirjen të jetë e integruar në sistemin e qeverisjes. Detyrat e qarta mundësojnë financim të synuar, planifikim më të mirë dhe mirëmbajtje të besueshme, duke reduktuar pabarazitë midis Tiranës dhe rajoneve të tjera, si dhe duke krijuar një kornizë koherente për përshtatjen e të gjitha hapësirave kulturore për audienca të ndryshme.

Një përparësi e dytë legjislative është krijimi i mekanizmave formalë që kërkojnë konsultim me komunitetin dhe mundësojnë modele bashkëmenaxhimi në institucionet kulturore. Masa të tilla u përgjigjen konstatimeve se përfshirja sot është shpesh e bazuar në aktivitete të veçuara ose simbolike, dhe jo një proces i vazhdueshëm dhe i integruar. Përmes rrugëve formale të pjesëmarrjes, veçanërisht ato që prekin personat me aftësi ndryshe, pakicat dhe grupet me të ardhura të ulëta, politikat shkojnë përtej planifikimit nga lart-poshtë, duke u mundësuar në të vërtetë komuniteteve të formësojnë, monitorojnë dhe vlerësojnë ofrimin e shërbimeve kulturore. Bashkëmenaxhimi rrit besimin, përmirëson përshtatjen e infrastrukturës dhe programeve ndaj nevojave reale, si dhe i ndihmon institucionet të parashikojnë barrierat përpara se ato të shfaqen, duke reduktuar kështu përjashtimin dhe duke forcuar qytetarinë kulturore.

Niveli Menaxherial

Reformat menaxheriale të përqendruara në krijimin e rrjeteve kombëtare dhe në programe të përbashkëta me diasporën dhe partnerë lokalë, mundësojnë përhapjen e praktikave të mira dhe kapërcimin e pabarazive territoriale. Rrjetet kombëtare u lejojnë institucioneve, veçanërisht atyre më të vogla apo atyre rajonale, të ndajnë burimet, trajnimet dhe inovacionet në fushën e aksesueshmërisë. Programimi i përbashkët, duke përfshirë bashkëpunimin me diasporën dhe organizatat lokale, zgjerojnë shtrirjen e iniciativave përtej kryeqytetit, sigurojnë përmbajtje më të larmishme dhe e shndërrojnë pjesëmarrjen kulturore në një proces tërësisht kombëtar dhe jo të përqendruar vetëm në urbane. Këto qasje e kthejnë përfshirjen në një përgjegjësi të përbashkët të mbarë sektorit dhe forcojnë bashkërendimin mes shtyllave të politikave që synojnë trashëgiminë, prodhimin krijues dhe programet edukative, me qëllim përparimin drejt një akses të drejtë dhe të barabartë për të gjithë.

5.5 Politikat ndërsektoriale

5.5.1 Ndërtimi i kapaciteteve

Sistemi i arsimit dhe aftësive në Shqipëri për sektorin e kulturës dhe trashëgimisë karakterizohet nga një nevojë urgjente për modernizim dhe integrim, siç është vënë në dukje nga palët e interesit dhe siç është diskutuar gjerësisht në analizën e situatës aktuale. Ekziston një konsideratë e lartë dhe gjerësisht e përhapur për vlerën që kanë lidhja e drejtpërdrejtë e arsimit me trashëgiminë; partneritetet ndërsektoriale midis shkollave, muzeve, artistëve dhe drejtorive rajonale të trashëgimisë kulturore (DRTK); dhe zgjerimi i trajnimit të specializuar në muzeologji, restaurim, zanate tradicionale dhe teknologji krijuese. Palët e interesit kanë bërë thirrje për departamente të dedikuara universitare, rrugëve të arsimit profesional, zhvillim të vazhdueshëm profesional, si dhe për qasje të strukturuara për të mbajtur gjallë artizanatin për brezat e ardhshëm. Analiza e gjendjes ekzistuese nënvizon pabarazitë rajonale, ku burimet, stafi i kualifikuar dhe infrastruktura arsimore janë të përqendruara në qendrat urbane si Tirana, ndërsa zonat rurale dhe periferike vuajnë nga mungesa e aftësive, pjesëmarrja më e ulët dhe aksesi i kufizuar. Për më tepër, zanatet tradicionale dhe trashëgimia kulturore jomateriale ruhen kryesisht përmes transmetimit informal, duke u munguar mbështetja sistematike dhe integrimi me arsimin formal ose me sistemin e praktikave profesionale. Muzetë luajnë një rol vendimtar, por përballen me sfida në lidhje me kapacitetet e stafit, aftësitë menaxheriale dhe transformimin digjital, çka rezulton në cilësi të pabarabartë shërbimi dhe angazhim të kufizuar të komunitetit nëpër rajone.

Shkaqet kryesore të këtyre dobësive të lidhura me arsimin dhe aftësitë përfshijnë:

- Rrugët e pamjaftueshme të arsimit profesional dhe të lartë në fushat e trashëgimisë, muzeologjisë, arteve dhe teknologjive krijuese.
- Mungesën e një kuadri për zhvillimin e vazhdueshëm profesional për profesionistët e trashëgimisë, stafin e muzeve dhe praktikuesit krijues, çka ka shpënë kryesisht drejt programeve *ad hoc* të trajnimeve të nxitura nga donatorët, të pambështetura në një program të institucionalizuar të të nxënit gjatë gjithë jetës për këto fusha.
- Bashkëpunimin e kufizuar ndërinstitucional midis ministrive, universiteteve, institucioneve kulturore dhe shoqatave të artizanëve, gjë që ka minimizuar inovacionin ndërsektorial dhe ndarjen e njohurive.
- Politikat e fragmentuara dhe centralizimin - të cilët thellojnë pabarazitë midis zonave urbane dhe rurale - si dhe inercinë e përtëritjes së aftësive dhe njohurive sektoriale.
- Nënfinancimin kronik, ku pjesa më e madhe e investimeve i kushtohet pagave, dhe jo zhvillimit të stafit, kërkimit shkencor apo inovacionit.

Këto sfida strukturore kanë pasoja konkrete mbi fuqinë punëtore në sektorin e trashëgimisë në Shqipëri:

- Mungesa e vazhdueshme në aftësive në restaurim, muzeologji, menaxhim arti dhe teknologji digjitale, çka ndikon drejtpërdrejt në cilësinë dhe shtrirjen e ruajtjes së trashëgimisë dhe operacioneve muzeore në të gjithë vendin.
- Projektet e restaurimit, ofrimi i shërbimeve dhe menaxhimi i muzeve dhe siteve kulturore shpesh vonohen në kohë ose kanë cilësi të pabarabartë, veçanërisht në rajonet e nënshërbyera në terma trajnimesh apo burimesh profesionale.
- Transmetimi dhe vitaliteti i artizanatit dhe i trashëgimisë jomateriale po pësojnë rënie, pasi rrjetet informale nuk janë në gjendje të rekrutojnë ose trajnojnë në mënyrë efektive brezat e rinj apo t'i përshtaten teknologjive dhe tregjeve bashkëkohore.
- Mungesa e aftësive ndërdisiplinore brenda stafece, në veçanti ato të orientuara drej biznesit dhe të angazhimit në komunitet, zbehin aftësinë e sektorit për të inovuar, komunikuar dhe angazhuar audienca më të gjera.

Ndikimi kumulativ i këtyre mangësive është i konsiderueshëm:

- Aftësia e Shqipërisë për të mbrojtur, vlerësuar dhe për të shfrytëzuar burimet e saj kulturore për edukim, turizëm dhe zhvillim ekonomik cenohet nga vonesat dhe paqendrueshmëria që lidhen me restaurimin, ofrimin e shërbimeve dhe hartimin e programeve.
- Rënia e transmetimit të trashëgimisë materiale dhe jomateriale, veçanërisht e zanateve tradicionale, vë në rrezik aspekte thelbësore të identitetit kulturor të Shqipërisë dhe vazhdimësisë ndërgjeneracionale.
- Aftësitë ripërtëritëse kapacitetet e sektorit për të tërhequr profesionistë janë dobësuar, duke përshpejtuar migrimin e profesionistëve të talentuar dhe duke pakësuar mundësitë për të rinjtë në fushat e trashëgimisë, muzeve dhe krijimtarisë kulturore.
- Vizibiliteti dhe aksesueshmëria e ulët në rajonet periferike përforcojnë pabarazitë territoriale, duke zvogëluar pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse dhe angazhimin kulturor në të gjithë vendin.
- Pa investime sistemike në arsim, kërkim shkencor dhe në kuadrin e të nxënit gjatë gjithë jetës, sektori kulturor i Shqipërisë mbetet i ekzposuar ndaj stanjacionit dhe i pafuqishëm për të përmbushur standardet ndërkombëtare për profesionalizim, inovacion dhe pjesëmarrje komunitare.

Kjo situatë dikton nevojën për një përgjigje strategjike, të fokusuar në rrugë të integruara arsimore, zhvillim të vazhdueshëm profesional, partneritete ndërsektoriale dhe masa të synuara për ndërtimin e kapaciteteve, me qëllim që institucionet dhe fuqia punëtore e trashëgimisë në Shqipëri të përparojnë në një kontekst global që evoluon me shpejtësi.

Drejtimet e përcaktuara, - njohja me ligj e profesioneve dhe kualifikimeve kulturore, mbështetja fiskale përmes bursave dhe granteve të trajnimit, si dhe strategjitë menaxheriale të përqendruara në zhvillimin e kapaciteteve dhe partneritetet - përbëjnë përgjigje strategjike të përshtatura për dobësitë dhe qëllimet specifike të sektorit të trashëgimisë dhe kulturës në Shqipëri. Duke ndjekur këto drejtime të politikave legjislative, fiskale dhe menaxheriale në një mënyrë të koordinuar, Shqipëria mund të kapërcejë mangësitë e rrenjosura thellë në profesionalizim, kapacitete dhe vizibilitetin sektorial, duke garantuar që fuqia e saj punëtore kulturore të shndërrohet në një themel për zhvillimin e qëndrueshëm kulturor, arsimor dhe socio-ekonomik.

Niveli Legjislativ

Njohja me ligj e profesioneve dhe kualifikimeve specifike kulturore krijon një kornizë themelore për profesionalizmin, rrugëtimet e karrierës dhe statusin e sektorit. Ky qartësim ligjor legjitimon fusha si muzeologjia, ruajtja e trashëgimisë dhe zanatet tradicionale, duke përmirësuar sigurinë e punës, duke tërhequr talente duke mundësuar që kualifikimet të jenë të transferueshme ndërmjet institucioneve dhe përtej kufijve. Një njohje e tillë gjithashtu e përafron Shqipërinë me standardet ndërkombëtare, përmirëson regjistrin kombëtar të aftësive dhe e pajis sektorin për t'iu përgjigjur kërkesave të ardhshme dhe nevojave lidhur me inovacionin. Pa këtë njohje, sektori mbetet i fragmentuar, jo konkurrues dhe më pak tërheqës për të rinjtë dhe profesionistët e rinj, çka kontribuuon në nxitjen e migrimit jashtë vendit dhe njëkohësisht në thellimin e mungesës së aftësive që kërkon sektori.

Niveli Fiskal

Bursat dhe grantet e trajnimit - aktualisht të perceptuara si subjekt nënfinancimi kronik - ndikojnë në zhvillimin e stafit dhe kërkimin shkencor në fushën e trashëgimisë. Mbështetja fiskale ul barrierat ekonomike për individët që hyjnë ose përparojnë në profesionet r lidhura me trashëgiminë, u hap akses studentëve nga rajonet rurale ose të nënshërbyera dhe i nxit të rinjtë të ndjekin karriera në zanate, muzeologji dhe teknologji krijuese. Përmes rialokimit të burimeve përtej pagave të thjeshta, këto investime sigurojnë një linjë të vazhdueshme praktikuesish të kualifikuar, balancojnë pabarazitë rajonale dhe ndihmojnë në garantimin e transmetimit ndërgjeneracional të aftësive moderne dhe atyre tradicionale, të cilat mbetem thelbësore për vitalitetin kulturor të Shqipërisë.

Përveç kësaj, një program bursash mund të shërbejë si një instrument strategjik për të nxitur përfshirjen e ndërmarrjeve private në mbështetjen e edukimit kulturor dhe zhvillimin e fuqisë punëtore krijuese. Përmes partneriteteve ndërmjet sektorit publik, sektorit privat dhe institucioneve kulturore e arsimore, mund të krijohen mundësi të reja për mbështetjen e talenteve të reja, forcimin e lidhjeve ndërmjet arsimit dhe tregut të punës, si dhe diversifikimin e burimeve të financimit për kulturën dhe artet.

Çdo mekanizëm mbështetës që përfshin sektorin privat do të zhvillohet në përputhje me kuadrin ligjor dhe financiar në fuqi, përmes instrumenteve të përshtatshme të politikëbërjes dhe në përputhje me prioritetet kombëtare.

Nivel Menaxherial

Iniciativat menaxheriale, ku përfshihen programet për zhvillimin e kapaciteteve dhe partneritete të qëndrueshme me universitete, shkolla profesionale dhe institucione kulturore, mundësojnë një proces sistematik të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe përshtatjen ndaj nevojave në zhvillim të sektorit. Korniza të tilla e zhvendosin trajnimin nga aktivitete *ad hoc*, të nxitura nga donatorët, në zhvillimin profesional të institucionalizuar dhe të bazuar në nevoja, duke përmirësuar rezultatet e restaurimit, cilësinë e muzeve dhe ruajtjen e zanateve tradicionale. Partneritetet gjithashtu nxisin shkëmbimin e njohurive, aftësitë ndërdisiplinore dhe angazhimin e komunitetit, duke siguruar barazi rajonale dhe planifikim inovativ dhe të përgjegjshëm të fuqisë punëtore. Këto masa janë thelbësore për të tejkaluar hendekun që ndan qendrat urbane nga ato rurale, për të forcuar aftësitë ripërtëritëse të sektorit dhe inkurajuar konkurrueshmërinë ndërkombëtare.

Për të maksimizuar ndikimin, programi i trajnimit dhe i praktikave profesionale duhet të zhvillohet në bashkëpunim me universitetet për të garantuar njohjen formale të tij. Kjo iniciativë duhet të shtrihet në të gjitha segmentet e zinxhirit të prodhimit kulturor, duke integruar përvoja jo vetëm në institucionet publike, por edhe në organizatat e sektorit të tretë (shoqërisë civile) dhe ndërmarrjet private në sektor. Një mbulim i tillë gjithëpërfshirës do t'u ofronte studentëve dhe profesionistëve të rinj një edukim të larmishëm dhe të orientuar drejt praktikës, do të përforconte lidhjet midis arsimit formal dhe kërkesës së tregut të punës dhe do të kultivonte një kuptim holistik të punës kulturore. Në fund, kjo qasje do të çonte përpara ambicien e Shqipërisë për të krijuar një fuqi punëtore kulturore të adaptueshme dhe të qëndrueshme, të përgatitur për bashkëpunim dhe inovacion ndërsektorial.

5.5.2 Transformimi digjital dhe të dhënat

Transformimi digjital i Shqipërisë brenda sektorëve të kulturës dhe trashëgimisë kulturore karakterizohet nga plane ambicioze, por edhe sfida të theksuara. Grupet e interesit theksojnë nevojën urgjente për integrimin e teknologjisë brenda muzeve, digjitalizimin e arkivave dhe krijimin e bazave të të dhënave të certifikuara dhe të unifikuara për informacionin mbi trashëgiminë. Institucionet rajonale të trashëgimisë kërkojnë posaçërisht udhëzime praktike dhe burime për digjitalizimin lokal, ndërsa institucionet qendrore i japin përparësi ndërtimit të platformave kombëtare të unifikuara dhe të ndërveprueshme për të harmonizuar dokumentacionin dhe për të rritur aksesin.

Ristrukturimi i fundit i Ministrisë përgjegjëse për kulturën duke konsoliduar turizmin, kulturën dhe sportet i kushton rëndësi edhe më të madhe transformimit digjital si një përparësi sektoriale dhe si një mjet për ndërtimin e imazhit të kombit. Pavarësisht hapave pozitivë, progresi më i madh është shënuar në institucionet kryesore në Tiranë, ndërsa muzetë dhe arkivat rajonale mbeten pas sa i përket kapaciteteve digjitale dhe vizibilitetin publik. Analiza e situatës së tanishme nxjerr në pah këtë hendek digjital, duke vënë re se, ndërsa disa institucione kanë zbatuar biletat online dhe udhërrëfyes digjitalë, shumë aktorë rajonalë mbeten të shkëputur nga këto përmirësime teknologjike, gjë që rrezikon të riprodhojë pabarazitë ekzistuese territoriale dhe institucionale.

Nënzhvillimi i ekosistemit të trashëgimisë digjitale të Shqipërisë i ka rrënjët në disa çështje strukturore:

- Mungesa e platformave dhe protokolleve të integruara digjitale që lidhin muzetë, arkivat dhe sitet e trashëgimisë në nivel kombëtar.
- Ekspertizë teknike e pamjaftueshme dhe trajnimi i pakët profesionalnë digjitalizim, menaxhim digjital dhe kurimin e të dhënave në të gjitha institucionet qendrore dhe rajonale.
- Financimi i fragmentuar, ku një pjesë e konsiderueshme e burimeve orientohet drejt institucioneve bërthamë, dhe investimet shumëvjeçare në infrastrukturën digjitale, mjete apo në ngritjen e kapaciteteve përtej kryeqytetit janë të kufizuara.
- Mungesa e udhëzuesve kombëtarë të standardizuar ose proceseve të çertifikimit për projektet e digjitalizimit, duke rezultuar në qasje të ndryshme dhe mungesë ndërveprimi.
- Ndërgjegjësimi dhe shtrirja midis aktorëve lokalë të kulturës sa u përket përfitimeve dhe kërkesave të digjitalizimit.

Efektet e drejtpërdrejta të këtyre mangësive sistemike janë të konsiderueshme:

- Arkivat dhe bazat e të dhënave në mbarë vendin mbeten të shkëputura, duke i bërë sfidues, shpesh dhe të pamundur proceset që lidhen me shkëmbimin e të dhënave, kërkimin shkencor ndërinstitucional dhe menaxhimin gjithëpërfshirës të trashëgimisë. Informacioni publik në lidhje me koleksionet, sitet dhe pasuritë historike është shpesh i paplotë, i vjetëruar ose i vështirë për t'u aksesuar - veçanërisht jashtë qendrave të mëdha urbane.
- Institucionet rajonale përjashtohen nga shtrirja kombëtare ose ndërkombëtare, duke kufizuar kapacitetet e tyre për zhvillimin e audiencës, programimin edukativ dhe angazhimin e komunitetit.
- Investimet në infrastrukturën digjitale priren të përforcojnë çekuilibrat gjeografikë dhe sektorialë ekzistues, pasi Tirana dhe një numër i vogël institucionesh urbane dominojnë inovacionin dhe prezencën publike, ndërsa

shumë site rajonale janë digjitalisht të padukshme ose u mungon qoftë edhe një prezantim bazë online.

Ndikimet e stanjacionit në terma transformimi digjital janë sa të menjëhershme, ashtu edhe afatgjata:

- Vizibiliteti i Shqipërisë në rrjetet evropiane dhe ndërkombëtare të trashëgimisë dhe muzeve është i kufizuar nga aksesi digjital i fragmentuar dhe i vjetruar, duke kufizuar mundësitë lidhur me diplomacinë kulturore dhe partneritetet.
- Mungesa e sistemeve të qëndrueshme kombëtare të të dhënave cënon menaxhimin e njohurive, monitorimin e politikave dhe aftësinë për t'ju përgjigjur rreziqeve (fizike, mjedisore ose demografike) në mbarë peizazhin e trashëgimisë.
- Ruajtja dhe transmetimi i njohurive të komunitetit zbehen, veçanërisht për historitë lokale dhe të pakicave, traditat gojore dhe arkivat vendore që rrezikojnë të humbasin pa u digjitalizuar.
- Burimet shoqërore për edukimin, turizmin, kërkimin shkencor dhe industritë krijuese nuk shfrytëzohen sa duhet, duke penguar si potencialin ekonomik ashtu edhe aftësinë e vendit për të promovuar identitetin e tij kulturor në epokën digjitale.

Një strategji koherente për transformimin digjital duhet të përqendrohet te zgjerimi i ekspertizës teknike, krijimi i platformave dhe standardeve të unifikuara kombëtare, duke i dhënë përparësi përfshirjes rajonale dhe duke nxitur investime të qëndrueshme në modernizimin e infrastrukturës së informacionit kulturor të Shqipërisë. Vetëm kjo qasje mund të garantojë që trashëgimia e Shqipërisë të jetë e aksesueshme, e qëndrueshme dhe me interes për brezat e ardhshëm, si në nivel lokal ashtu edhe në atë global. Drejtimet e rekomanduara të politikave për transformimin digjital të Shqipërisë në sektorët e kulturës dhe trashëgimisë - legjislative (qeverisja e të dhënave dhe standardet e ndërveprimit), fiskale (programet e financimit të digjitalizimit) dhe menaxheriale (trajnimi i operatorëve, certifikimet e centralizuara të përmbajtjes, digjitalizimi i proceseve organizative) - pasqyrojnë drejtpërdrejt diagnozën e barrierave sistemike dhe janë të nevojshme për të kapërcyer fragmentimin ekzistues, mangësitë në kapaciteteve dhe faktorët e mosefiçiencës.

Të marra së bashku, këto nivele politikash krijojnë parakushtet për një ekosistem të trashëgimisë digjitale të aksesueshëm, të ndërveprueshëm dhe të përgatitur për të ardhmen. Qartësia legjislative, financimi i synuar dhe zbatimi i përpiktë menaxherial do të garantojnë që trashëgimia kulturore e Shqipërisë jo vetëm të ruhet, por të shfrytëzohet si një nxitës për edukimin, kërkimin shkencor, diplomacinë kulturore, zhvillimin ekonomik dhe identitetin kombëtar në epokën digjitale.

Niveli Legjislativ

Niveli legjislativ është thelbësor për krijimin e një infrastrukture të njësuar dhe efektive të trashëgimisë digjitale. Miratimi i kornizave të qarta të qeverisjes së të dhënave dhe standardeve të ndërveprueshmërisë do të adresojë mungesën aktuale të integrimit dhe praktikat jokonsistente nëpër muzetë, arkivat dhe sitet e trashëgimisë. Këto standarde janë thelbësore për të mundësuar ndarjen pa pengesa të të dhënave, kërkimin shkencor bashkëpunues, menaxhimin e burimeve ndërinstitucionale dhe certifikimin e përmbajtjes digjitale në nivel kombëtar. Reformat legjislative gjithashtu garantojnë sigurinë e të dhënave, respektimin e pronësisë intelektuale, mbrojtjen e privatësisë dhe krijojimin e rregullave uniforme për aktorët rajonalë dhe lokalë, duke reduktuar kështu pabarazitë territoriale dhe institucionale.

Niveli Fiskal

Politika fiskale e fokusuar në financimin e digjitalizimit përbën motorin për ndryshimin operacional. Nevojiten grante dhe programe investimi të synuara për të pajisur institucionet kryesore dhe rajonale me infrastrukturë digjitale, softuerë dhe mjete teknologjike. Financimi i synuar mbështet përthithjen e ekspertizës teknike dhe mundëson modernizimin e qëndrueshëm të arkivave, koleksioneve dhe sistemeve të aksesit. Mbështetja fiskale - veçanërisht ajo që garantom vazhdimësi disavjeçare - ndihmon që transformimi digjital të mos kufizohet vetëm në projekte urbane me intensitet të lartë kapitali, por të shtrihet edhe muzetë lokale, arkivat dhe ruajtësit e trashëgimisë së pakicave, duke nxitur kështu barazinë territoriale dhe një përfitim më të gjerë shoqëror. Kapitulli "*Financimi dhe operacionalizimi i strategjisë*" eksploron instrumente dhe dhe mekanizma konkretë, si "*Këshilli i Artit*", etj.

Nivel Menaxherial

Masat menaxheriale - si trajnimi i stafit, certifikimi i centralizuar i përmbajtjes digjitale dhe digjitalizimi i proceseve organizative - janë thelbësore për përkthimin e inovacionit legjislativ dhe fiskal në një praktikë efektive të përditshme. Zhvillimi profesional në digjitalizim dhe menaxhim digjital rrit kapacitetin institucional, duke kapërcyer hendekun e ekspertizës teknike si në organet qendrore ashtu edhe në ato rajonale. Certifikimet e centralizuara sigurojnë qëndrueshmëri, cilësi dhe besim në të dhënat digjitale dhe mundësojnë përputhshmërinë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Për më tepër, digjitalizimi i proceseve organizative përmirëson efikasitetin e menaxhimit, transparencën dhe ofrimin e shërbimeve, duke u mundësuar institucioneve të angazhohen më mirë me publikun, partnerët edukativë dhe rrjetet e turizmit.

5.5.3 Pjesëmarrja e komunitetit dhe partneritetet

Konsultimet me palët e interesit dhe analiza e gjendjes ekzistuese evidentojnë se forcimi i pjesëmarrjes së komunitetit dhe i partneriteteve është një nxitës thelbësor ndërsektorial për politikën kulturore të Shqipërisë. Aktorët vendorë, duke përfshirë

institucionet dhe OJQ-të, advokojnë gjithnjë e më shumë vendimmarrje të përbashkët ("*co-decision*") dhe qeverisje të përbashkët në menaxhimin e siteve, ndërsa institucionet kombëtare kërkojnë rregulla të qarta dhe të standardizuara për bashkëpunim. Ekziston gjithashtu dhe një kërkesë e gjerë për mekanizma konsultimi më gjithëpërfshirës, për krijimin e një rrjeti kombëtar muzeor, si dhe partneritete të forta me aktorët lokalë, rajonalë, ndërkufitarër dhe të diasporës. Për më tepër, të dhënat dhe rishikimet e politikave tregojnë se qasjet aktuale ndaj angazhimit të komunitetit janë kryesisht simbolike - të përqendruara në festivale ose ngjarje publike - dhe jo të integruara në qeverisje, planifikim dhe role operacionale. Ndonëse *Konventa e Faros* është nënshkruar, Shqipëria ende nuk e ka ratifikuar atë, duke kufizuar kështu integrimin formal të komuniteteve në administrimin e trashëgimisë. Praktikat e pakicave mbeten të nënvlerësuara dhe mundësitë për kontributin lokal në vendimmarrje janë të pakta.

Këto sfida burojnë nga mekanizmat e kufizuar dhe jokonsistentë të konsultimit, mungesa e platformave të përhershme për koordinim dhe nga qasjet e fragmentuara ndaj zbatimit të politikave. Mbështetja financiare dhe teknike për iniciativat e udhëhequra nga komuniteti mbetet e pamjaftueshme, ndërsa përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve janë sporadike dhe nuk bazohen sistematikisht në kornizat e politikave. Mekanizmat e dobët të zbatimit për çështje të tilla si trafikimi i paligjshëm gjithashtu dobësojnë besimin e komunitetit në qeverisjen e trashëgimisë.

Si rezultat, ndjenja e përkatësisë dhe e përgjegjësisë lokale për projektet kulturore mbetet e dobët dhe duplikimi i iniciativave është e zakonshme. Projekteve shpesh u mungon angazhimi i qëndrueshëm i komunitetit dhe në vend të kësaj, ata mbështeten në menaxhimin nga lart poshtë që kufizon administrimin efektiv dhe inovacionin. Pabarazitë rajonale në pjesëmarrje dhe programim kulturor vazhdojnë dhe shumë zëra të komunitetit, veçanërisht ata që përfaqësojnë pakicat ose zonat periferike, vazhdojnë të mbeten të margjinalizuar.

Këto mangësi prodhojnë projekte të paqëndrueshme, sinergji të humbura dhe përfitime të kufizuara shoqërore, duke cenuar themelet e një ekosistemi kulturor të ripërtërishëm, pluralist dhe gjithëpërfshirës. Margjinalizimi i komuniteteve në vendimmarrje çon në cenueshmëri, fragmentim dhe nënshfrytëzim të burimeve të larmishme kulturore të Shqipërisë. Pa një reformë strukturore, pjesëmarrja e komunitetit do të mbetet një objekti retorik dhe jo një realitet praktik, me pasoja negative për kohezionin shoqëror afatgjatë, transmetimin e trashëgimisë dhe përafrimin efektiv me praktikat më të mira evropiane.

Ndërhyrjet legjislative dhe menaxheriale janë thelbësore për transformimin e pjesëmarrjes dhe partneriteteve të komunitetit nga objektiva retorike në nxitës efektivë të politikës kulturore të Shqipërisë. Kjo qasje me disa nivele trajton drejtpërdrejt

fragmentimin, ndjenjën e dobët të përkatësisë e përgjegjësisë lokale dhe mungesën e qëndrueshmërisë të theksuar në analizën e situatës. Veprimet e integruara legjislative dhe menaxheriale - të bazuara në konsultime me palët, korniza ligjore dhe rrjetet e koordinuara - janë drejtimet e politikave më të përshtatshme për të ndërtuar një ekosistem kulturor të ripërtërishëm, pluralist dhe të qëndrueshëm në Shqipëri, siç kërkohet nga prioritetet kombëtare dhe standardet mbarëevropiane.

Niveli Legjislativ
Mekanizmat formalë për konsultimin dhe bashkëmenaxhimin me komunitetin janë të nevojshëm për të mundësuar qeverisjen e përbashkët të aseteve kulturore. Konsultimi formal, ratifikimi i Konventës së Faros dhe njohja ligjore e aktorëve nga pakicat dhe diaspora do të lehtësonin pjesëmarrjen e gjerë, do të kanalizonin njohuritë e komunitetit në menaxhimin e siteve dhe do të ushqenin ndjenjën lokale të pronësisë mbi to. Reforma të tilla janë thelbësore për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të adaptueshëm të projekteve dhe për shfaqjen e sinergjive ndërsektoriale që synojnë kornizat kombëtare dhe evropiane.

Niveli Menaxherial
Krijimi i rrjeteve kombëtare të muzeve dhe zbatimi i programimit të përbashkët me partnerë vendorë, të diasporës dhe ndërkufitarë janë përgjigje të nevojshme menaxheriale ndaj menaxhimit të vazhdueshëm nga lart-poshtë dhe koordinimit të brishtë. Këto iniciativa mundësojnë planifikim të përbashkët, shkëmbim operativ dhe programim të larmishëm, të cilat përforcojnë përfshirjen, zvogëlojnë duplikimin e iniciativave dhe garantojnë që interesat e komunitetit të jenë të përfshira në hartimin dhe zbatimin e projektit. Reformat menaxheriale duhet të ngrenë platforma të përhershme për konsultim, të investojnë në mbështetje teknike dhe ndërtim kapacitetesh për institucionet lokale dhe OJQ-të, si dhe të nxisin partneritete të bazuara në rregulla të qarta dhe të standardizuara. Kjo përafron prioritetet kombëtare dhe lokale, rrit përfaqësimin e praktikave të pakicave dhe atyre rajonale, si dhe gjeneron përfitime të qëndrueshme kulturore, ekonomike dhe sociale në të gjitha nivelet territoriale.

6. Objektivat e Strategjisë

Sistemi kulturor i një kombi kryen funksione thelbësore: ai mbron, ruan dhe promovon trashëgiminë e krijuar në të kaluarën, stimulon krijimin e vlerave të reja kulturore përmes prodhimit krijues bashkëkohor, konsolidon ndjenjën e përkatësisë dhe unitetit, kontribuon në mirëqenien dhe cilësinë e jetesës, si dhe vepron si një sektor ekonomik në zhvillim, i pajisur me profesione të kualifikuara dhe aftësinë për të ushtruar një ndikim pozitiv në fusha të tjera. Gjatë identifikimit të shtyllave kryesore të Strategjisë

Kombëtare të Kulturës këto dimensione janë konsideruar në mënyrë të integruar, duke i lidhur, me vizionin strategjik kombëtar që përputhet me drejtimin e planifikuar të vendit për rritjen ekonomike, inovacionin, turizmin, arsimin dhe politikat rinore. Korniza strategjike e paraqitur në këtë dokument i përgjigjet si prioriteteve kombëtare, ashtu edhe zhvillimeve të politikave evropiane, veçanërisht *Busullës Kulturore për Evropën* të BE-së, e miratuar në nëntor 2025, e cila e pozicionon kulturën në qendër të qëndrueshmërisë demokratike, kohezionit social dhe konkurrueshmërisë ndërkombëtare.



Duke u nisur nga këto konsiderata, janë identifikuar tre shtylla kryesore rreth të cilave do të hartohet strategjia për kulturën, duke pasur parasysh prioritetet e identifikuara nga Ministria e Turizmit Kulturës dhe Sportit. Dy të parat rrjedhin nga konsiderimi i kulturës si një burim strategjik për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit dhe pozicionimin ndërkombëtar; e treta puerbën një shtyllë teknike, të domosdoshme për të hedhur bazat për dy të parat dhe për të udhëhequr shpërndarjen e burimeve financiare, teknike dhe njerëzore.

1. Duke u përqendruar në dimensionin e zhvillimit të qëndrueshëm, shtylla e parë e strategjisë e konsideron **Kulturën si nxitës për cilësinë e jetës.** Kultura përfaqëson një faktor kritik për cilësinë shoqërore. Kryesisht, kjo ndodh sepse prodhimi dhe konsumi i përditshëm i kulturës pasurojnë indin socialnë aspektin e kohezionit të komunitetit, cilësisë së marrëdhënieve njerëzore, besimit, vullnetit për të bashkëpunuar dhe ndjenjës së identitetit. Të gjithë këta elementë modifikojnë si kufizimet, ashtu edhe mundësitë e jetës së përditshme, duke

zvogëluar të parat dhe duke përmirësuar e shtuar të dytat. Cilësia sociale mund të përkufizohet si masa në të cilën njerëzit janë në gjendje të marrin pjesë në jetën sociale, ekonomike dhe kulturore të komuniteteve të tyre, në kushte që rrisin mirëqenien dhe potencialin e tyre individual. Njëkohësisht, cilësia sociale u mundëson gjithashtu individëve të kenë qasje në kulturë, në format e saj të larmishme, në trashëgimi, në të drejtat themelore të qytetarisë, në shëndet të mirë dhe kapital njerëzor të shtuar, si dhe, në një kuptim më të gjerë aftësinë për të marrë pjesë në jetën e komunitetit dhe për të zhvilluar projekte personale.

2. Shtylla e dytë, **Kultura si mjet dialogu në nivel ndërkombëtar,** lidhet me dimensionin e pozicionimit ndërkombëtar. Reputacioni është një aset që, për t'u ruajtur dhe përmirësuar, kërkon investime të konsiderueshme si nga burime publike, ashtu edhe nga ato private. Këto investime janë thelbësore për të nxitur cilësinë e prodhimit kulturor dhe krijues. Ekzistojnë dy drejtime kryesore strategjike që duhen ndjekur për të forcuar reputacionin ndërkombëtar të prodhimit dhe trashëgimisë kulturore shqiptare: zhvillimi i diplomacisë kulturore dhe zgjerimi i aksesit në tregjet globale.

3. Shtylla e tretë, **Mundësimi i ekosistemit kulturor**, përqendrohet në forcimin e përgjithshëm të sistemit, përmes rishikimit të kuadrit ligjor - aty ku është e nevojshme-, investimit për ndërtimin e kapaciteteve, krijimin e instrumenteve të reja operacionale dhe ndërhyrjeve të synuara në sistem. Ndërhyrje të tilla mund të përfshijnë grante dhe mekanizma mbështetës për prodhimin dhe shpërndarjen, duke ndikuar drejtpërdrejt në efikasitetin dhe kapacitetin e sektorit kulturor.

Kjo qasje pasqyron peizazhin në zhvillim të politikave evropiane, veçanërisht *Busullën e re për Kulturën të BE-së për Evropën*, e cila përcakton katër drejtime kryesore:

- respektimin e të drejtave dhe vlerave kulturore,
- fuqizimin e artistëve dhe profesionistëve të kulturës,
- mbështetjen te kultura për qëndrueshmëri dhe kohezion, si dhe
- promovimin e marrëdhënieve kulturore ndërkombëtare.

Korniza me tre shtylla e Shqipërisë është e lidhur drejtpërdrejt me këto prioritete. Fokusimi te kultura si një nxitës për cilësinë e jetës përputhet me theksin e BE-së në zgjerimin e pjesëmarrjes dhe rritjen e mirëqenies. Shtylla e pozicionimit ndërkombëtar pasqyron angazhimin e Busullës për forcimin e partneriteteve kulturore globale dhe shfrytëzimin e kulturës si një aset strategjik. Shtylla e mundësimit të ekosistemit mbështetës trajton të njëjtat çështje strukturore që BE-ja i identifikon si thelbësore: kushtet e punës, lëvizshmërinë ndërkufitare, ndërtimin e kapaciteteve, zhvillimin institucional, etj. Të dy kornizat e politikave pranojnë se sektorët e zhvilluar kulturorë kërkojnë ndërhyrje të njëkohshme në aspektin e prodhimit ashtu edhe atë të konsumit, me reforma qeverisëse, ndërtimin e kapaciteteve të palëve të interesit dhe mjete

financiare të adaptueshme që sigurojnë qëndrueshmëri dhe konkurrueshmëri brenda konteksteve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Renditja dhe objektivat e zgjedhura të shtyllave rrjedhin nga një analizë e plotë sektoriale e nevojave dhe potencialit kulturor të Shqipërisë. Modeli kështu i formësuar reflekton një qasje të njohur në ekonominë kulturore se ndërhyrjet e njëkohshme kërkohen si në anën e prodhimit (mbështetja e krijimit kulturor, infrastrukturës dhe kornizave ligjore) ashtu edhe në anën e konsumit (rritja e pjesëmarrjes, zhvillimi i audiencës dhe aksesi kulturor). Veprimet kryesore që do të zbatohen do ta operacionalizojnë këtë qasje të dyfishtë, duke mundësuar një rritje të ekuilibruar ku publiku i informuar dhe i angazhuar funksionon si një forcë kontrolli të cilësisë dhe nxitjeje të tregut, duke mbështetur njëkohësisht krijuesit dhe prodhuesit me investimet dhe reformat e nevojshme të sistemit. Kjo qasje e strukturuar bën që veprimet të mos mbeten të veçuara, por të fuqizojnë njëra-tjetrën, përmes një sekuencimi të qartë që pasqyron kompleksitetin dhe prioritetet e zhvillimit të një sektori kulturor të qëndrueshëm në Shqipëri.

6.1 Shtylla 1 - Kultura si nxitëse për cilësinë e jetës

Duke u zgjeruar në dimensionin e zhvillimit të qëndrueshëm, shtylla e parë e strategjisë kombëtare të kulturës e vendos atë në plan të parë si një nxitës kyç për përmirësimin e cilësisë së jetës. Kjo perspektivë nënvizon se si aktivitetet kulturore dhe shprehjet krijuese luajnë një rol transformues në forcimin e kohezionit shoqëror, besimit dhe bashkëpunimit brenda komuniteteve. Ndikimi i kulturës shtrihet përtej pasurimit estetik, duke ndryshuar rrënjësisht kufizimet dhe mundësitë që formësojnë rezultatet e jetës së përditshme. Cilësia shoqërore nuk është vetëm niveli i pjesëmarrjes individuale në fushat shoqërore, ekonomike dhe kulturore, por edhe shkalla në të cilën qasja në pasuritë kulturore promovon mirëqenie më të gjerë dhe mundëson realizimin e potencialit individual dhe kolektiv.

Zgjerimi i aksesit në kulturë përbën një parakusht themelor që kultura të shërbejë si një faktor vërtet transformues brenda shoqërisë. Kur barrierat për pjesëmarrjes kulturore reduktohen në mënyrë sistematike dhe mundësitë për t'u angazhuar me forma të ndryshme të shprehjes kulturore zgjerohen, individët dhe komunitetet fuqizohen për të krijuar realitetet e tyre shoqërore, për të bashkëkrijuar kuptim dhe për të mobilizuar burime për përparim kolektiv. Aksesueshmëria e përmirësuar jo vetëm që lehtëson zhvillimin personal dhe qytetar, por gjithashtu nxit përfshirjen, inovacionin dhe qëndrueshmërinë në të gjitha grupet shoqërore.

Përpjekjet për të promovuar qasje të gjerë dhe të barabartë në kulturë - duke përfshirë sitet dhe praktikat e trashëgimisë, industritë krijuese, iniciativat arsimore dhe platformat komunitare - janë thelbësore për të cliruar kapacitetin e plotë të kulturës

për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm, për të forcuar lidhjet shoqërore dhe për të katalizuar ndryshime pozitive në mbarë shoqërinë shqiptare.

Ndikimi transformues i kulturës

Ky seksion paraqet grupin gjithëpërfshirës të objektivave dhe veprimeve përkatëse sipas Shtyllës 1 - Kultura si nxitëse për cilësinë e jetës - brenda Strategjisë Kombëtare për Kulturën të Shqipërisë 2026-2030. Të konceptuar në përputhje të plotë me kornizat kryesore ndërkombëtare, këto objektiva e bëjnë të zbatueshëm një vizion strategjik i cili e pozicionon kulturën si një burim themelor për përfshirjen sociale, mirëqenien gjatë gjithë jetës dhe fuqizimin individual dhe kolektiv. Hartimi dhe zbatimi i këtyre objektivave mbështeten në praktikat më të mira dhe në prioritetet e politikave të përcaktuara nga Bashkimi Evropian dhe UNESCO, me një fokus të veçantë në maksimizimin e ndikimit transformues të kulturës në të gjithë shoqërinë shqiptare. Çdo objektiv shoqërohet me tregues të matshëm dhe veprime të synuara, duke siguruar një qasje të orientuar drejt rezultateve, të aftë për të tejkaluar mangësitë e vazhdueshme në aksesueshmëri, pjesëmarrje dhe angazhim komunitar. Duke çuar përpara këtë agjendë, strategjia synon të forcojë qëndrueshmërinë dhe kohezionin e komuniteteve në Shqipëri, të nxisë krijimtarinë dhe inovacionin, si dhe të garantojë qëndrueshmëri kulturore për brezat e ardhshëm, duke forcuar rolin e kulturës si një shtyllë thelbësore në zhvillimin kombëtar.

6.1.1 Objektivat dhe veprimet e Shtyllës 1

Objektivat e përcaktuara në Shtyllën 1 - Kultura si nxitëse për cilësinë e jetës – janë hartuar për të përkthyer vizionin strategjik në rezultate të zbatueshme për sektorin kulturor të Shqipërisë. Në përputhje me kornizat kryesore nga Bashkimi Evropian dhe UNESCO, secili objektiv pasqyron praktikat më të mira ndërkombëtare që synojnë maksimizimin e ndikimit transformues shoqëror të kulturës. Këto objektiva i japin përparësi aksesit gjithëpërfshirës, inovacionit, mirëqenies dhe pjesëmarrjes gjatë gjithë jetës, duke siguruar që kultura të kontribuojë në mënyrë aktive në zhvillimin ndërsektorial dhe prosperitetin kolektiv të shoqërisë shqiptare. Përmes kësaj qasjeje gjithëpërfshirëse, strategjia synon të ndërtojë komunitete me kapacitete ripërtëritjeje dhe kohezioni dhe të nxisë fuqizimin individual, duke ruajtur njëkohësisht diversitetin dhe trashëgiminë kulturore për brezat e ardhshëm. Secili prej këtyre objektivave dëshmon një harmonizim të qartë me prioritetet globale dhe evropiane për kulturën të shprehura në kornizat kryesore të referencës së BE-së dhe UNESCO-s, duke garantuar që strategjia shqiptare pasqyron praktikat më të mira dhe qëllimet e përbashkëta për qëndrueshmëri dhe përfshirje kulturore.

Objektivat kryesore janë:

- Nxitja e potencialit krijues, qasjeve sipërmarrëse dhe angazhimit aktiv qytetar në nivel komuniteti.
- Zgjerimi i aksesit të barabartë në trashëgiminë kulturore dhe mundësitë krijuese për të gjitha grupet demografike.
- Rritja e kohezionit komunitar dhe e përfshirjes sociale përmes pjesëmarrjes kulturore.
- Promovimi i të drejtave themelore të qytetarisë dhe mbështetja e shëndetit të mirë dhe mirëqenies përmes pjesëmarrjes kulturore.
- Promovimi i ndërgjegjësimit për të drejtat dhe përgjegjësitë kulturore ndërmjet qytetarëve dhe komuniteteve
- Forcimi i kapitalit njerëzor dhe shoqëror duke mundësuar të nxënit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimin personal përmes kulturës.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1. Nxitja e potencialit krijues, qëndrimeve sipërmarrëse dhe angazhimit aktiv qytetar në nivel komuniteti.

Politikat kulturore synojnë mbështetjen e krijuesve, sipërmarrësve dhe inovatorëve vendas, duke fuqizuar individët që të nisin projekte, të formësojnë komunitetet e tyre dhe të nxitur inovacionin social. Kjo përbën një përgjigje strategjike ndaj sfidës së integrimit të kulturës dhe industrive kulturore dhe krijuese në kornizat rajonale dhe ndërkombëtare të bashkëpunimit, siç u evidentua dhe në analizën e situatës aktuale. Duke mbështetur krijuesit, sipërmarrësit dhe inovatorët vendas, këto politika fuqizojnë individët dhe grupet për të ndërmarrë iniciativa, për të bashkëpunuar brenda dhe përtej komuniteteve të tyre, si dhe për të zhvilluar zgjidhje inovative që janë thelbësore për pjesëmarrjen në programet e BE-së, të tilla si *Evropa Krijuese*, si dhe mundësitë ndërkufitare të lidhura me procesin e anëtarësimin në BE dhe fondet *IPA*.

Kjo qasje trajton drejtpërdrejt mangësitë e vërejtura në zhvillimin e aftësive dhe nevojën për rritjen e kapacitetit krijues dhe digjital të përshkruara në analizën e situatës aktuale - përfshirë rënien e edukimit artistik dhe mbështetjen e kufizuar ndaj sipërmarrjës. Duke nxitur ekosistemet lokale të inovacionit dhe duke mbështetur artistët dhe sipërmarrësit kulturorë me akses në trajnime, burime dhe platforma ndërkombëtare, këto politika ndërtojnë themelet për pjesëmarrje efektive në rrjetet dhe tregjet evropiane. Ato përforcojnë aftësinë e Shqipërisë për të shfrytëzuar bashkëpunimin rajonal, rrisin konkurrueshmërinë dhe garantojnë që krijimtaria kulturore të jetë si një aset lokal ashtu edhe një urë lidhëse drejt partneriteteve ndërkombëtare, siç kërkohet nga logjika e integrimit në BE dhe dinamikat kulturore globale.

Objektivi SPECIFIK 2. Zgjerimi i aksesit të barabartë në trashëgiminë kulturore dhe në mundësitë krijuese për të gjitha grupet demografike.

Zvogëlimi i barrierave financiare, gjeografike dhe sociale siguron që sitet e trashëgimisë, muzetë dhe programet krijuese të jenë të hapura për popullsinë rurale, urbane, të rinjtë, të moshuarit dhe pakicat, duke mbështetur të drejtat kulturore dhe diversitetin.

Zgjerimi i aksesit të barabartë në trashëgiminë kulturore dhe mundësitë krijuese trajton drejtpërdrejt mangësitë lidhur me zbatimin efektiv të të drejtave kulturore të identifikuara në analizën e situatës aktuale, e cila theksonte se aksesi në kulturë në Shqipëri është i pabarabartë, me pabarazi të dukshme midis qendrave urbane dhe zonave periferike ose rurale, pengesa të konsiderueshme për komunitetet minoritare dhe popullsinë në nevojë ekonomike, dhe me mungesë të masave gjithëpërfshirëse të aksesit për personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e margjinalizuara. Duke hequr pengesat financiare, gjeografike dhe sociale, ky objektiv strategjik i përgjigjet pikave të dobëta specifike të theksuara në analizë. Për shembull, vërehet përqendrimi i burimeve dhe aktiviteteve kulturore në zonat urbane, duke i lënë rajonet rurale dhe të largëta të nënshërbyera. Gjithashtu evidentohen dhe mangësitë në shtrirjen dhe programimin e synuar për pakicat, rininë, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, të cilët kanë më pak mundësi të marrin pjesë plotësisht në jetën kulturore për shkak të pengesave fizike, ekonomike ose të mentalitetit.

Gjithashtu, angazhimi për akses të barabartë është në përputhje si me *Deklaratën Universale të UNESCO-s mbi Diversitetin Kulturor* (2001) ashtu edhe me *Agjendën e Re Evropiane të BE-së për Kulturën* (2018), të cilat theksojnë se e drejta për të marrë pjesë në kulturë duhet t'u garantohet të gjithëve - pavarësisht vendndodhjes, aftësisë apo prejardhjes. Trajtimi i këtyre mangësive, si dhe rekomandimet specifike në analizën e situatës aktuale lidhur me nevojën për përfshirje më të madhe, është thelbësor për të përmbushur të drejtat kulturore, për të ushqyer diversitetin dhe për të nxitur ndjenjën e përkatësisë për të gjitha grupet demografike. Kjo qasje garanton që trashëgimia kulturore dhe produkti krijues shqiptar të jenë të qasshëm, kuptimplotë dhe me pjesëmarre në shkallë kombëtare, duke trajtuar modelet e mëhershme të përjashtimit dhe duke mundësuar angazhimin e plotë shoqëror me kulturën.

Për më tepër, lehtësimi i aksesit në ngjarje dhe shprehje të ndryshme kulturore nxit dialogun midis grupeve të ndryshme, ndërton mirëkuptim midis brezave dhe prejardhjeve dhe lufton izolimin social përmes pjesëmarrjes kolektive. Duke iu referuar *Kornizës Evropiane për Veprim mbi Trashëgiminë Kulturore* (Komisioni Evropian, 2019), ky objektiv promovon aksesin e hapur në ngjarjet kulturore dhe përvojat krijuese, me qëllim që të nxitet ndërveprimi midis komuniteteve, rajoneve dhe brezave.

Krijimi dhe zhvillimi i platformave që lehtësojnë rregullisht pikëtakimet me kulturën, u lejon individëve dhe komuniteteve të realizojnë potencialin e tyre të plotë dhe të kontribuojnë në prosperitetin kolektiv. Investimi në hapësirat publike, qasjent digjitale

dhe shtrirjen programatike garanton një jetë kulturore të gjallë e të qasshme në kontekstin e përditshmërisë, duke mbështetur si përmbushjen individuale, ashtu edhe prosperitetin e shoqërisë shqiptare në tërësi. "*Metoda e hapur e koordinimit*" e Komisionit Evropian në politikën kulturore (OMC, 2017) dhe Rekomandimi i UNESCO-s në lidhje me *Mbrojtjen dhe Promovimin e Muzeve dhe Koleksioneve* (2015) theksojnë të dyja investimin në infrastrukturën dhe mjetet digjitale të nevojshme për pjesëmarrje kulturore aktive dhe me bazë të gjerë.

OBJEKTIVI SPECIFIK 3. Rritja e kohezionit të komunitetit dhe përfshirjes sociale përmes pjesëmarrjes kulturore.
Përmes kultivimit të përvojave kulturore të përbashkëta dhe mbështetjes së modeleve të qeverisjes me bazë komunitare, strategjia synon të forcojë lidhjet ndërmjet qytetarëve, të reduktojë fragmentimin social dhe të promovojë ndjenjën e përkatësisë për të gjithë, përfshirë grupet e margjinalizuara ose të nënpërfaqësuara. Iniciativat kulturore të konceptuara mbi parimet e përfshirjes dhe bashkëpunimit kontribuojnë në forcimin e besimit të ndërsjellë, promovojnë sjelljen bashkëpunuese në shoqëri dhe mbështesin zhvillimin e një identiteti të përbashkët qytetar, të rrënjosur në trashëgiminë dhe vlerat e Shqipërisë.

Rritja e kohezionit të komunitetit dhe përfshirjes sociale përmes pjesëmarrjes kulturore adreson drejtpërdrejt disa dobësi kritike të identifikuara në analizën e situatës aktuale të sektorit kulturor shqiptar. Ajo thekson se përfshirja e komunitetit në qeverisjen e kulturës në Shqipëri mbetet e nënzhvilluar. Për shembull, ndërkohë që Konventa e Faros promovon trashëgiminë si një burim për pjesëmarrje demokratike dhe menaxhim të përbashkët, duke nxitur forcimin e ndjenjës së pronësisë nga qytetarët, Shqipëria e ka nënshkruar por nuk e ka ratifikuar ende atë. Ky hendek ligjor pasqyrohet në mungesën e një kornize kombëtare për qeverisjen e përbashkët ose menaxhimin të burimeve kulturore, në vecanti ai i tipologjisë së "*pasurive të përbashkëta (commons)*", i cili do t'u mundësonte komuniteteve të jenë më shumë sesa thjesht përfitues të iniciativave kulturore - duke i fuqizuar ato si bashkëpronarë dhe bashkëvendimmarrës efektivë në ruajtjen, vlerësimin dhe promovimin e trashëgimisë shqiptare.

Aktualisht, roli i komuniteteve në vendimmarrje në lidhje me burimet kulturore është më shumë i fokusuar në procese konsultative apo i kufizuar në pjesëmarrjen në ngjarje dhe festivale, se një angazhim i strukturuar për bashkëqeverisje ose bashkë-krijim politikash. Pakicat dhe grupet e margjinalizuara mbeten të nënpërfaqësuara në këto procese dhe qasja e tyre në kulturë është shpesh më e kufizuar, veçanërisht në zonat periferike dhe ato jo-urbane.

Analiza e situatës aktuale thekson gjithashtu se se infrastrukturat kulturore, programet dhe mundësitë për pjesëmarrje shpesh janë të përqendruara në qendrat urbane si

Tirana, duke i lënë periferitë, zonat rurale dhe pakicat në një pozitë disavantazhi. Ky çekuilibër territorial kufizon qasjen e barabartë dhe kontribuon në fragmentimin shoqëror, si dhe në nivele më të ulëta të besimit dhe identifikimit me institucionet kombëtare.

Duke promovuar nisma kulturore gjithëpërfshirëse dhe të drejtuara nga komuniteti, strategjia mund t'i trajtojë dobësi përmes:

- Nxitjes së përvojave të përbashkëta kulturore që kapërcejnë dallimet midis qendrës dhe periferisë, urbane dhe rurale, si dhe midis grupeve të ndryshme, duke forcuar kështu lidhjet shoqërore.
- Mbështetjes së qeverisjes me bazë komunitare dhe të kornizave bashkëpunuese që ndërtojnë besim midis qytetarëve dhe institucioneve, duke adresuar deficitin e besimit.
- Nxitjes së zhvillimit të një identiteti të përbashkët qytetar duke e vlerësuar trashëgiminë si një e mirë të përbashkët - jo thjesht si një aset në shërbim vetëm të zhvillimit turistik të vendit - dhe duke stimuluar një kulturë pjesëmarrjeje dhe mirë-administrimi.
- Fuqizimin e barazisë në terma mundësish kulturore përmes programeve të synuara për pakicat dhe komunitetet e margjinalizuara, siç rekomandohet nga konventat ndërkombëtare dhe legjislacioni kombëtar.

Kjo qasje është në përputhje me *Konventën e Faros* të Këshillit të Evropës dhe *Konventën e UNESCO-s për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore* (2005), të cilat e pozicionojnë trashëgiminë kulturore si një nxitëse e pjesëmarrjes demokratike, përfshirjes dhe e një identiteti qytetar pluralist. Për më tepër, ajo i bën të zbatueshme rekomandimet nga analiza e situatës aktuale për të kaluar nga zbatimi sporadik i politikave dhe angazhimi i bazuar vetëm në ngjarje të veçuara, drejt reformave institucionale dhe kornizave programore që nxisin një qeverisje të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese në të gjithë sektorin kulturor të Shqipërisë.

Promovimi i të drejtave themelore të qytetarisë dhe mbështetja e shëndetit dhe mirëqenies përmes pjesëmarrjes kulturore. Angazhimi në aktivitete kulturore nxit ndërgjegjësimin për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve, ndërkohë që ofron gjithashtu përfitime të provuara për mirëqenien mendore, reduktimin e stresit dhe cilësinë e përgjithshme të jetës. *Plani i Punës për Kulturën i BE-së 2019–2022* thekson kontributin e pjesëmarrjes kulturore në mirëqenien më të gjerë dhe ushtrimin e demokracisë, në përputhje me agjendën e UNESCO-s për të drejtat kulturore.

Për më tepër, pjesëmarrja e gjerë në kulturë shoqërohet me përmirësime të mbështetura nga evidenca konkrete për sa i përket shëndetit mendor, stresit dhe cilësisë së jetës - dimensione që mbështesin shtyllën sociale të qëndrueshmërisë dhe përforcojnë aftësitë e shoqërisë për ripërtëritje. Për Bashkimin Evropian, kultura nuk është thjesht një aset sektorial, por një komponent kyç i mirëqenies kolektive, veçanërisht në mbështetjen e përfshirjes sociale për grupet e margjinalizuara dhe të cenueshme. Duke e integruar pjesëmarrjen kulturore në zemër të veprimeve të politikave, Shqipëria mund të kalojë përtej zbatimit sporadik të projekteve individuale drejt një qasjeje sistematike në të cilën kultura shfrytëzohet qëllimisht për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm shoqëror, për të trajtuar fragmentimin dhe për të nxitur vlerat e përbashkëta në të gjitha komunitetet, si urbane ashtu dhe rurale.

OBJEKTIVI SPECIFIK 4. Forcimi i kapitalit njerëzor dhe shoqëror duke mundësuar të nxënit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimin personal përmes kulturës.
Strategjia u jep përparësi iniciativave arsimore dhe të nxënit joformal përmes kulturës, duke nxitur krijimtarinë, të menduarit kritik dhe të vetëshprehjn, të cilat janë thelbësore si për rritjen personale ashtu edhe për ekonominë e dijes. Forcimi i kapitalit njerëzor dhe shoqëror përmes mundësimit të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimit personal përmes kulturës trajton drejtpërdrejt sfidën e rënies së regjistrimeve në arsimin artistik në nivele të caktuara, pavarësisht kërkesës në rritje për aftësi krijuese dhe kapacitete digjitale. Duke i dhënë përparësi si edukimit kulturor formal ashtu edhe atij joformal, strategjia e bën krijimtarinë, të menduarit kritik dhe aftësitë digjitale bazë të qasshme për segmente më të gjera të popullsisë dhe përafron përpjekjet me nevojat në rritje të ekonomisë së dijes. "*Kultura në Agjendën 2030*" e UNESCO-s dhe "*Korniza Evropiane e BE-së për kompetencat kyçe për mësimin gjatë gjithë jetës*" (2018) theksojnë rolin e kulturës në nxitjen e aftësive kritike, vetëzhvillimit dhe kohezionit social.

6.1.2 Aktivitetet e Shtyllës 1:

1.3.1 Mbrojtja e TKJ-së
2.2.1 Modernizimi i sistemit muzeor
3.3.1 Platforma e Inovacionit në Trashëgimi dhe e Sipërmarrjes Krijuese
3.4.1 Pjesëmarrja komunitare dhe kujdestaria e përbashkët
4.3.1 Inovacion dhe partneritete
6.1.3 Qendra e Inovacionit të Trashëgimisë dhe Sipërmarrjes Krijuese
8.1.1 Qendrat Kulturore si Qendra Krijuese
8.1.2 Zhvillimi i muzeve të rinj në Shqipëri
8.1.3 Ringjallja e Kullave Tradicionale në Veriun e Shqipërisë
8.2.1 Përmirësimi i Infrastrukturës së Prodhimit Kulturor
9.1.1 Grupi Kombëtar i Punës për Përfshirjen Kulturore
9.2.1 Krijimtaria Gjithëpërfshirëse
9.2.2 Karta Universale Vjetore e Hyrjes në Muze
9.2.3 Programi Kombëtar i Promovimit të Leximit në Familje
9.3.1 Këshillat Bashkiake të Pjesëmarrjes Kulturore

10.1.1 Javët Kulturore Ndërkombëtare, "*International Cultural Weeks*"
10.1.2 Programi i Rezidencës "*Urat Kulturore*".
11.3.1 Sinergjitë mes Trashëgimisë së Hapur dhe GLAM
12.1.1 Laboratori i Kurrikulave Gjithëpërfshirëse
12.1.2 Rrjeti Kombëtar i Qendrave Kulturore për Fëmijë
12.1.3 Edukimi përmes Kulturës

6.2 Shtylla 2 - Kultura si mjet dialogu në nivel ndërkombëtar

Shtylla e dytë e strategjisë kulturore e pozicionon kulturën si një instrument thelbësor për dialogun dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Në një epokë të shënuar nga një ndërlidhje globale gjithnjë në rritje, aktivitetet kulturore dhe praktikat krijuese shërbejnë si ura, duke mbështetur mirëkuptimin, besimin dhe bashkëpunimin midis shoqërive dhe kombeve të ndryshme. Ndikimi transformues i kulturës në arenën ndërkombëtare shtrihet përtej transmetimit të trashëgimisë artistike; ajo krijon hapësira të përbashkëta për shkëmbimin e ideve dhe vlerave, si dhe njohjen reciproke të identiteteve.

Kjo shtyllë kërkon një investim strategjik në forcimin e reputacionit ndërkombëtar, si duke avancuar reputacionin global përmes diplomacisë kulturore, ashtu edhe duke rritur cilësinë e produkteve kulturore dhe krijuese, me qëllim përmirësimin e aftësisë së sektorit për të eksportuar dhe shpërndarë produkte kulturore në të gjithë botën. Hartëzimi, aktivizimi dhe angazhimi i vazhdueshëm i artistëve, shkrimtarëve, kuratorëve dhe profesionistëve të kulturës të diasporës shqiptare jashtë vendit duhet të trajtohen si prioritet strategjik për diplomacinë kulturore dhe promovimin ndërkombëtar.

Përdorimi i kulturës si një platformë për dialog ndërkombëtar kërkon zgjerimin e pjesëmarrjes në nismat ndërkufitare, inkurajimin e diplomacisë kulturore dhe përfshirjen e shkëmbimit ndërkulturor në kornizat e politikave.

Rritja e pranisë kulturore të Shqipërisë në arenën globale përmes dialogut

Trashëgimia historike e Shqipërisë si një udhëkryq i kulturave të ndryshme, një vend dialogu fetar dhe një tokë e formësuar nga valët e migrimit dhe kthimit, e pozicionon atë në mënyrë unike për të pohuar identitetin e vetë dhe për të kontribuar në mënyrë aktive në ndërtimin e paqes, zgjidhjen e konflikteve dhe zhvillimin e shoqërive gjithëpërfshirëse. Ky sfond e shndërron angazhimin e Shqipërisë në dialogun kulturor ndërkombëtar në një aset strategjik, si për reputacionin e saj, ashtu edhe për aftësinë e saj për të nxitur kohezionin social në një shkallë më të gjerë.

Zbatimi i diplomacisë kulturore udhëhiqet bashkërisht nga MTKS dhe MEPJ, ndërsa ambasadat, konsullatat dhe rrjeti i gjerë diplomatik funksionojnë si kanalet kryesore operacionale për avancimin e pranisë kulturore ndërkombëtare të Shqipërisë. Një mekanizëm i përhershëm koordinimi ndërmjet MTKS-së dhe MEPJ-së duhet të ngrihet për të siguruar planifikimin, zbatimin dhe raportimin e përbashkët të aktiviteteve të diplomacisë kulturore të Shqipërisë jashtë vendit.

Kalendari vjetor i diplomacisë kulturore duhet të përgatitet bashkërisht nga MTKS dhe MEPJ, në koordinim me rrjetin diplomatik, dhe të harmonizohet me datat kombëtare, sezonet kulturore ndërkombëtare, festivalet dhe panairet kryesore, si dhe aktivitetet e diasporës.

Për këtë qëllim, do të përcaktohen pikat fokale në ambasadat dhe konsullatat prioritare, me përgjegjësi për identifikimin e mundësive, raportimin dhe koordinimin. Së fundmi, duhet të hartohet një raport i përbashkët vjetor për diplomacinë kulturore, i cili të përfshijë të dhëna nga ambasadat, rezultatet, sfidat dhe rekomandimet për vitin pasardhës.

6.2.1 Objektivat dhe aktivitetet e Shtyllës 2

Objektivat e përcaktuara më poshtë paraqesin vizionin strategjik në kuadër të Shtyllës 2. Çdo objektiv bazohet në korniza të përcaktuara dhe rekomandime e politikave nga BE dhe UNESCO, duke siguruar përputhshmërinë e nevojshme me normat dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Përmes avancimit të këtyre objektivave, strategjia synon të konsolidojë rolin e Shqipërisë si një aktor kulturor dinamik në arenën globale, duke nxitur dialogun, bashkëpunimin dhe pasurimin e ndërsjellë me shtetet dhe shoqëritë në mbarë botën.

Objektivat kryesore janë:

- Ndërtimi i partneriteteve për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në arenën ndërkombëtare.
- Inkurajimi i iniciativave të përbashkëta në industritë krijuese dhe nxitja e inovacionit kulturor përmes bashkëpunimeve globale.
- Rritja e vizibilitetit dhe njohjes globale të kulturës dhe industrive krijuese shqiptare.
- Forcimi i reputacionit ndërkombëtar dhe konkurrueshmërisë së Shqipërisë nëpërmjet diplomacisë kulturore dhe angazhimit global, duke rritur promovimin ndërkombëtar dhe kapacitetin eksportues të industrive krijuese të Shqipërisë, përfshirë botimet, filmin, dizajnin, artizanatin, muzikën dhe produktet kulturore digjitale.
- Mbështetja e lëvizshmërisë dhe rrjetëzimit të artistëve, profesionistëve të kulturës dhe të rinjve në nivel ndërkombëtar, duke promovuar gjithashtu bashkëpunimin përmes programeve të shkëmbimit artistik, arsimor dhe shkencor.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1. Ndërtimi i partneriteteve për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore në arenën ndërkombëtare.
Trashëgimia kulturore e Shqipërisë, e cila përfshin si elementët ashtu edhe ato jomateriale, shërben si një aset i paçmueshëm për të kuptuar evolucionin e Mesdheut dhe për të forcuar një identitet të përbashkët evropian. Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare, qeveritë dhe OJF-të përbën një rrugë strategjike për të mbrojtur, restauruar dhe promovuar këtë trashëgimi, pasi i lejon Shqipërisë të përvetësojë praktikat më të mira dhe të përfitojë nga ekspertiza globale. Një angazhim i tillë ndërkombëtar e pozicionon vendin në të njëjtën linjë me prioritetet më të gjera evropiane, veçanërisht në përshtatjen e trashëgimisë kulturore ndaj rreziqeve që lidhen me klimën, si dhe ndihmon në sigurimin e flukseve të qëndrueshme dhe të larmishme të financimit të nevojshme për ruajtje efektive.

Analiza e gjendjes ekzistuese ka theksuar se mbështetja financiare e fragmentuar ose e jokonsistente kërcënon qëndrueshmërinë afatgjatë të pasurive kulturore të Shqipërisë. Pjesëmarrja në partneritete globale i mundëson Shqipërisë të shfrytëzojë mekanizma më të gjerë financimi dhe ekspertizë kolektive, duke siguruar stabilitet edhe në klima të pasigurta politike. Për më tepër, këto bashkëpunime e fuqizojnë Shqipërinë për të marrë një rol edhe më aktiv në debatet rajonale dhe ndërkombëtare mbi qëndrueshmërinë kulturore, veçanërisht pasi sfidat e përbashkëta evropiane - të tilla si ndryshimi i klimës, rritja e angazhimit të komunitetit dhe inovacioni i nxitur nga trashëgimia - kërkojnë zgjidhje të përbashkëta ndërkufitare.

Këto partneritete mbështesin integrimin e trashëgimisë me industritë krijuese dhe diplomacinë kulturore, siç promovohet nga Konventa e UNESCO-s e vitit 2003 dhe *Agjenda e Re Evropiane për Kulturën*, duke përforcuar aftësinë e Shqipërisë për të zhvilluar dhe për të nxitur komunitete të angazhuara dhe me aftësi ripërtëritjeje.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2. Nxitja e iniciativave të përbashkëta në industritë krijuese dhe nxitja e inovacionit kulturor përmes bashkëpunimeve globale.
Një nga mënyrat më efektive që Shqipëria të angazhohet në nivel ndërkombëtar është bërja e prodhimeve të saj krijuese të dukshme dhe konkurruese në tregjet globale. Mbështetja aktive e bashkëproduksioneve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta, si dhe e inkubatorëve kulturorë ndërkufitarë u mundëson artistëve dhe ndërmarrjeve shqiptare të inovojnë duke ndërthurur traditën lokale me trendet ndërkombëtare, në përputhje me programin *Creative Europe* të BE-së dhe Raportin Global të UNESCO-s "*Riformësimi i politikave për krijimtarinë*" (2022).

Ky objektiv trajton drejtpërdrejt vështirësitë strukturore të vërejtura gjatë analizën së situatës së tanishme, konkretisht infrastrukturën e nënzhvilluar dhe tregun e kufizuar kulturor në Shqipëri. Duke nxitur iniciativa të përbashkëta në industritë krijuese dhe duke mbështetur bashkëpunimet globale, si bashkëproduksionet ndërkombëtare,

inkubatorët kulturorë dhe shkëmbimet e njohurive, Shqipëria rrit qasjen e saj në njohuritë teknike, në mundësitë e reja të tregut dhe në praktikat inovative. Këto veprime krijojnë sisteme thelbësore mbështetëse për artistët, përmirësojnë transferimin e aftësive dhe forcojnë zbatimin e të drejtave të autorit dhe të pronësisë intelektuale përmes miratimit të standardeve ndërkombëtare.

Më tej, diaspora e konsiderueshme shqiptare përbën një audiencë të gjerë e dinamike, si edhe një katalizator për nisma të reja kulturore dhe mundësi tregu. Shfrytëzimi i këtij potenciali jo vetëm që mbështet shpërndarjen në nivel global të produktit kulturor shqiptar, por stimulon dhe krijimin e rrjeteve kulturore transnacionale që mund të ushqejnë sipërmarrjen, shkëmbimin e njohurive dhe zhvillimin artistik. Kjo qasje duhet të mbështetet dhe të operacionalizohet më tej, te "*Strategjia për Diasporën*" dhe Ligji nr 16/2018 "*Për Diasporën*" (i ndryshuar) të hartuar nga *Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme*, të cilat ofrojnë kuadrin e përgjithshëm të politikave për angazhimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit. Përfshirja e diasporës në politikat për industritë krijuese, përmes komunikimit të strukturuar, kërkimit të tregut dhe platformave bashkëpunuese krijuese, është në përputhje me Konventën e UNESCO-s të vitit 2005 për *Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore* dhe me *Kuadrin Evropian për Lëvizshmërinë e Artistëve dhe Profesionistëve të Kulturës.*

Së fundmi, kjo qasje sistemike, e mbështetur nga praktikat më të mira ndërkombëtare dhe instrumentet e politikave publike, përforcon konkurrueshmërinë e Shqipërisë, nxit inovacionin kulturor dhe ndihmon në ndërtimin e një ekosistemi kulturor të qëndrueshëm dhe me orientim global.

Rritja e vizibilitetit dhe njohjes globale të kulturës dhe industrive krijuese shqiptare.
Pas krijimit të një ekosistemi kulturor produktiv dhe me cilësi të lartë, hapi tjetër i rëndësishëm është rritja e veçantisë dhe e njohjes ndërkombëtare të kulturës dhe industrive krijuese shqiptare. Ky objektiv kërkon përpjekje fushat e vizibilitetit, platformave digjitale dhe ngjarjeve të kuruara, të konceptuara për të prezantuar shprehjet kulturore të Shqipërisë para audiencave të ndryshme globale dhe për të lehtësuar lidhjet strategjike me partnerët ndërkombëtarë.

Forcimi i vizibilitetit të krijimtarisë shqiptare nënkupton foksuimin te marka (*branding*) dhe rrëfimi (*storytelling*), që vënë në pah trashëgiminë unike të vendit dhe inovacionin bashkëkohor. Kjo përfshin pozicionimin e Shqipërisë si një burim i përmbajtjes artistike origjinale në festivale, tregjet dhe mediat ndërkombëtare, si dhe shfrytëzimin e teknologjive digjitale për të arritur audienca të specializuara dhe masive në mbarë botën - në përputhje me *Agjendën e Re Evropiane për Kulturën* të Komisionit Evropian (2018) dhe Konventën e UNESCO-s të vitit 2005. Për më tepër, ky objektiv kërkon zhvillimin e markave identifikuese (*labels*) të njohshme, pjesëmarrjen në rrjete ndërkombëtare (p.sh. *Qytetet Krijuese* të UNESCO-s), si dhe angazhim proaktiv me

median dhe ndikuesit (*influencers*) për të rritur ndërgjegjësimin global dhe aksesin në treg. Përmes përmbushjes së këtyre synimeve, Shqipëria do të rrisë jo vetëm vizibilitetin e prodhimit të saj artistik, por edhe tërheqjen dhe konkurrueshmërinë e sektorit krijues.

OBJEKTIVI SPECIFIK 3. Forcimi i reputacionit ndërkombëtar dhe konkurrueshmërisë së Shqipërisë nëpërmjet diplomacisë kulturore dhe angazhimit global, duke rritur promovimin ndërkombëtar dhe kapacitetin eksportues të industrive krijuese të Shqipërisë, përfshirë botimet, filmin, dizajnin, artizanatin, muzikën dhe produktet kulturore digjitale.
Ky objektiv synon përmirësimin në mënyrë proaktive të pozicionit ndërkombëtar të Shqipërisë duke përdorur diplomacinë kulturore si një instrument kyç të politikave kulturore dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Diplomacia kulturore dhe rrjeti shqiptar jashtë vendit mbështeten përmes ambasadave, konsullatave, diasporës dhe kanaleve të promovimit ndërkombëtar, të cilat ndihmojnë në zgjerimin e pranisë kulturore të Shqipërisë, forcimin e vizibilitetit dhe lidhjen e institucioneve kombëtare me partnerët dhe komunitetet e huaja.

Aktivitetet kryesore përfshijnë negocimin dhe zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe që mbështesin iniciativa të përbashkëta në fushën e ruajtjes së trashëgimisë, industrive krijuese, arsimit dhe kërkimit, duke kontribuar në thellimin e lidhjeve kulturore ndërkombëtare. Këto iniciativa mund të përfshijnë ekspozita, festivale ndërkombëtare, marrëveshje kulturore dypalëshe dhe pjesëmarrje në forume globale për të siguruar që kultura dhe krijimtaria shqiptare të njihen dhe vlerësohen në arenën ndërkombëtare.

Forcimi i reputacionit ndërkombëtar të Shqipërisë përmes diplomacisë kulturore dhe angazhimit global është një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj kritiviteteve të identifikuara gjatë analizën së gjendjes aktuale, veçanërisht ato lidhur me bashkëpunimin e kufizuar rajonal dhe ndërkufitar. Përmes përdorimit proaktiv të diplomacisë kulturore - përmes marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, projekteve të përbashkëta në trashëgimi dhe industri krijuese, si dhe rritjes së pjesëmarrjes së Shqipërisë në ngjarjet me rëndësi globale - Shqipëria mund të ndërtojë partneritete dhe të ketë akses në burime të reja financimi, siç promovohet nga *Agjenda e re Evropiane për Kulturën* e BE-së (2018) dhe nga konventat përkatëse të UNESCO-s.

Ky objektiv në fakt përputhet me Agjendën e re Evropiane për Kulturën të BE-së (2018), e cila promovon diplomacinë kulturore si një mjet për të rritur bashkëpunimin dhe reputacionin ndërkombëtar. UNESCO gjithashtu inkurajon shtetet palë të nxisin njohjen ndërkombëtare përmes projekteve dhe konventave kulturore (Konventa e UNESCO-s për "*Mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjeve kulturore*").

Mbështetja e lëvizshmërisë dhe rrjetëzimit të artistëve, profesionistëve të kulturës dhe të rinjve në nivel ndërkombëtar, duke promovuar gjithashtu bashkëpunimin përmes programeve të shkëmbimit artistik, edukativ dhe shkencor. Zhvillimi i granteve, bursave të studimit dhe skemave të shkëmbimit për t'u mundësuar artistëve dhe punonjësve të kulturës të marrin pjesë në ngjarje, rezidenca dhe rrjete ndërkombëtare. Një lëvizshmëri e tillë ndihmon në transferimin e njohurive, ndërtimin e aftësive dhe krijimin e marrëdhënieve të qëndrueshme profesionale në të gjithë botën, ndërsa bashkëpunimet pasurojnë sektorin kulturor shqiptar, stimulojnë krijimtarinë dhe gjenerojnë zgjidhje inovative për sfidat e përbashkëta shoqërore.

Mbështetja e lëvizshmërisë dhe rrjetëzimit të artistëve, profesionistëve të kulturës dhe të rinjve është një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj shqetësimeve të identifikuara gjatë analizës së situatës së tanishme lidhur me infrastrukturën dhe tregun kulturor të nënzhvilluar; me mekanizmat e pamjaftueshëm mbështetës si financimi për artistët, zbatimi i të drejtave të autorit dhe trajnimi profesional"; me bashkëpunimin e kufizuar ndërkufitar; dhe me angazhimin të diasporës. Duke krijuar grante, bursa dhe skema shkëmbimi, Shqipëria mund të ofrojë burime financiare thelbësore dhe qasje në mundësi ndërkombëtare për artistët dhe punonjësit e kulturës, duke trajtuar mangësitë në trajnimin profesional dhe në infrastrukturë që pengojnë talentin vendas të arrijë tregje më të gjera.

Lëvizshmëria dhe pjesëmarrja në rrjetet ndërkombëtare jo vetëm që lehtësojnë transferimin e njohurive, ndërtimin e kapaciteteve dhe përthithjen e praktikave më të mira globale, por ndihmojnë gjithashtu artistët të ndërtojnë marrëdhënie që mbështesin karrierën e tyre dhe të rrisin standardet profesionale brenda industrive krijuese të vendit.
Këto shkëmbime mbështeten nga politikat dhe fondet brenda Programit të BE-së për *Creative Europe, Horizont Europe* dhe *Fondit të Lëvizshmërisë të UNESCO*-s, të cilat së bashku përforcojnë integrimin strategjik të Shqipërisë në kornizat kulturore rajonale, evropiane dhe globale. Për më tepër, këto mekanizma trajtojnë çështjet strukturore duke krijuar akses për profesionistët shqiptarë - veçanërisht për të rinjtë dhe talentet në zhvillim - në rezidenca artistike, ekspozita dhe bashkëpunime, duke kompensuar brishtësinë e tregut vendor dhe duke zgjeruar shtrirjen e kulturës shqiptare jashtë vendit.

Si përfundim, prioritizimi i lëvizshmërisë dhe bashkëpunimit ndërkombëtar forcon njëkohësisht bazën e aftësive, zgjeron rrjetet dhe kompenson sistemet e kufizuara të mbështetjes vendase, duke i shndërruar ato në leva strategjike për tejkalimin e vështirësive infrastrukturore dhe kufizimeve të kapaciteteve të dokumentuara gjatë analizës së situatës.

6.2.2 Aktivitetet e Shtyllës 2:

5.3.1 Art dhe Zeje - Dizajnuar në Shqipëri
5.3.2 Zërat shqiptarë
7.1.1 Marrëveshje bashkëpunimi
7.2.1 Fondi për Festivale dhe Panaire
7.2.2 Zyra e Mobilitetit dhe Projekteve
7.2.3 Programi i Çmimeve Kombëtare të Arteve
8.1.4 Programi Kombëtar i Artit Publik dhe Kulturës Urbane
8.3.4 "*Culturalb*", Platforma Kombëtare e Brandingut Kulturor dhe Promovimit Dixhital - Platformë promovuese shumëgjuhëshe për përfaqësimin diplomatik dhe kulturor
8.4.1 Infrastruktura e Integruar Kulturore dhe Zhvillimi i Turizmit

6.3 Shtylla 3 - Mundësimi i ekosistemit kulturor

Ndërtimi i kapaciteteve për transformim brenda sektorit kulturor kërkon një qasje të strukturuar për zhvillimin e kushteve themelore teknike, rregullatore dhe financiare që mbështesin inovacionin dhe rritjen kulturore. Kjo shtyllë identifikon dimensionet kryesore të nevojshme për të fuqizuar Ministrinë përgjegjëse për Kulturën dhe institucionet e saj, për të nxitur zhvillimin profesional dhe për të modernizuar qeverisjen në mbarë fushën e kulturës. Përmbushja efektive e objektivave të kësaj strategjisë kombëtare për kulturën është e ndërvarur nga forcimi i kornizave ligjore dhe rregullatore që udhëheqin aktivitetet kulturore, investimi në ndërtimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të aktorëve të sektorit, vënia në zbatim i mjeteve të reja digjitale dhe organizative dhe krijimi i mekanizmave transparentë dhe të qasshëm të granteve. Këto masa krijojnë një mjedis të favorshëm për palët e interesit në fushën e kulturës, përmirësojnë qëndrueshmërinë e sektorit dhe sigurojnë që përfitimet e zhvillimit kulturor të shpërndahen në mënyrë të barabartë.

Ndërtimi i një ekosistemi kulturor të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe inovativ

Duke u mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe i udhëhequr nga dokumentet e politikave të Bashkimit Evropian dhe UNESCO-s, kjo shtyllë e vë theksin te modernizimi ligjor dhe rregullator, ndërtimi i kapaciteteve në të gjithë sektorin, mekanizmat e qëndrueshëm të financimit dhe adoptimin e mjeteve të reja digjitale. Përmes këtyre masave gjithëpërfshirëse, Shqipëria synon të fuqizojë institucionet kulturore, të nxisë krijimtarinë dhe pjesëmarrjen, si dhe të garantojë që të drejtat dhe burimet kulturore të jenë të aksesueshme për të gjitha komunitetet - duke siguruar kështu zhvillim të qëndrueshëm kulturor për brezat e ardhshëm.

6.3.1 Objektivat dhe aktivitetet e Shtyllës 3

Shtylla e tretë e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2026–2030, *Mundësimi i ekosistemit kulturor*, është konceptuar për të vendosur bazat thelbësore strukturore, rregullatore dhe financiare që do të sigurojnë qëndrueshmërinë, inovacionin dhe gjithëpërfshirjen e sektorit kulturor. Duke u mbështetur në dokumentet kryesore të politikave ndërkombëtare dhe praktikat më të mira si nga BE ashtu edhe nga UNESCO, kjo shtyllë përshkruan objektivat strategjike që do të fuqizojnë institucionet kulturore, do të rrisin profesionalizimin e sektorit, do të nxisin transformimin digjital dhe do të garantojnë shpërndarjen e drejtë të burimeve. Përmes këtyre masave, Shqipëria synon të krijojë një ekosistem ku krijimtaria, të drejtat kulturore dhe zhvillimi i qëndrueshëm mund të zhvillohen në dobi të të gjitha komuniteteve.

Objektivat kryesore janë:

- Ndërtimi i kapaciteteve në të gjitha institucionet kulturore dhe komunitetet, duke rritur aftësitë, njohuritë dhe nivelin drejtues për t'iu përgjigjur sfidave dhe mundësive të reja.
- Përdorimi i mjeteve të reja digjitale dhe organizative për të nxitur inovacionin, për të përmirësuar efikasitetin e menaxhimit dhe për të modernizuar praktikat e sektorit.
- Zhvillimi i sistemeve transparente dhe të qasshme të granteve për të promovuar krijimtarinë, për të mbështetur nisma të ndryshme kulturore dhe për të garantuar shpërndarje të drejtë të burimeve.
- Nxitja e një sektori kulturor të ripërtërishëm, të qëndrueshëm dhe të aftë për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive ndryshimeve dhe për të siguruar një pjesëmarrje të gjerë.
- Forcimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për të siguruar qeverisje të adaptueshme, gjithëpërfshirëse dhe bashkëkohore për sektorin kulturor.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1. Ndërtimi i kapaciteteve në të gjitha institucionet dhe komunitetet kulturore, duke rritur aftësitë, njohuritë dhe nivelin drejtues për t'iu përgjigjur sfidave dhe mundësive të reja.

Ky objektiv nënkupton konceptimin dhe zbatimin sistematik të programeve të trajnimit, mentorimit, shkëmbimeve profesionale dhe iniciativave të nivelit drejtues të synuara për menaxherët kulturorë, artistët, administratorët dhe udhëheqësit e komuniteteve lokale. Fokusimi në ndërtimin e kapaciteteve në institucionet kulturore dhe komunitetet u përgjigjet drejtpërdrejt dobësive të identifikuara në analizën e situatës aktuale, e cila vëren një infrastrukturë dhe zhvillim tregu të pamjaftueshëm, mangësi të theksuara në trajnimin profesional, financimin dhe strukturat mbështetëse për artistët dhe praktikuesit e kulturës. Zbatimi i programeve sistematike të trajnimit, mentorimit dhe shkëmbimeve profesionale - siç theksohet si në *Objektivat e Kulturës*

për Zhvillim të Qëndrueshëm të UNESCO-s ashtu edhe në *Planin e Punës së BE-së për Kulturën* (2019–2022) - i pajis profesionistët, menaxherët dhe drejtuesit e kulturës me njohuri kritike, aftësi digjitale dhe aftësi drejtuese të nevojshme për të lundruar mes sfidave sektoriale dhe për të shfrytëzuar mundësitë e reja.

Duke u fokusuar te formimi profesional, strategjia trajton mungesën kronike të mbështetjes të evidentuar në analizën e situatës aktuale dhe kontribuon në krijimin e një sektori kulturor më të qëndrueshëm dhe më inovativ. Për më tepër, nxitja e zhvillimit profesional dhe e nivelit drejtues forcon kapacitetet institucionale, të cilat janë një parakusht për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës mbështetëse dhe të aksesit/qëndrimit në tregjet kopmetitive kulturore. Kjo, nga ana tjetër, kontribuon në perspektiva më të mira karriere për talentet e reja krijuese. Ndonëse nuk përbën një zgjidhje të plotë për fenomenin e "ikjes së trurit" dhe emigrimin e profesionistëve të rinj (një kërcënim ky i nënvizuar dhe në analizën SWOT), rritja e aksesit në trajnim me cilësi të lartë dhe në mundësi avancimi brenda sektorit kulturor të Shqipërisë, i bën më tërheqës rrugëtimet loakale të karrierës, duke zbutur kështu pjesërisht riskun e humbjes së talenteve.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2. Përdorimi i mjeteve të reja digjitale dhe organizative për të nxitur inovacionin, për të përmirësuar efikasitetin e menaxhimit dhe për të modernizuar praktikat e sektorit.
I fokusuar te transformimi digjital, ky objektiv mbështet adoptimin e teknologjive të përparuara, sistemeve të integruara të menaxhimit, arkivave digjitale dhe platformave digjitale bashkëpunuese.

Ky objektiv trajton drejtpërdrejt çështjen kryesore të identifikuar në analizën e situatës aktuale: mjedisin institucional të fragmentuar dhe lidhjet e dobëta mes ministrive përgjegjëse, si dhe midis sektorit publik dhe atij privat, kjo si në kulturë ashtu dhe në industritë kulturore dhe krijuese. Gjatë Forumit të hapur "*Gjendja e Kulturës në Shqipëri*" (Tetor 2025), shumë institucione kulturore vunë theksin te mungesa e platformave të rregullta për dialog dhe shkëmbim njohurish si një dobësi e ndjeshme. Ato nënvizuan se aktivitetet e dedikuara për rrjetëzim ishin vendimtare për nxitjen e dialogut jo vetëm ndërmjet institucioneve, por edhe me organizatat e pavarura, duke evidentuar nevojën për zgjidhje të qëndrueshme digjitale dhe bashkëpunuese.

Për më tepër, mungesa e platformave digjitale të integruara dhe e sistemeve të përbashkëta të menaxhimit vazhdon të pengojë komunikimin dhe bashkëpunimin, duke cuar në mungesë efikasiteti, mbivendosje të përpjekjeve dhe rënie të kapacitetit për inovacion.

Në një vështrim më të gjerë, analiza e situatës aktuale evidenton se proceset e punës dhe praktikat organizative në sektorin kulturor dhe atë të shoqërisë civile, janë ende

dhe në masë të madhe, të padigjitalizuara. Kjo pengon transparencën, aksesueshmërinë dhe aftësinë për të zgjeruar aktivitetet apo për të nxënë në mënyrë kolektive. Përdorimi i mjeteve të avancuara të teknologjisë së informacionit, arkivave digjitale dhe platformave bashkëpunuese — të identifikuara si prioritete si nga UNESCO ashtu edhe nga BE — do të mundësonte një menaxhim më fleksibël, procese pune më transparente dhe një shtrirje më të gjerë të aktiviteteve, si edhe bashkëpunim në kohë reale ndërmjet aktorëve në të gjitha nivelet.

Këto masa promovojnë një ekosistem kulturor më koheziv, efikas dhe inovativ, duke kapërcyer izolimin institucional dhe duke garantuar që burimet dhe idetë të ndahen në mënyrë më efektive në të gjithë sektorin. Rekomandimi i UNESCO-s në lidhje me *Mbrojtjen dhe Promovimin e Muzeve dhe Koleksioneve* (2015) nënvizon rëndësinë e inovacionit digjital për menaxhimin dhe aksesin kulturor. Përveç kësaj, *Agjenda Digjitale për Evropën* (2010) e Komisionit Evropian dhe programi *Creative Europe* mbështesin integrimin e platformave digjitale dhe teknologjive inovative në sektorin kulturor.

OBJEKTIVI SPECIFIK 3. Zhvillimi i granteve transparente dhe të aksesueshme për të promovuar krijimtarinë për të mbështetur nisma të ndryshme kulturore dhe për të garantuar shpërndarje të barabartë të burimeve.
Zhvillimi i sistemeve transparente dhe të aksesueshme të granteve adreson një prej dobësive të identifikuara në mënyrë të përsëritur gjatë analizën së situatës ekzisutese, intervistat me palët e interesit dhe konsultimet publike, përkatësisht alokimi relativisht i ulët buxhetor për sektorin kulturor, modelet jo konsistente të financimit dhe barrierat e perceptuara për artistët dhe organizatat që kërkojnë mbështetje financiare. Duke zbatuar mekanizma financimi të drejtë, llogaridhënës dhe të komunikuar qartë, ky objektiv synon të demokratizojë qasjen në burime - duke ulur ngarkesën administrative dhe duke siguruar që mbështetja të arrijë jo vetëm tek institucionet e konsoliduara, por edhe tek krijuesit e rinj, grupet e nënpërfaqësuara dhe komunitetet në rajone të ndryshme. Kjo qasje është veçanërisht vendimtare në një kontekst ku infrastruktura dhe tregjet e nënzhvilluara, si dhe mbështetja e pamjaftueshme për trajnimin profesional dhe të drejtën e autorit, e ndërlikojnë më tej pabarazinë e mundësive.

Për më tepër, analiza e situatës thekson riskun në rritje të rënies së financimeve ndërkombëtare për kulturën, gjë që mund të ndikojë negativisht në qëndrueshmërinë e sektorit kulturor të Shqipërisë. Për këtë arsye, krijimi i mekanizmave të fortë të financimit vendas bëhet një prioritet i menjëhershëm për të garantuar qëndrueshmëri afatgjatë dhe autonomi. Sistemet transparente dhe gjithëpërfshirëse të granteve, siç rekomandohen nga *Agjenda e Re Evropiane për Kulturën* e BE-së dhe *Udhëzimet Operacionale* të UNESCO-s të Konventës të vitit 2005, jo vetëm që forcojnë besueshmërinë dhe efektivitetin e mbështetjes financiare, por gjithashtu nxisin

inovacionin dhe diversifikimin duke fuqizuar një bazë të gjerë aktorësh kulturorë me potencial krijues.

Duke u përqendruar në këto çështje afatgjata dhe strukturore, ky objektiv hap rrugën për një peizazh kulturor më të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe dinamik, duke zvogëluar varësinë nga burimet e jashtme të financimit dhe duke e bërë kornizën e politikave kulturore të Shqipërisë më të përgatitur për të menaxhuar pasiguritë e ardhshme.

OBJEKTIVI SPECIFIK 4. Nxitja e një sektori kulturor të ripërtërishëm, të qëndrueshëm, dhe të aftë për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive ndryshimeve dhe për të siguruar një pjesëmarrje të gjerë.
Përmes vlerësimit gjithëpërfshirës të riskut, planifikimit të skenarëve, angazhimit të palëve të interesit dhe konceptim fleksibël të programeve, ky objektiv synon të ndërtojë një sektor që mund t'u rezistojë krizave, të shfrytëzojë mundësitë dhe të ruajë nivele të larta angazhimi në të gjitha rajonet dhe grupet.
Nxitja e një sektori kulturor të ripërtërishëm, të adaptueshëm dhe të qëndrueshëm që mund t'i përgjigjet në mënyrë efektive ndryshimit është thelbësore për të korrigjuar një nga dobësitë qendrore të identifikuara në analizën e situatës aktuale: zbatimin sporadik të politikave dhe projekteve kulturore.

Duke i dhënë përparësi vlerësimit të riskut, planifikimit të skenarëve dhe angazhimit aktiv të palëve të interesit përmes qasjeve nga poshtë-lart, ky objektiv parashtron politika dhe struktura programore që mbështesin vizionin afatgjatë dhe konsistencën oepracionale. Miratimi i kornizave të tilla si *Treguesit e Kulturës 2030* të UNESCO-s dhe udhëzimet nga *Viti Evropian i Trashëgimisë Kulturore* përforcojnë më tej aftësinë ripërtërtëse dhe përshtatshmërinë e instrumenteve strategjike të Ministrisë përgjegjëse për kulturën. Këto korniza promovojnë integrimin e menaxhimit të riskut, konsultimin e vazhdueshëm dhe konceptimin fleksibël të programeve si praktikat më të mira, duke iu përgjigjur drejtpërdrejt nevojës së evidentuar në analizën e situatës aktuale për planifikim më të mirë, vlerësim strategjike dhe instrumente organizative në të gjithë sektorin kulturor.

Gjithashtu, zgjerimi i pjesëmarrjes, si në planifikim ashtu edhe në zbatim, bën që politika kulturore të jetë jo vetëm e qëndrueshme, por edhe gjithëpërfshirëse, duke reflektuar zërat dhe nevojat e komuniteteve të ndryshme, një aspekt ky i evidentuar gjatë analizës së situatës aktuale vazhdimisht si i nënzhvilluar. Pajisja e stafit dhe e institucioneve me instrumentet dhe kompetencat përkatëse shndërron ndërhyrjet *ad hoc* në veprime të strukturuara, duke rritur aftësinë e Ministrisë përgjegjëse për kulturën, për të lundruar edhe në kushtet e mungesës së qëndrueshmërisë dhe për të siguruar vitalitetin afatgjatë të sektorit.

OBJEKTIVI SPECIFIK 5. Forcimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për të siguruar qeverisje të adaptueshme, gjithëpërfshirëse dhe bashkëkohore për sektorin kulturor. Ky objektiv përfshin përditësimin e kornizës rregullatore dhe të politikave kulturore për të reflektuar nevojat bashkëkohore të shoqërisë, për të siguruar fleksibilitet, përfshirje dhe transparencë më të madhe, si dhe për të mundësuar përgjigje proaktive ndaj sfidave sektoriale. Ai gjithashtu përfshin harmonizimin e legjislacionit kombëtar me standardet ndërkombëtare për të nxitur një harmonizim dhe bashkëpunim më të mirë.

Forcimi i kornizës rregullatore për sektorin kulturor të Shqipërisë adreson drejtpërdrejt vështirësitë e identifikuara gjatë analizës së situatës aktuale, veçanërisht zbatimin sporadik të politikave kulturore, vendimmarrjen e kufizuar nga poshtë lart dhe mjedisi i fragmentuar institucional. Përmes përmirësimit të kuadrit ligjor rregullator, synohet një qeverisje më e qëndrueshme dhe transparente, si përmirësimi i proceseve të qarta për konsultim publik dhe dhënien e opinioneve, ose krijimi i tyre atu ku mekanizmat mungojnë aktualisht. Kjo përpjekje mundëson që politikat dhe projektet të ekzekutohen në mënyrë të besueshme, duke kapërcyer mospërputhjet që vijnë si pasojë e fragmentimit administrativ ose mandateve të paqarta.

Nga ana tjetër, është thelbësore të pranohet se jo të gjithë elementët e sistemit ligjor ekzistues që lidhen me kulturën kërkojnë rishikim, shumë dispozita janë tashmë të përshtatshme dhe thjesht kërkojnë zbatim efektiv. Prandaj, një pjesë e rëndësishme e këtij objektivi është zbatimi më i mirë i ligjeve dhe politikave ekzistuese. Kjo qasje e ekuilibruar rrit sigurinë ligjore, forcon qeverisjen sektoriale, nxit bashkëpunimin midis ministrive si dhe me aktorët e sektorit privat e të industritë krijuese dhe favorizon harmonizimin me standardet ndërkombëtare. Kjo është thelbësore për reduktimin e fragmentimit institucional, siç është vënë re edhe në analizën e situatës aktuale.

Ky objektiv udhëhiqet nga parimet e përcaktuara në *Agjendën e re Evropiane të BE-së për Kulturën* (2018), e cila kërkon një qeverisje të përditësuar dhe fleksibile për të trajtuar trendet kulturore në zhvillim dhe prioritetet ndërsektoriale. Konventa e UNESCO-s e vitit 2005 për *Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore* thekson gjithashtu nevojën për reforma ligjore për të mbështetur diversitetin, pjesëmarrjen dhe të drejtat kulturore.

6.3.2 Aktivitetet e Shtyllës 3:

1.1.1 Korniza e mbrojtjes së trashëgimisë
1.2.1 Konservimi i adaptueshëm
1.3.1 Mbrojtja e TKJ-së
2.1.1 Ndërtimi i kapaciteteve në të gjithë sektorin
2.3.1 Platforma DIGIT AL HERITAGE
2.3.2 Akademia Digjitale GLAM

3.1.1 Integrimi i trashëgimisë në planifikimin e zhvillimit
3.2.1 Turizëm kulturor i qëndrueshëm
4.1.1 Sistemet e Menaxhimit të Trashëgimisë
4.2.1 Financimi i qëndrueshëm i trashëgimisë
4.4.1 DIGIT AL INSIGHTS
5.1.1 Korniza Ligjore (Statusi i Artistit)
5.2.1 Reforma e Sistemit të Integruar të Granteve
5.2.2 Stimuj për Investime Kulturore
5.4.1 Instrumenti i Garancisë së Investimeve Kulturore
5.4.2 Engjëjt e Biznesit Kulturor dhe Rrjeti i Sipërmarrjeve
5.4.3 Bonus krijues
6.1.1 AL CLOUD
6.1.2 Akademia Digjitale e IKK-ve
8.2.2 Këshilli i artit
8.3.1 Plani Kombëtar "*Kultura e Ndërlidhur*"
8.3.2 VISIT AL. Mjete ndërveprimi për kulturën
8.3.3 Parku i Artit – Kinostudio
9.4.1 Sistemi i monitorimit të pjesëmarrjes kulturore
11.1.1. Programi i Ndërtimit të Kapaciteteve Gjithëpërfshirëse

6.4 Përputhja e tre shtyllave strategjike me prioritetet kulturore kombëtare për vitet 2026–2030

Tre shtyllat e identifikuara në këtë pjesë të Strategjisë u përgjigjen drejtpërdrejt katër prioriteteve kryesore të përcaktuara nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, të cilat përfshijnë ruajtjen e trashëgimisë, rritjen e industrive krijuese, zhvillimin e infrastrukturës kulturore dhe promovimin e përfshirjes dhe aksesueshmërisë.

Shtylla 1 - Kultura si nxitëse për cilësinë e jetës - garanton që mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë materiale dhe jomateriale të Shqipërisë të mbetet thelbësore për mirëqenien sociale dhe identitetin komunitar. Përmes përforcimit të përcjelljes së vlerave kulturore dhe mbështetjes së artizanatit, strategjia vë theksin te menaxhimi i qëndrueshëm, përfshirja e komunitetit dhe roli i trashëgimisë në jetën e përditshme.

Shtylla 2 - Kultura si mjet për dialog dhe pozicionim ndërkombëtar - nxit drejtpërdrejt rritjen e industrive krijuese. Ajo mbështet artistët, sipërmarrësit dhe organizatat kulturore përmes aksesit të përmirësuar në tregjet globale, mundësive të partneritetit dhe diplomacisë kulturore. Bashkëpunimi ndërkufitar dhe aleancat krijuese rrisin si vizibilitetin ashtu edhe konkurrueshmërinë e produktit kulturor shqiptar.

Shtylla 3 - Mundësimi i ekosistemit kulturor - trajton mundësuesit themelorë të nevojshëm për zhvillimin e sektorit kulturor. Përmes fokusimit te reforma e qeverisjes, ngritja e kapaciteteve, mjetet e reja digjitale dhe mekanizmat e qasshëm të granteve, kjo shtyllë mbështet përpjekjet për të krijuar ose përmirësuar hapësirat kulturore dhe për të integruar inovacionin digjital, duke rritur kësisoj angazhimin publik, edukimin kulturor dhe profesionalizmin.

Çdo shtyllë përfshin një angazhim për akses të gjerë dhe të drejtë - në aspektin strukturor, ekonomik dhe digjital. Strategjia i jep përparësi angazhimit të komuniteteve të nënpërfaqësuara, duke përfshirë të rinjtë, gratë dhe pakicat, si dhe kultivon ndërgjegjësimin kulturor midis brezave.

Duke e strukturuar Strategjinë Kombëtare për Kulturën rreth këtyre tre shtyllave të ndërvarura (mirëqenia sociale, pozicionimi ndërkombëtar dhe fuqizimi i sistemit) Shqipëria garanton një përgjigje të koordinuar ndaj sfidave bashkëkohore, duke shfrytëzuar plotësisht kulturën si një burim transformues për një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

6.5 Analiza e riskut: risqet institucionale, financiare, të kapaciteteve, politike dhe masat konkrete parandaluese

Qëllimi dhe kuadri

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2026–2030 kërkon një qasje të strukturuar ndaj riskut, pasi ndërthur reforma rregullatore, modernizim institucional, programim investimesh, riekuilibrim territorial, transformim digjital dhe skema financimi më komplekse se ato në zbatim aktualisht. Strategjia e pranon se kushtet e zbatimit mund të ndryshojnë ndjeshëm gjatë periudhës 2026–2030; prandaj, ajo parashikon tre skenarë alternativë buxhetorë — bazë, progresiv dhe optimal — të cilët konceptohen si ritme të ndryshme zbatimi dhe jo si drejtime të ndryshme politike. Gjithashtu, dokumenti specifikon se rishikimet dhe planet operacionale vjetore janë të domosdoshëm për të përshtatur strategjinë nëse rrethana e brendshme e të jashtme ndryshojnë, si dhe thekson se procesi i zbatimit duhet të mbetet mjaftueshëm fleksibël për t'iu përgjigjur goditjeve, kufizimeve dhe mundësive që mund të lindin.

Prandaj, ky seksion vlerëson rreziqet kryesore institucionale, financiare, të kapaciteteve dhe politike që mund të ndikojnë në realizimin e objektivave, si dhe propozon një interpretim operacional të tre skenarëve.

Një implikim kyç i arkitekturës së skenarëve është se **skenari bazë** duhet trajtuar jo vetëm si pragu minimal i zbatimit në kushte normale të kufizimit të burimeve, por edhe

si plan standard i funksionimit kur kushtet përkeqësohen (për shëmbull, nëse financimi nuk rritet sipas pritshmërive ose nëse materializohet një nivel i lartë rreziku, etj.). Ky skenar korrespondon me një trajektore më konservative, me rreth 4,9 miliardë lekë në vit, intensitet të reduktuar zbatimi, një ndarje më të kujdesshme në faza të masave sistemike e infrastrukturore, si dhe një prioritarizim më përzgjedhës të veprimeve. Për këtë arsye, ai përbën skenarin më të përshtatshëm të referencës për planifikimin e qëndrueshmërisë: ai ruan arkitekturën strategjike, duke i lejuar Ministrisë të mbrojë edhe në kushte të pafavorshme, reformat thelbësore, funksionet bazë të trashëgimisë dhe angazhimet minimale për gjithëpërfshirjen.

Profili i rrezikut

Strategjia bazohet në diagnozën e një sektori që ka potencial të konsiderueshëm, por edhe brishtësi strukturore: qeverisje të fragmentuar, akses territorial të pabarabartë, kapacitete menaxhuese dhe digjitale të pamjaftueshme, koordinim nën-optimal midis niveleve të qeverisjes dhe kufizime financiare që historikisht kanë vështirësuar zbatimin, veçanërisht atë të programeve të investimeve kapitale. Në fushën e trashëgimisë, inventarët e fragmentuar, zbatimi ende jo i plotë i kuadrit ligjor, procedurat e përqendruara, mungesa e stafit dhe kapacitetet e pabarabarta institucionale krijojnë kriticitet në zbatim ende pa u ndërmarrë reformat e reja.

E njëjta diagnozë vlen për të gjithë sistemin e kulturës. Muzetë dhe institucionet e kulturës mbeten të përqendruara në qendrat urbane, transformimi digjital është i pabarabartë, aksesi në nivel rajonal mbetet i kufizuar dhe sektori i pavarur vuan ende nga mungesa e qëndrueshmërisë pavarësisht rëndësisë strategjike që i njihet.

Strategjia adreson këto dobësi nëpërmjet një arkitekture politikash në tre nivele - legjislativ, fiskal dhe organizativo-menaxherial - por kjo arkitekturë bart edhe një ndërvarësi: dështimi në një prej këtyre dimensioneve mund të kompromentojë efektivitetin e të tjerëve. Për shembull, një vonesë në miratimin e legjislacionit zbatues mund të dobësojë reformën institucionale; kapaciteti i pamjaftueshëm institucional mund të penalizojë përthithjen e buxheteve më të mëdha; kapaciteti i kufizuar i bashkëfinancimit mund të pengojë aksesin në mundësitë e BE-së; dhe mungesa e vazhdimësisë politike mund të ndërpresë trajektoren e planifikuar të skenarit progresiv për rritjen e buxhetit nga nivelet aktuale drejt 1–1.2 për qind të PBB-së. Prandaj, profili i rrezikut është sistemik dhe jo i izoluar: kërcënimet më të rëndësishme janë ato që krijojnë efekte "kaskadë" në qeverisje, financa dhe zbatim.

Profili i rrezikut përfshin gjithashtu një dimension mjedisor strukturor. Shqipëria klasifikohet ndër vendet me rrezikun më të lartë sizmik në Evropë, siç u dëshmua nga tërmeti i nëntorit 2019, i cili shkaktoi dëme të konsiderueshme në objektet e trashëgimisë dhe nxiti financimin emergjent të BE-së për restaurimin. Përtej ngjarjeve

sizmike, vendi është gjithnjë e më i ekspozuar ndaj episodeve të reshjeve intensive, përmbytjeve të vrullshme, erozionit bregdetar përgjatë brigjeve të Adriatikut dhe Jonit, si dhe efekteve afatgjata të ndryshimeve klimatike në sitet arkeologjike, qendrat historike dhe peisazhet kulturore. Kjo krijon rrezikun e humbjes së pasurive të trashëgimisë ose dëmtimit të pakthyeshëm, faktor ky që është kryesisht ekzogjen në raport me logjikën e zbatimit të strategjisë, por cenon drejtpërdrejt bazën e saj të investimeve: burimet e dedikuara për restaurimin, vlerësimin dhe aktivizimin turistik mund të zhvlerësohen nga një ngjarje e vetme mjedisore nëse masat e konservimit parandalues dhe të qëndrueshmërisë strukturore nuk integrohen në programin e zbatimit. Prandaj reagimi me qëllim zbutjen e efekteve, duhet të përfshijë integrimin sistematik të vlerësimit të rrezikut dhe standarteve të gatishmërisë ndaj emergjencave në vendimet për investime, harmonizimin me kornizën e BE-së për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, dhe një mekanizëm rezerve për raste emergjente, si pjesë e *Fondit të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore*, të caktuar posaçërisht për stabilizimin emergjent dhe restaurimin pas fatkeqësive. Ky dimension duhet të reflektohet shprehimisht gjatë monitorimit, në mënyrë që në raportet vjetore të performancës të bëhet një dallim i qartë midis humbjes së trashëgimisë për shkaqe mjedisore dhe dështimit në zbatimin e strategjisë.

Rreziqet institucionale

Kategoria e parë e rreziqeve lidhet me qeverisjen dhe arkitekturën institucionale. Kompetencat e fragmentuara, centralizimi, mekanizmat e pamjaftueshëm të pjesëmarrjes, legjislacioni zbatues jo i plotë dhe autoriteti i kufizuar operacional i institucioneve të specializuara pengojnë qeverisjen kulturore efektive. Gjithashtu, është thelbësore të nënvizohet se efektiviteti i reformave ligjore dhe i politikave do të varet drejtpërdrejt nga kapaciteti real i Ministrisë përgjegjëse për kulturën, i IKTK-së, DRTK-ve dhe i organeve të tjera zbatuese për të përthithur, koordinuar dhe përmbushur përgjegjësitë e reja që u janë ngarkuar.

Rrjedhimisht, një rrezik madhor institucional është **fragmentimi i zbatimit**. Strategjia mbështetet në një numër në rritje instrumentesh dhe aktorësh: plane operacionale vjetore, plan-veprime, monitorime të bazuar në tregues kryesorë të performancës (KPI), Fondi i Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore, Këshilli i Artit, autoritetet e qeverisjes vendore, institutet e specializuara, projektet e financuara nga donatorë dhe mekanizmat e mundshëm të financimit privat. Së këndejmi, në mungesë të një njësie të fuqishme qendrore përgjegjëse për strategjinë, mandateve të qarta dhe sistemeve ndërveprues të raportimit, zabtimi rrezikon të shpërndahet në linja paralele, duke shkaktuar mbivendosje, mbingarkesë administrative dhe kritere divergjente kualifikimi ose raportimi.

Së dyti, një rrezik tjetër institucional lidhet me **ngadalësimin e operacionalizimit të reformave**. Disa nga synimet kryesore strategjike — përfshirë mirëqeverisjen, modernizimin e mekanizmave të financimit, qartësimin e instrumenteve ligjore dhe fuqizimin e autonomisë ose performancës për institucionet — miratimin e akteve nënligjore dhe rregulloreve të reja operacionale. Nëse vijon ngërçi i mosplotësimit të kuadrit rregullator, Strategjia rrezikon të mbetet një dokument thjesht deklarativ, pa mjetet e nevojshme administrative për zbatimin e saj në praktikë.

Së treti, një rrezik tjetër institucional lidhet me **asimetrinë e koordinimit midis nivelit qendror dhe atij vendor.** Strategjia synon të trajtojë pabarazinë territoriale dhe të zgjerojë shtrirjen e shërbimeve përtej Tiranës dhe qendrave kryesore urbane; megjithatë, ajo pranon se institucionet rajonale dhe strukturat vendore shpesh shfaqin kapacitete më të kufizuara, më pak burime teknike dhe infrastrukturë të amortizuar. Kjo mbart rrezikun që Strategjia të riprodhojë modele centralizimi, edhe pse formalisht synon reduktimin e tyre. Në praktikë, institucionet më të konsoliduara mund të vijojnë të përthithin pjesën dërrmuese të burimeve, nëse shpërndarja territoriale dhe masat mbështetëse nuk integrohen që në fazat fillestare.

Së katërti, një rrezik tjetër institucional është **bashkërendimi i pamjaftueshëm ndërministror**. Disa nga ndërhyrjet më me peshë të Strategjisë kushtëzohen nga një bashkëpunim i qëndrueshëm me dikastere jashtë fushës së përgjegjësisë së MTKS-së: integrimi i trashëgimisë në planifikimin territorial kërkon angazhimin e ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe zhvillimin urban; programet edukative përmes kulturës kërkojnë **sinergji** me Ministrinë e Arsimit, ndërsa instrumentet e stimujve fiskalë varen tërësisht nga Ministria e Financave. Në praktikë, koordinimi ndërministror në Shqipëri historikisht ka shfaqur paqëndrueshmëri, pasi sektori i kulturës ka peshë të kufizuar politike për të garantuar bashkëpunimin e ministrive me burime më të pasura. Kjo krijon rrezikun që veprimet ndërsektoriale të stagnojnë ose të zbehen në pikëtakimin e përgjegjësive ndërministrore, pikërisht aty ku synimet janë më të larta. Zbutja e këtij rreziku kërkon formalizimin e mekanizmave koordinues që në zanafillë, përmes grupeve të përbashkëta të punës me mandate të qarta, objektivave të integruar në strategjitë përkatëse sektoriale dhe sanksionimit të angazhimeve ndërministrore në planet operacionale.

Në terma të përgjithshëm, masa kryesore zbutëse konsiston në sekuencimin e qartë të ndërhyrjeve institucionale. Duke pasur parasysh ekspozimin ndaj rrezikut, prioriteti parësor i zbatimit duhet të jetë aktivizimi i njësisë përgjegjëse për Strategjinë, qartësimi i mandateve dhe funksionalizimi i Fondit të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore e i Këshillit të Artit, përmes rregullave të qarta të mirëqeverisjes. Paralelisht, mbetet thelbësor integrimi i instrumenteve dhe mekanizmave të monitorimit financiar dhe të performancës.

Rreziqet financiare

Rreziku financiar përfaqëson kategorinë më të prekshme dhe më të detajuar të analizës. Strategjia është kostuar kundrejt një trajektoreje të vetme referimi (skenari progresiv), e pozicionuar midis dy projeksione agregate alternative (skenari bazë dhe ai optimal). Skenari bazë përputhet me tavanet paraprake buxhetore të vitit 2026; skenar progresiv rritet gradualisht drejt nivelit 1–1.2% të PBB-së deri në vitin 2030; dhe skenari optimal, që synon këtë nivel që nga viti 2026 e në vijim. Të tre skenarët janë ndërtuar mbi supozimin konservator të një PBB-je të qëndrueshme, me qëllim shmangien e mbivlerësimit të hapësirës fiskale në një kontekst makroekonomik volatil.

Rreziku parësor financiar qëndron **në pamundësinë e sigurimit të burimeve në përputhje me trajektoret progresive ose optimale**. Vetë skenari progresiv paraqitet si një kompromis realist, por dokumenti paralajmëron shprehimisht se ai kushtëzohet nga rritja e vazhdueshme vjetore e financimit publik, aksesi i zgjeruar në burimet e BE-së dhe donatorëve, si dhe nga një kontribut më i fuqishëm i aktorëve privatë. Nëse këto supozime nuk materializohen, në mesin e ciklit mund të shfaqen vakuume financiare, duke diktuar riprogramime të befta, anulime ose tkurrje të objektivave strategjikë.

Së dyti, një rrezik tjetër financiar lidhet me **përsëritjen e fenomenit të nën-ekzekutimit të buxhetit**, veçanërisht sa i përket investimeve kapitale dhe programeve komplekse ndërinstitucionale. Strategjia evidenton mangësi historike në realizimin e buxhetit në sektorin e trashëgimisë dhe paralajmëron se rritja e alokimeve, në vetvete, nuk garanton përthithje efektive të fondeve. Ky rrezik amplifikohet në skenarin optimal, ku rritja e shpejtë e volumit financiar mund të tejkalojë kapacitetet aktuale administrative, duke prodhuar raporte të ulëta kosto-përfitim, përzgjedhje të nxituar të projekteve ose krijimin e mbetjeve buxhetore.

Së treti, një rrezik financiar madhor është **mbivarësia nga burimet ekzogjene dhe private**, të cilat nuk janë ende të konsoliduara strukturalisht. Strategjia bazohet në kontribute të pritshme nga fondet e BE-së (IPA III), Banka Botërore, partneritetet dypalëshe, si dhe nga mekanizma si sponsorizimet, Partneritetet Publik-Privat (PPP) dhe angazhimi i diasporës. Dokumenti pranon se pjesëmarrja private mbetet e kufizuar dhe se kapaciteti bashkëfinancues i Shqipërisë për programet e BE-së është i shtrënguar. Kjo krijon një brishtësi strukturore: suksesi i skenarëve më ambiciozë varet nga flukse financimi, parashikueshmëria e të cilave mbetet e pjesshme.

Kjo brishtësi ka një dimension specifik që lidhet me maturitetin e tregut, i cili kërkon trajtim të veçantë. Disa nga instrumentet e parashikuara në Strategji — përfshirë Mekanizmin e Garancisë për Investimet Kulturore, Rrjetin e *Business Angels* dhe Kapitalin e Rrezikut (*Venture*) për Kulturën, mekanizmat PPP për valorizimin e trashëgimisë dhe rritjen e industrive krijuese — mbështeten mbi supozime për gatishmërinë e sektorit privat dhe thellësinë e tregut, të cilat mund të mos përkojnë ende me kushtet e tregut shqiptar. Tregu kulturor në Shqipëri mbetet i brishtë:

investimet private në kulturë janë të ulëta sipas standardeve rajonale, kultura e sponsorizimit është ende e nënzhvilluar dhe shumica e operatorëve të sektorit krijues funksionojnë në shkallë mikro-ndërmarrjeje, me kapacitet të kufizuar për të përthithur ose shërbyer instrumente financiare të strukturuara. Kjo krijon rrezikun e dështimit të instrumenteve të tregut, ku mekanizmat e projektuar mbeten formalisht të disponueshëm, por nuk gjejnë zbatim në praktikë, pasi kushtet e kërkesës — si gatishmëria për rrezik, edukimi financiar, modelet e qëndrueshme të biznesit dhe aksesi në kapital qarkullues — janë të pamjaftueshme. Zhvillimi i tregut duhet parë si parakusht dhe jo si supozim për suksesin e instrumenteve inovative. Rrjedhimisht, çdo lançim duhet të ndërthuret me mbështetje teknike për përfituesit, objektiva realistë përthithjeje dhe një klauzolë rishikimi pas vitit të parë, duke lejuar riprojektimin e instrumentit nëse performanca mbetet strukturalisht nën nivelet e pritshme.

Së katërti, një rrezik tjetër financiar lidhet me **asimetrinë e shpërndarjes së burimeve brenda sektorit.** Pavarësisht skenarit buxhetor — qoftë ai shtrëngues apo i favorshëm — ekziston rreziku i mbi-përqendrimit të fondeve: në skenarin bazë, drejt qendrave tashmë të konsoliduara; ndërsa në skenarin optimal, drejt projekteve infrastrukturore me vizibilitet të lartë. Në të dyja rastet, institucionet e vogla, zonat rurale, grupet minoritare dhe skena e pavarur kulturore rrezikojnë të mbeten në periferi të vëmendjes, duke kompromet uar objektivat e Strategjisë për gjithëpërfshirje dhe kohezion territorial.

Rreziqet lidhur me kapacitetet

Rreziku i kapaciteteve përshkon të gjitha shtyllat e Strategjisë. Analiza evidenton mangësi qenësishme në rrafshin e kapaciteteve profesionale, teknike, menaxhuese dhe digjitale, të cilat prekin institucionet e specializuara, muzetë, strukturat rajonale dhe të gjithë ekosistemin kulturor. Gjithashtu, vërehet një asimetri midis investimeve të fundit në infrastrukturë apo restaurim dhe nivelit të aftësive teknike e menaxhuese, të cilat nuk kanë pësuar një rritje përpjesëtimore.

Një rrezik parësor mbetet **kapaciteti i kufizuar përthithës**. Edhe në kushtet e disponueshmërisë financiare, institucionet mund të hasin vështirësi në hartimin e projekteve, menaxhimin e prokurimeve, mbikëqyrjen e zbatimit, raportimin te donatorët apo përputhshmërinë me kërkesat administrative të BE-së. Strategjia e identifikon këtë problematikë si rrezik kritik për skenarët progresivë dhe optimalë, veçanërisht pas vitit 2027, kur vëllimet e investimeve pritet të rriten dhe sistemi do të duhet të menaxhojë ndërhyrje më komplekse kapitale, digjitale dhe territoriale.

Së dyti, një rrezik tjetër lidhet me **asimetrinë midis aktorëve të konsoliduar dhe atyre me kapacitete të kufizuara.** Institucionet kombëtare dhe aktorët me seli në Tiranë zotërojnë avantazhe në terma të burimeve njerëzore, vizibilitetit dhe ekspertizës

teknike, çka u garanton akses më të lehtë në financimet konkurruese apo në zbatimin e programeve komplekse. Ndërkohë, institucionet periferike dhe operatorët më të vegjël rrezikojnë margjinalizimin. Në mungesë të një asistence teknike të mirëtargetuar, kjo asimetri mund të thellojë pabarazitë rajonale, në vend që të shërbejë për zbutjen e tyre

Së treti, një rrezik tjetër institucional buron nga **deficitet në kapacitetet e nevojshme për transformimin ndërsektorial dhe digjital.** Strategjia i jep përparësi infrastrukturës digjitale, sistemeve ndërvepruese të të dhënave, modeleve të reja të prodhimit kulturor dhe një bashkërendimi më të ngushtë me politikat e turizmit, arsimit dhe inovacionit. Ndonëse këto drejtime mbartin vlerë të lartë strategjike, ato kërkojnë kompetenca specifike që ende nuk zotërohen gjerësisht brenda sistemit, duke përfshirë: kurimin digjital, qeverisjen e të dhënave, financimin e projekteve, monitorimin, mbledhjen e fondeve dhe menaxhimin e partneriteteve. Përtej deficitit të kapaciteteve, dimensioni digjital mbart një rrezik shtesë: **cenueshmërinë sistemike** të infrastrukturës teknologjike. Teksa Strategjia synon avancimin e digjitalizimit të koleksioneve të trashëgimisë dhe zhvillimin e platformave kombëtare, sektori do të gjenerojë volume gjithnjë në rritje të të dhënave të ndjeshme dhe të pazëvendësueshme. Në mungesë të protokolleve të sigurisë kibernetike, arkitekturave të arkivimit rezervë (backup) dhe qeverisjes së kontrollit të aksesit, kjo infrastrukturë mbetet e ekspozuar ndaj humbjes së të dhënave, ndërhyrjeve të paautorizuara, kolapsit të platformave apo mungesës së ndërveprueshmërisë midis sistemeve të prokurura në mënyrë të fragmentuar nga aktorë të ndryshëm — rreziqe këto që janë materializuar tashmë në mjedise të ngjashme institucionale në rajon. Masat zbutëse duhet të parashikojnë integrimin e kërkesave të sigurisë kibernetike në të gjitha specifikimet teknike të prokurimeve digjitale, protokolle strikte për ruajtjen dhe rikuperimin e bazave të të dhënave të trashëgimisë, si dhe harmonizimin e plotë me standardet e Direktivës NIS2 të BE-së, në kuadër të procesit të anëtarësimit. Adresimi i rrezikut të ndërveprueshmërisë kërkon miratimin e një arkitekture teknike të përbashkët si parakusht, përpara zhvillimit të çdo sistemi të veçuar.

Së katërti, një rrezik tjetër madhor buron nga **ndryshimet demografike** të nxitura prej emigracionit dhe migrimit të brendshëm. Shqipëria ka përjetuar në tre dekadat e fundit një nga normat më të larta të emigrimit në Evropë; paralelisht profesionistët e kualifikuar të kulturës përbëjnë një nga kategoritë me mobilitetin më të lartë. Brenda vendit, shpopullimi i zonave rurale përshpejton humbjen e praktikave kulturore të gjalla dhe dobëson komunitetet që shërbejnë si mbartës të trashëgimisë jomateriale. Për Strategjinë, kjo krijon një brishtësi të dyfishtë: sistemi institucional rrezikon të humbasë memorien institucionale dhe personelin e trajnuar pikërisht në fazën kur nevojat për zbatim rriten, ndërsa shtrirja territoriale e programeve kulturore rrezikon të tkurret teksa pesha demografike përqendrohet më tej në Tiranë dhe qendrat kryesore urbane. Masat zbutëse duhet të përfshijnë mekanizma të strukturuar për mbajtjen e personelit — si rrugët e zhvillimit të karrierës dhe aksesin në skemat evropiane të

mobilitetit — së bashku me programe specifike për dokumentimin dhe mbajtjen gjallë të trashëgimisë jomateriale në komunitetet nën presion demografik. Këto masa duhet të jenë të ankoruara në veprimet e propozuara për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale dhe në instrumentet për gjithëpërfshirjen territoriale.

Zbutja e këtyre rreziqeve dikton **prioritizimin e fuqizimit të kapaciteteve që në fazën e parë të zbatimit të Strategjisë**. Dokumenti rekomandon shprehimisht ndërhyrje intensive gjatë periudhës fillestare 2026–2027, me qëllim konsolidimin e aftësive në hartimin e projekteve, asistencën teknike, prokurimin, raportimin dhe menaxhimin financiar në të gjithë hierarkinë — nga Ministria dhe njësitë e qeverisjes vendore, deri te operatorët kulturorë. Në praktikë, zhvillimi i kapaciteteve nuk duhet trajtuar si një aktivitet mbështetës, por si një parakusht strategjik për realizimin e suksesshëm të investimeve në shkallë të gjerë në vijim.

Rreziqet politike

Rreziku politik përfaqëson një kategori komplekse që përfshin si ndryshimet institucionale formale, ashtu edhe dinamika më të gjera që prekin legjitimitetin, vazhdimësinë dhe besimin e palëve të interesit. Në një kontekst pasigurie globale dhe rajonale, presionet për konsolidim fiskal apo ndryshimet në agjendat politike mund të fragmentojnë trajektoren e parashikuar buxhetore.

Së pari, një rrezik madhor politik është **mungesa e vazhdimësisë së angazhimit përgjatë ciklit 2026–2030.** Duke qenë se Strategjia synon riorientimin e prioriteteve të shpenzimeve, të mekanizmave të qeverisjes dhe të marrëdhënieve ndërsektoriale (kulturë, turizëm, zhvillim territorial dhe integrim në BE), ajo kërkon qëndrueshmëri afatgjatë dhe jo vendimmarrje sporadike. Çdo lëkundje e prioriteteve politike rrezikon t'i shndërrojë reformat në një dokument thjesht deklarativ, duke ngadalësuar zbatimin dhe duke cenuar karakterin operacional të Strategjisë.

Së dyti, **mospërputhja e pritshmërive** përbën një sfidë politike të qenësishme. Dokumenti konstaton se shoqëria civile ka kërkuar nivele shumë më të larta të shpenzimeve publike, ndërkohë që skenari bazë ofron vetëm një trajektore minimale të qëndrueshmërisë dhe ai progresiv mbetet i kushtëzuar. Nëse pritshmëritë e operatorëve kulturorë rriten me një ritëm më të shpejtë se rezultatet e prekshme, Strategjia mund të ekspozohet ndaj kritikave për mungesë ambicieje ose dështim në realizim, veçanërisht nëse ekzekutimi administrativ mbetet pas deklaratave publike.

Së treti, ekziston **rreziku i kontestimit të prioriteteve për shpërndarjen e burimeve.** Një Strategji që ndërthur trashëgiminë, infrastrukturën, industritë krijuese, sektorin e pavarur dhe gjithëpërfshirjen territoriale, kërkon domosdoshmërisht kompromise strategjike. Nëse flukset financiare perceptohen si tej mase të përqendruara, të politizuara apo të orientuara ekskluzivisht drejt institucioneve të mëdha, kjo mund të

minojë besimin dhe angazhimin aktiv të aktorëve vendorë, operatorëve të pavarur dhe grupeve vulnerabël.

Së katërti, **cenimi i reputacionit institucional** si pasojë e ekzekutimit të pamjaftueshëm ose qeverisjes jotransparente përbën një rrezik serioz. Rritja e tavanit të shpenzimeve shoqërohet në mënyrë të pashmangshme me një monitorim më rigoroz; rrjedhimisht, vonesat në zbatim apo mbetjet buxhetore mund të interpretohen si keqmenaxhim. Për këtë arsye, Strategjia insiston në raportimin vjetor publik, auditimin e jashtëm, monitorimin me pjesëmarrje dhe kornizat e mirëpërcaktuara të performancës..

Përtej dinamikave të brendshme, Strategjia ekspozohet ndaj **rrezikut të kushtëzimit** nga procesi i integrimit në BE. Me progresin aktiv të anëtarësimit, detyrimet për përafrim legjislativ, administrativ dhe fiskal shtohen ndjeshëm. Për sektorin kulturor, kjo përfaqëson sa një mundësi, aq edhe një rrezik: nëse përafrimi i legjislacionit (e drejta e autorit, shërbimet mediatike audiovizive, rregullat e ndihmës shtetërore dhe normat e mbrojtjes së trashëgimisë) nuk përmbush standardet e Komisionit Evropian, sektori mund të përballet me vlerësime negative. Kjo do të ndërlikonte aksesin në **IPA III** dhe instrumente të tjerë të para-anëtarësimit. Gjithashtu, nëse prioritetet e programimit të BE-së ndryshojnë për shkak të presioneve gjeopolitike, supozimet që mbështesin skenarët progresivë dhe optimalë mund të kërkojnë rikalibrim. Zbutja e këtij rreziku kërkon integrimin e objektivave të anëtarësimit në ciklin e rishikimit vjetor të strategjisë, caktimin e përgjegjësive të qarta brenda MTKS-së për ndjekjen e përafrimit legjislativ dhe mbajtjen e një dialogu të vazhdueshëm me institucionet përkatëse për të siguruar që kultura të mos trajtohet si dytësore ndaj kapitujve me profil më të lartë politik

Masat zbutëhe në këtë rrafsh varen tërësisht nga kredibiliteti i qeverisjes. Ministria duhet ta ankorojë publikisht Strategjinë në një logjikë me faza, duke shpjeguar qartë kushtet e aktivizimit të skenarit bazë. Transparenca duhet të sigurohet përmes raporteve vjetore që detajojnë ekzekutimin dhe shpërndarjen territoriale; kategoritë e përfituesve dhe treguesit e gjithëpërfshirjes; dhe progresin në mekanizmat strategjikë si Fondi për Kujdesin e Trashëgimisë, Këshilli i Artit, stimujt fiskalë dhe alokimi i të ardhurave të lidhura me turizmin. Ky lloj raportimi minimizon rrezikun që rishikimi i skenarëve të interpretohet si zmbrapsje nga angazhimet, duke e pozicionuar atë si një menaxhim dinamik dhe të përgjegjshëm që i përshtatet rrethanave reale.

Përgjigjja ndaj rrezikut në varësi të skenarëve

Të tre skenarët duhet të interpretohen si pjesë integrale e arkitekturës së rrezikut. Skenari optimal rezulton i zbatueshëm vetëm nëse hapësira fiskale, bashkëfinancimi, gatishmëria institucionale dhe vazhdimësia politike janë mjaftueshëm të konsoliduara për të mbështetur një shkallëzim të shpejtë të veprimtarisë. Skenari progresiv mbetet rruga e preferuar e reformës në kushte mesatarisht të favorshme, pasi ai balancon

ambicien me aftësimin gradual, sekuencimin e duhur të hapave dhe përputhshmërinë administrative.

Megjithatë, në rastet kur përkojnë dy kushte — së pari, kur nuk ka rritje të ndjeshme të financimit përtej tavanit aktual buxhetor dhe, së dyti, kur materializohet një nivel i lartë rreziku institucional, politik ose makro-fiskal — strategjia duhet të mbështetet qëllimisht te skenari bazë. Ky 'hap pas' nuk nënkupton margjinalizimin e Strategjisë, por përkundrazi, mbrojtjen e integritetit operacional të saj duke e përqendruar zbatimin vetëm te ndërhyrjet me vlerën më të lartë sistemike. Këtu përfshihen përmbyllja e kuadrit ligjor dhe ngritja institucionale; mbrojtja thelbësore e trashëgimisë dhe garantimi i gjithëpërfshirjes minimale; sistemet e monitorimit dhe një grup i përzgjedhur projektesh pilote që ruajnë dinamikën e zbatimit, duke mbrojtur njëkohësisht besueshmërinë fiskale dhe atë reputacionale.

Në këtë kuptim, skenari bazë duhet të formalizohet si një skenar i qëndrueshmërisë *(resilience scenario)*. Ai është mekanizmi që lejon Strategjinë të mbetet funksionale edhe nën presion, parandalon mbingarkesën me detyrime të papërballueshme dhe ruan mundësinë e kalimit të mëvonshëm drejt trajektores progresive, sapo të përmirësohen kushtet financiare, kapacitetet ose rrethanat politike. Strategjia ofron tashmë bazën konceptuale për këtë interpretim, duke e përshkruar skenarin bazë si pragun minimal të zbatueshmërisë dhe duke rekomanduar rishikimin afatmesëm dhe rikalibrimin me qëllim përshtatjen e saj ndaj rrethanave të reja.

Matrica e rreziqeve

Rreziku	Kategoria	Probabiliteti (Gjasa)	Ndikimi	Pasojat Kryesore	Masat Kryesore Zbutëse
Qeverisje e fragmentuar dhe mbivendosje organesh	Institucional	Mesatare-Lartë	Lartë	Vonesa, duplikim funksionesh, llogaridhënie e dobët	Ngritja e njësisë qendrore të strategjisë; qartësimi i mandateve; integrimi i sistemeve të raportimit

Vonesa në aktet nënligjore dhe procedurat operacionale	Institucional	Lartë	Lartë	Reformat mbeten deklarative; pasiguri juridike	Sekuencimi i hershëm i reformave ligjore; përcaktimi i afateve; lidhja e piketave me rishikimin vjetor
Koordinim i dobët qendër-territor	Institucional	Mesatare	Lartë	Përqendrim te qendrat e konsoliduara; asimetri territoriale	Grupimi gjeografik, kuotat territoriale, mbështetje e dedikuar për rajonet me kapacitete të kufizuara
Bashkërendim i dobët ndërministror	Institucional	Mesatare-Lartë	Mesatare-Lartë	Izolim i sektorit; bllokim i veprimeve ndërsektoriale	Formalizimi i grupeve të punës; integrimi i objektivave në strategjitë sektoriale (Turizëm, Arsim)
Mungesë e rritjes së financimit mbi tavanet aktuale	Financiar	Mesatare-Lartë	Mesatare	Tkurrje e veprimeve, vonesa, reduktim i ambicies	Adoptimi i skenarit bazë si plan qëndrueshmëri e; prioritizimi i ndërhyrjeve me impakt të lartë

Nën-ekzekutimi i buxhetit (investimet kapitale)	Financiar	Mesatare-Lartë	Lartë	Mbetje buxhetore, rënie e besueshmërisë, vonesë në rezultate	Monitorim në kohë reale, filtrimi i portofolit të projekteve, rialokim bazuar në performancë
Mospërmbushje e parashikimeve për financim ekzogjen	Financiar	Mesatare-Lartë	Mesatare	Vakuume financiare, riprogramim i beftë, rënie e bashkëfinancimit	Buxhetim konservator, strategji bashkëfinancimi, zhvillim i listës së projekteve për donatorët (pipeline)
Maturitet i ulët i tregut për instrumentet private	Financiar	Mesatare-Lartë	Mesatare	Instrumentet mbeten formalisht aktive por të papërdorura	Asistencë teknike për përfituesit; objektiva realistë përthithjeje; klauzolë rishikimi pas vitit të parë
Asimetri e alokimit drejt projekteve me vizibilitet	Financiar / Politik	Mesatare	Mesatare	Margjinalizimi i zonave rurale dhe i skenës së pavarur	Përcaktimi i kuotave minimale për gjithëpërfshirjen dhe zonat periferike

Kapacitet i ulët përthithës dhe menaxhues	Kapacitetet	Lartë	Lartë	Vonesa në prokurime dhe në realizimin e fondeve të BE-së	Front-loading i trajnimeve dhe asistencës teknike në periudhën 2026–2027
Kapacitete teknike të pabarabarta territoriale	Kapacitetet	Lartë	Mesatare-Lartë	Përthithje e burimeve vetëm nga aktorët e konsoliduar	Asistencë e përshtatur, thirrje me faza, thjeshtim i procedurave për aplikantët e vegjël
Mungesë e aftësive digjitale dhe ndërsektoriale	Kapacitetet	Mesatare-Lartë	Mesatare-Lartë	Zbatim i dobët i masave të inovacionit	Module të specializuara trajnimi; lidhja e investimeve me mbështetjen operacionale
Cenueshmëri e sigurisë kibernetike/infrastrukturës	Kapacitetet / Digjital	Mesatare	Lartë	Humbje e të dhënave, dështim platformash, humbje e trashëgimisë	Integrimi i kibersigurisë në prokurime; protokolle backup; harmonizim me NIS2; arkitekturë e përbashkët
Presioni demografik	Kapacitetet	Lartë	Mesatare-Lartë	Humbje e kapitalit njerëzor;	Mekanizmat e retencionit; itineraret e

(emigracioni/ shpopullim)				gërryerje e trashëgimisë së gjallë	karrierës; dokumentimi i trashëgimisë në rrezik
Rreziku sizmik dhe mjedisor-klimatik	Ndërsektorial	Mesatare-Lartë	Lartë	Dëmtim i pasurive; humbje e bazës së investimit për turizëm	Përgatitja ndaj fatkeqësive; rezervë emergjence në Fondin e Trashëgimisë; dallimi i shkaqeve në M&E
Mungesa e vazhdimësisë politike 2026–2030	Politik	Mesatare-Ulët	Mesatare	Ndërprerje e financimit, zbehje e pronësisë institucionale	Marrëveshje afatmesme me Financat; raportim publik; sinkronizim me prioritetet e BE-së
Kushtëzimi nga procesi i anëtarësimit në BE	Politik / Jashtëm	Mesatare	Lartë	Vlerësime negative; bllokim i IPA III; vonesa në përafrimin ligjor	Integrimi i standardeve të BE-së në rishikimin vjetor; dialog i vazhdueshëm me Këshillin e Integrimit
Mospërputhje e	Politik	Mesatare	Lartë	Mosbesim i shoqërisë	Komunikim transparent mbi skenarët;

pritshmërive me rezultatet				civile; humbje e reputacionit	rezultate me faza; forume monitorimi me pjesëmarrje
Perceptimi i zbatimit si "simbolik/jo transformues"	Politik	Mesatare - Lartë	Mesatare - Lartë	Rënie e mobilizimit të palëve të interesit	Përcaktimi i skenarit bazë si prag minimal zbatueshmërie; sigurimi i arritjeve strategjike (wins)

Rekomandime operacionale përmbyllëse

Panorama e përgjithshme e rrezikut dëshmon se Strategjia është e realizueshme, me kusht që disiplina e zbatimit të jetë në lartësinë e ambicies strategjike. Dokumenti tashmë ofron instrumentet kryesore për këtë disiplinë: **sekuencimin buxhetor**, rishikimin vjetor, mirëqeverisjen financiare, monitorimin pjesëmarres dhe fokusin e pandërprerë te kapacitetet përthithëse. Nevoja imediate është **kodifikimi** i këtyre elementeve në një protokoll formal të menaxhimit të rrezikut gjatë zbatimit.

Nga ky këndvështrim, parimi operacional i rekomanduar është i drejpërdrejtë: **skenari progresiv mbetet trajektorja parësore** kur kushtet fiskale dhe politike janë të qëndrueshme, pasi ai ofron balancën optimale mes ambicies dhe **fizibilitetit operacional**. Megjithatë, në rast të shtrëngimit të financimit apo rritjes së rreziqeve institucionale dhe makro-fiskale, Ministria duhet të funksionalizojë skenarin bazë si **skenar të qëndrueshmërisë**. Ky kalim siguron përqendrimin e burimeve në ndërhyrjet prioritare ligjore dhe institucionale, në garantimin e kohezionit minimal territorial e social, si dhe në një portofol të kontrolluar ndërhyrjesh me impakt të lartë. Kjo qasje mbron **besueshmërinë institucionale**, shmang ekspozimin ndaj detyrimeve të papërballueshme dhe mban të hapur mundësinë e rikthimit në një trajektore më ambicioze zbatimi sapo të përmirësohen rrethanat.

7. Strategjia në veprim

7.1 Treguesit e performancës për prioritetin "Ruajtja dhe mbrojtja e siteve të trashëgimisë kulturore"

Qëllimi Strategjik	Objektivat	Veprimet	Viti	Treguesit kryesorë të performancës	Dimensioni
1. Mbrojtja dhe vlerësimi i trashëgimisë kulturore të Shqipërisë	1.1 Forcimi i kornizës sociale, institucional dhe planifikues për mbrojtjen e trashëgimisë.	1.1.1 Korniza e mbrojtjes së trashëgimisë	2026-27	• Reduktimi i përqindjes së aseteve të listuara me pronësi të pazgjidhur ose me mangësi në dokumentacion (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e përqindjes së projekteve madhore të investimeve publike në zonat e mbrojtura, të shqyrtuara përmes Vlerësimit të Ndikimit në Trashëgimi - HIA (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e përqindjes së projekteve madhore të investimeve publike në zonat e mbrojtura, të cilat shmangin, reduktojnë ose zbusin në mënyrë të përshtatshme ndikimet në vlerat e trashëgimisë (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e përqindjes së koleksioneve dhe arkivave të jashtme prioritare që identifikohen, dokumentohen, digjitalizohen ose bëhen të aksesueshme për institucionet shqiptare dhe publikun; numri i marrëveshjeve të suksesshme të lidhura për akses, huazim, përfitim ose riatdhesim (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Korniza ligjore
	1.2 Përmirësimi i ruajtjes, gatishmërisë ndaj riskut dhe qëndrueshmërisë ndaj klimës	1.2.1 Konservimi i adaptueshëm	2026-27	• Rritja e përqindjes së institucioneve të trashëgimisë dhe menaxherëve të siteve që zbatojnë në praktikë udhëzimet kombëtare të menaxhimit të riskut (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e përqindjes së siteve prioritare të trashëgimisë me plane të zbatuara dhe të testuara për gatishmërinë ndaj riskut (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e përqindjes së planeve të konservimit që integrojnë në mënyrë sistematike kriteret e riskut, duke përfshirë rreziqet klimatike, të fatkeqësive dhe të degradimit (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Mjete të reja
	1.3 Mbrojtja dhe transmetimi i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (TKJ)	1.3.1 Mbrojtja e TKJ-së	2026-27	• Rritja e përqindjes së elementeve të TKJ-së me plane të përfunduara të ruajtjes (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e përqindjes së mësuesve dhe faciliteteve të trajnuar që zbatojnë në mënyrë aktive metodat e ruajtjes dhe transmetimit të TKJ-së në shkolla dhe në mjedise komunitare (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Mjete të reja
2. Modernizimi dhe forcimi i ekosistemit të trashëgimisë	2.1 Ndërtimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale në sektorin e trashëgimisë dhe muzeve.	2.1.1 Ndërtimi i kapaciteteve në të gjithë sektorin	2026-27	• Rritja e përqindjes së stafit të IKTK-së. IKRTK, DRTK të trajnuar (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e numrit të partneriteteve me universitetet dhe institutet kërkimore (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e përqindjes së DRTK-ve që marrin pjesë në program (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e përqindjes së muzeve që marrin pjesë në program (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Mjete të reja
	2.2 Modernizimi i sistemit muzeor dhe promovimi i përsosmërisë	2.2.1 Modernizimi i sistemit muzeor	2027-29	• Rritja e përqindjes së muzeve që zbatojnë standarde të reja të qeverisjes dhe ato profesionale (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e përqindjes së stafit që merr pjesë në programet e zhvillimit të burimeve njerëzore (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Zhvillimi i audiencës
	2.3 Forcimi i dokumentacionit dhe inventarëve digjitalë përmes platformës kombëtare DIGIT AL HERITAGE	2.3.1 Platforma DIGIT AL HERITAGE	2026-27	• Përfundimi i projekteve pilot dhe ngarkimi i të dhënave bazë. • Publikimi i Regjistrit Kombëtar të të Dhënave (RKDH) dhe Katalogut API. • Rritja e përqindjes së institucioneve kulturore rajonale me infrastrukturë digjitale të besueshme dhe akses të sigurt në të dhëna (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Mjete të reja
		2.3.2 Akademia Digjitale GLAM	2026-27	• Rritja e përqindjes së profesionistëve të GLAM të trajnuar (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e përqindjes së institucioneve të mbështetura në adoptimin e standardeve të të dhënave meta (metadata) dhe publikimin e bashkësive të të dhënave (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Ndërtimi i kapaciteteve
3. Trashëgimia si nxitës i zhvillimit të qëndrueshëm dhe mirëqenies së komunitetit	3.1 Integrimi i trashëgimisë në kornizat kombëtare dhe lokale të zhvillimit.	3.1.1 Integrimi i trashëgimisë në planifikimin e zhvillimit	2026-27	• Rritja e përqindjes së aseteve të regjistruara të trashëgimisë kulturore me status ligjor të përditësuar, profil vlere dhe vlerësim të gjendjes fizike (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Mjete të reja
	3.2 Promovimi i turizmit të qëndrueshëm kulturor	3.2.1 Turizëm kulturor i qëndrueshëm	2026-27	• Rritja e përqindjes së stafit të sektorit të kulturës dhe turizmit që përfundojnë programet e trajnimit (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e përqindjes së fondeve publike kulturore të alokuara për projekte që përfshijnë menaxhimin e riskut, vazhdimësinë digjitale ose qëndrueshmërinë mjedisore (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Mjete të reja

	3.3 Mbështetja e ekonomive krijuese dhe kulturore të bazuara në trashëgimi	3.3.1 Platforma e Inovacionit në Trashëgimi dhe e Sipërmarrjes Krijuese	2027-29	• Rritja e numrit të ndërmarrjeve të inkubuara dhe të mbështetura (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e shtrirjes në treg dhe e produkteve të gatshme për eksport (+25% deri në vitin 2030). • Rritja e punësimit dhe të ardhurave të ndërmarrjeve të mbështetura (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Cilësia e prodhimit
	3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së komunitetit, të drejtave kulturore dhe kujdesit të përbashkët	3.4.1 Pjesëmarrja komunitare dhe kujdestaria e përbashkët	2027-29	• Rritja e numrit të këshillave komunitare të trashëgimisë të ngritura dhe të trajnuara (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Zhvillimi i audiencës
4. Inovacioni, financimi dhe qeverisja e bazuar në prova	4.1 Modernizimi i sistemeve kombëtare të qeverisjes dhe menaxhimit të trashëgimisë.	4.1.1 Sistemet e Menaxhimit të Trashëgimisë	2027-29	• Numri i menaxherëve të siteve të trajnuar (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Piketat e monitorimit të arritura (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Korniza ligjore
	4.2 Vendosja e mekanizmave të qëndrueshëm të financimit për trashëgiminë	4.2.1 Financimi i qëndrueshëm i trashëgimisë	2027-29	• Rritja e financimit (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Korniza ligjore
	4.3 Promovimi i inovacionit dhe partneriteteve ndërsektoriale	4.3.1 Inovacion dhe partneritete	2027-29	• Numri i projekteve fituese të zbatuara (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Cilësia e prodhimit
	4.4 Zhvillimi i të dhënave, statistikave dhe treguesve të ndikimit të trashëgimisë kombëtare	4.4.1 DIGIT.AL.INSIGHTS	2029-30	• Rritja e përqindjes së të dhënave të integruara (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Ndërtimi i kapaciteteve

7.2 Treguesit e performancës për prioritetin "Nxitja e rritjes së industrive krijuese"

Qëllimi Strategjik	Objektivat	Aktivitetet	Viti	Treguesit kryesorë të performancës	Dimensioni
5. Krijimi i një ekosistemi të qëndrueshëm sipërmarrës dhe krijues	5.1 Krijimi i një kuadri të përshtatshëm ligjor (njohja e statusit të artistit)	5.1.1 Korniza Ligjore	2026-27	• Rritja e përqindjes së artistëve dhe profesionistëve të kulturës të regjistruar dhe certifikuar në nivel kombëtar (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e aksesit të artistëve në skemat e mbrojtjes sociale dhe të drejtat kontraktuale (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e vlerës totale të sponsorizimeve ose kontributeve private për artistët e certifikuar dhe projektet kulturore (monitoruar përmes Këshillit të Artit) (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e partneriteteve midis kompanive private dhe institucioneve kulturore (p.sh., përmes "Art Bonus" ose modeleve të bashkëprodhimit) (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Shkalla e kënaqësisë së palëve të interesuara nga konsultimet periodike me shoqatat e artistëve dhe sponsorët (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Korniza ligjore
	5.2 Ngritja e programeve të mbështetjes financiare dhe politikave fiskale të favorshme	5.2.1 Reforma e Sistemit të Integruar të Granteve	2026-27	• Fondet e mbledhura në vit (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Fondet e shpërndara në vit (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Sistemi i granteve dhe financimit
		5.2.2 Stimuj për Investime Kulturore	2027-29	• Rritja e përqindjes së investimeve private në sektorin e kulturës në raport me shpenzimet totale kulturore (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). •	Sistemi i granteve dhe financimit
	5.3 Nxitja e bashkëpunimit midis bizneseve kulturore dhe sektorëve të tjerë prodhues	5.3.1 Art dhe Zeje - Dizajnuar në Shqipëri	2027-29	• Rritja e numrit të artizanëve / bizneseve kulturore të mbështetura përmes granteve ose mentorimit (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e numrit të prototipave të produkteve të reja / koleksioneve të zhvilluara (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e numrit të fushatave ndërkombëtare të promovimit të zbatuara (përfshirë ato të udhëhequra nga diaspora) (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Strategjitë e tregut

		5.3.2 Zërat shqiptarë	2027-29	• Rritja e përqindjes së aplikimeve që vijnë nga territore të nën-shërbyera (bashki rurale / të thella / komunitete të vogla etnike) (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Përqindja e përfituesve të granteve që raportojnë vazhdimësi të aktivitetit përtej ciklit të financimit (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Strategjitë e tregut
	5.4 Përmirësimi i aksesit në rrjetet e kreditit dhe investimeve	5.4.1 Instrumenti i Garancisë së Investimeve Kulturore	2027-29	• Rritja e numrit të akseseve në garanci (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Sistemi i granteve dhe financimit
		5.4.2 Engjëjt e Biznesit Kulturor dhe Rrjeti i Sipërmarrjeve	2027-29	• Rritja e numrit të startup-eve krijuese të mbështetura (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e numrit të pjesëmarrësve në Forume (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e shumës së investuar (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Sistemi i granteve dhe financimit
		5.4.3 Bonus krijues	2027-29	• Rritja e numrit të kontratave të reja dhe e përdorimit të bonusit krijues (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Sistemi i granteve dhe financimit
6. Promovimi i inovacionit digjital në industritë kulturore	6.1 Mundësimi i një ekosistemi bashkëpunues kulturor dhe krijues	6.1.1 AL CLOUD	2026-27	• Rritja e numrit të përdoruesve dhe projekteve bashkëpunuese të akomoduara (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e numrit të granteve të dhëna për projektet e bashkëprodhimit digjital (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Shkalla e adoptimit nëpër muzetë rajonalë dhe IKK-të (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Mjete të reja
		6.1.2 Akademia Digjitale e IKK-ve	2026-27	• Rritja e numrit të mikro-kredencialeve të grumbullueshme të lëshuara (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Ndërtimi i kapaciteteve
		6.1.3 Qendra e Inovacionit të Trashëgimisë dhe Sipërmarrjes Krijuese	2027-29	• Numri i laboratorëve rajonalë të inovacionit të aktivizuar (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Numri i startup-eve dhe projekteve kërkimore të mbështetura përmes granteve të MTKS-së (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Cilësia e prodhimit

7. Përmirësimi i aksesit në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare	7.1 Lehtësimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe shkëmbimeve kulturore	7.1.1 Marrëveshje bashkëpunimi	2026-27	• Pikat e kontaktit në ambasadat dhe konsullatat prioritare të ngritura. • Rritja e numrit të projekteve të bashkëpunimit (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e numrit të "Këndeve të Letërsisë Shqipe / Dritareve të Letërsisë Shqipe" në bibliotekat dhe institucionet partnere jashtë vendit (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Numri vjetor i ngjarjeve kulturore të drejtuara nga ambasadat, partneriteteve formale, aktiviteteve të diasporës, pasqyrimit në mediat ndërkombëtare dhe marrëveshjeve të zbatuara në mënyrë efektive (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Diplomacia kulturore
	7.2 Ofrimi i mbështetjes për ndërkombëtarizimin e sipërmarrjeve krijuese	7.2.1 Fondi për Festivale dhe Panaire	2026-27	• Rritja e numrit të IKK-ve të mbështetura nga Fondi për panairet ndërkombëtare (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e shumës së mbështetjes financiare në vit (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e numrit të ngjarjeve ndërkombëtare ku Shqipëria zgjidhet "Vendi i vitit" (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Strategjitë e tregut
		7.2.2 Zyra e Mobilitetit dhe Projekteve	2026-27	• Rritja e numrit të projekteve të financuara përmes programeve publike (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Diplomacia kulturore
		7.2.3 Programi i Çmimeve Kombëtare të Arteve	2027-29	• Rritja e numrit të produksioneve të reja të realizuara falë granteve të prodhimit (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Cilësia e prodhimit

7.3 Treguesit e performancës për prioritetin "Zhvillimi i infrastrukturës kulturore"

Qëllimi Strategjik	Objektivat	Aktivitetet	Viti	Treguesit kryesorë të performancës	Dimension
8. Zgjerimi dhe modernizimi i infrastrukturës kulturore materiale dhe jomateriale në nivel kombëtar	8.1 Zvogëlimi i hendekut të mundësive midis prodhuesve dhe konsumatorëve kulturorë në zonat urbane dhe rurale	8.1.1 Qendrat Kulturore si Qendra Krijuese	2026-27	• 40% e qendrave (hub-eve) totale të vendosura në zona jo-metropolitane ose rurale. • Rritje me 25% e normave të pjesëmarrjes në aktivitetet kulturore në bashkitë e synuara.	Zhvillimi i audiencës
		8.1.2 Zhvillimi i muzeve të rinj në Shqipëri	2027-29	• 50,000+ vizitorë unikë vjetorë pas 5 vitesh.	Cilësia e prodhimit
		8.1.3 Ringjallja e Kullave Tradicionale në Veriun e Shqipërisë	2026-27	• Rritja e numrit të kullave të ripërdorura (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e numrit të përdoruesve dhe vizitorëve (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Cilësia e prodhimit
		8.1.4 Programi Kombëtar i Artit Publik dhe Kulturës Urbane	2027-29	• Rritja e numrit të bashkive që zbatojnë standardet dhe procedurat kombëtare të artit publik (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Nxitja e rritjes së industrive krijuese
	8.2 Forcimi i sistemit të prodhimit kulturor për të rritur kapacitetin dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të sektorit	8.2.1 Përmirësimi i Infrastrukturës së Prodhimit Kulturor	2027-29	• Vlerësimi kombëtar i përfunduar deri në vitin 2026. • Rritja e numrit të operatorëve që përfitojnë nga skema e granteve të infrastrukturës (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Përmirësime në kapacitetin e prodhimit rajonal dhe në punësim (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Cilësia e prodhimit
		8.2.2 Këshilli i artit	2026-27	• Rritja e numrit të projekteve të financuara (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Vetëqëndrueshmëria me 60% të fondeve nga burime jo të MTKS-së (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Mjete të reja
	8.3 Promovimi i zhvillimit dhe miratimit të zgjidhjeve teknologjike për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e organizatave	8.3.1 Plani Kombëtar "Kultura e Ndërlidhur"	2026-27	• Rritja e përqindjes së institucioneve kulturore me brez të gjerë (broadband) dhe Wi-Fi publik (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e numrit të institucioneve GLAM të pajisura me mjete digjitale të standardizuara (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Mjete të reja
		8.3.2 VISIT AL Mjete ndërveprimi për kulturën	2026-27	• Rritja e numrit të institucioneve të integruara në dashboard-in e VISIT.AL (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Mjete të reja
		8.3.3 Parku i Artit – Kinostudio	2027-29	• Rritja e numrit të vizitorëve/pjesëmarrësve në aktivitete nga komuniteti lokal, nga qyteti i Tiranës, nga qytete të tjera shqiptare dhe nga jashtë (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e numrit të nismave të zhvilluara në partneritet me institucione të tjera kulturore me bazë në Tiranë ose ndërkombëtare (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Cilësia e prodhimit
		8.3.4 "Culturalb", Platforma Kombëtare e Brandingut Kulturor dhe Promovimit Dixhital	2026-2027	• Rritja e numrit të ngjarjeve dhe aktiviteteve të listuara në vit (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Diplomacia kulturore
	8.4 Koordinimi i strategjisë së kulturës dhe strategjisë së turizmit	8.4.1 Infrastruktura e Integruar Kulturore dhe Zhvillimi i Turizmit	2029-30	• Rritja e numrit të bashkive me mekanizma të ngritur të financimit të kulturës dhe linja buxhetore për kulturën (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Diplomacia kulturore

7.4 Treguesit e performancës për prioritetin "Promovimi i përfshirjes dhe aksesueshmërisë"

Qëllimi Strategjik	Objektivat	Aktivitetet	Viti	Treguesit kryesorë të performancës	Dimensioni
9. Sigurimi i aksesit të barabartë në kulturë për të gjitha grupet shoqërore	9.1 Zbatimi i politikave që nxisin përfshirjen e minoriteteve, grave dhe personave me aftësi të kufizuara	9.1.1 Grupi Kombëtar i Punës për Përfshirjen Kulturore	2026–27	• Përqindja e bashkive që kontribuojnë me të dhëna në sistem (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Zhvillimi i audiencës
	9.2 Zhvillimi i programeve kulturore që synojnë grupet vulnerabël	9.2.1 Krijimtaria Gjithëpërfshirëse	2027–29	• Rritja e përqindjes së mjediseve kulturore që plotësojnë standardet e aksesueshmërisë (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e përqindjes së institucioneve me programe vjetore gjithëpërfshirëse (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Zhvillimi i audiencës
		9.2.2 Karta Universale Vjetore e Hyrjes në Muze	2026–27	• Rritja e përqindjes së pjesëmarrjes në muze nga qytetarët (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Zhvillimi i audiencës
		9.2.3 Programi Kombëtar i Promovimit të Leximit në Familje	2027–29	• Rritja e përqindjes së qytetarëve që lexojnë rregullisht (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Zhvillimi i audiencës
	9.3 Promovimi i pjesëmarrjes aktive në proceset kulturore nga të gjithë qytetarët	9.3.1 Këshillat Bashkiake të Pjesëmarrjes Kulturore	2029–30	• Rritja e numrit të qytetarëve të angazhuar çdo vit në aktivitetet e këshillave (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Zhvillimi i audiencës
	9.4 Vlerësimi dhe monitorimi i efektivitetit të politikave gjithëpërfshirëse	9.4.1 Sistemi i monitorimit të pjesëmarrjes kulturore	2026–27	• Rritja e përqindjes së pjesëmarrjes kulturore nga qytetarët (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Mjete të reja
10. Promovimi i diversitetit kulturor dhe dialogut ndërkulturor	10.1 Lehtësimi i shkëmbimeve dhe bashkëpunimeve kulturore midis komuniteteve të ndryshme	10.1.1 Javët Kulturore Ndërkombëtare	2026–27	• Rritja e numrit të qyteteve dhe rajoneve jashtë Tiranës që marrin pjesë në çdo edicion (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e numrit të pjesëmarrësve në aktivitetet e Javëve Ndërkombëtare të Kulturës (të ndarë sipas gjinisë, moshës dhe rajonit) (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e numrit të partnerëve ndërkombëtarë të përfshirë (ambasada, institute kulturore, organizata ndërkombëtare) (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Vlerësimi i ndikimit turistik dhe territorial (numri i vizitorëve në qytetet pritëse gjatë eventeve).	Cilësia e prodhimit
		10.1.2 Programi i Rezidencës "*Urat Kulturore*".	2027–29	• Rritja e numrit të projekteve të financuara/nisura (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Cilësia e prodhimit
11. Përmirësimi i aksesit kulturor përmes mjeteve digjitale dhe fizike. Shfrytëzimi i transformimit digjital si një mjet për përfshirjen kulturore, aksesin dhe pjesëmarrjen, duke kapërcyer barrierat ekonomike,	11.1 Ndërtimi i kornizës për institucionet kulturore në këtë fushë	11.1.1 Programi i Ndërtimit të Kapaciteteve Gjithëpërfshirëse	2026–27	• Rritja e përqindjes së institucioneve me programe vjetore gjithëpërfshirëse (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Ndërtimi i kapaciteteve
	11.2 Promovimi i aksesit universal dhe lëvizshmërisë inteligjente	11.2.1 Programi "Kultura në lëvizje"	2026–27	• Rritja e pjesëmarrjes kulturore në zonat rurale dhe të thella (+30% deri në vitin 2030).	Zhvillimi i audiencës
	11.3 Promovimi i pjesëmarrjes së audiencës dhe mbledhjes së burimeve nga publiku për të	11.3.1 Sinergjitë mes Trashëgimisë së Hapur dhe GLAM	2027–29	• Rritja e numrit të pjesëmarrësve në nismat e grumbullimit të kontributeve nga publiku (crowdsourcing) (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Cilësia e prodhimit

gjuhësore dhe fizike.	zbatuar dokumentacionin digjital dhe inventarët e trashëgimisë kulturore shqiptare				
12. Edukimi mbi ndërgjegjësimin kulturor dhe shoqëror	12.1 Integrimi i temave të përfshirjes dhe respektit kulturor në komunikim dhe në kurrikulat shkollore	12.1.1 Laboratori i Kurrikulave Gjithëpërfshirëse	2026-27	• Rritja e numrit të shkollave që integrojnë modulet e rishikuara kulturore gjithëpërfshirëse (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Cilësia e prodhimit
		12.1.2 Rrjeti Kombëtar i Qendrave Kulturore për Fëmijë	2027-29	• Rritja e numrit të qendrave kulturore për fëmijë të ngritura dhe që operojnë nën kuadrin kombëtar (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030). • Rritja e numrit të fëmijëve që marrin pjesë çdo vit në programet e qendrave, të ndarë sipas moshës, gjinisë dhe sfondit socio-ekonomik (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Zhvillimi i audiencës
		12.1.3 Edukimi përmes kulturës	2026-27	• Rritja e numrit të shkollave dhe klasave të përfshira në partneritete me institucionet kulturore (norma vjetore e rritjes, norma e rritjes 2026–2030).	Zhvillimi i audiencës

8. Financimi dhe operacionalizimi i strategjisë

Në këtë seksion, paraqiten treguesit financiarë dhe buxhetorë për zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë. Arsyetimi lidhet me përafrimin e Shqipërisë me investimet në kulturë dhe rekreacion të vendeve të BE-së.

8.1 Buxheti dhe arsyetimi financiar

Dimensioni financiar i Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2026–2030 është konceptuar për të siguruar si fizibilitetin ashtu edhe qëndrueshmërinë afatgjatë, duke i përafruar investimet kulturore të Shqipërisë me standardet evropiane. Strategjia bazohet në një vlerësim realist të shpenzimeve publike ekzistuese dhe në një rritje progresive të angazhimit të buxhetit të shtetit, ndërsa burimet e jashtme dhe plotësuese trajtohen si burime financimi të kushtëzuara që mund të mbështesin zbatimin aty ku ato janë të disponueshme.

Sipas Eurostat (2023), shpenzimet mesatare të shteteve anëtare të BE-së për rekreacion, kulturë dhe fe arrijnë në afërsisht 1.2% të PBB-së.



Në të kundërt, niveli i shpenzimeve publike në këtë sektor në vitet e kaluara në Shqipëri është rreth 0.3% - 0,5% e PBB-së, siç tregohet edhe në *Programin e Reformës Ekonomike të Shqipërisë 2025–2027*, i cili përcakton një diapazon të parashikuar midis 0.3% dhe 0.5% të PBB-së për shpenzimet kulturore dhe rekreative, ndër nivelet më të ulëta në Evropë (Berberi e Tummers 2025, f. 5).

Projektbuxheti i vitit 2026 për Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve pasqyron sa vijon:

- Buxheti total prej 7.4 miliardë lekësh për MTKS (+20% krahasuar me 2025)
- Kultura: 4.95 miliardë lekë, 67% e fondeve të Ministrisë, +19.4% krahasuar me vitin 2025
- Turizmi: 919 milionë lekë, në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit
- Sporti: 834.6 milionë lekë, +32% krahasuar me vitin e kaluar
- Rinia: 285.8 milionë lekë, për financimin e politikave rinore

Shoqëria civile, veçanërisht *Skena e Pavarur Kulturore* (SPK), ka argumentuar se kjo shifër është e pamjaftueshme dhe ka bërë thirrje për rritjen e shpenzimeve publike për kulturën në 2% të PBB-së. Raporti i Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit ka vënë në dukje ekzekutimin vazhdimisht të dobët të buxheteve të trashëgimisë kulturore, veçanërisht për ndërhyrjet kapitale, ku normat e shpërndarjes mbeten shumë të ulëta krahasuar me alokimet. Raportet gjithashtu theksojnë se planifikimi i buxhetit nuk ofron linja të qarta ose të dedikuara për pasuritë në Listën e Trashëgimisë Botërore, duke kufizuar transparencën dhe përparësitë efektive (KLSH, 2024). Në përputhje me detyrimet ndërkombëtare në fushën e trashëgimisë, të cilat vendosin përgjegjësinë parësore mbi shtetin, funksionet bazë të mbrojtjes së trashëgimisë kërkojnë financim publik të parashikueshëm dhe nuk duhet të varen nga ciklet konkurruese të projekteve, duke forcuar argumentin për një alokim bazë më të lartë nga Ministria e Financave.

Përfshirja e sektorit privat mbetet e kufizuar. Ligjet ekzistuese të sponsorizimit dhe instrumentet e PPP-ve në përgjithësi janë vlerësuar si joefektive për sektorin kult uror, për shkak të stimujve të dobët dhe mangësive në zbatim (Kern, 2018, f. 12). Kufizimet ligjore kombëtare janë identifikuar gjithashtu si penguese për aftësinë e Shqipërisë për të bashkëfinancuar projektet e *Creative Europe* (Kern, 2018, f. 15). Që atëherë, Shqipëria ka rritur pjesëmarrjen si partnere në projektet e Creative Europe, megjithëse lidershipi dhe kapaciteti i bashkëfinancimit vendas mbeten sfida të vazhdueshme. Ndërsa Shqipëria i afrohet integrimit në BE, sektori kulturor do të duhet gjithnjë e më shumë të përmbushë standardet administrative, financiare dhe të menaxhimit të projekteve të kërkuara nga programe të tilla si *Horizont Europe* dhe Creative Europe. Megjithëse do të nevojiteshin të dhëna më të fundit për të kapur plotësisht dinamikën aktuale, këto barriera strukturore ende përmenden shpesh në diskutimet mbi politikat.

Mospërputhja me vendet e tjera të BE-së nxjerr në pah në fakt nevojën për një rrugë të strukturuar dhe realiste të rritjes financiare. **Prandaj, Strategjia përcakton një objektiv afatmesëm për arritjen e 1-1,2% të PBB-së të dedikuar për kulturën dhe rekreacionin në planin afatgjatë**,- në përputhje me mesataren e BE-së dhe me shtete si Rumania dhe Bullgaria, por edhe Italia, duke identifikuar efektivisht dyfishimin e nivelit aktual të investimeve si një drejtim strategjik, dpër ta vendosur kështu Shqipërinë në një trajektore të qëndrueshme drejt mesatares evropiane.

Modeli financiar i Strategjisë është ndërtuar mbi tri rrjedha plotësuese financimi që sigurojnë si vazhdimësi ashtu edhe inovacion në financimin e sektorit:

1. **Fondet ekzistuese për kulturën**– që korrespondon me afërsisht 4 miliardë lekë në vit, që përfaqëson mesataren historike të alokimeve kombëtare për artet, kulturën dhe trashëgiminë. Këto burime do të ridrejtohen dhe racionalizohen pjesërisht për t'u përshtatur me prioritetet e reja strategjike dhe për të maksimizuar ndikimin e tyre.
2. **Shpërndarje të reja publike**– burime shtesë buxhetore që do të mobilizohen nga Ministria përgjegjëse për kulturën, veçanërisht në fazën fillestare të zbatimit (2026–2027), për të mbuluar forcimin institucional, projektet kryesore dhe investimet në infrastrukturë.
3. **Burime të jashtme dhe plotësuese**– duke përfshirë fondet ndërkombëtare, partneritetet publik-privat dhe mekanizmat e mbledhjes së fondeve. Këto do të shfrytëzojnë kontributet nga programet e BE-së dhe donatorët dypalësh, si dhe nismat e angazhimit të diasporës. Këto burime nuk janë pjesë e buxhetit bazë të garantuar dhe duhet të trajtohen si mbështetje shtesë që mund të jetë e disponueshme vetëm nëse plotësohen kushte specifike. Ato mund të përforcojnë Strategjinë, por nuk duhet të llogariten si financim plotësisht i siguruar apo automatik në buxhetin bazë.

Kostimi i detajuar i veprimeve dhe objektivave të Strategjisë, i paraqitur në tabelat e mëposhtme, është ndërtuar mbi skenarin progresiv, i cili shërben si trajektorja financiare e referimit të Strategjisë. Skenari bazë dhe ai optimal paraqiten si projeksione agregate alternative të shpenzimeve, të shprehura si përqindje e PBB-së, duke përshkruar ritme më të shpejta ose më të ngadalta të zbatimit, dhe jo si plane veprimi të kostuara veçmas. Në rast se aktivizohet ndonjëri prej skenarëve, alokimet në nivel veprimi do të rishpërndahen proporcionalisht, duke ndjekur hierarkinë e prioritizimit të përcaktuar në Seksionin 8.5.

Strategjia është e strukturuar rreth një rritjeje progresive të financimit publik për kulturën, duke u rritur nga 3.23 miliardë lekë në vitin 2026 në 4.24 miliardë lekë në vitin 2027, 5.32 miliardë lekë në vitin 2028, 6.29 miliardë lekë në vitin 2029 dhe 7.01 miliardë lekë në vitin 2030. Kjo trajektore reflekton një fuqizim të qëllimshëm të zërit buxhetor të kulturës brenda MTKS-së, duke siguruar që financimi të rritet në të njëjtin hap me zbatimin me faza të Strategjisë.

Sipas të dhënave financiare të siguruara nga Ministria, zbatimi i strategjisë aktualisht është i garantuar përmes alokimeve bazë nga Buxheti i Shtetit, me një vlerë totale prej 22,371,336,000 lekë gjatë periudhës 2026–2030. Ndërsa faza fillestare (2026–2027) mbulohet plotësisht nga burimet kombëtare - duke shfaqur një sufiçit strukturor fillestar në vitin 2027 - një hendek financiar progresiv shfaqet duke filluar nga viti 2028 teksa kërkesat e përgjithshme të strategjisë rriten. Kjo mungesë vjetore arrin në 862.20 milionë lekë në vitin 2028 dhe zgjerohet në 2.03 miliardë lekë deri në vitin 2030, duke rezultuar në një deficit të përgjithshëm kumulativ prej rreth 4.20 miliardë lekë gjatë tre viteve të fundit.

Për të garantuar zbatimin e plotë të të gjitha objektivave të planifikuara pa cenuar fushëveprimin e tyre, ky hendek financiar do të adresohet nëpërmjet:

- **Programeve të Financimit të BE-së & Donatorëve të Jashtëm:** Mobilizimit aktiv të burimeve nga grantet evropiane, kontributet e donatorëve ndërkombëtarë dhe kornizat e bashkëfinancimit.
- **Planifikimit Operacional Përshtatës:** Rikalibrimit dhe riprioritizimit periodik të aktiviteteve të projekteve për të harmonizuar afatet kohore të zbatimit me burimet e disponueshme.

Në vend që të mbështetet në një kosto vjetore fikse zbatimi, Strategjia parashikon një profil të diferencuar financimi përgjatë periudhës pesëvjeçare. Buxheti i shtetit mbetet burimi kryesor i mbështetjes, ndërsa instrumentet e BE-së, IPA III, Banka Botërore, bashkëpunimet dypalëshe dhe donacionet, mobilizohen në mënyrë selektive për të përforcuar veprimet prioritare, nismat pilot dhe nevojat për investime. Zbatimi do të bëhet me faza dhe do të harmonizohet me ciklin e programimit buxhetor afatmesëm për vitet 2027–2029, duke siguruar përputhshmërinë midis prioriteteve strategjike, planifikimit fiskal dhe procesit të negocimit të buxhetit vjetor.

Burimi i Financimit	Përshkrimi	Pjesa e vlerësuar (2030)
Fondet e rialokuara nga Buxheti i Shtetit	Një fond bazë prej afërsisht 4 miliardë lekësh në vit, i ridrejtuar drejt prioriteteve strategjike.	7 0%
Fondet Ndërkombëtare dhe të BE-së	Fondet e BE-së, IPA III, Banka Botërore dhe bashkëpunimi dypalësh i donatorëve.	15%
Kontribute private	Donacione, sponsorizime dhe mbledhje fondesh nga diaspora.	10%
Partneritetet Publiko-Private (PPP)	Investime të përbashkëta në infrastrukturën kulturore dhe qendrat e inovacionit.	5%

Referenca ndaj "fondeve ndërkombëtare dhe të BE-së" në tabelën e mësipërme duhet të konsiderohet si orientuese dhe jo si një burim i konfirmuar financimi. Konkretisht, aty ku skedat e veprimeve citojnë IPA III si burim, kjo i referohet një mbështetjeje të pritshme - duke përfshirë një projekt të propozuar binjakëzimi në fushën e kulturës (2025–2027, i vlerësuar në rreth 1 milion euro) - i cili ende nuk është miratuar zyrtarisht. Për rrjedhojë, ky dhe çdo instrument tjetër i BE-së në proces përgatitjeje do të konfirmohet, emërtohet dhe integrohet në buxhet vetëm pas miratimit zyrtar dhe nuk duhet të trajtohet si pjesë e bazës së financimit të garantuar.

Ndërsa alokimi vjetor për kulturën rritet, Strategjia bëhet në mënyrë progresive më e vetëqëndrueshme nga këndvështrimi i financave publike, ndërsa burimet e jashtme vazhdojnë të luajnë një rol plotësues dhe katalitik. Rrjedhimisht, funksioni i tyre nuk është të kompensojnë një kosto totale konstante, por të rrisin shtrirjen, cilësinë dhe përshpejtimin e zbatimit në përputhje me rritjen e angazhimit publik.

Zbatimi i Strategjisë parashikon një trajektore financiare progresive.

Faza 1: Nisja dhe zgjerimi (2026–2027)

Në dy vitet e para, Strategjia parashikon një rritje graduale të buxhetit vjetor kulturor nga 3.23 miliardë lekë në vitin 2026 në 4.24 miliardë lekë në vitin 2027. Kjo fazë ka për qëllim të mbështesë aktivizimin fillestar të programeve prioritare, forcimin institucional, masat për ngritjen e kapaciteteve dhe valën e parë të investimeve përgatitore dhe zbatuese.

Faza 2: Thellimi dhe konsolidimi (2028–2030)

Nga viti 2028 e në vazhdim, alokimi vjetor vazhdon të rritet në mënyrë progresive, duke arritur në 5.32 miliardë lekë në vitin 2028, 6.29 miliardë lekë në vitin 2029 dhe 7.01 miliardë lekë në vitin 2030. Në vend që të stabilizohet në një nivel fiks, buxheti zgjerohet hap pas hapi, duke i lejuar Strategjisë të thellojë zbatimin, të zgjerojë mbulimin e saj dhe të konsolidojë rezultatet në të gjithë sektorin.

8.2 Mekanizmat për qeverisje financiare dhe qëndrueshmëri

Deri në përfundim të zbatimit te Strategjisë, Ministria synon të arrijë:

- Një rritje progresive të shpenzimeve publike për kulturën dhe rekreacionin në 0.8% të PBB-së, duke rritur parashikimin e dhënë në Programin e Reformës Ekonomike të Shqipërisë 2025–2027 dhe në përputhje me trendet e BE-së. Mbajtja e buxhetit në një nivel më të ulët gjatë dy viteve të para të zbatimit krijon hapësirën e nevojshme institucionale për të avancuar negociatat për rritjen e buxhetit të MTKS-së paralelisht, si dhe për të siguruar kushtet për një alokim më të konsiderueshëm më vonë gjatë kohështrirjes së Strategjisë.

- Një buxhet kulturor prej rreth 7 miliardë lekësh deri në vitin 2030, me flukse financimi të diversifikuara dhe të qëndrueshme që garantojnë vazhdimësinë në vijim.

- Një sistem financimi i integruar, transparent dhe pjesëmarrës, që kombinon burimet shtetërore, ndërkombëtare dhe private nën një menaxhim strategjik koherent.

Përmes këtij modeli, Strategjia përcakton një rrugë pragmatike, por edhe ambicioze, drejt përforcimit financiar të ekosistemit kulturor të Shqipërisë. Ajo balancon rritjen me qëndrueshmërinë, mobilizon partnerë të ndryshëm dhe i përshtat shpenzimet publike kulturore të Shqipërisë me standardet evropiane të efikasitetit, transparencës dhe ndikimit social.

Për të siguruar transparencë, llogaridhënie dhe efikasitet në menaxhimin e burimeve, Strategjia prezanton një sërë instrumentesh plotësuese të qeverisjes financiare:

Mjete financiare të dedikuara

- Krijimi i një fondi për trashëgiminë (përforcimi i Fondit ekzistues të Trashëgimisë Kulturore të parashikuar në ligjin nr.27/2018, i ndryshuar dhe në VKM 737/2020, e ndryshuar) bashkimi i burimeve publike, private dhe ndërkombëtare, të synuara posaçërisht për financimin dhe funksionalizimin e strategjisë, që do të funksiononte si një fond barazimi dhe si një mjet për mbledhjen e donacioneve, i menaxhuar nga një bord drejtues brenda Ministrisë.

- Rikrijimi i një Këshilli për Artin me fokus mbledhjen dhe rishpërndarjen e fondeve. Këshilli i Artit do të përcaktohet qartë si një entitet që funksionon nën MTKS, por i pajisur me autonomi që i mundëson të sigurojë fonde nga burime të shumëfishta: buxheti i Ministrisë, sponsorizimet , kursimet e gjeneruara nga procedurat e prokurimit publik, donacione dhe fonde ndërkombëtare. Shih veprimin 8.2.2 Këshilli i Artit në Dokumentin e Veprimeve të Detajuara.

Këta mekanizma do të prezantohen në mënyrë progresive, duke lënë hapësirë për negociata për të përcaktuar procedurat e financimit, rregullimet institucionale dhe rregullat operacionale përpara zbatimit të plotë. Masa të tilla do të vihen në zbatim vetëm pas vlerësimit teknik të qëndrueshmërisë së tyre financiare, realizueshmërisë institucionale dhe përputhshmërisë me rregullat përkatëse kombëtare dhe të BE-së.

Mekanizma angazhimi të sektorit privat dhe qytetarëve

Në një skenar zbatimi progresiv, mekanizmat e financimit që përfshijnë kontributin privat do të kishin kohën e nevojshme për t'u negociuar siç duhet dhe më pas për t'u prezantuar gradualisht në praktikë, duke u mundësuar palëve përkatëse të vlerësojnë realizueshmërinë, pranueshmërinë dhe efektivitetin e tyre aktual përpara aplikimit në shkallë të plotë, falë një vlerësimi teknik të qëndrueshmërisë financiare, realizueshmërisë institucionale dhe përputhshmërisë me rregullat përkatëse kombëtare dhe të BE-së. Megjithatë, ata mbeten thelbësorë sepse edhe në nivel ndërkombëtar kultura po financohet gjithnjë e më shumë përmes një kombinimi të burimeve publike dhe private, duke qenë se financimi publik në vetvete rezulton i pamjaftueshëm. Në të gjithë Evropën, janë përdorur incentiva të dedikuara për sektorë specifikë, si trashëgimia dhe performanca e gjallë, si dhe për trajtimin fiskal të donacioneve dhe sponsorizimeve, duke përfshirë modele si "*Art Bonus*" në Itali. Inçentiva të tilla nuk kanë vetëm një efekt ekonomik mbi sektorin; ato gjithashtu ndihmojnë në ndërtimin e një ndjenje të përbashkët të përgjegjësisë dhe pjesëmarrjes kulturore. Për më tepër, në shumë raste ato nuk përfaqësojnë të ardhura që shteti do t'i arkëtonte plotësisht në rrethana të tjera, sepse ato shuma shpesh do të alokoheshin diku tjetër brenda buxheteve private ose korporative.

Autonomia institucionale dhe të ardhurat tregtare:
Një burim shtesë të ardhurash mund të vijë nga rritja e shkallës së autonomisë operacionale të muzeve, e lidhur gjithashtu me rishikimin e politikave të çmimeve të biletave dhe me mundësinë për ofrimin e shërbimeve me karakter tregtar. Forcimi i autonomisë institucionale, siç parashikohet në Veprimet 2.2.1 Modernizimi i sistemit muzeor dhe 4.2.1 Financimi i qëndrueshëm i trashëgimisë, do t'u mundësonte muzeve të mbajnë dhe të riinvestojnë në mënyrë strategjike të ardhurat e gjeneruara nga burime të diversifikuara, përfshirë tarifa hyrjeje të diferencuara për rezidentët vendas

dhe turistët ndërkombëtarë; dhënien me qira të hapësirave për aktivitete private (si evente korporative, xhirime filmike etj); shërbime projektimi dhe huadhënie ekspozitash brenda dhe jashtë vendit; tregtim produktesh përmes dyqaneve muzeore; shërbimesh kateringu; licencim të përmbajtjeve digjitale dhe riprodhimeve; programe edukative të specializuara. Kalimi nga një model i centralizuar i përqëndrimit të të ardhurave drejt një kuadri të menaxhimit financiar autonom do t'u mundësonte institucioneve të reagojnë në mënyrë dinamike ndaj mundësive të tregut, të investojnë në përmirësimin e cilësisë dhe të zhvillojnë modele biznesi të qëndrueshme që plotësojnë financimin publik, duke garantuar njëkohësisht akses të barabartë për qytetarët shqiptarë (shih Veprimin 9.2.2 Karta Universale Vjetore e Aksesit në Muze)

Qasje e balancuar ndaj çmimit të biletave: Duke marrë në konsideratë diferencën aktuale të fuqisë blerëse midis qytetarëve shqiptarë dhe atyre evropianë, si dhe synimin për të ruajtur akses të gjerë në pjesëmarrjen kulturore, rekomandohet që zhvillimi i këtij burimi të ardhurash të balancohet me instrumente aksesi falas për qytetarët. Kjo qasje mbështetet edhe nga fakti se të ardhurat nga biletat mbulojnë vetëm një pjesë të kufizuar të nevojave operacionale të institucioneve kulturore në shumicën e konteksteve ndërkombëtare. Edhe muzetë me numër të lartë vizitorësh zakonisht sigurojnë vetëm 15–30% të të ardhurave totale nga tarifat e hyrjes. Për këtë arsye, politikat e çmimeve duhet të kalibrohen me kujdes për të plotësuar, dhe jo për të zëvendësuar, financimin publik. Paralelisht, duhet të zbatohen instrumente si Karta Universale Vjetore e Aksesit në Muze (Veprimi 9.2.2); ditë me hyrje falas; programe të targetuara për grupet në nevojë.

Këta mekanizma synojnë heqjen e barrierave ekonomike për pjesëmarrjen kulturore të rezidentëve shqiptarë, paga mesatare mujore prej rreth 860 euro e bën edhe një tarifë modeste hyrjeje një shpenzim të ndjeshëm për familjet, ndërkohë që u mundësojnë institucioneve të gjenerojnë të ardhura plotësuese të konsiderueshme nga turistët ndërkombëtarë me fuqi blerëse më të lartë.

Ky model i balancuar siguron që optimizimi i të ardhurave të mos cenojë angazhimin themelor të Strategjisë për barazi territoriale, përfshirje sociale dhe demokratizim të aksesit në trashëgiminë kulturore dhe krijimtarinë bashkëkohore. Pas një pilotimi fillestar në sektorin muzeor, kjo qasje mund të shtrihet edhe në artet skenike dhe prodhime të tjera kulturore, duke përshtatur parimet e çmimeve të diferencuara, mbajtjes së të ardhurave dhe aksesit të barabartë në teatro, salla koncertesh, festivale dhe forma të tjera programimi kulturor.

Menaxhimi, Monitorimi dhe Ndërtimi i Kapaciteteve:

- Integrimi i mjeteve të monitorimit financiar brenda sistemeve të menaxhimit të Ministrisë për të siguruar ndjekjen e buxhetit në kohë reale dhe vlerësimin e ndikimit.

- Programet e ngritjes së kapaciteteve për institucionet dhe profesionistët në sektorin e kulturës në mbledhjen e fondeve, menaxhimin e projekteve dhe qeverisjen financiare.
- Përforcimi i skemave transparente dhe konkurruese të granteve, të arritshme si për institucionet publike ashtu edhe për operatorët e pavarur.

8.2.1 Operacionalizimi i strategjisë

Për të operacionalizuar në mënyrë efektive Strategjinë dhe për të finalizuar kornizën e saj financiare, Ministria përgjegjëse për kulturën do të ngrejë një grup pune përgjegjëse për strategjinë, e cila do tëkoordinoj me stafin e Ministrisë, dhe do të lehtësojë zhvillimin e projekteve ekzekutive të shoqëruara me një analizë të thelluar të kapitujve të shpenzimeve, personelit institucional dhe strukturave të kostos. Ky proces do të fillojë me një hartëzim të detajuar të përbërjes aktuale të shpenzimeve, duke identifikuar shpërndarjen aktuale për program, institucion dhe funksion brenda mandatit kulturor të Ministrisë. Bazuar në këtë fazë diagnostikuese, do të ndërmerret një analizë gjithëpërfshirëse kosto-përfitim për të harmonizuar burimet e disponueshme me prioritetet strategjike dhe për të përcaktuar kërkesat realiste të financimit për çdo fushë politike.

Me qëllim parametrizimin e alokimit të burimeve duke marrë parasysh investimet dhe shpenzimet sipas zonës gjeografike, me synim korrigjimin e disekuilibrave ndërmjet Tiranës dhe pjesës tjetër të vendit, rekomandohet që, gjatë fazës së planifikimit ekzekutiv, të merren në konsideratë parametra të tillë si dendësia e popullsisë, dendësia dhe ekspozimi ndaj rrezikut i aseteve të trashëgimisë kulturore (përfshirë cenueshmërinë sizmike dhe klimatike), prania e grupeve minoritare, përqindja e personave nën 18 vjeç në popullsinë totale, përqendrimi i ndërmarrjeve të industrive kulturore dhe krijuese, si dhe vëllimi i turistëve për çdo territor. Kjo do të bënte funksionalë mekanizmat e kuotave territoriale të parashikuara tashmë si një masë zbutëse për përqendrimin asimetrik të burimeve, duke ndihmuar në alokimin më efektiv të fondeve në përgjigje të boshllëqeve dhe nevojave specifike që karakterizojnë secilën zonë.

Planet ekzekutive do të shërbejnë si skema operative, duke ofruar qartësi mbi nevojat buxhetore, afatet kohore të zbatimit dhe fitimet e mundshme në efikasitet. Ato gjithashtu do të mbështesin negociatat buxhetore të bazuara në prova me Ministrinë e Financave dhe do të lehtësojnë integrimin e kulturës në planifikimin më të gjerë ekonomik kombëtar.

Këto mekanizma synojnë të krijojnë një ekosistem financiar të qëndrueshëm për kulturën, një ekosistem që promovon inovacionin, shfrytëzon kapitalin privat dhe siguron investim afatgjatë kulturor të harmonizuar me kornizat e financimit të BE-së.

Njësia do të përgatisë dhe botojë raporte vjetore zbatimi që mbulojnë progresin në të gjitha prioritetet strategjike, objektivat dhe veprimet. Këto raporte do të përfshijnë:

- Të dhëna sasiore të performancës kundrejt treguesve kryesorë të performancës (KPI) të përcaktuar në fletët e veprimit dhe planin e monitorimit (Shtojca "Veprimet e Detajuara");
- Të dhëna të ekzekutimit financiar për çdo fushë prioritare, veprim dhe burim financimi, të ndara sipas rajonit dhe kategorisë së përfituesit (duke përfshirë sektorin e pavarur, institucionet, bashkitë, etj.);
- Vlerësim cilësor të arritjeve, sfidave dhe mësimeve të nxjerra gjatë periudhës raportuese;
- Të dhëna mbi shpërndarjen territoriale të investimeve kulturore, duke treguar përqindjen e fondeve të alokuara jashtë Tiranës dhe në 12 qarqet;
- Metrika të përfshirjes sociale, duke përfshirë numrin e përfituesve të Statusit të Artistit, shkallët e pjesëmarrjes nga grupet vulnerabël dhe përmirësimet e aksesueshmërisë;
- Progres mbi reformat ndërsektoriale, si operacionalizimi i Fondit të Trashëgimisë, Këshillit të Artit, stimujve fiskalë dhe mekanizmave të alokimit të të ardhurave nga turizmi.

Raportet vjetore do të hartohen në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit të Integuar të Politikave (GMIP), departamentet përkatëse brenda MTKS-së dhe institucionet kulturore, me Agjencinë Shtetërore për Mbështetjen dhe Promovimin e Programeve dhe Politikave të Zhvillimit (SASPAC), në rolin e saj si Sekretariat Teknik i GMIP-it, përgjegjëse për validimin e raporteve përpara dorëzimit të tyre, dhe do të bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë dhe përmes kanaleve zyrtare të komunikimit, duke siguruar akses të gjerë për palët e interesuara dhe qytetarët.

Në përputhje me praktikat e mira të qeverisjes dhe angazhimet e Shqipërisë në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE, raportet vjetore të zbatimit dhe ekzekutimi i përgjithshëm financiar i Strategjisë do të jenë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH). Përveç mbikëqyrjes institucionale, Strategjia do të promovojë mekanizma të monitorimit të bazuar në pjesëmarrje që përfshijnë organizatat e shoqërisë civile, shoqatat profesionale, skenën e pavarur kulturore dhe përfaqësues të qeverisë vendore. Një forum periodik konsultimi me palët e interesuara do të organizohet nga Ministria përgjegjëse kulturunën për të rishikuar progresin, për të diskutuar sfidat dhe për të mbledhur kontribute për menaxhimin e përshtatur dhe finalizimin e politikave.

Kjo kornizë shumështresore e llogaridhënies siguron që Strategjia të mbetet jo vetëm një dokument politike, por një udhërrëfyes i gjallë, transparent dhe i përbashkët për zhvillimin kulturor të Shqipërisë.



8.3 Buxheti i aktiviteteve

Në lidhje me buxhetin paraprak të veprimeve, gjatë analizës së punës u përgatitën 3 skenare: një skenar bazë, i kalibruar sipas buxhetit paraprak 2026 për kulturën, i zbatuar në mënyrë uniforme në çdo vit; një skenar progresiv, që fillon në vitin 2026 me buxhetin aktual dhe rritet në mënyrë lineare deri në 1-1.2% të PBB-së në vitin 2030; një skenar optimal, i barabartë me 1-1.2% të PBB-së që nga viti 2026. Strategjia është kostuar kundrejt një trajektoreje të vetme referimi, skenarit progresiv.

Skenari progresiv parashikon një rritje graduale të shpenzimeve publike për kulturën drejt 0,8-1% të PBB-së duke filluar nga viti 2026, në përputhje me nivelin mesatar të shpenzimeve kulturore në BE. Zbatimi i tij kërkon një zgjerim të qëndrueshëm të burimeve të MTKS-së si përmes alokimeve kombëtare ashtu edhe përmes aftësisë për të mobilizuar financimet evropiane, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe kontributet private të mbështetura nga masat dhe inçentivat fiskale. Në këtë kuadër, financimi rritet hap pas hapi përgjatë periudhës së strategjisë, në vend të një rritjeje të vetme të menjëhershme, duke e mbajtur nën kontroll buxhetin e nevojshëm publik ndërkohë që sistemi përthith gradualisht burime shtesë.

Nën këtë strukturë, totali vjetor rritet në mënyrë progresive nga rreth 3.23 miliardë lekë në vitin 2026 në 7.01 miliardë lekë në vitin 2030. Shpërndarja e burimeve mbetet e orientuar fuqimisht drejt investimeve strukturore, veçanërisht infrastrukturës së prodhimit kulturor sipas Veprimit 8.2.1, ruajtjes së trashëgimisë, modernizimit të muzeve dhe programeve të përfshirjes dhe pjesëmarrjes.

Ky konfigurim maksimizon potencialin transformues sepse lejon progres të njëkohshëm në reformën institucionale, infrastrukturë, digjitalizim, barazinë

territoriale dhe përfshirjen sociale, duke shmangur presionin e menjëhershëm fiskal dhe duke ruajtur hapësirën për negocim, përshtatje dhe zbatim me faza.

Të tre skenarët ruajnë të njëjtat prioritete relative ndërmjet mbrojtjes së trashëgimisë, industrive krijuese, infrastrukturës dhe programeve të përfshirjes, ndaj mund të interpretohen si ritme alternative zbatimi dhe jo si zgjedhje thelbësisht të ndryshme politike:

- Skenari optimal përfaqëson zbatimin e plotë të Strategjisë sipas projektimit fillestar, me mbulim maksimal dhe potencial transformues, i kushtëzuar nga një angazhim i fortë fiskal.
- Skenari bazë përshkruan një rrugë me "*prag minimal zbatueshmërie*", në të cilën Strategjia zbatohet me intensitet të reduktuar, duke nënkuptuar afate më të gjata dhe prioritarizim më selektiv të veprimeve.
- Skenari progresiv ofron një qasje reformash të sekuencuara, duke përputhur kurbën e të nxënit dhe të ndërtimit institucional me një rritje të parashikueshme të burimeve, dhe është veçanërisht i përshtatshëm si bazë negocimi me Ministrinë e Financave dhe partnerët ndërkombëtarë.

Theksohet se për qëllime të zbatimit dhe buxhetimit, veprimet do të klasifikohen si të financuara plotësisht nga shteti, të bashkëfinancuara me bashkitë, ose të zbatuara vetëm me pjesëmarrjen e bashkive. Në pjesën dërrmuese të rasteve, bashkitë përfshihen vetëm në nivelin e zbatimit, përveç rasteve kur një skedë veprimi parashikon shprehimisht një kontribut financiar. Çdo masë që përfshin bashkëfinancim nga bashkitë ose detyrime specifike për njësitë e vetëqeverisjes vendore, do t'i nënshtrohet konsultimit paraprak dhe dakordësisë me bashkitë përkatëse, në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*".

Rreziqet kryesore:

Presion i lartë makrofiskal dhe kosto oportuniteti. Kalimi i menjëhershëm në nivelin 1–1.2% të PBB-së nënkupton një buxhet vjetor prej rreth 7.0 miliardë lekësh që në fillim, një rritje e ndjeshme krahasuar me nivelet aktuale dhe projektbuxhetin e MTKS-së për vitin 2025. Kjo mund të ushtrojë presion mbi hapësirën fiskale, veçanërisht nëse rritja e të ardhurave ngadalësohet ose nëse sektorë të tjerë prioritarë (shëndetësia, arsimi, mbrojtja sociale) kërkojnë burime shtesë të konsiderueshme.

Rrezik i lartë përthithjeje dhe ekzekutimi. Një rritje e shpejtë dhe në shkallë të gjerë e shpenzimeve për kulturën mund të tejkalojë kapacitetet ekzistuese administrative, teknike dhe menaxheriale, duke çuar në nënzbatim të ngjashëm me atë të vërejtur në disa programe kapitale të trashëgimisë. Ekziston rreziku i raportit të ulët kosto–përfitim, përzgjedhjes së nxituar të projekteve dhe shpenzimeve joefikase, nëse institucionet nuk janë të përgatitura për të menaxhuar buxhete më të mëdha.

Varësi nga financime të jashtme dhe private jo të garantuara. Edhe pse 70% e kostos vjetore të vlerësuar të Strategjisë pritet të mbulohet nga shteti, arritja e nivelit të plotë të skenarit optimal mbështetet gjithashtu në kontributet e BE-së, donatorëve dhe sektorit privat. Nëse këto burime nuk materializohen në shkallën e parashikuar, shteti mund të detyrohet të kompensojë mungesën, duke rritur rrezikun fiskal, ose alternativisht të reduktojë veprimet e planifikuara gjatë ciklit.

Rrezik politik dhe social nëse pritshmëritë nuk përputhen me rezultatet. Një nivel i lartë shpenzimesh krijon pritshmëri të mëdha tek operatorët kulturorë dhe qytetarët. Nëse zbatimi vonohet ose fondet mbeten të paekzekutuara, kjo mund të çojë në pakënaqësi dhe kritika për keqmenaxhim ose shpërdorim të burimeve, duke dobësuar mbështetjen politike për investimin në kulturë.

Rrezik i shpërndarjes së pabalancuar brenda sektorit. Projekte të mëdha infrastrukturore dhe iniciativa me dukshmëri të lartë mund të margjinalizojnë nisma më të vogla, komunitare ose eksperimentale, pavarësisht synimit të Strategjisë për të ruajtur balancën ndërmjet trashëgimisë, industrive krijuese, përfshirjes dhe barazisë territoriale.

Masat zbutëse:

Rritje graduale operacionale brenda kuadrit optimal. Edhe nëse alokimi 1–1.2% i PBB-së sigurohet që nga viti 2026, zbatimi duhet të parashikojë çlirimin e fondeve në mënyrë të shkallëzuar, duke lidhur disbursimet me gatishmërinë e projekteve dhe kapacitetin institucional.

Paraprirje e investimeve në forcimin institucional, reforma rregullatore dhe ndërtim kapacitetesh, e ndjekur nga një rritje e fazuar e disbursimeve kapitale dhe programore.

Forcim i kuadrit të llogaridhënies dhe performancës. Vendosja e kontratave të qarta performance ndërmjet MTKS-së dhe institucioneve përfituese, me tregues të matshëm për rezultatet dhe produktet në linjat kryesore buxhetore (trashëgimia, infrastruktura, grantet, digjitalizimi).

Rritje e rolit të auditimit të jashtëm, vlerësimit të pavarur dhe raportimit publik (përfshirë site të Trashëgimisë Botërore dhe mbështetjen për skenën e pavarur), duke adresuar mangësitë e evidentuara nga organet kombëtare të mbikëqyrjes.

Vlerësim dhe përzgjedhje rigoroze e projekteve. Zbatim i analizave të plota kosto–përfitim dhe vlerësimeve të ndikimit socio-kulturor për projektet e mëdha, duke prioritarizuar ato që kontribuojnë më shumë në përafrimin me BE-në, kohezionin territorial dhe përfshirjen. Forcim i standardeve teknike dhe i studimeve të parafizibilitetit për të reduktuar vonesat dhe rikonceptimet gjatë zbatimit.

Thellim i instrumenteve të lidhura me sektorin privat dhe turizmin. Përshpejtim i futjes së stimujve fiskalë, skemave të sponsorizimit dhe dedikimit të një pjese të taksës së turizmit për Fondin e Trashëgimisë, me synim diversifikimin e burimeve dhe uljen graduale të presionit mbi buxhetin e shtetit.

Sigurim i mbështetjes së balancuar ndërmjet nën-sektorëve dhe territoreve. Ruajtje e objektivave të qarta të alokimit për mbështetjen e skenës së pavarur, programet e përfshirjes dhe zonat rurale apo të thella, për të shmangur përqendrimin e tepruar të burimeve në disa projekte të mëdha infrastrukturore ose të centralizuara.

8.4 Dispozita buxhetore

Parashikimet financiare dhe alokimet në nivel veprimi të paraqitura në këtë seksion janë përllogaritur mbi bazën e skenarit progresiv, i cili shërben si trajektorja financiare referuese e Strategjisë, duke u rritur gradualisht nga 0.4% drejt 1–1.2% të PBB-së gjatë periudhës 2026–2030. Skenari bazë (0.4% e PBB-së) dhe skenari optimal (1% e PBB-së nga viti 2026 e në vazhdim) përfaqësojnë projeksione alternative të shpenzimeve agregate dhe jo buxhete të detajuara veçmas në nivel veprimi; në rast se ndonjëri prej tyre aktivizohet gjatë fazës së zbatimit, alokimet në tabelat e mëposhtme do të rishikohen në mënyrë proporcionale, në përputhje me kriteret e prioritizimit të përcaktuara në Seksionin 8.5.

Në të tre skenarët, projeksionet janë ndërtuar mbi një supozim konservator të një PBB-je të qëndrueshme gjatë periudhës 2026–2030. Duke marrë parasysh pasigurinë aktuale ekonomike dhe politike globale, si dhe luhatshmërinë e parashikimeve të rritjes, është vendosur të mos përfshihen skenarë optimistë të rritjes së PBB-së, por modeli të ankorohet në një bazë me PBB konstante.

Kjo zgjedhje pasqyron një qasje të kujdesshme : ajo redukton rrezikun e mbivlerësimit të hapësirës fiskale për kulturën dhe siguron që objektivat e shpenzimeve të shprehura si përqindje e PBB-së të mbeten të besueshme edhe në kushte makroekonomike të pafavorshme.

Projeksionet financiare të paraqitura në këto tabela janë llogaritur mbi bazën e:

- Analizës së të dhënave të shpenzimeve të MTKS-së: Alokimi buxhetor mbështetet në një rishikim të plotë të llojeve të ndryshme të shpenzimeve që aktualisht menaxhohen nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, duke garantuar vazhdimësi dhe koherencë me flukset ekzistuese të burimeve.

- Analizës krahasuese të kostove: Vlerësimet bazohen në kostot e veprimeve të ngjashme të ndërmarra në nivel kombëtar ose rajonal nga vende të tjera, duke përshtatur praktikat më të mira dhe duke krahasuar shkallën e investimeve me kontekstin shqiptar.
- Vlerësimit të kostove të punës: Llogaritjet marrin në konsideratë nivelin e kostos së punës në Shqipëri, me vëmendje të veçantë ndaj kompetencave dhe profileve profesionale të nevojshme për zbatimin efektiv të secilit veprim.
- Logjikës së investimit të fazuar: Alokimi pasqyron nevojën për shpenzime më të larta në fazën e nisjes së disa veprimeve dhe në fazën e konsolidimit të të tjerave, në përputhje me afatet dhe piketat e zbatimit të përshkruara në fletët individuale të veprimeve.

Theksohet se për qëllime të zbatimit dhe buxhetimit, veprimet do të klasifikohen si të financuara plotësisht nga shteti, të bashkëfinancuara me bashkitë, ose të zbatuara vetëm me pjesëmarrjen e bashkive. Në pjesën dërrmuese të rasteve, bashkitë përfshihen vetëm në nivelin e zbatimit, përveç rasteve kur një skedë veprimi parashikon shprehimisht një kontribut financiar. Çdo masë që përfshin bashkëfinancim nga bashkitë ose detyrime specifike për njësitë e vetëqeverisjes vendore, do t'i nënshtrohet konsultimit paraprak dhe dakordësisë me bashkitë përkatëse, në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*".

Skenari progresiv[1]

Objektivat	Nr.	Veprimet	2026	2027	2028	2029	2030	Burimi
1.1 Forcimi i kornizës sociale, institucional dhe planifikues për mbrojtjen e trashëgimisë.	**1.1.1**	**Korniza e mbrojtjes së trashëgimisë**	175.000.000	231.250.000	287.500.000	343.750.000	350.000.000	MTKS
1.2 Përmirësimi i konservimit, gatishmërisë ndaj riskut dhe qëndrueshmërisë ndaj klimës	**1.2.1**	**Konservimi i adaptueshëm**	153.125.000	202.343.750	251.562.500	300.781.250	350.000.000	MTKS; Fondi Publik për Përgatitjen ndaj Rrezikut; fondet kombëtare të përshtatjes ndaj klimës; programet e mbrojtjes civile dhe të rrezikut nga fatkeqësitë e BE-së; bashkëpunimi dypalësh në qëndrueshmërinë e trashëgimisë
1.3 Mbrojtja dhe transmetimi i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (TKJ)	**1.3.1**	**Mbrojtja e TKJ-së**	65.625.000	86.718.750	107.812.500	128.906.250	150.000.000	MTKS; Fondi i mundshëm i UNESCO-s për TKJ; bashkefinancim me NJVV; partneritete me OJQ-të dhe organizatat me bazë komunitare

[1] *Referencat për fondet e BE-së, programet e BE-së ose IPA III në këtë tabelë janë orientuese për kategorinë e mbështetjes së jashtme të pritshme dhe nuk përbëjnë një angazhim financimi të konfirmuar apo të miratuar. Instrumentet, thirrjet ose projektet specifike – përfshirë këtu çdo projekt të pritshëm binjakëzimi të IPA III në fushën e kulturës – do të emërtohen dhe integrohen në buxhet vetëm pas miratimit të tyre zyrtar, në përputhje me sqarimin e dhënë në Seksionin 8.1.*

2.1 Ndërtimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale në sektorin e trashëgimisë dhe muzeve.	**2.1.1**	**Ndërtimi i kapaciteteve në të gjithë sektorin**	131.250.000	173.437.500	215.625.000	257.812.500	280.000.000	MTKS; fondet kombëtare të trashëgimisë; programet e bashkëpunimit dypalësh dhe rajonal; partneritetet me universitetet dhe institutet kërkimore; kontributet e donatorëve për ndërtimin e kapaciteteve dhe kërkimin.
2.2 Modernizimi i sistemit muzeor dhe promovimi i përsosmërisë	**2.2.1**	**Modernizimi i sistemit muzeor**	153.125.000	202.343.750	251.562.500	300.781.250	350.000.000	MTKS; fondet kombëtare të zhvillimit kulturor; programet e BE-së për qeverisjen kulturore dhe ndërtimin e kapaciteteve; bashkëpunimi kulturor dypalësh; partneritetet me universitetet dhe institucionet e trajnimit
2.3 Forcimi i dokumentacionit dhe inventarëve digjitalë përmes platformës kombëtare DIGIT AL HERITAGE	**2.3.1**	**Platforma DIGIT AL HERITAGE**	35.000.000	52.031.250	107.812.500	128.906.250	150.000.000	MTKS
	2.3.2	**Akademia Digjitale GLAM**	39.375.000	52.031.250	35.937.500	-	-	MTKS
3.1 Integrimi i trashëgimisë në kornizat kombëtare dhe lokale të zhvillimit.	**3.1.1**	**Integrimi i trashëgimisë në planifikimin e zhvillimit**	39.375.000	52.031.250	86.250.000	103.125.000	150.000.000	MTKS
3.2 Promovimi i turizmit të qëndrueshëm kulturor	**3.2.1**	**Turizëm kulturor i qëndrueshëm**	13.125.000	17.343.750	35.937.500	60.156.250	80.000.000	MTKS
3.3 Mbështetja e ekonomive krijuese dhe kulturore të bazuara në trashëgimi	**3.3.1**	**Platforma e Inovacionit në Trashëgimi dhe e Sipërmarrjes Krijuese**	13.125.000	17.343.750	35.937.500	60.156.250	80.000.000	MTKS; programet e BE-së; investimet private; partneritetet publik-privat; mikrofinancat dhe fondet me ndikim social
3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së komunitetit, të drejtave kulturore dhe kujdesit të përbashkët	**3.4.1**	**Pjesëmarrja komunitare dhe kujdestaria e përbashkët**	21.875.000	28.906.250	71.875.000	128.906.250	150.000.000	MTKS
4.1 Modernizimi i sistemeve kombëtare të qeverisjes dhe menaxhimit të trashëgimisë.	**4.1.1**	**Sistemet e Menaxhimit të Trashëgimisë**	21.875.000	28.906.250	35.937.500	42.968.750	50.000.000	MTKS
4.2 Vendosja e mekanizmave të qëndrueshëm të financimit për trashëgiminë	**4.2.1**	**Financimi i qëndrueshëm i trashëgimisë**	21.875.000	28.906.250	35.937.500	42.968.750	50.000.000	MTKS

4.3 Promovimi i inovacionit dhe partneriteteve ndërsektoriale	**4.3.1**	**Inovacion dhe partneritete**	21.875.000	28.906.250	35.937.500	42.968.750	50.000.000	MTKS; fondet për kërkim dhe inovacion të ndara përmes thirrjeve kombëtare; bashkëfinancim nga universitetet pjesëmarrëse, institucionet kërkimore dhe partnerët e industrisë kulturore dhe krijuese; burime shtesë financimi që do të përcaktohen gjatë zbatimit.
4.4 Zhvillimi i të dhënave, statistikave dhe treguesve të ndikimit të trashëgimisë kombëtare	**4.4.1**	**NJOHURITË DIGITALAL**	52.500.000	69.375.000	86.250.000	103.125.000	120.000.000	MTKS; alokimet për statistikat kombëtare dhe sistemet e trashëgimisë digjitale; bashkëfinancimi nga institucionet e trashëgimisë që marrin pjesë në integrimin e të dhënave; dhe burime shtesë financimi që do të përcaktohen gjatë zbatimit për zhvillimin e analizave dhe mirëmbajtjen e sistemit.

5.1 Krijimi i një kuadri të përshtatshëm ligjor (njohja e statusit të artistit)	**5.1.1**	**Korniza Ligjore**	87.500.000	57.812.500	35.938.000	-	-	Buxheti kombëtar (MTK dhe MF) Ndihma teknike e BE-së (IPA III, Creative Europe) Programet e politikave kulturore të UNESCO-s dhe Këshillit të Evropës Partneritetet e sektorit privat dhe skemat e sponsorizimit
5.2 Ngritja e programeve të mbështetjes financiare dhe politikave fiskale të favorshme	**5.2.1**	**Reforma e Sistemit të Integruar të Granteve**	21.875.000	28.906.250	71.875.000	128.906.250	150.000.000	MTKS, Donatorë të ndryshwm
	5.2.2	**Stimuj për Investime Kulturore**	87.500.000	115.625.000	215.625.000	257.812.500	280.000.000	Ndarjet buxhetore kombëtare për kulturën dhe nismat e reformës fiskale Financimet e BE-së (Creative Europe, IPA III, Horizon Europe) Programet ndërkombëtare të zhvillimit (UNESCO, BERZH, OECD, IFC) Partneritetet e sektorit privat dhe kontributet filantropike

5.3 Nxitja e bashkëpunimit midis bizneseve kulturore dhe sektorëve të tjerë prodhues	**5.3.1**	**Art dhe Zeje – Dizajnuar në Shqipëri Programi Kombëtar për Mjeshtritë Artistike, Traditat e Gjalla dhe Eksportit Krijues**	13.125.000	17.343.750	71.875.000	128.906.250	150.000.000	MTKS, financim dypalësh dhe mbështetje plotësuese nga partnerë dhe donatorë ndërkombëtarë (BE, UNESCO, projekte dypalëshe etj.).
5.3 Nxitja e bashkëpunimit midis bizneseve kulturore dhe sektorëve të tjerë prodhues	**5.3.2**	**Zërat shqiptarë: Programi i integrimit mes shërbimeve vizuale/të komunikimit dhe prodhimeve krijuese.**	13.125.000	17.343.750	71.875.000	128.906.250	150.000.000	MTKS, bashkëfinancim me NJVV dhe mbështetje plotësuese nga partnerë dhe donatorë ndërkombëtarë (BE, UNESCO, projekte dypalëshe etj.).
5.4 Përmirësimi i aksesit në rrjetet e kreditit dhe investimeve	**5.4.1**	**Instrumenti i Garancisë së Investimeve Kulturore**	13.125.000	17.343.750	57.500.000	103.125.000	125.000.000	Kapitalet bankare dhe financiare
5.4 Përmirësimi i aksesit në rrjetet e kreditit dhe investimeve	**5.4.2**	**Engjëjt e Biznesit Kulturor dhe Rrjeti i Sipërmarrjeve**	13.125.000	17.343.750	57.500.000	85.937.500	100.000.000	Programi i Creative Europe për skemën
5.4 Përmirësimi i aksesit në rrjetet e kreditit dhe investimeve	**5.4.3**	**Bonus krijues**	65.625.000	86.718.750	107.812.500	128.906.250	150.000.000	MTKS

6.1 Mundësimi i një ekosistemi bashkëpunues kulturor dhe krijues	**6.1.1**	**AL CLOUD**	21.875.000	28.906.250	107.812.500	214.843.750	230.000.000	MTKS; fondet kombëtare të digjitalizimit; programet e BE-së për inovacion krijues dhe digjital; partneritetet me ofruesit e teknologjisë; skemat e granteve që mbështesin prodhimin kulturor digjital
	6.1.2	**Akademia Digjitale e IKK-së**	21.875.000	28.906.250	35.937.500	42.968.750	50.000.000	MTKS; fondet kombëtare të punësimit dhe aftësive; partneritetet me universitetet dhe ofruesit e teknologjisë; programet digjitale dhe të inovacionit të BE-së; kontributet e donatorëve për zhvillimin e aftësive dhe sipërmarrjen.
	6.1.3	**Qendra e Inovacionit të Trashëgimisë dhe Sipërmarrjes Krijuese**	13.125.000	17.343.750	21.562.500	25.781.250	30.000.000	Financimi dhe programet e BE-së (Creative Europe)

7.1 Lehtësimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe shkëmbimeve kulturore	**7.1.1**	**Marrëveshje bashkëpunimi**	21.875.000	28.906.250	35.937.500	42.968.750	-	Financimi dhe programet e BE-së (Creative Europe)
7.2 Ofrimi i mbështetjes për ndërkombëtarizimin e sipërmarrjeve krijuese	**7.2.1**	**Fondi për Festivalet dhe Panairet**	21.875.000	28.906.250	71.875.000	171.875.000	190.000.000	MTKS
	7.2.2	**Zyra e Mobilitetit dhe Projekteve**	87.500.000	115.625.000	143.750.000	171.875.000	190.000.000	Financim i drejtpërdrejtë i Ministrisë
	7.2.3	**Programi i Çmimeve Kombëtare të Arteve**	4.375.000	5.781.250	7.187.500	8.593.750	10.000.000	MTKS, bashkëfinancim me NJVV , programe të BE-së (Creative Europe, Horizon Europe, Interreg), sponsorizime private ose partneritete të Përgjegjësisë Sociale të Korporatave
8.1 Zvogëlimi i hendekut të mundësive midis prodhuesve dhe konsumatorëve kulturorë në zonat urbane dhe rurale	**8.1.1**	**Qendrat Kulturore si Qendra Krijuese**	87.500.000	144.531.250	179.687.500	214.843.750	250.000.000	MTKS, bashkefinancim me NJVV, programe të BE-së (Creative Europe, Horizon Europe, Interreg), sponsorizime private ose partneritete të Përgjegjësisë Sociale të Korporatave
	8.1.2	**Zhvillimi i muzeve të rinj në Shqipëri**	43.750.000	57.812.500	71.875.000	85.937.500	100.000.000	MTKS, bashkefinancim me NJVV, programe të BE-së (Creative Europe, Horizon Europe, Interreg), sponsorizime private ose partneritete të Përgjegjësisë Sociale të Korporatave
	8.1.3	**Ringjallja e Kullave Tradicionale në Veriun e Shqipërisë**	13.125.000	17.343.750	21.562.500	25.781.250	30.000.000	MTKS; Programet e BE-së (Creative Europe, IPA III, Horizon Europe); fondet e bashkëpunimit dypalësh; sponsorizimi dhe investimet private; skemat e granteve të bashkëfinancuara me bashkitë dhe partnerët rajonalë.
	8.1.4	**Programi Kombëtar i Artit Publik dhe Kulturës Urbane**	21.875.000	28.906.250	35.937.500	42.968.750	50.000.000	Buxheti Shtetëror (MTKS dhe Ministria e Financave) Ndihma teknike e BE-së (IPA III, Creative Europe) Programet e politikave kulturore

								të UNESCO-s dhe Këshillit të Evropës Partneritetet e sektorit privat dhe skemat e sponsorizimit
8.2 Forcimi i sistemit të prodhimit kulturor për të rritur kapacitetin dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të sektorit	**8.2.1**	**Përmirësimi i Infrastrukturës së Prodhimit Kulturor.**	875.000.000	1.156.250.000	1.006.250.000	859.375.000	950.000.000	MTKS; fondet kombëtare të transformimit digjital; programet digjitale dhe të inovacionit të BE-së; partneritetet me ofruesit e telekomunikacionit; mbështetja e donatorëve për infrastrukturën digjitale dhe ndërtimin e kapaciteteve.
	8.2.2	**Këshilli i artit**	30.625.000	40.468.750	143.750.000	171.875.000	200.000.000	MTKS; fondet kombëtare të transformimit digjital; programet digjitale dhe të turizmit të BE-së
8.3 Promovimi i zhvillimit dhe miratimit të zgjidhjeve teknologjike për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e organizatave	**8.3.1**	**Plani Kombëtar "Kultura e Ndërlidhur"**	21.875.000	17.343.750	21.562.500	25.781.250	30.000.000	MTKS dhe donatorët
	8.3.2	**VISIT AL. Mjete ndërveprimi për kulturën**	21.875.000	28.906.250	35.937.500	42.968.750	50.000.000	MTKS dhe donatorët
	8.3.3	**Parku i Artit – Kinostudio**	21.875.000	28.906.250	50.312.500	77.343.750	80.000.000	MTKS
	8.3.4	**"Culturalb", Platforma Kombëtare e Brandingut Kulturor dhe Promovimit Dixhital**	21.875.000	28.906.250	35.937.500	42.968.750	-	MTKS
8.4 Koordinimi i strategjisë së kulturës dhe strategjisë së turizmit	**8.4.1**	**Infrastruktura e Integruar Kulturore dhe Zhvillimi i Turizmit**	21.875.000	28.906.250	35.937.500	42.968.750	50.000.000	MTKS, Donatorë
9.1 Zbatimi i politikave që nxisin përfshirjen e minoriteteve, grave dhe personave me aftësi të kufizuara	**9.1.1**	**Grupi Kombëtar i Punës për Përfshirjen Kulturore**	13.125.000	17.343.750	21.562.500	25.781.250	30.000.000	MTKS, Donatorët
9.2 Zhvillimi i programeve kulturore që synojnë grupet vulnerabël	**9.2.1**	**Krijimtaria Gjithëpërfshirëse**	21.875.000	28.906.250	35.937.500	42.968.750	50.000.000	Fondet publike kombëtare (MTKS, buxhetete NJVV) Programet e bashkëpunimit kulturor të BE-së dhe ndërkombëtar (p.sh., Creative Europe, IPA, Grantet EEA)

								Partneritete me subjekte filantropike dhe të sektorit privat që mbështesin angazhimin qytetar sipas ligjit të sponsorizimit ose ndonjë ligji tjetër.
	9.2.2	**Karta Universale Vjetore e Hyrjes në Muze**	153.125.000	202.343.750	215.625.000	214.843.750	230.000.000	Fondet e Ministrisë
	9.2.3	**Programi Kombëtar i Promovimit të Leximit në Familje**	153.125.000	202.343.750	215.625.000	214.843.750	230.000.000	MTKS
9.3 Promovimi i pjesëmarrjes aktive në proceset kulturore nga të gjithë qytetarët	**9.3.1**	**Kështillat Bashkëlake të Pjesëmarrjes Kulturore**	21.875.000	28.906.250	35.937.500	42.968.750	50.000.000	MTKS, programet e BE-së (p.sh. Creative Europe)
9.4 Vlerësimi dhe monitorimi i efektivitetit të politikave gjithëpërfshirëse	**9.4.1**	**Sistemi i monitorimit të pjesëmarrjes kulturore**	21.875.000	28.906.250	35.937.500	42.968.750	50.000.000	MTKS
10.1 Lehtësimi i shkëmbimeve dhe bashkëpunimeve kulturore midis komuniteteve të ndryshme	**10.1.1**	**Javët Kulturore Ndërkombëtare**	30.625.000	40.468.750	50.312.500	60.156.250	70.000.000	MTKS (MTKS, Ministria e Arsimit), programet e BE-së (Creative Europe, Horizon Europe, IPA III), fondet e bashkëpunimit dypalësh (p.sh.,

								UNESCO, UNDP), sponsorizime private dhe programe të Përgjegjësisë Sociale të Korporatave (PSK).
	10.1.2	**Programi i Rezidencës "Urat Kulturore"**	21.875.000	28.906.250	35.937.500	42.968.750	50.000.000	MTKS; fondet kombëtare të trashëgimisë digjitale; partneritetet me Fondacionin Wikimedia; programet e bashkëpunimit të BE-së; financimi i donatorëve për pjesëmarrjen digjitale dhe nismat e njohurive të hapura
11.1 Ndërtimi i kornizës për institucionet kulturore në këtë fushë	**11.1.1**	**Programi i Ndërtimit të Kapaciteteve Gjithëpërfshirëse**	21.875.000	28.906.250	35.937.500	42.968.750	50.000.000	MTKS; Programet e BE-së (Erasmus+, Creative Europe); fondet e arsimit të UNESCO-s; nismat e Përgjegjësisë Sociale të Korporatave (PSK) të sektorit privat
11.2 Promovimi i aksesit universal dhe lëvizshmërisë inteligjente	**11.2.1**	**Programi "Kultura në lëvizje"**	30.625.000	40.468.750	64.687.500	77.343.750	80.000.000	MTKS, Ministria e Arsimit; Programet e BE-së (Erasmus+, Creative Europe, IPA III); financime bilaterale (i.e

								UNESCO, UNDP), sponsorizim privat dhe nismat e Përgjegjësisë Sociale të Korporatave (PSK) të sektorit privat
11.3 Promovimi i pjesëmarrjes së audiencës dhe mbledhjes së burimeve nga publiku për të zbatuar dokumentacionin digjital dhe inventarët e trashëgimisë kulturore shqiptare	**11.3.1**	**Sinergjitë mes Trashëgimisë së Hapur dhe GLAM**	30.625.000	40.468.750	64.687.500	77.343.750	80.000.000	MTKS; fondet kombëtare për trashëgiminë digjitale; partneritete me Wikimedia Foundation; programet e bashkëpunimit të BE-së; financim nga donatorët për pjesëmarrje digjitale dhe iniciativa të dijes së hapur
12.1 Integrimi i temave të përfshirjes dhe respektit kulturor në komunikim dhe në kurrikulat shkollore	**12.1.1**	**Laboratori i Kurrikulave Gjithëpërfshirëse**	21.875.000	28.906.250	35.937.500	42.968.750	50.000.000	MTKS; Programet e BE-së (Erasmus+, Creative Europe); fondet e arsimit të UNESCO-s; nismat e Përgjegjësisë Sociale të Korporatave (PSK) të sektorit privat
	12.1.2	**Rrjeti Kombëtar i Qendrave Kulturore për Fëmijë**	21.875.000	28.906.250	35.937.500	42.968.750	50.000.000	MTKS, Donatorë
	12.1.3	**Edukimi përmes Kulturës**	21.875.000	28.906.250	35.937.500	17.187.500	10.000.000	MTKS, Donatorë
TOTAL			**3.233.125.000**	**4.237.656.250**	**5.318.785.938**	**6.290.625.000**	**7.005.000.000**	

8.5 Masat prioritare dhe mbrojtja e strategjisë nga krizat

Për të garantuar vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2026–2030 në kushte fiskale ose të jashtme të pafavorshme, është identifikuar një hierarki veprimesh prioritare që duhet të mbrohen edhe në skenarë me kufizime buxhetore. Ky kuadër prioritarizimi synon të ruajë detyrimet ligjore të Shqipërisë, të mbrojë funksionet thelbësore institucionale dhe të garantojë nivele minimale të përfshirjes sociale dhe barazisë territoriale, duke lejuar njëkohësisht fleksibilitet në fazimin e masave transformuese dhe të orientuara drejt inovacionit.

Prioritete të panegociueshme (themeli ligjor dhe institucional)

Këto veprime lidhen me angazhimet ligjore ndërkombëtare të Shqipërisë dhe me funksionet minimale të nevojshme për të garantuar funksionimin e sistemit të qeverisjes kulturore. Ato duhet të mbështeten me financim të vazhdueshëm, përfshirë edhe në periudha krize fiskale, për të ruajtur integritetin dhe vazhdimësinë e institucioneve dhe shërbimeve kulturore.

Mbrojtja dhe konservimi i trashëgimisë:

- **Veprimi 1.1.1 Korniza e mbrojtjes së trashëgimisë:** Siguron përputhshmërinë me Konventën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, konventat evropiane mbi trashëgiminë arkeologjike dhe arkitektonike, dhe detyrimet ligjore kombëtare për mbrojtjen e monumenteve dhe vendeve.
- **Veprimi 1.2.1 Konservimi i adaptueshëm:** Trajton gatishmërinë urgjente ndaj rrezikut, qëndrueshmërinë klimatike dhe konservimin parandalues, veçanërisht për pasuritë Botërore (Butrinti, Berati, Gjirokastra, Liqeni i Ohrit) dhe vendet e mbrojtura kombëtarisht. Nënekzekutimi ose shtyrja e ndërhyrjeve të konservimit çon në humbje të pakthyeshme dhe dëmtim reputacioni ndërkombëtar.
- **Veprimi 1.3.1 Mbrojtja e TKJ-së**: Zbaton detyrimet sipas Konventës së UNESCO-s për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Jo-Materiale (ratifikuar në 2006), duke përfshirë inventarin, transmetimin dhe mbrojtjen e bazuar në komunitet.

Modernizimi dhe forcimi i ekosistemit të trashëgimisë:

- **Veprimi 2.1.1 Ndërtimi i kapaciteteve në të gjithë sektorin:** Trajton boshllëqet kronike të aftësive në konservim, menaxhim, dixhitalizim dhe menaxhim projekti, duke i mundësuar institucioneve të përmbushin standardet e BE-së dhe kërkesat e bashkëfinancimit.
- **Veprimi 2.2.1 Modernizimi i sistemit muzeor:** Forcon qeverisjen muzeore, standardet profesionale dhe kapacitetin e shërbimit publik, me ndikim të drejtpërdrejtë në pjesëmarrjen kulturore dhe turizmin.

Reforma ligjore dhe institucionale:

- **Veprimi 5.1.1 Korniza Ligjore (Statusi i Artistit):** Krijon bazën rregullatore dhe fiskale për operatorët profesionalë nw sektorin kulturor, duke krijuar parakushtin për skemat e mëvonshme të mbështetjes dhe harmonizimit me BE-në. Zbatimi parashikohet të intensifikohet gjatë viteve 2026–2027, me një rënie graduale të kostove pas fazës fillestare.
- **Veprimi 5.2.1 Reforma e Sistemit të Integruar të Granteve:** Modernizon proceset e alokimit të granteve, redukton fragmentimin dhe përmirëson aksesueshmërinë për skenën e pavarur dhe aktorët lokalë. Krijon një bazë për financim transparent, konkurrues dhe gjithëpërfshirës.

Forcimi i sistemit të prodhimit kulturor:

- **Veprimi 8.2.2 Këshilli i Artit për** të përmirësuar kapacitetin dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të sektorit.
- **Veprimi 5.4.1 Instrumenti i Garancisë së Investimeve Kulturore dhe 5.4.2 Engjëjt e Biznesit Kulturor dhe Rrjeti i Sipërmarrjeve:** Instrumente financiare që shfrytëzojnë kapitalin privat dhe angazhimin e sektorit bankar.
- **Veprimi 7.2.2 Zyra e Mobilitetit dhe Projekteve** për të strukturuar pjesëmarrjen e organizatave shqiptare në programet e BE-së

Pjesëmarrja komunitare dhe të drejtat kulturore:

- **Veprimi 9.1.1 Grupi Kombëtar i Punës për Përfshirjen Kulturore:** Koordinon politikat ndërsektoriale të përfshirjes për pakicat, gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet vulnerabël.
- **Veprimi 9.2.2 Karta Universale Vjetore e Hyrjes në Muze dhe 9.2.3 Programi Kombëtar i Promovimit të Leximit në Familje:** Skema pjesëmarrjeje masive me ndikim të lartë social dhe arsimor, veçanërisht në zona të pashërbyer.
- **Veprimi 8.1.1 Qendrat Kulturore si Qendra Krijuese:** Redukton hendekun kulturor urban-rural, duke ofruar infrastrukturë të decentralizuar për prodhim, pjesëmarrje dhe punësimi.

Shtojcat

Shtojcë I – Terma dhe Përkufizime

Aksesi dhe pjesëmarrja kulturore. Aksesi kulturor është e drejta e çdo individi dhe komuniteti për të patur qasje fizike, intelektuale dhe financiare në pasuritë e trashëgimisë, shërbimet e institucioneve kulturore dhe ofertat artistike, pa diskriminim dhe pa pengesa sociale, territoriale apo ekonomike. Sipas Nenit 3, pika 2 të Ligjit Nr. 27/2018, E drejta për akses në trashëgiminë kulturore përbën një mundësi për të përdorur vlerat kulturore, duke siguruar akses fizik ose intelektual ndaj tyre, pa i dëmtuar apo ekspozuar ato ndaj çdo rreziku. Pjesëmarrja kulturore e zgjeron këtë nocion drejt angazhimit aktiv: mundësia jo vetëm për të gëzuar kulturën, por për të kontribuar, bashkëprodhuar dhe ndikuar në formësinë e jetës kulturore të komunitetit. Garantimi i të dyja dimensioneve, aksesi dhe pjesëmarrja, mbetet objektiv strategjik transversal i kësaj strategjie.

Autonomia institucionale. Parimi sipas të cilit institucionet kulturore publike ushtrojnë funksionet e tyre artistike, programore dhe menaxheriale mbi bazë vendimmarrjeje të pavarur, të mbrojtur nga ndërhyrjet e pajustifikuara administrative ose politike. Autonomia institucionale nuk përjashton llogaridhënien publike; ajo kërkon mekanizma të qartë qeverisje, raportim periodik dhe performancë të bazuar në kritere transparente.

Bashkëmenaxhimi. Forma e qeverisjes kulturore në të cilën autoriteti publik dhe aktorë të tjerë (bashkësitë lokale, organizata të shoqërisë civile, entitete private ose diaspora) ushtrojnë funksione të përbashkëta vendimmarrëse dhe operative për menaxhimin e pasurive ose programeve kulturore. Bashkëmenaxhimi kërkon korniza ligjore dhe kontraktuale të qarta që përcaktojnë rolet, detyrimet dhe mekanizmat e koordinimit të secilit partner.

Decentralizimi kulturor. Procesi i transferimit të funksioneve planifikuese, buxhetore dhe operative të politikës kulturore nga institucionet qendrore drejt bashkive, institucioneve rajonale dhe aktorëve lokalë, me qëllim sigurimin e aksesit të barabartë në kulturë në të gjithë territorin kombëtar dhe mbështetjen e krijimtarisë jashtë qendrave urbane kryesore.

Dialogu ndërkulturor. Procesi i shkëmbimit të hapur dhe i mbështetur në respekt ndërmjet individëve dhe grupeve me prejardhje, tradita dhe identitete të ndryshme kulturore, i cili synon rritjen e mirëkuptimit të ndërsjelltë, bashkëjetesën demokratike dhe ndërtimin e hapësirave kulturore gjithëpërfshirëse. Dialogu ndërkulturor paraqet një nga objektivat thelbësorë të diplomacisë kulturore shqiptare.

Diplomacia kulturore. Tërësia e politikave, programeve dhe instrumenteve nëpërmjet të cilave shteti promovon vlerat, trashëgiminë dhe krijimtarinë kombëtare jashtë kufijve, duke nxitur dialogun ndërkulturor, forcuar imazhin e vendit dhe thelluar marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtarë. Diplomacia kulturore shërben njëkohësisht si faktor i pozicionimit strategjik të Shqipërisë në hapësirën kulturore evropiane dhe globale.

Të drejtat kulturore. Të drejtat e njeriut që garantojnë lirinë e çdo individi dhe komuniteti për të marrë pjesë në jetën kulturore, për të shprehur identitetin dhe trashëgiminë e vet, për të patur akses në arsim kulturor dhe krijimtari, si dhe për të kontribuar në prodhimin dhe interpretimin e vlerave kulturore. Të drejtat kulturore mbështeten në Konventën e UNESCO-s të vitit 2005 mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore.

Ekosistemi kulturor dhe krijues. Tërësia e aktorëve, institucioneve, proceseve dhe marrëdhënieve ndërvepruese (artistë, organizata kulturore, industri krijuese, institucione arsimore, treg, politikë publike, audiencë dhe infrastrukturë) që bashkëpunojnë dhe ndërveprojnë për prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin e kulturës. Ekosistemi kulturor funksionon si sistem i hapur, ku qëndrueshmëria e secilit komponent varet nga kohezioni i sistemit në tërësi.

Industritë kulturore dhe krijuese (IKK). Sektorët ekonomikë që kombinojnë krijimtarinë artistike dhe kulturore me prodhimin, shpërndarjen dhe tregtimin e mallrave e shërbimeve me vlerë simbolike dhe kulturore. IKK-të përfshijnë, ndër të tjera, kinematografinë, muzikën, artizanatin, botimin, dizajnin, arkitekturën, median digjitale, modën dhe artet pamore. Sipas UNESCO-s, këto industri ndërthurin dimensionin e identitetit kulturor me potencialin ekonomik, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe inovacionin.

Infrastruktura kulturore. Tërësia e objekteve, hapësirave dhe sistemeve materiale dhe digjitale (teatro, muze, galeri, biblioteka, arkiva, qendra kulturore, hapësira publike artistike dhe platforma të shërbimit kulturor) që mundësojnë prodhimin, prezantimin, aksesin dhe transmetimin e vlerave kulturore. Infrastruktura kulturore është parakusht themelor për funksionimin e qëndrueshëm të ekosistemit kulturor dhe për garantimin e aksesit të barabartë të qytetarëve në kulturë.

Monitorimi dhe vlerësimi. Sistemi i strukturuar i mbledhjes, analizës dhe interpretimit të të dhënave mbi zbatimin e politikave, programeve dhe veprimeve të strategjisë kulturore, me qëllim matjen e progresit drejt objektivave të përcaktuara, identifikimin e devijimeve dhe informimin e vendimmarrjes për ndërhyrje korrektuese. Monitorimi është proces i vazhdueshëm; vlerësimi kryhet në faza periodike dhe mbështetet në tregues të matshëm të paracaktuar.

Ndërmjetësimi kulturor. Praktika që ndërlidhin institucionet kulturore, trashëgiminë dhe publikun përmes interpretimit, edukimit, lehtësimit dhe dialogut.

Ndërtimi i kapaciteteve. Procesi sistematik i forcimit të njohurive, aftësive, burimeve njerëzore dhe strukturave organizative të institucioneve, aktorëve dhe profesionistëve kulturorë, me qëllim rritjen e efektivitetit të zbatimit të politikave kulturore. Ndërtimi i kapaciteteve përfshin trajnimin profesional, kualifikimin e vazhdueshëm, këshillimin institucional dhe shkëmbimin e praktikave të mira.

Ndërveprueshmëria digjitale. Kapaciteti i sistemeve dhe bazave të të dhënave digjitale të institucioneve kulturore për të komunikuar, shkëmbyer dhe interpretuar të dhëna në mënyrë të standardizuar, sipas protokolleve dhe standardeve të njohura ndërkombëtarisht. Ndërveprueshmëria digjitale është parakusht për integrimin e Shqipërisë në hapësirën kulturore digjitale evropiane dhe për aksesin e qëndrueshëm ndaj trashëgimisë së digjitalizuar.

Partneriteti publik-privat. Marrëveshja e strukturuar e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve publike dhe subjekteve private, nëpërmjet të cilës burimet, rreziqet dhe përfitimet ndahen me qëllim realizimin e investimeve, programeve ose shërbimeve kulturore. Partneriteti publik-privat kërkon transparencë në procedura, qartësi kontraktuale dhe mekanizma monitorimi që garantojnë interesin publik.

Pasuria kulturore jomateriale. Sipas Nenit 5, pika 41 e Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzet": vlerat kulturore jomateriale, praktikat, paraqitjet, shprehjet,
njohuritë, dijebërja, veglat, objektet, artefaktet e hapësirat kulturore që i krijojnë dhe bashkëshoqërojnë ato, të cilat, bashkësitë, grupet dhe individët i pranojnë si pjesë përbërëse të trashëgimisë së tyre kulturore. Ato krijohen dhe përcillen brez pas brezi, të ndikuara nga mjedisi e historia, të cilat u japin atyre identitet dhe vazhdimësi biokulturore.

Pasuria kulturore materiale. Sipas Nenit 5, pika 40 e Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzet": tërësia e pasurive të luajtshme e të paluajtshme që, sipas përcaktimeve të neneve 50 dhe 51, të këtij ligji, kanë interes artistik, historik, arkeologjik, arkitektonik, urbanistik, etnografik, arkivistik, bibliofilik, si dhe objekte të tjera, të përcaktuara ose parashikuara nga ligji si bartës të pasurive të qytetërimeve.

Peizazhi kulturor. Kategori e pasurisë kulturore që përfaqëson bashkëpunimin ndërmjet njeriut dhe natyrës, duke mishëruar vlera historike, artistike, etnografike ose ekologjike të njohura dhe të mbrojtura si trashëgimi. Peizazhet kulturore janë objekt i mbrojtjes specifike sipas Ligjit Nr. 27/2018 dhe i planeve të menaxhimit të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore.

Plan menaxhimi. Dokumenti strategjik dhe operativ që përcakton objektivat e ruajtjes, mbrojtjes, promovimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të një pasurie ose siti kulturor, duke caktuar masat, afatet, burimet dhe mekanizmat e monitorimit të nevojshëm për mbarëvajtjen e tij, në përputhje me standardet e UNESCO-s dhe legjislacionin kombëtar.

Politika kulturore. Tërësia e synimeve, parimeve dhe instrumenteve ligjore, financiare dhe organizative, si dhe mekanizmave të koordinimit, që qeveria dhe autoritetet publike vendosin për të orientuar, mbështetur dhe rregulluar veprimtarinë kulturore, ruajtjen e trashëgimisë, prodhimin krijues dhe pjesëmarrjen qytetare në kulturë. Politika kulturore ndërvepron me politikat e arsimit, turizmit, zhvillimit rajonal dhe integrimit evropian.

Qëndrueshmëria dhe menaxhimi i rreziqeve. Kapaciteti i sektorit kulturor, institucioneve dhe aktorëve përkatës për të parashikuar, zbutur dhe rigjeneruar pas rrisqeve të brendshme ose të jashtme – financiare, klimatike, politike ose të emergjencave – duke ruajtur vazhdimësinë e funksioneve thelbësore dhe aftësinë për t'u riorganizuar. Menaxhimi i rreziqeve kërkon analiza periodike rreziku, plane emergjence dhe mekanizma financiarë të posacëm.

Qeverisja kulturore. Sistemi i parimeve, strukturave, procedurave dhe marrëdhënieve nëpërmjet të cilave vendimmarrja për politikat, burimet dhe prioritetet kulturore ushtrohet, koordinohet dhe kontrollohet nga aktorë publikë, privatë dhe të shoqërisë civile. Qeverisja kulturore e mirë mbështetet në transparencë, meritokraci, llogaridhënie publike, decentralizim dhe pjesëmarrje të gjerë të palëve të interesit.

Rijetzimi. Procesi i rikuperimit dhe rikthimit në përdorim aktiv të pasurive kulturore të paluajtshme, duke kombinuar restaurimin fizik me funksionin e ri ekonomik, social ose kulturor, në mënyrë të harmonizuar me vlerat historike dhe arkitekturore të pasurisë. Rijetzimi, sipas Ligjit Nr. 27/2018, është instrument i veçantë ligjor i menaxhimit të trashëgimisë kulturore.

Sektori i pavarur artistik. Tërësia e organizatave, artistëve, grupeve kreative dhe shoqatave profesionale kulturore që veprojnë jashtë strukturës së institucioneve publike shtetërore, duke kontribuar me iniciativa artistike autonome, projekte inovative dhe shkëmbime kulturore. Sektori i pavarur është komponent thelbësor i ekosistemit kulturor dhe objekt i mbështetjes financiare publike nëpërmjet granteve dhe thirrjeve publike.

Statusi i artistit. Korniza ligjore, fiskale dhe sociale e njohjes të punës artistike dhe krijuese, e cila garanton kushte të drejta pune, mbrojtje sociale, akses në sigurime shoqërore dhe të drejta profesionale për artistët dhe profesionistët e kulturës,

pavarësisht nga forma e marrëdhënies së punës. Sipas kësaj strategjie, statusi i artistit nuk parashikohet si ligj i veçantë, por si kornizë ndërsektoriale legjislative e integruar në disa akte, duke harmonizuar legjislacionin për artin dhe kulturën, dispozitat fiskale dhe mbrojtjen sociale. Burimi ndërkombëtar kryesor i referencës është Rekomandimi i UNESCO-s i vitit 1980 mbi Statusin e Artistit, i përditësuar sipas standardeve aktuale të punës së denjë të BE-së.

Trashëgimia kulturore. Sipas Nenit 5, pika 59 e Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzet": tërësia e pasurive kulturore, materiale dhe jomateriale, të një individi, grupi ose shoqërie të trashëguar nga e kaluara që ruan në të tashmen, për t'u përçuar brezave në të ardhmen si pjesë pasurisë kombëtare të një vendi, të cilat shprehin vlerat identitetin, njohuritë, traditat, besimet, si dhe pasuritë kulturore të peizazhit.

Turizmi kulturor i qëndrueshëm. Forma e turizmit që synon vizitimin, interpretimin dhe gëzimin e pasurive dhe shprehjeve kulturore, në mënyrë të tillë që të garantojë integritetin e pasurive, të mbështesë ekonomitë lokale dhe të kontribuojë në ruajtjen e identitetit dhe trashëgimisë së komuniteteve pritëse për gjeneratat e ardhshme.

Tregues performance (indikator). Masë e matshme, sasiore ose cilësore, e paracaktuar në planin e zbatimit, nëpërmjet të cilit vlerësohet shkalla e arritjes së objektivave të strategjisë. Treguesit e performancës shërbejnë si bazë e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit dhe garantojnë llogaridhënien publike ndaj palëve të interesuara.

Vlerësimi i trashëgimisë. Sipas Nenit 5, pika 65 e Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzet": ushtrimi i funksioneve dhe veprimtarive që kanë për qëllim promovimin e zhvillimin e trashëgimisë kulturore, si dhe krijimin e kushteve më të mira për përdorimin dhe gëzimin publik të saj. Në lidhje me peizazhin kulturor, vlerësimi përfshin, gjithashtu, rikualifikimin e objekteve të paluajtshme dhe të hapësirave të vendosura në mbrojtje, të dëmtuara ose degraduara.

Zhvillimi i audiencave. Strategjia dhe tërësia e programeve institucionale që synojnë zgjerimin, diversifikimin dhe thellimin e marrëdhënies ndërmjet institucioneve kulturore dhe publikut, duke ulur barrierat e aksesit dhe duke ndërtuar komunitete të angazhuara aktive me artin dhe trashëgiminë. Zhvillimi i audiencave nuk kufizohet tek rritja numerike e vizitorëve ose spektatorëve, por përfshin edhe cilësinë e angazhimit, përfshirjen sociale dhe formimin e audiencave të reja duke filluar nga moshat e hershme.

Zhvillimi i qëndrueshëm kulturor. Modeli i zhvillimit të sektorit kulturor që plotëson nevojat e gjeneratës aktuale pa kompromotuar kapacitetin e gjeneratave të ardhshme për të gëzuar, ruajtur dhe zhvilluar trashëgiminë dhe krijimtarinë kulturore. Zhvillimi i qëndrueshëm kulturor integron dimensionin ekonomik, social dhe mjedisor, dhe mbështetet në parimet e Agjendës 2030 të OKB-së dhe Konventës së UNESCO-s të vitit 2005 mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore.

Bibliografia

Raporti Shqipëria 2025 që shoqëron dokumentin KOMUNIKIM NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN EVROPIAN, KËSHILLIN, KOMITETI EKONOMIK DHE SOCIAL EVROPIAN DHE KOMITETI I RAJONEVE Komunikata 2025 mbi politikën e zgjerimit të BE-së, https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf

Akademia E Shkencave E Shqipërisë, Konferenca Shkencore Mbarëkombëtare "Muzika Shqiptare Si Krijimtari, Interpretim, Muzikologji Dhe Edukim Artistik" Rekomandime, 30 Tetor 2025. E disponueshme në: https://www.vasiltole.com/wp-content/uploads/2025/10/rekomandime%20fund.pdf

Carta di Solfagnano - documento G7 Inclusione e Disabilità. E disponueshme në: https://disabilita.governo.it/it/carta-di-solfagnano/carta-di-solfagnano-solfagnano-charter-charte-de-solfagnano-carta-solfagnano/

Përmbledhje e Politikave dhe Trendeve Kulturore. (2025). Shqipëria: Profili i Vendit. fq. 5, 9.

Convenzione delle Nazioni Unite sui diritti delle persone con disbilità (Artikulli 30). Faqja zyrtare ONU. https://www.un.org/development/desa/disabilities/convention-on-the-rights-of-persons-with-disabilities/article-30-participation-in-cultural-life-recreation-leisure-and-sport.html

Këshilli i Evropës, Konventa e Faros mbi Vlerën e Trashëgimisë Kulturore për Shoqërinë (2005).

Referencë: Këshilli i Evropës. (2005). Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës mbi Vlerën e Trashëgimisë Kulturore për Shoqërinë (Konventa e Faros). E disponueshme në: https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=199

Këshilli i Evropës. (2005). Konventa Kornizë mbi Vlerën e Trashëgimisë Kulturore për Shoqërinë (CETS Nr. 199). Këshilli i Evropës. (Konventa e Faros). E disponueshme në: https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=199

Këshilli i Bashkimit Evropian (2022). Rezoluta e Këshillit mbi planin e punës së BE-së për kulturën 2023–2026 (2022/C 466/01). Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian. I aksesueshëm në: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32022G1207%2801%29&qid=1671635488811

Këshilli i Bashkimit Evropian. "Përfundime mbi Dialogun Ndërkulturor." Bruksel, 2008.

Culture Action Europe (2022). Dokument qëndrimi mbi kulturën, shëndetin dhe mirëqenien. Bruksel.

Dow, R., Warran, K., Letrondo, P., & Fancourt, D. (2023). Artet në politikat e shëndetit publik: Progresi dhe mundësitë. The Lancet Public Health, 8(2), e155–e160. I aksesueshëm në: https://doi.org/10.1016/S2468-2667(22)00313-9

Plani i Punës së Këshillit të BE-së për Kulturën 2019–2022.

Referencë: Këshilli i Bashkimit Evropian. (2018). Plani i Punës së Këshillit për Kulturën 2019-2022. I aksesueshëm në: https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-13948-2018-INIT/en/pdf

Programi i BE-së për Creative Europe.

Referencë: Komisioni Evropian. (2021). Creative Europe 2021-2027. Bruksel: Bashkimi Evropian. I aksesueshëm në: https://ec.europa.eu/culture/creative-europe

"Metoda e Hapur e Koordinimit" e Komisionit Evropian në politikën kulturore dhe Rekomandimi i UNESCO-s në lidhje me Mbrojtjen dhe Promovimin e Muzeve dhe Koleksioneve (2015).

Referencat: Komisioni Evropian. (2017). Grupi i Punës i Metodës së Hapur të Koordinimit (OMC) mbi rolin e arteve publike dhe institucioneve kulturore në promovimin e diversitetit kulturor dhe dialogut ndërkulturor. Bruksel: Bashkimi Evropian. I aksesueshëm në: https://ec.europa.eu/culture/sites/default/files/library/documents/2017-omc-report-promotion-diversity-dialogue_en.pdf

Komisioni Evropian (2024) Raporti i Shqyrtimit: Shqipëria – Grupi 3 (Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse). Bruksel: Komisioni Evropian.

Komisioni Evropian / Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm. "Drejt një strategjie të BE-së për marrëdhëniet kulturore ndërkombëtare", Bruksel, 2016; dhe komunikimi "Kultura në zemër të OZHQ-ve".

Komisioni Evropian, Korniza Evropiane për Veprim mbi Trashëgiminë Kulturore (2019).

Komisioni Evropian. (2019). Korniza Evropiane për Veprim mbi Trashëgiminë Kulturore. Bruksel: Bashkimi Evropian. I aksesueshëm në: https://ec.europa.eu/culture/document/european-framework-action-cultural-heritage_en

Komisioni Evropian. "Një agjendë e re evropiane për kulturën", Bruksel, 2018.

Komisioni Evropian. " Një agjendë e re evropiane për kulturën" Bruksel, 2018.

Komisioni Evropian. "Programi 'Creative Europe 2021–2027'." Bruksel.

Komisioni Evropian. "Programi 'Europe for Citizens 2014-2020'." Bruksel.

Komisioni Evropian. "Dokumenti i Gjelbër i Trashëgimisë Kulturore Evropiane", 2019.

Komisioni Evropian. "Dokumenti i Gjelbër – Trashëgimia Kulturore Evropiane: Një Burim për Evropën." Bruksel, 2019.

Komisioni Evropian. "Horizon Europe – Programi Kornizë për Kërkim dhe Inovacion." Bruksel.

Komisioni Evropian. "Misionet Horizon Europe." Bruksel.

Komisioni Evropian. "Rregullorja (BE) nr. 234/2014 që krijon një Instrument Partneriteti për bashkëpunim me vendet e treta." Bruksel.

Komisioni Evropian. (2018). Një agjendë e re evropiane për kulturën. Bruksel: Bashkimi Evropian.

I aksesueshëm në: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=COM:2018:267:FIN

Komisioni Evropian. (2018). Një agjendë e re evropiane për kulturën. Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian. I aksesueshëm në: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1527241001038&uri=COM:2018:267:FIN

Komisioni Evropian. (2018). Kompetencat kryesore për mësimin gjatë gjithë jetës.

I aksesueshëm në: https://data.europa.eu/doi/10.2766/565566

Komisioni Evropian. Drejtoria e Përgjithshme për Arsim, Rini, Sport dhe Kulturë & ECORYS. (2023). Kultura dhe demokracia, provat: Si rrit angazhimin qytetar, demokracinë dhe kohezionin social pjesëmarrja e qytetarëve në aktivitetet kulturore: mësime nga kërkimet ndërkombëtare. Zyra e Publikimeve. I aksesueshëm në: https://data.europa.eu/doi/10.2766/39199

European Museums Academy's Situation for Museums in Europe Report 2024.Available at: https://europeanmuseumacademy.eu/wp-content/uploads/2025/02/250217-EMA-European-Museum-Report-2024-final.pdf

Fancourt, D., & Finn, S. (2019). Cilat janë provat mbi rolin e arteve në përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies? Një rishikim i fushëveprimit (Raporti sintetik nr. 67 i Rrjetit të Dëshmive Shëndetësore (HEN). Zyra Rajonale e OBSH-së për Evropën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë. I aksesueshëm në: http://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK553773/

Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara (FAO); Organizata Botërore për Shëndetin e Kafshëve (OIE); Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) (2008). Kontributi në Një Botë, Një Shëndet: Një Kornizë Strategjike për Zvogëlimin e Rreziqeve të Sëmundjeve Infektive në Ndërfaqen Kafshë-Njeri-Ekosisteme. I aksesueshëm në: https://www.fao.org/4/aj137e/aj137e00.pdf?utm

Gonxhja, B. (2025). Fjalim në Konferencën e Turizmit në Fund Sezoni. Tiranë, 4 shtator 2025. I aksesueshëm në: https://youtu.be/q_m-6egchgY?si=JGHQFItX_JioiMWv (Qasja: 12 shtator 2025).

IKTK – Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore. (2020). Raporti Vjetor 2020. Tiranë.

IKTK – Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore. (2021). Raporti Vjetor 2021. Tiranë.

IKTK – Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore. (2022). Raporti Vjetor 2022. Tiranë.

IKTK – Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore. (2023–2024). Listat e Pasurive Kulturore dhe zonave të mbrojtura sipas qarqeve. I aksesueshëm në: https://iktk.gov.al/site/pasuri-kulturore

IKTK – Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore. (2023). Raporti Vjetor 2023. Tiranë.

IKTK – Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore. (2024). Raporti Vjetor 2024. Tiranë.

